



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



BULETINI

VJETOR-2014

ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Malishevë, 2014



Përmbajtja:

Kryetari Begaj për Vit të Ri, ka vizituar të gjitha shërbimet kujdestare dhe të rendit.....	16
Kryetari Begaj takoi Shoqatën e të Verbërve të Kosovës	16
Opozita braktisi seancën, shtyhet zgjedhja e kryesuesit të Asamblesë.....	17
Begaj priti komandantin e jugut të KFOR-it, kolonelin Topaloğlu	18
Përsëri shtyhet mbledhja e KK-së	18
Shkarkohen drejtorët e drejtorive	19
Përsëri ndërpritet mbledhja e parë e rregullt e KK-së	19
Begaj formoi qeverinë komunale të Malishevës	20
Rexhep Mazreku emërohet nënkryetar i komunës së Malishevës.....	21
U mbajt mbledhja e parë e qeverisë së re komunale	22
Shkolla në Damanek, do të përfundoj brenda 18 muajve	22
Begaj e Basha bisedojnë për menaxhimin e mbeturinave.....	23
U mbajt mbledhja e dytë e Këshillit të Drejtorëve	24
Komuna do ta mbështes Handikos-in edhe në vitin 2014.....	25
Këshilli i Drejtorëve do të takohet çdo të hënë nga ora 8:30.....	25
Kryetari Begaj, priti pjesëtarët e LMT-së (KFOR) në Malishevë.....	26
Caritas Kosova dhe Komuna do të vazhdojnë mbështetjen në shëndetësi.....	27
Komuna dhe UNHABITAT-i do të vazhdojnë me fazat e mëtutjeshme për PZHK-në	27
Evropianët e rinj kërkojnë fuqizimin e rinisë në Malishevë.....	28
Enver Hoti kryesuesi i Kuvendit të Komunës	29
Gjatë viti 2013, 10.17 % më shumë të hyra nga tatimi në pronë	30
Këshilli i Drejtorëve mbajti mbledhjen e rregullt të së hënës	30
Përkujtohen Ali Kryeziu e Hysni Mazreku	31
Kryetari Begaj, priti pjesëtarët e LMT-së (KFOR) në Malishevë.....	34
Shpaloset Plani i Veprimit të Strategjisë për parandalimin e Etheve Hemorragjike	35
Këshilli i Drejtorëve, mbajti mbledhjen e rregullt.....	38
Kryetari Begaj, priti drejtoreshën rajonale të OSBE-së, Sara Bonotti.....	38
Kuvendi i Komunës formoi komitetet obligative	39
Regjistrohet rasti i parë i thumbit nga rriqrat në vitin 2014.....	40
Kryetari Begaj, takoi drejtuesit e QKMF-së.....	41
Finalet e Ipko Kupa e Kosovës në basketboll do të mbahen në Malishevë	42



Kryetari Begaj, priti përfaqësuesit e Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve	43
Mbeturinat dhe kanalizimi, problemet kryesore në Marali.....	43
Kryetari Begaj priti kryetarin e Mamushës Arif Bütüç	45
Policia dhe drejtorja e arsimit mbajnë ligjëratat në shkollë për sigurinë	46
Kryetari Begaj, takoi banorët e Llapqevës dhe Panorcit.....	47
Kryetari priti palët	48
Me nderime varroset veterani i luftës së UÇK-së, Sahit Thaçi.....	49
Malisheva, shënoi gjashtë vjetorin e Pavarësisë	50
Kryetari Begaj dhe KFOR-i biseduan për bashkëpunim kundër etheve hemorragjike	53
PZHK prezantoi projektin për zgjerimin e urës në qytet.....	53
Kryetari Begaj, takoi banorët e Damanekut, Bublilit dhe Qupevës	55
Pensionistët takuan kryetarin	56
Kryetari Begaj priti zyrtarët e Ministrisë e Forcës së Sigurisë të Kosovës	56
Malisheva dhe Suhareka shkëmbejnë përvojat në fushën e Informimit Publik	57
Kryetari Begaj vazhdon vizitat nëpër fshatra	58
Kryetari Begaj, priti palët	59
U mbajt mbledhja e rregullt e qeverisë komunale	60
Kryetari Begaj, priti komandantin e jugut të KFOR-it, kolonelin Topaloğlu.....	61
Blerina Mazreku kryetare e KVRL në Malishevë	62
Kryetari Begaj, priti përfaqësuesit e MPB-së	62
Komuna vazhdon takimet me qytetar	63
Konstituohet komiteti për komunitete në Malishevë	65
“The Dreamers” garon në 12 festivale.....	66
Malisheva bëhet me kujdestari të barnatoreve, 24 orë	66
Kryetari Begaj, vizitoi bibliotekën e qytetit.....	67
Komuna dhe Caritas Kosova vazhdojnë projektin për pakujdesjen shëndetësore.....	68
Furnizimi me ujë në Malishevë i plotë	70
KPF në mbledhjen e parë të saj, i bëri 10 rekomandime për KK	70
Kryetari Begaj, bisedoi me institucionet shëndetësore për ethet hemorragjike	71
Malisheva po shënon “Epopenë e UÇK-së”	72
KK në Malishevë, mbajti seancë solemne për nderë të “Epopesë së UÇK”-së.....	73
Bashkësia Islame në Malishevë, shënoi manifestimin “Epopëja e UÇK”-së	76



U shënua Dita e Mësuesit	77
Ka vazhduar realizimi i projekteve në infrastrukturë.....	78
Begaj takoi Sindikatën e Shëndetësisë së Kosovës	79
Komuna dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ndajnë 700 mijë euro për ujëmbledhësin në Senik .80	
Uji për pije dhe një pjesë e kanalizimit, shqetësimet kryesore të Drenocit	81
U mbajt tribuna profesionale për ethet hemorragjike	83
Prilli muaji i pastrimit të ambientit	84
Kryetari Begaj inspektoi punimet në disa projekte.....	84
Mbahet ligjëratë për parandalimin e etheve hemorragjike, me nxënësit e Qendrës së Kompetencës	85
Kryetari Begaj, takoi banorët e fshatit Vërmicë.....	86
Guncat me shumë nevoja emergjente.....	87
Kryetari Begaj prezantoi qeverinë dhe programin e tij, para anëtarëve të KK-së	88
Java që shkoi me shumë zjarre në malet e Malishevës	90
Bizneset në Malishevë, lirohen nga taksat komunale	90
U varros me nderime veterani i luftës Atdhe Hoti.....	91
Për here të parë, pas 100 viteve u kujtua “Kryengritja e Banjës”	93
Nesër fillon muaji i pastrimit në Komunën e Malishevës	94
Begaj e Ibishi, biseduan për koordinimin kundër etheve hemorragjike.....	95
U përkujtuan të vrarët në masakrën Burimit.....	96
Kryetari Begaj, priti përfaqësuesit e UNMIK-ut	97
Kanalizimi dhe ujësjellësi nevoja emergjente për Bubavecin dhe Kijevën	97
Filloi muaji i pastrimit në Malishevë	100
Ministria e Mjedisit, kërkon mbrojtjen e monumenteve natyrore	101
Në Drenoc, u prezantua projekti ideor i ujësjellësit	102
Djegia e gomave për furrat e gëlqeres problemi kryesor për Bardhin	102
Seminar për rritjen e bashkëpunimit mes KKSB-së, KLSP-së dhe Policisë	104
Begaj priti, zyrtarët e LMT-së.....	105
QMF e Kijvës, prej tani punon në dy ndërrime	106
Vazhdon aksioni i pastrimit të ambientit.....	107
Komiteti për Komunitete, mbajti mbledhjen e dytë.....	107
Kryetari Begaj priti përfaqësuesen e Këshillit të Evropës	108



Dita e shëndetësisë, u organizua në Malishevë.....	109
Vazhdon aksioni i pastrimit në Komunën e Malishevës	110
Begaj: Për 100 ditë, kemi zvogëluar shpenzimet dhe kemi rritur aktivitetet	111
KKSB mbajti takimin e parë të punës.....	113
Ministria e Shëndetësisë, ndihmon QKMF-në me një autoambulancë.....	114
Drejtoria e bujqësisë në përkrahje të fermerëve	114
Kryetari u takua me zyrtarët e IRSHP-së.....	115
Krasniqi: Taksat komunal për biznese, lloji i “haraqit”	116
RTV21 fitues i TEB Kupës së Kosovës në basketboll për junior.....	118
Këtë javë pritet të filloj spërkatja kundër rriqrave	119
KPF mbajti mbledhjen e dytë.....	120
Bora në Malishevë, përcillet me dëme	120
Begaj: Premtoj vazhdimin e përkrahjes për organizatën e pensionistëve	121
Begaj: Komuna e Malishevës, do të jetë e para, që do ta zhduk korrupsionin	122
HAI në ndihmë të fëmijëve jetim	126
Begaj priti përfaqësuesit e OJQ “Jesus Christ”.....	126
Komuna do ta ndihmoj familjen Gegaj, për ndërtimin e shtëpisë së djegur.....	127
Begaj: Korrupsioni nuk do të përmendet në Komunën e Malishevës	128
Begaj takoi banorët e Kërvasarisë dhe Pagarushës	129
Vërshime të mëdha nga uji, në lagjen e Gurit në Malishevë.....	130
Begaj takoi banorët e Bellanicës dhe Temeqinës	131
Kryetari Begaj dhe familjet e të pagjeturve, morën pjesë në shënimin e ditës së të zhdukurve ...	132
Së shpejti do të vlerësohen dëmet e nga vërshimet	132
Disa projekte janë duke u realizuar në Komunën e Malishevës.....	133
Lendrit Jonuzaj, merr pjesë në olimpiadën botërore të biologjisë.....	134
Bashkatdhetarët ndihmojnë sportin malishevas.....	135
Komuna e Malishevës, merr vendim për mbrojtjen e vlerave të natyrës	136
Fitues të krosit pranveror në Malishevë, Florian Begaj dhe Mihrie Bacaliu	137
Komuna përkrahë shoqatën “Gratë e vyera”, në ndërtimin e dy serrave.....	139
Begaj takoi banorët e Fshatit të Ri, Berishës dhe Tërpezës.....	139
Kryetari Begaj, nderoi dëshmorët e fshatit Kleçkë	140
Spërkatja kundër rriqrave, filloi një ditë para planifikimit.....	141



Këtë javë fillojnë të realizohen edhe disa projekte	142
Kryetari Begaj u takua me drejtoreshën e zyrës rajonale të OSBE-së	142
KK formoi katër komitete jo obligative	143
U shënuar 10 vjetori i ditës së shkollës në Turjakë	144
Komuna mbështet shoqatën e shurdhë-memecëve në Malishevë	145
Filloi spërkatja kundër rriqrave në Senik	145
Begaj, mori pjesë në shënimin e katër ditëve të shkollave dhe përkujtime për dëshmorët.....	146
Malisheva, për herë të parë do të bëhet me çerdhe për fëmijë	147
Kryetari Begaj, bisedoi me zyrtarët e Hidroregjionit për rritjen e kapaciteteve të ujit	148
Lendrit Jonuzaj, zë vendin e tretë në olimpiadën botërore të biologjisë	149
KKSB: Malisheva vazhdon të jetë komuna më e sigurt.....	149
Përfundon spërkatja kundër rriqrave në Banjë dhe nesër vazhdon në Malishevë	150
Komiteti për komunitete zgjodhi nënkryetarin e saj	151
MASHT dhe GIZ, në përkrahje të rritjes së nivelit në arsimin profesional në Malishevë	151
Filloi ndërtimi i shkollës në Gollubovc	152
SHMU “I.Mazreku” fituese e garave të futbollit në nivel të shkollave	153
KDI me vlerësim pozitiv për punën e Komunës së Malishevës	154
Malisheva dhe Suhareka nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi në sport.....	154
Drejtorja e arsimit organizoi koncert për maturantët e Malishevës	155
Malisheva shpalli fermerët më të mirë të vitit	156
Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e tretë të radhës	157
Banorët e Bubavecit kërkuar ndihmën e kryetarit për mosprivatizim të pronave	158
Po zhvillohen një varg projektesh në Malishevë	158
Filloi ndërtimi i shkollës në Gurishtë.....	159
Tri komitete dhe komisioni për emërtimin e rrugëve zgjedhin kryesuesit e tyre	160
Në Vërmicë filloi hapja e rrugës, ndërsa në Gollubovc asfaltimi	161
Kryetari Begaj, mori pjesë në ceremoninë e nderimit të Fatmir Limajt me titullin “Doctor Honoris Causa”	162
Banja dhe Tërpeza shënuar ditët e shkollave të tyre	163
Filloi ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Drenoc	163
Kryetari Begaj, i shikoi nga afër realizimin e katër projekteve	164
Filloi ndërtimi i rrugës Bellanicë-Bardh.....	165



Edhe Malisheva i bashkohet aksionit “Ta pastrojmë Kosovën”	166
Deri më tani, janë spërkatur rreth 1660 hektar hapësirë kundër rriqrave.....	166
KK formoi Këshillin Organizativ për shënimin e 16 Qershorit.....	167
Anëtarët e KK të Malishevës, bojkotojnë mbledhjen, kërkojnë rritjen e pagave dhe trajtim më të mirë	168
Komuna dhe MAPL financojnë ndërtimin e kanalizimit Banjë-Bellanicë.....	169
Topa futbollit për fëmijët në Ploçicë	169
Filloi asfaltimi i rrugës në Guncat.....	170
Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e UN-HABITAT-it	171
Funksionalizohet komiteti për shëndetësi.....	171
Asfaltohen edhe tri rrugë në Bellanicë	172
Kryetari Begaj refuzon ftesën e AKP-së dhe kundërshton privatizimin e pronave.....	173
Begaj e Hulaj, biseduan për situatën nga thumbimi i rriqrave	175
Komisioni për emërtimin e rrugëve, takohet me kryetarët e fshatrave.....	175
Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e parë	176
Qendra e Kompetencës shënon katër vjetorin e saj.....	177
Filloi ndërtimi i shkollës në Damanek	178
U ndërtua edhe një rrugë në Lumnishtë.....	179
Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e parë	179
U zbulua memoriali për varrezat e veteranëve të UÇK-së.....	180
Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e dytë	183
U varros veterani i luftës Mazllum Krasniqi	183
Asfaltohet rruga e Fshatit të Ri	184
KO për shënimin e 16 Qershorit, caktoi agjendën	185
Filloi asfaltimi i rrugës Bardh-Bellanicë.....	185
Begaj, priti kolonelin turk Topaloğlu.....	186
Filloi asfaltimi i një rruge në fshatin Turjakë.....	187
Kryetari priti palët	188
Filloi asfaltimi edhe i një rruge në Gurbardh	188
Punëtorët e kompanisë “Beni” ankohen të kryetari, pasi nuk kanë marrë pagat e muajit të kaluar	189
KO për 16 Qershorin, mbajti takimin e radhës	190



KK i Malishevës, vendosi për çmimet tradicionale të 16 Qershorit	190
Kryetari Begaj priti monitoruesit e BE-së për zgjedhjet.....	191
U mbajt testi i maturës në Malishevë	191
Sot u zhvilluan disa aktivitete për në kuadër të shënimit të 16 Qershorit	192
Vazhdojnë aktivitetet në kuadër të shënimeve për 16 Qershorin.....	193
Malisheva po shënon Ditën e Çlirimit.....	193
Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e rregullt.....	195
Komiteti për komunitete takoi komandën e stacionit policor në Malishevë	196
Ka filluar dezinfektimi i stallave	196
Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e KFOR-it zviceran (LMT).....	197
U mbajt punëtorja “Të drejtat e viktimave në sistemin e drejtësisë”	197
“Tourtaste-Turizimi dhe Shija” prezantohet në Malishevë me ushqimet tradicionale	198
Vazhdon spërkatja kundër rriqrave në Llapqevë	199
Situata me ethe hemorragjike e qetë dhe nën kontroll	199
Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e radhës.....	200
Punimet në ujësjellësin e Drenocit po vazhdojnë sipas planit.....	200
Komuna ndihmon bletarët vendas	201
Kryetari Begaj, mbajti takimin e parë publik me qytetar.....	201
Asambleja Komunale e Malishevës nuk e miraton qarkoren e parë buxhetore	203
Filloi spërkatja nga ajri kundër rriqrave	204
Kryetari Begaj i falënderon të gjithë që po merren me spërkatjen kundër rriqrave dhe reagon ndaj mos miratimit të qarkores së parë buxhetore.....	205
Sot përfundoi spërkatja nga ajri kundër rriqrave	208
Filloi zgjerim i urës kryesore në Malishevë	209
Kryetari Begaj, në përkrahje të rinisë së Malishevës.....	210
Nga e hëna fillon dezinfektimi i bagëtisë.....	210
Nga Mbledhja e Këshillit të Drejtorëve.....	211
Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e gjashtë të radhës.....	212
Kanë filluar korrje-shirjet në Malishevë.....	212
Marrëveshje mes Komunës dhe MASHT-it për rritjen e cilësisë në mësimin profesional	213
Kryetari Begaj inspektoi punimet e fazës së dytë të ujësjellësit në Drenoc	214
Ekipi i futbollit U11 KF “Malisheva” kampion në Turnirin Ndërkombëtar në Shqipëri	214



Komiteti për Arsim mbajti mbledhjen e tretë të radhës	215
Kryetari Begaj inspektoi disa punime të projekteve	215
Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e OJQ “Jesus Krishti”	216
Kryetari priti palët	216
Thumbimi nga rriqrat në rënie.....	217
Edhe Malisheva i bashkohet thirrjes për drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës	218
Kryetari Begaj vizitoi një shpezëtarë që merret me rritjen e zogjve	218
Begaj e Tahiri, ju bëjnë thirrje malishevasve ta nënshkruajnë peticionin	219
KK miratoi rishikim e buxhetit dhe kornizën afatmesme buxhetore 2015-2017.....	220
Kryetari Begaj priti komandanti turk Topaloğlu.....	220
Malisheva në përgatitje të festivalit folklorik	221
Largohen nga tregu 412 kg djathë	222
Kryetari Begaj, shtroi iftarin tradicional për familjet e dëshmorëve	223
Filloi rregullimi i dy rrugëve në fshatrat e Malishevës.....	224
Komiteti për Planifikim urban, kadastër, mbrojtje të mjedisit, turizëm dhe monitorim të projekteve publike hartoi planin e punës	225
U zbulua busti i dëshmorit Ruzhdi Gjyliqi	225
Asambleja Komunale miratoi emërtimin e të gjitha rrugëve	226
Kryetari Begaj takoi bizneset e Malishevës.....	227
Malisheva e treta në vend për realizimin e të hyrave vetanake për 2014	228
Shi e breshër në Malishevë, i përcjellë me dëme	229
Kryetari Begaj i uron të gjithë qytetarët me rastin e Fitër Bajramit	230
Dëme të mëdha nga breshëri i së premtes.....	230
Begaj priti çiftin Nelson, donator në ujësjellësin e Drenovcit.....	231
Komiteti për shëndetësi mbajti mbledhjen e dytë të radhës	232
U hap panairi artizanal në Malishevë	234
Përfundoi nata e parë e festivalit “Oda e Llapushës”	234
Përfundoi festivali “Oda e Llapushës”, fitues SHKA “Shote Galica” dhe bijtë e SefëMleqanit	235
Këtë vit asnjë rast me vdekje nga ethet hemorragjike	236
Kryetari Begaj takoi përfaqësuesit e UNHABITAT-it	237
Filloi ndërtimi i shkollës në Carrallukë	238
Pritet rehabilitimi i nëntë ujësjellësve në Malishevë.....	239



Nga Mbledhja e Këshillit të Drejtorëve.....	240
Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e KFOR-it zviceran	240
Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e rregullt.....	241
AAK dhe Komuna nënshkruan marrëveshje për regjistrimin e pronave	242
Filloi asfaltim i rrugëve në Pllloqicë	242
Qarkorja e dytë buxhetore, minus 600 mijë euro në investime kapitale	243
Komuna dhe Kryqi i Kuq i Kosovës, vazhdojnë bashkëpunimin e mirë	244
Inspektorët komunal largojnë ndërtimin pa leje mbi “Tumën ilire”	245
OSBE do të përkrah komunën në punëtorinë për hartimin e buxhetit	246
Me gjithë fluksin e madh, shërbimet komunale kanë qenë në nivel.....	247
Përkujtohet dëshmorët e Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova”	248
K i Malishevës mori dy vendime dhe miratoi disa raporte	248
Komiteti i arsimit i uron fillimin e vitit të ri shkollor	249
U mbajt Kampi Rinor dy ditor në malet e Berishës.....	250
U mbajt punëtorja për hartimin e buxhetit komunal	251
Begaj: Asnjë person nuk është larguar për bindje politike	254
Kryetari Begaj, i uron nxënësit për fillimin e vitit të ri shkollor.....	255
Kryetari Begaj, priti nënkolonelin Mogoliq	255
Projekt buxheti për vitet 2015-2017 i gatshëm	256
Po vazhdon fushata e repelimit të kafshëve.....	257
Përkujtohen viktimat e 11 shtatorit.....	258
Përfundoi seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës	258
Largohen reklamat pa leje në hapësirat publike	259
Në Malishevë po shënohet Dita e Rinisë	260
Janë hequr reklamat pa leje në qytet	260
Dhurohen 15 ari truall për ndërtimin e kullës për Tahir Berishën.....	261
U mbajt mbledhja e tetë të radhës e KPF-së.....	262
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, mbajti mbledhjen e pestë.....	262
14 raste të dyshuara me “Gjuha e kaltër”	263
Begaj priti ambasadorin Minxhozi	264
Kryetari Begaj ka vizituar panairin e produkteve bujqësore.....	265
Asfaltohen tri rrugë në Tërpezë	265



Kryetari Begaj mori pjesë në hapjen e panairit ndërkombëtar “Agrobiznesi 2014” në Tiranë	266
Artefakti i gjetur në Banjë shkon për studim në institutin arkeologjik.....	267
KK shpalli zgjedhjet për zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave të Malishevës	267
Kryetari Begaj, inspektoi punimet në katër rrugë.....	268
Filloi asfaltimi edhe i 1.5 km rrugë në Llapqevë	269
Begaj kërkon përgjegjësi për projektet e papërfunduara.....	270
Kuvendi i Komunës diskutoi për gjendjen në arsim.....	271
KK i Malishevës miratoi buxhetin për vitin e ardhshëm	272
Përkujtohet dr.Shpëtim Robaj, në 16 vjetorin e rënies	273
GLV prezantoi projektin “Eko Llapusha”	274
U përrua fusha e sportit në shkollën e Panorcit.....	276
Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e KFOR-it zviceran (LMT).....	277
Kryetari Begaj uron të gjithë qytetarët me rastin e festës së Kurban Bajramit.....	278
Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me rastin e festës së Kurban Bajramit uron të gjithë besimtarët e besimit islam. “Në emër të Komunës së Malishevës dhe emrin tim personal, i uroi të gjithë qytetarët e Malishevës, me rastin e festës së Kurban Bajramit. Në këtë ditë feste për të gjithë besimtarët myslimanë, le të mbizotërojë solidariteti, paqja, toleranca dhe respekti. Nën frymën e kësaj feste të bekuar, të vazhdojmë të kultivojmë vlerat tona kombëtare dhe fetare, për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për gjeneratat që vijnë pas”	278
Kryetari priti palët	278
KKSB në Malishevë, dënon të gjitha llojet e shprehjes së ekstremizmit	279
Komiteti për komunitete mbajti takimin e rregullt	280
Begaj takoi amerikanët që ndihmuan ndërtimin e ujësjellësit për Drenovc	280
Homazhe në Fushë-Arrëz për maturantët e Malishevës	281
Komisioni për organizimin e zgjedhjeve në fshatra, filloi punën.....	282
10 vjet nga humbja e jetës së 15 maturantëve gjimnazist të Malishevës	282
GLV organizoi debat për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal	285
Komiteti për shëndetësi jep rekomandime për debat në KK.....	286
Komisioni për zgjedhje në fshatra, hartoi planin e punës	286
Projektet kapitale në fazën përfundimtare	287
Komiteti për diasporë kërkon zyre për bashkatdhetarët	287
Ligjëratë për pasojat e përdorimit të narkotikëve.....	288
KPF mbajti mbledhjen e nëntë.....	289



Nga java e ardhshme fillon rindërtimi i kadastrit në Malishevë	289
Zgjedhjet në fshatrat e Malishevës fillojnë me 3 nëntor	290
Asfaltohen disa rrugë në fshatin Shkozë.....	291
Begaj, takoi kryetarin dhe prefektin e Orhangazit.....	292
Shtrohen rrugët në fshatin Janqisht	293
Vazhdojnë ligjëratat kundër përdorimit të narkotikëve	293
Delegacioni nga Malisheva, vizitoi Bursën.....	294
Komuniteti RAE i integruar në shoqëri	295
Malisheva pjesë e festimit të Ditës së Republikës së Turqisë.....	296
Biznesmeni Hoxha nga Stambolli, pritet që shpejt të sjellë një filial të fabrikës në Malishevë.....	297
KK i Malishevës, miratoi statutin e Komunës	297
Po vazhdojnë projektet për ndërtimin e infrastrukturës.....	300
Kanë filluar zgjedhjet në fshatrat e Malishevës.....	301
Begaj priti drejtuesin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK).....	301
Për këtë vjeshtë pritet të mbillen 3 722 hektar me grurë në Malishevë.....	302
Përfundojnë zgjedhjet edhe në katër fshatra	302
Kryetari i Tropojës, Kortoçi vizitoi Malishevën	303
Shtrohen disa rrugë në Bubavec.....	304
Kryetari Begaj, vizitoi familje e Gegaj, së cilës i është rindërtuar shtëpia	304
Kryetari i Komunës, viziton shkollat në prag të fillimit të dimrit	305
Komandanti i kontingjentit gjerman të KFOR-it, vizitoi Malishevën.....	306
Kryetari Begaj priti palët	Error! Bookmark not defined.
Vazhdojnë investimet kapitale dhe përkrahja për bujqit	306
Kryetari Begaj, priti përfaqësuesin e UN HABITAT-it në Kosovë.....	307
Mbyllen 12 lokale të lojërave të fatit.....	308
Kryetari Begaj, vizitoi tetë shkolla.....	308
Kryetari Begaj priti komandantit e kontingjentit turk të KFOR-it kolonelin Demircioğlu	309
Begaj u takua me ambasadoren e Turqisë, Ozan.....	310
Kryetari Begaj vizitoi disa shkolla dhe inspektoi disa punime	310
KPF mbajti mbledhjen e dhjetë të radhës.....	311
Banorët e Bardhit të shqetësuar nga përdorimi i gomave për djegie	312
Punëtorët e Komunës së Malishevë në ndihmë të 14 vjeçarit Ilir Berisha	312



Filloi ndërtimi i shkollës në Bubavec.....	313
Asfaltohet edhe një rrugë në Astrazup.....	314
Komuna përmirëson kushtet e punës për zjarrfikësit	315
Komiteti për arsim mbajti mbledhjen e shtatë të radhës.....	316
Filloi ndërtimi i ujëmbledhësit në Panorc	316
Rregullohen rrugë edhe në Balincë.....	317
Kryetari Begaj priti qytetarët.....	Error! Bookmark not defined.
Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e nëntë të rregullt	318
Këshilli Drejtorëve, bisedoi për përgatitjet për shënimin e 28 Nëntorit	318
Nga mbledhja e Komitetit për Diasporë	319
Kryetari Begaj, inspektoi punimet në dy projekte	319
KK i Malishevës, kundër kalimit nën regjionin e Gjakovës.....	320
U mbajt mbledhja e njëmbëdhjetë e KK-së	321
Malisheva një prej vendeve më të qeta në aspektin e sigurisë	322
U përrua rregullimi i urës kryesore në Malishevë	322
U zbulua lapidari i dëshmorëve në Gurishtë.....	323
28 Nëntori fat i mbarë i kombit shqiptar	324
KPF me disa rekomandime për KK	327
Administrata komunale, e përgatitur për ofrimin e shërbimeve për mërgimtarët.....	328
Handikos falënderon kryetarin Begaj për përkrahje.....	329
Si pasojë e eksplozimit të gazit, humbi jetën punëtori i shkollës.....	330
KK i Malishevës mbajti mbledhjen e dymbëdhjetë	331
U mbajt mbledhje komemorative për Zymer Hotin	331
Këshilli i Drejtorëve mbajti mbledhjen e radhës.....	332
Shtrohen rrugët në Vërmicë dhe Mleqan	333
Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e dhjetë të radhës	333
Komuna ndihmon fermerët	334
Ligji për skemën sociale rrezikon të lë jashtë listës shumë familje	334
Kërkohet përkujdesje e zonave të mbrojtura	335
Begaj: Mbi 31 kilometra rrugë të ndërtuara gjatë këtij viti	337
U hap panairi i veshjeve dhe ushqimeve tradicionale	338
Kopja e altarit që i kushtohet hyjneshës “Nemezë” kthehet në Malishevë	339



Begaj: 2014-ta vit i suksesshëm	339
KKSB mbajti mbledhjen e fundit për vitin 2014	341
KK i Malishevës mbajti mbledhjen e fundit për këtë vit	342
Komiteti për Diasporë mbajti mbledhjen e fundit për këtë vit.....	342
Gëzim Elshani, sportisti i vitit në Malishevë, me 13 medalje ari	343
Në vazhdim disa të dhëna rreth investimeve kapitale të Komunës gjatë vitit 2014	345



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 122 - Janar 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>
www.malisheva-komuna.org



Ragip Begaj-Kryetar i Malishevës



Formimi i qeverisë komunale



Enver Hoti-Kryesues i KK

Kryetari Begaj për Vit të Ri, ka vizituar të gjitha shërbimet kujdestare dhe të rendit

Malishevë, 3 janar

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në natën e ndërrimit të moteve, rreth orës 00:00, ka vizituar të gjitha institucionet që kryejnë shërbime kujdestare dhe të rendit, duke i uruar për Vitin e Ri 2014, si dhe duke i përgëzuar për angazhimin e tyre edhe në natën e ndërrimit të moteve.

Me këtë rast kryetari Begaj, ka vizituar, stacionin policor në Malishevë, Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë, Shërbimin e Zjarrfikësve dhe të Shpëtimit në Malishevë, si dhe KEDS-in.

Sipas Kryetarit Begaj, “të gjitha këto shërbime kanë qenë në krye të detyrës dhe kanë kryer punën e tyre ashtu siç edhe e kërkon detyra e tyre”. Po ashtu kryetari Begaj, tha se është njoftuar nga Policia e Kosovës, se gjatë natës së ndërrimit të moteve nuk ka pasur persona të lënduar.

Kryetari Begaj takoi Shoqatën e të Verbërve të Kosovës

Malishevë, 3 janar



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij, drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës (SHVK), z.Mexhid Foniqi, me bashkëpunëtor, me të cilët kanë biseduar për gjendjen e tyre në përgjithësi dhe përkrahjen që mund ta kenë nga ana e Komunës së Malishevës, për këtë kategori, të cilët duhet të ndihen pjesë e barabartë e shoqërisë.

“Unë e çmojë jashtëzakonisht shumë punën që bëni dhe angazhim tuaj për të qenë pjesë e barabartë e shoqërisë. Ne si komunë, do ti shfrytëzojmë të gjitha mundësitë tona, për ti ofruar

mbështetje shoqatës në Malishevë dhe përkujdesja jonë nuk do të mungoj, ndërsa ligji për këta persona, nga ana e komunës, do të zbatohet në njëqind për qind”, tha kryetari Begaj, i cili paraprakisht i falënderoi për vizitën.

Ndërsa z.Mexhid Foniqi, nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës, tha se “ligji për personat e verbër, megjithëse i miratuar nuk po zbatohet. Sipas ligjit, personat e kësaj kategorie, përveç aspektit financiar, do të duhej të lirohen edhe nga disa obligime, siç janë taksat dhe shërbimet komunale”.

Sipas përfaqësuesve të shoqatës së të verbërve, në Malishevë, numri i personave të verbër arrin në 270, prej tyre 96 persona janë një qind për qind të verbër, ndërsa në tërë Kosovës, janë 3500-4000 persona të verbër.

Opozita braktisi seancën, shtyhet zgjedhja e kryesuesit të Asamblesë

Malishevë, 6 janar



Kuvendi i Komunës së Malishevës, sot ka mbajtur mbledhjen e parë të punës, në të cilën është dashur të zgjidhet kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, por opozita (PDK, LDK dhe VV) ka braktisur seancën, menjëherë pas miratimit të rendit të ditës, duke shkaktuar mungesë kuorumi dhe rrjedhimisht është ndërprerë seanca.

Seancën e braktisën 18 nga 31 anëtarët e Kuvendit të Komunës (PDK-8, LDK-8 dhe VV-2), ndërsa në sallën mbetën 13 anëtar të Kuvendit (IQM-11, AAK-1 dhe AKR-1).

Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, pritet të bëhet në vazhdimin e seancës së parë të punës, e cila do të mbahet brenda afatit ligjor për vazhdimin e seancës së parë, për zgjedhjen e kryesuesit.

Begaj priti komandantin e jugut të KFOR-it, kolonelin Topaloğlu

Malishevë, 8 janar



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën tij, komandantin e detashmentit të Përbashkët Rajonal të Jugut (JRD) të KFOR-it, kolonelin Zorlu Topaloğlu, në një takim me karakter njohës, ku është biseduar për bashkëpunimi e ndërsjellë në fushën e sigurisë, si dhe për aspekte tjera të përgjithshme.

Kryetari Begaj, pasi i falënderoi për vizitën, uroi ushtarakët e KFOR-it, për misionin e tyre në Kosovë. “Bashkëpunimi i im me KFOR-in, ka qenë gjithmonë i mirë dhe i tillë do të vazhdoj të mbetet”, tha mes tjerash kryetari Begaj dhe vlerësoi lartë punën e KFOR-it në Kosovë, si dhe bashkëpunimin me njësinë e KFOR-it, LMT në Malishevë. Po ashtu kryetari Begaj, e njoftoi ushtarakun turk, me rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, si dhe me problemet me të cilat përballet komuna e Malishevës.

Nga ana tjetër, koloneli turk, Topaloğlu, e uroi kryetarin Begaj, për postin e të parit të Malishevës, duke i dëshiruar suksese në punë. Më pas koloneli Topaloğlu, u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në fushën e sigurisë. Pasi foli për rolin e KFOR-it në Kosovës në fushën e sigurisë së përgjithshme, koloneli Topaloğlu, vlerësoi lartë edhe të arriturat e Policisë së Kosovës dhe FSK-së.

Përsëri shtyhet mbledhja e KK-së

Malishevë, 9 janar

Është shtyrë përsëri vazhdimi i mbledhjes së parë të punës së Kuvendit të Komunës së Malishevës, mbledhje në të cilën është paraparë zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Mbledhja është shtyrë për shkak të kuorunit, pasi partitë opozitare, sikur herën e parë, përsëri kanë bojkotuar këtë seancë.



Vazhdimi i mbledhjes pritet të mbahet në ditët në vijim.

Shkarkohen drejtorët e drejtorive

Malishevë, 10 janar

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, në kuadër të përgatitjeve për formimin e qeverisë së re komunale, sot ka mbajtur një takim me drejtorët e deritanishëm të drejtorive komunale, të cilëve ju ka komunikuar vendimin për shkarkimin e tyre.

“Ju kam përgatitur vendimet për shkarkimin e të gjithë drejtorëve të drejtorive”, ka thënë kryetari Begaj, “Ju mund ta bënë dorëzimin e detyrave tek shefat e drejtorive, të cilët do ta ushtrojnë detyrën tuaj, deri në emërimin e drejtorëve të rinj” tha në fund të takimit Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj.

Sipas kryetarit, deri në emërimin e drejtorëve të rinj, shefat e drejtorive do ti kryejnë obligimet e drejtorëve.

Ky vendim i kryetarit, është në kuadër të përgatitjeve për formimin e qeverisë së re komunale, si rezultat i zgjedhjeve të fundit lokale, ku kryetari Begaj, qytetarët i kanë dhënë besimin për udhëheqjen e Komunës së Malishevës, në katër vitet e ardhshme.

Përsëri ndërpritet mbledhja e parë e rregullt e KK-së

Malishevë, 13 janar

Edhe sot, për herë të tretë radhazi, është ndërprerë seanca e mbledhjes së parë të rregullt e punës, së Kuvendit të Komunës në Malishevë, për shkak të mungesës së kuorumit në sallë. Në këtë seancë, është e paraparë që të zgjidhet kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës. mbledhja është ndërprerë, pasi opozita, përsëri ka bojkotuar seancën.



Në këtë mbledhje, ka mbajtur një fjalim edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili tha se: “E pashë të arsyeshme ta marr fjalën, për shkak të rrethanave të krijuara në KK. Unë kam dëshirë të kem përkrahjen e të gjitha subjekteve, pasi tani e konsideroj veten se jam përfaqësues i të gjithëve. Dua të sqaroj se jam fitues i zgjedhjeve dhe më takon ta formoj qeverinë dhe të sqaroj se unë nuk jam pengesë për punën e Kuvendit. Bashkëpunimi im do të jetë me ju të gjithë, pa marrë parasysh se kush bëhet kryesues. Unë nuk brengosëm se sa drejtori ju mund ti merrni, po unë brengosëm për mirëqenien e qytetarëve të Malishevës, për kategoritë sociale. Me qeverinë time, do të zbatojmë të gjitha vendimet e ligjshme të kuvendit. Shkuarja eventuale në zgjedhje për Asamble, është vendim i juaji si anëtar të KK-së dhe jo i imi”, tha mes tjerash kryetari Begaj, para anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Pavarësisht kësaj thirrje të kryetarit Begaj, dhe pas diskutimeve nga përfaqësuesit e grupeve të partive anëtare të KK të Malishevës, mbledhja është ndërprerë sërish, pasi paraprakisht 8 anëtarët nga radhët e PDK-së, nuk morën pjesë fare në këtë seancë, ndërsa 8 anëtar të LDK-së dhe 2 të VV-së, lëshuan sallën, duke shkaktuar mungesë kuorumi.

Begaj formoi qeverinë komunale të Malishevës

Malishevë, 13 janar



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, sot edhe zyrtarisht ka prezantuar qeverinë komunale, me të cilën do ta udhëheq Komunën e Malishevës, për katër vitet e ardhshme, pas besimit të marrë nga qytetarët, në zgjedhjet e 3 nëntorit, përkatësisht 1 dhjetorit të këtij viti.

“Ju uroj suksese dhe bashkëpunim të sinqertë, të gjithë drejtorëve të emëruar. Kemi marrë besimin e qytetarëve dhe do të jemi të gatshëm të japim përgjegjësi para qytetarëve, për premtimet e dhëna gjatë fushatës elektorale”, ka kryetari Begaj, me rastin e emërimit të drejtorëve të rinj.

Drejtorët e drejtorive, të emëruara nga kryetari Begaj, janë:

Drejtoria për Arsim dhe Edukim-	Blerim Thaçi
Drejtoria për Administratë-	Ekrem Kastrati
Drejtoria për Ekonomi dhe Financa-	Vesel Krasniqi
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenia Sociale-	Hajdin Berisha
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër -	Fadil Shala
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim-	Ahmet Morina
Drejtoria për Urbanizëm-	Urim Kastrati
Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari-	Hajrullah Mazreku
Drejtoria për Kulturë, rini dhe sport-	Blertë Krasniqi
Drejtoria e Shërbimeve Publike-	Milazim Morina
Drejtoria e Inspektoratit-	Sejdi Paçarizi

Rexhep Mazreku emërohet nënkryetar i komunës së Malishevës

Malishevë, 13 janar



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, në kuadër të ndërtimit të organeve udhëheqëse komunale, ka emëruar sot edhe Nënkyetarin e Komunës së Malishevës. Nënkyetar i Komunës së Malishevës, për katër vitet e ardhshme, do të jetë z.Rexhep Mazreku.

Emërimi i nënkryetarit, është bërë në ceremoninë e prezantimit të qeverisë komunale të Malishevës.

Për z.Rexhep Mazreku, kjo është hera e dytë që emërohet në pozitën e Nënkyetarit të Komunës së Malishevës.

U mbajt mbledhja e parë e qeverisë së re komunale

Malishevë, 14 janar



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, sot ka mbajtur mbledhjen e parë të Këshillit të Drejtorëve, të cilët i ka njoftuar me punët dhe përgjegjësitë që drejtorët e sapozgjedhur i kanë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Me këtë rast kryetari Begaj, kërkoi nga drejtorët punë, përgjegjësi dhe disiplinë në detyrat e tyre si përgjegjës të drejtorive.

“Dua të jem një bashkëpunëtor i mirë dhe dua të bashkëpunojmë pa rezerva dhe dua të jem i informuar për çdo gjë dhe ju e keni ndihmën e plotë timen”, ju ka thënë mes tjerash, kryetari Begaj, drejtorëve të drejtorive komunale. Më pas Begaj kërkoi që drejtorët të përgatisin raportet e rregullta të punës, të bëjnë planifikimin për punët, për projektet dhe mbi të gjitha kërkoi disiplinë në punë.

Po ashtu kryetari Begaj, tha se është i formuar komisioni, i cili do të bëjë pranim dorëzimit të inventarit në zyrat e tyre.

Drejtorët e drejtorive, i shprehën të gatshëm të bashkëpunojnë dhe kryejnë obligimet e tyre si përgjegjës të drejtorive, si dhe u shprehën të bindur në suksesin e tyre dhe të qeverisë komunale të formuar nga Kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj.

Shkolla në Damanek, do të përfundoj brenda 18 muajve

Malishevë, 14 janar

Sot në Malishevë ka qëndruar një delegacion nga zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë, të shoqëruar nga përfaqësuesit e MAPL-së si dhe kompanive të cilat do ta ndërtojnë, përkatësisht kompaninë e cila do ta menaxhojë projektin, të cilët janë pritur nga Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, dhe me këtë rast është bërë e ditur se ka filluar faza e parë për ndërtimin e shkollës në Damanek, përkatësisht faza e përgatitjes, e cila do të zgjat 90 ditë, ndërsa i tërë projekti, do të përfundojë për 18 muaj.



Përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Prishtinë, z. Luc Faber, tha se “është përzgjedhur kompania e cila do ta ndërtoj shkollën në Damanek, sikur edhe është caktuar kompania e cila do ta menaxhoj ecurinë e realizimit të projektit”. Sipas z.Faber, i tërë projekti do të përfundoj brenda 18 muajve.

Me këtë rast, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i ka falënderuar përfaqësuesit e zyrës së BE-së në Prishtinë, për vizitën si dhe për njoftimin se tashmë është zgjedhur kompania e cila do ta ndërtoj këtë shkollë. “Është kënaqësi e madhe për mua, ndërtimi i kësaj shkolle, në kohën kur nxënësit e kësaj shkolle, nuk kanë kushte për zhvillimin e procesit mësimor, pasi objekti aktual është shumë i vjetër dhe jashtë standardeve”, tha Begaj.

Në këtë takim, i bisedua edhe për detaje tjera, që kanë të bëjnë me realizimin e projektit dhe obligimet që kanë të gjitha palët në realizimin e tij.

Begaj e Basha bisedojnë për menaxhimin e mbeturinave

Malishevë, 15 janar

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij, drejtorin ekzekutiv të “Eko-regionit jugor”, z.Nehat Basha, me të cilin kanë biseduar për gjendjen aktuale të menaxhimit të mbeturinave nga njësia e kësaj kompanie në Malishevë dhe gjendjen e përgjithshme me mbeturina në Komunën e Malishevës, si dhe janë diskutuar mundësitë e zgjerimit të operimit nga njësia në Malishevë.



“Do të bashkëpunoj me Eko regionin dhe njësinë në Malishevë, për mirëmbajtjen e pastërtisë në të gjitha vendbanimet. Ambienti është i papastër dhe dëshiroj të gjendet një formë për ndalimin e hedhjes së mbeturinave dhe largimin e tyre nga vendet ku ka grumbullime ilegale të mbeturinave, sikur edhe pastrimin e lumit Mirusha”, tha Begaj.

Në anën tjetër, drejtori ekzekutiv i Eko regjionit jugor, z.Nehat Basha, u shpreh i kënaqur me punën që bën njësia në Malishevë. “Njësia në Malishevë është më e mira, sikur është në nivel edhe bashkëpunimi me qytetarët”, tha Basha, i cili u shpreh i gatshëm për ta ndihmuar njësinë në Malishevë, në rritjen e aktiviteteve të saj.

Në këtë takim, u bisedua edhe për mundësinë e gjenerimit të vendeve të reja të punës, përmes rritjes së kapaciteteve operuese të njësisë dhe për pastrimin e lumit Mirusha, nga mbeturinat.

U mbajt mbledhja e dytë e Këshillit të Drejtorëve

Malishevë, 16 janar



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur takimin e dytë me drejtorët e drejtorive komunale, nga të cilët është njoftuar për gjendjen aktuale në drejtoritë, dy ditë pas marrjes së detyrave, si dhe ka kërkuar që të punohet në vazhdimin e punëve dhe projekteve aktuale, sikur edhe planifikimi për të ardhmen.

“Unë kërkoj nga ju që të punoni si dhe të bëhen planifikimet dhe planet e punës nga ana juaj, dhe nuk kam asnjë dyshim në suksesin tonë si qeveri komunale”, ka thënë kryetari Begaj.

Nga ana tjetër drejtorët kanë njoftuar për pranim dorëzimit të detyrave, si dhe për gjendjen në të cilën i kanë marrë zyrat e tyre. Po ashtu të gjithë drejtorët, thanë se brenda pak ditësh, nga ana e zyrtarëve përkatës, do të përfundohen edhe raportet e punës për vitin e kaluar.

Komuna do ta mbështes Handikos-in edhe në vitin 2014

Malishevë, 16 janar



shpenzimet tjera të qendrës.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe koordinatoresha e Qendrës së Rehabilitimit “Handikos” në Malishevë, znj.Feride Hoxha, kanë nënshkruar sot një marrëveshje mirëkuptimi për mbështetje të aktiviteteve të kësaj organizate, edhe për vitin 2014, ku përfshihet transporti i personave me nevoja të veçanta, trajtimi i tyre në këtë qendër dhe

Komuna e Malishevës, në vazhdimësi, tash e dhjetë vite me radhë, e ka përkrahur këtë organizatë, në ofrimin e shërbimeve për personat me nevoja të veçanta, pasi veprimtaria e qendrave rehabilituese, si Handikos, nuk përkrahen nga niveli qendror.

Shuma totale e përkrahjes për Qendrën e Rehabilitimit në Malishevë, është rreth 22 mijë euro.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Këshilli i Drejtorëve do të takohet çdo të hënë nga ora 8:30

Malishevë, 20 janar

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e tretë të radhës së Këshillit të Drejtorëve, të cilët i ka informuar se mbledhjet e rregullta do të mbahen në ditën e parë të javës, duke filluar nga ora 8:30. Po ashtu në këtë mbledhje janë diskutuar edhe një varg çështjesh tjera që kanë të bëjnë me punën e qeverisë komunale.

Fillimisht kryetari Begaj, kërkoi nga drejtorët që të kenë një raport për gjendjen në drejtoritë përkatëse, si dhe kërkoi nga drejtorët që të evidentojnë mangësitë dhe defektet në drejtoritë e tyre, në mënyrë që të eliminohen dhe të përmirësohen mangësitë eventuale.

Në këtë mbledhje, u diskutua edhe për gjendjen e furnizimit me ujë për pije, për rastet ekstreme, që nuk kanë qasje në rrjetet e sistemeve të ujësjellësit, të cilët për shkak të thatësisë së madhe që po mbretëron, po përballen me mungesë të ujit.

Kryetari Begaj, me këtë rast, kërkoi që të evidentohen të gjitha rastet dhe rastet e rënda sociale, të ndihmohen që të furnizohen me ujë për pije.

Kryetari Begaj, priti pjesëtarët e LMT-së (KFOR) në Malishevë

Malishevë, 20 janar



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën tij kapitenin zviceran Patric Masshardt, pjesëtar i KFOR-it (LMT), të cilët veprojnë në Malishevë, në një takim me karakter njohës, ku është biseduar për bashkëpunimi e ndërsjellë në fushën e sigurisë, si dhe për aspekte tjera të përgjithshme.

Kryetari Begaj, falënderoi për vizitën, uroi ushtarakët e KFOR-it, për misionin e tyre në Kosovë dhe vlerësoi lartë punën e KFOR-it në Kosovë, si dhe bashkëpunimin me njësinë e KFOR-it, LMT në Malishevë. Po ashtu kryetari Begaj, e njoftoi ushtarakun zviceran me rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, me prioritetet, si dhe me problemet me të cilat përballen Komuna e Malishevës, probleme me të cilat direkt apo indirekt, ndërlidhen me sigurinë e përgjithshme, siç janë pajisjet për zjarrfikësit.

Gjendja sigurisë së përgjithshme, si nga ana e LMT-së, ashtu edhe nga kryetari Begaj, u vlerësua e qetë dhe pa incidente të cilat mund ta prishin sigurinë e përgjithshme në Komunën e Malishevës.

Caritas Kosova dhe Komuna do të vazhdojnë mbështetjen në shëndetësi

Malishevë, 21 janar



Komuna e Malishevës dhe Caritas Kosova, do të vazhdojnë bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë në Malishevë, në vazhdimin e projektit për perkujdesjen shëndetësore shtëpiake. Kështu janë pajtuar sot Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe zyrtari i Caritas Kosova, z.Pal Baftijaj, në takimin e mbajtur sot në zyrën e Kryetarit të Komunës.

Kryetari Begaj, me këtë rast, ka falënderuar Caritas Kosova, për bashkëpunimin e mirë dhe për ndihmën e dhënë në projektin për perkujdesjen shëndetësore shtëpiake, si dhe u shpreh i gatshëm në vazhdimin e këtij projekti të përbashkët edhe në këtë vit.

Begaj e Baftijaj përveç se janë dakorduar për vazhdimin e këtij projekti dhe janë shqyrtuar mundësitë për bashkëpunim edhe në fusha tjera.

Komuna dhe UNHABITAT-i do të vazhdojnë me fazat e mëtutjeshme për PZHK-në

Malishevë, 21 janar

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot një delegacion nga zyra e UN HABITAT-it në Prishtinë, të prirë nga shefja e kësaj zyre, znj, Gwendoline Mennetrier, ku është biseduar për punën e deritanishme të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) si dhe për hapat e mëtutjeshëm, drejt përfundimit të këtij plani.



Kryetari Begaj, me këtë rast, ka falënderuar UNHABITAT-in për “ndihmën profesionale të dhënë për Malishevën, në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, pasi kjo është një ndër gjërat më të rëndësishme drejt zhvillimit të Komunës së Malishevës”.

Nga ana tjetër znj.Mennetrier, e ka njoftuar kryetarin Begaj, për hapat e deritanishëm nga ana UNHABITAT-it, të cilët kanë angazhuar dy zyrtar të saj, për ta ndihmuar drejtorinë e urbanizmit në hartimin e këtij plani, me shumë rëndësi për Malishevën dhe tha se “Malisheva është njëra prej 12 komunave me të cilat bashkëpunon kjo organizatë në këtë fushë dhe se Malisheva, është komuna e parë që do ta ketë këtë plan, në harmoni të plotë me ligjin për Planifikimin Hapësinor”.

UN HABITAT ka ofruar ndihmë profesionale në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal për Malishevën, që nga viti 2012, kur edhe është filluar të punohet në këtë aspekt. Deri më tani është hartuar draft i parë i këtij plani dhe procesi është duke vazhduar drejt përfundimit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.

Evropianët e rinj kërkojnë fuqizimin e rinisë në Malishevë

Malishevë, 21 janar

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur në një takim pune, Presidentin e Këshillit të Rinisë Evropiane për Kosovën (KREK), z.Avdullah Hasanin, me të cilin kanë biseduar për fuqizimin e rinisë në Kosovë, me theks të veçantë në Malishevë. Ky takim është bërë në kuadër të vizitave të KREK, me kryetarët e komunave në Kosovë.

“Të rinjtë e Malishevës, konsideroj se janë të përfshirë në vendimmarrje, duke pasur parasysh se shumica e punëtorëve në administratë janë të rinj, për çka edhe ndihemi krenar”, ka thënë Begaj.

Nga ana tjetër, Begaj e Hasani, kanë biseduar edhe për mundësitë e përkrahjes për fuqizimin e rinisë së Malishevës.



Enver Hoti kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Malishevë, 22 janar

Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka vazhduar me seancën e parë të saj, ku në rend dite ishte zgjedhja e kryesuesit të kuvendit. Me shumicë të votave, në rrethin e tretë të votimit, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës, u zgjodh z.Enver Hoti, nga Iniciativa Qytetare për Malishevën.



Në këtë mbledhje të kryesuar nga anëtari më i vjetër i KK-së, z.Aziz Thaçi, në mbledhje ishin prezentë edhe Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, deputeti i Kuvendit të Kosovës z.Haxhi Shala, drejtorët e drejtorive komunale, mediet, përfaqësues të organizatave monitoruese dhe qytetar të tjerë.

Pas procesit të votimit, kryesuesi i sapozgjedhur, z.Enver Hoti, duke marrë fjalën, i falënderoi të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës. “Unë do të jem zëri i qytetarëve të Malishevës dhe i ftoj të gjithë anëtarët e KK-së, që ta kontrollojnë punën e Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale”, tha Hoti, duke ja kujtuar kryetarit edhe premtimet e dhëna dhe presionin nga KK, për realizimin e premtimeve. Kryesuesi Hoti, me këtë rast premtoi transparencë të plotë në udhëheqjen e Kuvendit të Komunës.

Në anën tjetër Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, pasi e uroi kryesuesin Hoti, për kryesimin e KK-së në katër vitet e ardhshme, tha se: do të bashkëpunoj me të gjithë anëtarët e KK-së, në të mirë të qytetarit dhe për ta qar përpara Malishevën. Të gjithë së bashku mund ta zhvillojmë Malishevën.

Edhe përfaqësuesit e subjekteve politike në Kuvendin e Komunës së Malishevës, e kanë uruar kryesuesin Hoti, për kryesimin e legjislativit të Malishevës, në katër vitet e ardhshme.



Në fillim të seancës, e dhanë betim edhe tre anëtar të KK-së, të cilët kanë zëvendësuar tre anëtar të tjerë, të cilët janë tërhequr nga KK, për shkak të pozitive të tyre udhëheqëse ose në administratën komunale. Anëtar e rinj të KK-së janë, Islam Vrenezi, Rifat Mazreku dhe Driton Halilaj.

Gjatë viti 2013, 10.17 % më shumë të hyra nga tatimi në pronë

Malishevë, 23 janar

Zyra e tatimit në pronë, gjatë vitit 2013 ka tejkaluar planifikimin e të hyra nga tatimi në pronë, për 10.17 për qind, apo shprehur në shifra, nga 145 mijë euro të planifikuara, janë realizuar 159 746 euro, bëhet e ditur në raportin e Zyrës për Tatimin në Pronë, në Komunën e Malishevës.

Menaxheri i Zyrës së Tatimit në Pronë, pranë drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z.Avni Krasniqi, tha se “nga planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë, është tejkaluar ky planifikim për 10.17 për qind, gjatë vitit 2013”.

Sipas Krasniqit, gjatë vitit 2013, në bazë të regjistrimeve, janë bërë edhe 848 faturime të reja dhe 1160 verifikime. Ankesa me shkrim të drejtuar në këtë zyre, janë regjistruar 17 ankesa, prej tyre, 14 për objekte banimi, 3 për objekte afariste dhe një për një objekt të papërfunduar dhe të gjitha ankesa janë aprovuar nga Bordi Komunal për shqyrtimin e ankesave.

Gjatë vitit 2013, janë lëshuar 7566 certifikata të pagesës për tatimpagues.

Këshilli i Drejtorëve mbajti mbledhjen e rregullt të së hënës

Malishevë, 27 janar

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku janë diskutuar një varg çështjes lidhur me punët dhe obligimet e drejtorive komunale, në mënyrë që të realizohen në përpikëri detyrat e drejtorive komunale, si dhe është diskutuar edhe çështja e problemit kryesor të Malishevës, ajo e etheve hemorragjike.

Drejtorët e drejtorive komunale, kanë raportuar para kryetarit për aktivitetet e tyre gjatë javës se kaluar, si dhe për aktivitetet dhe detyrat që kanë gjatë javës në vijim.

Një pikë e veçantë e diskutuar në këtë mbledhje, ishte ajo për ethet hemorragjike, ku drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z.Hajdin Berisha, njoftoi se ka pasur disa takime me institucionet përgjegjëse, ku është biseduar për aktivitetet që pritet të zhvillohen gjatë këtij viti, në parandalimin e etheve hemorragjike.

Sipas drejtorit Berisha, kanë filluar disa aktivitete, kryesisht me ligjërata me mjekët nga ekspertët e kësaj fushe, ndërsa sipas parashikimeve nga institutet përgjegjëse, përkatësisht nga Instituti Rajonal i Shëndetit Publik, bazuar në kushtet e deritanishme klimatike, mund të kemi situatë të vështirë, andaj marrja e masave dhe veprimi sa më i shpejt, është i domosdoshëm.

Përkujtohen Ali Kryeziu e Hysni Mazreku

Malishevë, 30 janar



Me një akademi përkujtimore dhe duke bërë homazhe në vendin e rënies, sot është shënuar 24 vjetori i ngjarjes tragjike, ku kanë humbur jetën Ali Kryeziu dhe Hysni Mazreku, si dhe janë lënduar rëndë e lehtë, 11 qytetar të Malishevës, si dhe janë maltretuar rëndë katër qytetar të tjerë. Për opinion e gjerë, kjo ngjarje e 30 janarit 1990, njihet si “masakra e Malishevës”, ngjarje e cila shënon kundërshtimin edhe institucional të Komunës së

Malishevës, ndaj regjimit serbo-sllav të asaj kohe.

“Përveç vrasjes së dy të rinjve të pafajshëm, kjo ngjarje, shënon edhe rastin e parë të ngritjes së zërit nga ana e institucioneve komunale të Malishevës, kundër padrejtësive që i bëheshin popullit shqiptar në Kosovë, duke bërë jehonë të madhe ky reagim institucional”, tha mes tjerash, në fjalën e rastit, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Ndërsa ish kryetari i Komunës së Malishevës në vitin 1990, z.Daut Krasniqi, duke evokuar kujtimet e asaj ngjarje, në mënyrë kronologjike, kujtoi angazhimin e institucionit të komunës, në raport me ngjarjen dhe situatën e krijuar, duke bërë që edhe “Kuvendi i Kosovës, të ndryshoj qasjen e shqyrtimit dhe vendosjes, për ti paraprirë ngjarjeve të mëdha të asaj kohe”.



Ndërsa në emër të Kuvendit të Komunës së Malishevës, një fjalë rasti e mbajti edhe kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, i cili e cilësoi si një ngjarje me rëndësi të jashtëzakonshme. “Protestat e atyre viteve, ishin lajmëtar i lirisë, e cila do të vjen me gjak. Jemi krenar dhe me krenari ne i kujtojmë dëshmorët e kombit, të rënë për lirinë e Kosovës”.

Në emër të familjeve të dy rënëve, të pranishmit i përshëndeti dhe i falënderoi, mulla Xhevat Kreyziu.

Në vazhdim, fjalimi i plotë i kryetarit Begaj, mbajtur me rastin e mbajtjes së akademisë përkujtimore për Ali Kreyziu dhe Hysni Mazrekun:

Të nderuara familje të dëshmorëve, martirëve dhe të gjithë atyre që u flijuan për Lirinë e Pavarësinë e Kosovës dhe të trojeve tjera shqiptare,

Të nderuar, invalidë dhe veteranë të UÇK-së, anëtarë të Kuvendit Komunal të Malishevës, zyrtarë të institucioneve shtetërore, përfaqësues të Shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, përfaqësues të komunitetit fetar, OSBE-së, medieve dhe ju të pranishëm të tjerë në këtë akademi përkujtimore, me rastin e përkujtimit të 30 janarit të vitit 1990,

-Të respektuara familje të: Ali Dinë Kreyziut dhe Hysni Avdullah Mazrekut,

- Të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës,

Në ditën që po shënojmë 30 janarin e vitit 1990, duam të kujtojmë me pietet dy martirët që ranë 24 vjet më parë, Ali Dinë Kreyziun, nga Bubaveci dhe Hysni Avdullah Mazrekun, nga Malisheva, në ditën dhe kohën e vlimeve e zhvillimeve të rëndësishme për popullin e Kosovës, në kohën që shqiptarët masovisht kundërshtonin edhe me forcë veprimet e regjimit kriminal serbo-jugosllav.

Por fillimisht, ju të nderuar të pranishëm, më lejoni të kujtoj para jush një historik të disa ngjarjeve të rëndësishme, sa të dhembshme, po aq edhe krenare në vazhdimësinë e janarëve, të cilat i shënon historia e kombit shqiptar, pasi që përpjekjet e popullit shqiptar në Kosovë për Liri e Pavarësi, nuk u ndalën kurrë.

Ne sot po kujtojmë janarin e para pesë shekujve e gjysmë, kur u nda nga jeta figura më madhështore e kombit, Gjergj Kastrioti-SkënderBeu (17 janar 1468), po ashtu kujtojmë janarin e vrasjes së heroit kombëtar Isa Boletini,

Për gjeneratën tonë dhe për kombin shqiptar në përgjithësi, kujtesa është e freskët për janarin e vrasjes së atdhetarëve të kombit Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës në Gjermani më 17 janar 1982, të vrarë nga duart e kriminelëve të pamëshirshëm, që asnjëherë nuk u ngopën me gjakun shqiptar. Po me këtë rast ne kujtojmë vrasjen e atdhetarëve e veprimtarëve



Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, që të gjithë dëshmorë e heronj kombi.

Pikërisht muaji janar ishte muaji i flijimit të këtyre burrave të mëdhenj të kombit dhe me të drejtë thuhet se janari është muaji i flakës së lirisë, flaka dhe rruga drejtë shtetësisë së Kosovës.

Janari nuk mbeti pa e prekur edhe Komunën e Malishevës dhe pikërisht më 30 janar të vitit 1990, u përgjakën rrugët e Komunës sonë nga makineria vrastare serbo-jugosllave, ku barbarisht u vranë Ali Dinë Kryeziu dhe Hysni Avdullah Mazreku, martirë kombi.

Edhe pse, nga kjo ngjarje e dhembshme kanë kaluar 24 vite, kujtesa e jonë është e freskët, si një nga ngjarjet që tronditën jo vetëm Malishevën.

Të nderuar të pranishëm,

Pos dhembjes nga humbja e jetës së dy të rinjve të pafajshëm, që kishin dalë të protestonin kundër dhunës e masave barbare serbo-jugosllave ndaj shqiptarëve shumicë që në Kosovë kërkonin të drejtat që u takonin si popull, Malisheva kishte edhe 15 të plagosur rëndë. Malisheva u përgjak, por asnjëherë nuk u dorëzua në rrugëtimin drejt lirisë së atdheut.

Malisheva si komunë ende e vogël dhe me pak vite funksionimi, pa pasur fare frikë për pasojat e mëtejme, jo vetëm si popullatë, por edhe si udhëheqje komunale, e vetme në Kosovë, e ngriti zërin me krenari ndaj padrejtësive që po i bëheshin popullit shqiptar nga pushtuesi serbo-jugosllav. Zëri i Malishevës u dëgjua edhe në OKB.

Me suspendimin e autonomisë së Kosovës, që nga 28 marsi famëkeq i vitit 1989, ishte e vetmja Komunë në Kosovë, që u nda padrejtësisht në katër komuna tjera, vetëm e vetëm për të mos ekzistuar më si komunë pothuajse tërësisht etnike shqiptare.

Rënia heroike e të rinjve, plagosja e dhjetëra qytetarëve, suspendimi i Komunës së Malishevës, si dhe maltretimi i përditshëm i qytetarëve, nuk e ndali asnjëherë dëshirën për organizimin e strukturave të luftës për liri .

Malisheva u kalit në këto ngjarje të rëndësishme dhe doli fitimtare në të gjitha betejat. Këtu duhet kujtuar organizimin e shtabeve lokale të UÇK-së në gjithë territorin e Komunës sonë, angazhimin, përkushtimin, sakrificën dhe luftën e shenjtë deri në përfundimin e luftës së viteve 1998/99, luftës që Kosovës i solli Lirinë dhe hapi rrugën për Pavarësinë e Kosovës.

Luftës për Lirinë e Kosovës, Komuna e Malishevës, pos martirëve të vitit 1990, i dha edhe 74 dëshmorë, disa nga të cilët ranë edhe për lirinë e të drejtat e popullit shqiptar që padrejtësisht kanë mbetur jashtë territorit të Kosovës, si në Maqedoni e Kosovën Lindore (Preshevë). Po ashtu nga Komuna e Malishevës, u flijuan edhe mbi 400 martirë, ndërsa janë ende të zhdukur edhe rreth 30 qytetarët të Komunës së Malishevës.

Prandaj, me gjithë këtë mund, sakrificë e flijim, jemi krenarë që i takojmë Malishevës heroike, për të cilën ne që tani drejtojmë institucionet legjitime me votën e qytetarëve,

obligohemi që të punojmë për një jetë e mirëqenie më të mirë të të gjithë qytetarëve, për familjet e dëshmorëve e të të gjithë atyre që u flijuan për këtë Liri e Pavarësi që e gëzojmë ne tash e 15 vjet, përkatësisht 6 vjet.

- Lavdi Dëshmorëve të Kombit,

Lavdi të gjithë të rënëve për lirinë e trojeve shqiptare

Malishevë, 30 janar 2014

Ragip Begaj, kryetar i Komunës së Malishevës

Kryetari Begaj, priti pjesëtarët e LMT-së (KFOR) në Malishevë

Malishevë, 31 janar



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën tij kapitenin zviceran Patric Masshardt, dhe një pjesëtar tjetër të KFOR-it (LMT), të cilët veprojnë në Malishevë, në një takim , ku është biseduar për disa shqetësime të qytetarëve dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e sigurisë, si dhe për aspekte tjera të përgjithshme.

Kryetari Begaj, falënderoi për vizitën, dhe për bashkëpunimi të ndërsjellë që kanë (LMT)

KFORI me Komunën e Malishevës si dhe që shprehen disa nga shqetësimet e qytetarëve tek ai, dhe vlerësoi lartë punën e KFOR-it në përgjithësi jo vetëm në Malishevë. Në mes tjerash kryetari Begaj, tha se “është shqetësuese dhe shumë brengosëse për mua çdo problem dhe shqetësimi i qytetarit të Malishevës, dhe do mundohem maksimalisht që ti zvogëloj shqetësimet që ata shfaqin tek unë”. “Unë do jem i hapur dhe i afërt në çdo kohë për qytetarët e mi, dhe do të kujdesem që të kenë një jetë të mirë, dhe dua të jem i barabartë me ta”.

Gjendja e sigurisë së përgjithshme, si nga ana e LMT-së, u vlerësua më e qeta ndër të gjitha komunat dhe pa incidente të cilat mund ta prishin sigurinë e përgjithshme në Komunën e Malishevë

Shpaloset Plani i Veprimit të Strategjisë për parandalimin e Etheve Hemorragjike

Malishevë, 31 janar 2014



Organizuar nga Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Komuna e Malishevës, sot në Malishevë, u mbajt takimi i Këshillit Ndërmintor për parandalimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo EHKK.

Në këtë takim, me pjesëmarrje edhe të përfaqësuesve të lartë të katër komunave: Malishevë, Rahovec, Klinë e Suharekë dhe të ekspertëve ndërkombëtarë, ndër të cilët edhe eksperti nga Turqia, Prof. Dr. Zati

Vatansever dhe përfaqësues të Fakultetit të Bujqësisë nga Shqipëria, u shpalos Plani i veprimit të Strategjisë për parandalimin e Etheve Hemorragjike në Kosovë.

Ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, tha se ballafaqimi me këtë aksident mjedisor me të cilin është ballafaquar Malisheva dhe komunat e tjera përreth, ka qenë preokupim i tij prej ditëve të para të mandatit të tij. Ai tha se duke e parë kompleksitetin e këtij problemi dhe faktin që MSh ishte e vetmuar në ballafaqimin me këtë problematikë, që vitin e kaluar mori 11 jetë dhe pati mbi 5200 pickime të qytetarëve nga rriqrat, MSH veprroi në mënyrë emergjente brenda mundësive që i kishte, por u vërejt qartë edhe nevoja e lidhshimit dhe veprimit të koordinuara edhe më akterët e tjerë.

Bazuar në këtë, tha ai, "kam inicuar formimin e Këshillit Ndërmintor që ka mbajtur 13 takime dhe është arritur që përmes tyre të elaborohet Plani Strategjik për ballafaqim me këtë problematikë me ndarje të qartë të detyrave, plan ky i miratuar në Këshill dhe i cili pritet të miratohet edhe në Qeverinë e Kosovës".

"Sivjet jemi shumë më të përgatitur për ballafaqim me këtë problematikë se vitin e kaluar, edhe-pse kjo luftë do të jetë mjaft e komplikuar dhe e lidhur edhe me ndryshimet që ndodhin në ekosistem...", shtoi më tej Ministri Agani. Ai tha se Plani do të ndihmojë Këshillin dhe veprimet në teren, pasi që këto veprime do të jenë më të koordinuara dhe të planifikuara mirë si dhe do të mundësojnë veprim më efikas se vitin e kaluar, në mënyrë që lufta të jetë sa më efikase dhe pasojat sa më të vogla.

Kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, tha se është i sigurt kur sheh që një takim i këtij niveli të lartë mbahet në Malishevë, duke ditur se kjo komunë dhe komunat përreth kanë qenë shumë të prekura nga Ethet Hemorragjike, se ky angazhim i të gjitha faktorëve do të ndihmojë që shqetësimet do të jenë më të vogla. "Kur shohin këtë mobilizim të faktorëve që merren në mënyrë të organizuar për parandalimin dhe luftimin e EHKK, jemi të bindur se rezultatet do të jenë të mira dhe shqetësimet e qytetarëve tanë më të vogla", tha Begaj.



Planin e Veprimit të Strategjisë për parandalimin e EHKK e ka shpalosur drejtori i IKSHP-së, Naser Ramadani, në veçanti aktivitetet e parapara për vitin 2014 në komunat Malishevë, Suharekë, Rahovec e Klinë dhe në komunat e tjera ku mund të paraqiten raste të EHKK.

Në këtë plan që në esencë ka parandalimin dhe reduktimin e shkallës së sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së popullatës nga EHKK, janë paraparë aktivitetet për secilin resor ministror dhe ata lokal me qëllim që lufta për parandalim, informimin, zbulimin e hershëm të infeksionit, diagnostikimi, raportimi dhe trajtimi i rasteve të bëhet në mënyrë sa më profesionale.

Përvojën e shtetit të Turqisë në ballafaqim me EHKK e ka prezantuar eksperti nga ky shtet, dr. Zati Vatansever, duke qenë që edhe Turqia është ballafaquar me raste të EHKK.

Me diskutime rreth problematikës së EHKK dhe përvojave të deritanishme, në këtë tryezë kanë kontribuar anëtarët e Këshillit Ndërmintorë, pjesëmarrësit nga komunat më të prekura dhe pjesëmarrësit e tjerë.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 123- Shkurt 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>
www.malisheva-komuna.org



Pamje gjatë shënimit të 17 shkurtit
Ditës së Pavarësisë

Këshilli i Drejtorëve, mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 3 shkurt

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të së hënës, ku janë diskutuar një varg çështjesh, që kanë të bëjnë me angazhimet e përditshme të drejtorive komunale, gjatë javës së kaluar dhe për detyrat në javën në vazhdim.

Drejtorët e drejtorive, kanë raportuar para kryetarit të Komunës, për angazhimet e tyre, ku angazhimi më i madh gjatë javës së kaluar, ishte në drejtorët për arsim dhe atë të shëndetësisë, ndërsa gjatë javës në vijim, drejtorët kanë paralajmëruar një varg aktivitete.

Nga drejtorja për bujqësi, u bë e ditur se po bëhen të gjitha përgatitjet për subvencionimin e grurit për bujqit, të cilët i plotësojnë kriteret, ndërsa nga ana e drejtorisë së shërbimeve publike, u bë e ditur, se kërkesat për furnizim me ujë për pije, janë në rritje e sipër dhe se kjo drejtori ka intervenuar në disa raste, për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve.

Kryetari Begaj, priti drejtoreshën rajonale të OSBE-së, Sara Bonotti

Malishevë, 3 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune, drejtoreshën e OSBE-së për rajonin e Prizrenit, znj.Sara Bonotti, me të cilën ka biseduar për rrjedhat e përgjithshme në Malishevë dhe për rritjen e bashkëpunimit mes Komunës së Malishevës dhe OSBE-së, në fusha të ndryshme.

Fillimisht, znj.Bonotti, e uroi kryetarin Begaj, për suksesin e arritur në zgjedhjet e fundit lokale dhe për pozitën e të parit të Malishevës, si dhe e përgëzoi që në mesin e udhëheqësve të drejtorive

komunale, ka emëruar një femër për udhëheqjen e një drejtorie komunale, si një akt jo i zakonshëm në komunat e regjionit të Prizrenit, pasi të pakta janë rastet kur femrave ju ofrohet menaxhimi i një departamenti të caktuar.

Më pas, Begaj e Bonotti, kanë biseduar për çështje të ndryshme, që lidhen me Komunën e Malishevës, e që janë pjesë e monitorimit, që bën OSBE-ja, ku u vlerësua lartë gatishmëria e kryetarit, për bashkëpunim me qytetarët, përmes takimeve të drejtpërdrejta në terren, pastaj bashkëpunimi me zyrën për informim publik, në projektin e OSBE-së për bashkëpunim ndërkomunal, si dhe për përkrahjen e grupeve të rinisë, përkatësisht Këshillit Lokal Rinor në Malishevë dhe për grupet e femrave.

Në këtë takim, u diskutuan edhe çështje tjera, që kanë të bëjnë me Kuvendin e Komunës dhe qeverinë komunale, ku kryetari Begaj, shprehi gatishmërinë e tij, për bashkëpunim me të gjitha grupet në Kuvendin e Komunës, duke ju ofruar anëtarëve të KK të Malishevës, që ta përcjellin në përpikëri punën e kryetarit dhe të qeverisë komunale.

Kuvendi i Komunës formoi komitetet obligative

Malishevë, 7 shkurt

Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka mbajtur sot mbledhjen e dytë të radhës, ku janë formuar komitetet obligative, si Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komiteti për



Komunitete, si dhe është marrë vendim për formimin e komisionit të punës, për hartimin e planit të punës së Kuvendit.

Mbledhja e sotme, është kryesuar nga kryesuesi z.Enver Hoti, ndërsa në mbledhja ka marrë edhe kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, i cili është përgjegjës në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, drejtuar kryetarit, për çështje të ndryshme.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës, sot kanë miratuar katër vendime, ku është vendosur për formimin e KPF-së, që do të ketë 11 anëtar (kryesuesi me 4 anëtar nga IQM-ja, 3 anëtar PDK-ja dhe 3 anëtar LDK-ja), pastaj Komitetin për Komunitete, që do të përbëhet prej 7



anëtarëve, pastaj është formuar komisioni për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2014, komision që përbëhet nga 7 anëtarë, nga të gjitha partitë politike në KK dhe kryesuesi. Po ashtu KK mori vendim, që nga kjo seancë, të publikohen procesverbalet e mbledhjeve të KK, në ueb faqen zyrtare të komunës.

Regjistrohet rasti i parë i thumbit nga rriqrat në vitin 2014

Malishevë, 10 shkurt

Qeveria komunale e Malishevës, e udhëhequr nga kryetari z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të së hënës, në të cilën janë debatuar një varg çështjesh me rëndësi, ndërsa shqetësimi kryesor ishte, fillim i regjistrimit të rasteve të para të thumbimit nga rriqrat, i shënuar gjatë fundjavës.

“Jam njoftuar se është regjistruar rasti i parë i thumbimit nga rriqrat dhe kjo është vërtetë shqetësuese, andaj kërkoj që masat për parandalimin e etheve hemorragjike, të fillojnë sa më shpejt dhe niveli i gatishmërisë, të rritet”, ka thënë kryetari Begaj, duke e shprehur shqetësimin e tij.

Edhe drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z.Hajdin Berisha, e ka konfirmuar këtë, duke thënë, se “rasti i parë për këtë vit është regjistruar gjatë fundjavës, përkatësisht të shtunën, në fshatin Turjakë”.

Përndryshe, në këtë mbledhje, kryetari Begaj, mes tjerash ka kërkuar që sa më shpejt që është e mundur, të regjistrohen vendgrumbullimet e mbeturinave ilegale dhe të largohen mbeturinat, të cilat mes tjerash janë edhe rrezik permanent i infeksioneve të ndryshme, përfshi edhe si strehim për brejtës dhe rriqra, dhe ndikojnë direkt në përhapjen e etheve hemorragjike. “Kjo është emergjente, andaj kërkoj nga drejtorja dhe shërbimet tjera, që sa më shpejt të veprohet në këtë drejtim”, tha Begaj.

Kryetari Begaj, në këtë mbledhje, ka kërkuar nga drejtorët, zbatim të rreptë të ligjit në të gjitha sektorët, si dhe ka dhënë detyrat për drejtoritë dhe shërbimet e caktuara, për javët në vazhdim, sikur edhe për obligimet që drejtorët e drejtorive, kanë në raport me kuvendin e komunës.

Kryetari Begaj, takoi drejtuesit e QKMF-së

Malishevë, 12 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenies sociale, z.Hajdin Berisha, kanë vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Malishevë, ku është takuar me drejtuesit e kësaj qendre shëndetësore, me të cilët ka biseduar për gjendjen e përgjithshme në QKMF, problemet, nevojat dhe me përgatitjet për përballje me rastet e thumbimeve nga rriqrat dhe ethet hemorragjike.



Me këtë rast kryetari Begaj, i ofroi QKMF-së mbështetjen e plotë të Komunës së Malishevës, për të gjitha nevojat e tyre, në mënyrë që shërbimet në raport me qytetarin të jenë sa më të mira, sikur që kërkoi në të njëjtën kohë, që punëtorët shëndetësor të respektojnë punën dhe orarin e punës. “Jemi në sezonin e përballjes me problemin e etheve hemorragjike dhe thumbimet nga rriqrat, dhe ju keni

përkrahjen e plotë, në mënyrë që së bashku, të arrijmë t’ju dalim në ndihmë qytetarëve tanë dhe në të njëjtën kohë të punojmë për parandalimin e etheve hemorragjike”, tha mes tjerash kryetari Begaj.

Nga ana tjetër, drejtori i QKMF-së, z.Besim Zogaj, e njoftoi kryetarin për gjendjen e përgjithshme në QKMF, si dhe për nevojat që ka kjo qendër, në mënyrë që shërbimet ndaj qytetarëve të Komunës së Malishevës, të jenë në nivelin më të mirë të mundshëm.

Po ashtu edhe për ethet hemorragjike, “si QKMF, kemi planifikuar që ligjëratat të fillojnë një muaj më herët, se vitet e tjera, sikur edhe fushatat e vetëdijesimit, po ashtu të fillojnë më herët”. Përndryshe, drejtori Zogaj, bëri të ditur se deri më tani janë regjistruar tri raste të thumbimit nga rriqrat dhe të gjitha rastet janë në gjendje të mirë dhe nuk kanë indikacione të infektimit eventual me ethe hemorragjike.

Finalet e Ipko Kupa e Kosovës në basketboll do të mbahen në Malishevë

Malishevë, 12 shkurt



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot përfaqësuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), sekretarin e FBK-së z.Jeton Nixha dhe koordinatorin teknik z.Faton Kurshumlja, me të cilët kanë biseduar për mbajtjen e garave finale të Ipko Kupa e Kosovës në basketboll, për kategoritë e reja, në Malishevë, përkatësisht në palestrën sportive “Habib Zogaj” në Malishevë, me qëllim të inspirimit të rinisë malishevase, për tu marrë edhe më

shumë me sport.

Me këtë rast, kryetari Begaj i ka falënderuar përfaqësuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës për vizitën në Malishevë, por edhe për përzgjedhjen e qytetit të Malishevës, për mbajtjen e garave gjysmëfinale dhe finale të Ipko Kupa e Kosovës në basketboll, për kategoritë e reja. Me këtë rast, kryetari Begaj, ofroi të gjitha mundësitë e komunës, për mbajtjen e këtyre garave.

Këto gara të gjysmëfinaleve dhe finaleve, do të bashkëorganizohen nga Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK), Komuna e Malishevës dhe klubi i basketbollit “Malisheva”.

Garat gjysmëfinale dhe finale të Ipko Kupa e Kosovës, mbahen për kategoritë e reja (U19, U16 dhe U14) në basketboll.

Kryetari Begaj, priti përfaqësuesit e Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve

Malishevë, 12 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj priti në zyrën e tij përfaqësuesit e Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve, përkatësisht zyrtarin ndërlidhës të Shoqatës së të Shurdhërve të Kosovës, z.Ramadan Gashi, ku biseduan për gjendjen dhe nevojat e këtij komuniteti.

Kryetari Begaj i falënderoi për vizitën dhe ju dha mbështetje për punën e tyre me personat, të cilët nuk dëgjojnë. “Ju me jepni vullnet, kur ju shoh se si angazhoheni për këtë kategori, në mënyrë që këta persona, ta ndiejnë veten të barabartë në shoqëri”, tha Begaj.

Në këtë takim, u diskutuan edhe disa nga objektivat e shoqatës, siç është punësimi i personave që nuk dëgjojnë, mësimi gjuhës së shenjave dhe të tjera, ku kryetari Begaj la të hapur mundësinë për realizimin e disa objektivave që u ceken në këtë takim.

Mbeturinat dhe kanalizimi, problemet kryesore në Marali

Malishevë, 12 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar edhe nga një pjesë e qeverisë komunale, ka vizituar fshatin Marali, ku janë takuar me banorët e këtij fshati, me qëllim të informimit të drejtpërdrejtë me problemet dhe nevojat e banorëve të këtij fshati, e ku problem kryesor, doli të jetë largimi dhe grumbullimi i mbeturinave dhe rregullimi i kanalizimit.

“Duhet që së bashku me ju, ta pastrojmë ambientin dhe ky është synimi i im kryesor. Kërkoj edhe ndihmën e juaj si banor të fshatit, që ti largojmë mbeturinat dhe në të njëjtën kohë, të mos i hidhni mbeturinat, por të futeni në sistemin e grumbullimit të tyre”, ju ka thënë Begaj, banorëve të fshatit Marali.

“Ato mbeturina janë edhe burim i shumë sëmundjeve, përfshi edhe përhapjen e brejtësve dhe rriqrave, e rrjedhimisht edhe i etheve hemorragjike, andaj, ju ftoj që së bashku, të angazhohemi në largimin e tyre”, tha Begaj, ndërsa drejtori i shërbimeve publike, z.Milazim Morina dhe përgjegjësi i njësisë së “Eko regjionit” në Malishevës, z.Nuhi Shala, i njoftuan banorët me procedurat e futjes në sistemin e grumbullimit të mbeturinave.



Nga ana tjetër, edhe drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, i ka njoftuar banorët për rrezikun nga rriqrat dhe ethet hemorragjike. “Angazhimi ynë institucional, është në nivelin më të lartë, edhe pse kjo si sëmundje, është problem nacional, por ne si komunë, jemi më të prekur. Në të njëjtën kohë, kërkoj nga ju që të keni kujdes të shtuar, sidomos me fëmijët, në mënyrë që të zvogëlojmë rrezikun e infektimit nga ethet hemorragjike”, tha mes

tjerash drejtori Berisha, i cili i njoftoj edhe me përgatitjet për fushatat në nivel komunal por edhe qendror, në luftimin dhe parandalimin e kësaj sëmundje.

Nga an tjetër, banorët e fshatit Marali, shprehën problemet dhe nevojat e tyre si fshat, me të cilave, largimi i mbeturinave dhe kanalizimi, si nevoja emergjente për intervenim, për çka edhe morën mbështetjen e kryetarit Begaj, për zgjidhjen e këtyre problemeve. Çështje tjera me të cilat përballen, janë edhe rrejtja e dobët, ujësjellësi, asfaltimi i disa rrugicave, trajtim më të mirë për disa raste të rënda sociale.

Për të gjitha këto probleme, banorët e fshatit, kanë marrë premtimin e kryetarit Begaj, për angazhim maksimal në zgjidhjen e të gjitha problemeve, ndërsa prioritet për kryetarin, mbetet çështja e grumbullimit të mbeturinave dhe rregullimi i kanalizimit.

Kryetari Begaj priti kryetarin e Mamushës Arif Bütüç

Malishevë, 13 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me bashkëpunëtor, ka pritur sot kryetarin e Komunës së Mamushës, z.Arif Bütüç, me bashkëpunëtor, ku është diskutuar edhe mundësia e bashkëpunimit mes dy komunave, në të gjitha fushat dhe shkëmbimi i përvojave mes drejtorive komunale, si në administratë, bujqësi, kulturë dhe fusha tjera.



Fillimisht kryetari Begaj e informoi kryetarin Bütüç, me qeverinë komunale, pastaj për gjendjen e përgjithshme në Komunën e Malishevës. “Bashkëpunimi mes dy komunave, është i mirëseardhur, sidomos me një komunë, siç është Mamusha, e cila është një shembull i mirë i funksionimit të komunës, pavarësisht që është njëra prej komunave më të reja”, tha Begaj, i cili u shpreh i gatshëm të ofroj përvojën e Malishevës, në fushat e caktuara.

Nga ana tjetër, kryetari i Mamushës, z.Bütüç, tha se “dëshiron të ketë bashkëpunim mes dy komunave, mes drejtorive, për ti shkëmbyer përvojat e mira, në gjitha fushat e qeverisjes komunale”, tha Bütüç, i cili shprehi gatishmërinë e tij, për ndërmjetësuar në shkëmbimin e përvojave edhe me komunat e Turqisë. Kryetari Bütüç, e ftoi Komunën e Malishevës, që të marr pjesë në festivalin tradicional të domates, që mbahet në Mamushë, sikur edhe i bëri ftesë kryetarit Begaj dhe qeverisë komunale, për një vizitë në Mamushë, për të vazhduar bashkëpunimin mes dy komunave.



“Jam krenar që jam kosovar. Kosova është një shtet kur të gjithë kanë të drejta të barabarta dhe këtë e them gjithmonë edhe në asociacionin botëror të komunave që flasin gjuhën turke. Ndihem mirë dhe krenar edhe me kontributin e Turqisë, në vazhdimësi që ka dhënë për Kosovën”, tha kryetari i Mamushës, Arif Bütuç.

“Mamusha gjatë luftës së UÇK-së, ka strehuar 45 mijë refugjatë dhe dhurata më e mirë për këtë kontribut të Mamushës, është dhënia e statutit të komunës, por ne punojnë për shtetin e Kosovës, për Kosovën Evropiane dhe ndihemi krenar për këtë. Neve na ndanë vetëm gjuha, të gjitha të tjerat i kemi të përbashkëta dhe ne nuk dallohemi nga shumica shqiptare, pasi i kemi të gjitha të drejtat e barabarta, duke filluar nga shkollimi, lëvizja e lirë, dokumentacioni dhe të tjerat, që neve nuk na dallon nga të tjerët”, tha kryetari Bütuç. Bütuç, tha “e ka letërnjoftimin në gjuhën e tij, në gjuhën turke, dhe kjo dëshmon se turqit janë të barabartë”.

Policia dhe drejtorja e arsimit mbajnë ligjërata në shkolla për sigurinë

Malishevë, 13 shkurt



Policia e Kosovës, në bashkëpunim me drejtorinë komunale për Arsim dhe Edukim, sot kanë përfunduar ciklin e ligjëratave në shkollat e mesme të larta të Komunës së Malishevës, për çështjen e sigurisë në shkolla, me qëllim të ruajtjes së sigurisë në shkollat e komunës sonë dhe krijimit të ambientit të qetë dhe të sigurt për nxënësit dhe mësuesit. Këto ligjërata janë mbajtur nga komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapitenit Halil Morina dhe drejtorit komunal për arsim,

z.Blerim Thaçi.

“Siguria në shkollat e Komunës së Malishevës, është në nivelin e kënaqshëm, pasi nuk janë shënuar raste të rënda të prishjes së imazhit të sigurisë në shkolla, por qëllimi ynë është që ta ruajmë këtë gjendje të mirë të sigurisë”, tha mes tjerash kapiteni Morina. Sipas tij, ngjarjet e fundit në disa shkolla në qytete të ndryshme të Kosovës, i kanë shtyrë që të mbajnë këto takime, me qëllim të vetëdijesimit të nxënësve dhe stafit mësues. “Ne si polici, jemi të

gatshëm të ofrojmë siguri të plotë për të gjithë, edhe jashtë ambienteve të shkollave, por na duhet edhe bashkëpunimi i juaj dhe i qytetarëve, për ruajtjen e sigurisë, pavarësisht se deri më tani përveç incidenteve të vogla, në shkollat tona, nuk janë regjistruar raste të cilat rrezikojnë sigurinë e nxënësve apo të mësimit”, tha komandanti i stacionit policor në Malishevë.

Nga ana tjetër, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Blerim Thaçi, ka falënderuar Policinë e Kosovës, “jo vetëm për këto ligjërata, por edhe për kujdesin e shtuar në raport me shkollat e Komunës së Malishevës dhe përkrahjen që po japin për krijimin e sigurisë së plotë në shkollat tona”. “Pavarësisht se nuk ka pasur raste të rrezikimit të sigurisë në shkollat, masat parandaluese duhet të merren edhe nga menaxhmenti i shkollave”, tha drejtori Thaçi.

Ligjërata e mbajtur sot në Qendrën e Kompetencës në Malishevë, ishte e treta me radhë në kuadër të ligjëratave në shkollat e nivelit të mesëm të lartë, pasi paraprakisht, këto ligjërata dhe debate, janë mbajtur në shkollën profesionale në Kijevë dhe Gjimnazin në Malishevë.

Kryetari Begaj, takoi banorët e Llapqevës dhe Panorcit

Malishevë, 14 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, në kuadër të vizitave në fshatra, mbrëmë ka vizituar fshatrat Llapqevë dhe Panorc, ku është biseduar me banorët për problemet e tyre në përgjithësi dhe në veçanti për çështjen e mbeturinave dhe etheve hemorragjike, ku kryetari Begaj, ka kërkuar që të largohen mbeturinat nga pikat ilegale të hedhjes së tyre dhe të bëhet kujdes i shtuar në raport me ethet hemorragjike.

“Largimi i mbeturinave nga ambienti, është prioritet i qeverisjes sonë dhe këtë do ta bëjmë, por ta bëjmë të gjithë së bashku, në mënyrë që të jetojmë në një ambient të pastër, për të mirën tonë, për shëndetin tonë dhe të fëmijëve tanë”, ka thënë mes tjerash kryetari Begaj. “Këto mbeturina, janë edhe burim i infeksioneve të ndryshme, përfshi edhe ethet hemorragjike, pasi në to jetojnë brejtësit, por edhe rriqrat, si burimet kryesore të infektimit



me ethe hemorragjike”, tha Begaj. Kryetari Begaj, po ashtu, ju bëri thirrje, që banorët e këtyre dy fshatrave, të futen në sistemin e grumbullimit të mbeturinave.

Një pikë tjetër me rëndësi në këtë debat me qytetarët e këtyre fshatrave, ishte edhe problemi i etheve hemorragjike. “Ne si komunë, bëjmë gjithçka që është në dorën tonë dhe angazhimi ynë nuk mungon, por ju lus të bëni kujdes të shtuar, qoftë me fëmijët tuaj, qoftë gjatë kryerjes së punëve të përditshme në fushë. Kontrolloneni veten dhe fëmijët, nëse janë të prekur nga rriqrat dhe mos i largon vet rriqrat, por shkoni në qendrat mjekësore”, ju ka thënë Begaj banorëve, përderisa i ka informuar edhe me aktivitetet e Komunës dhe institucioneve përgjegjëse për luftimin e etheve hemorragjike, sikur edhe me strategjinë kombëtare për luftimin e kësaj sëmundje vdekjeprurëse. “Mos lejoni që për shkak të pakujdesisë të shkaktohen vdekje”, ju ka thënë kryetari Begaj, banorëve.

Funksionimi i kanalizimit, pastaj uji për pije dhe investimet në infrastrukturën e përgjithshme, ishin problemet kryesore me të cilat përballem banorët e këtyre fshatrave, e po ashtu nuk mbesin anash as problemet socio-ekonomike, për çka kryetari Begaj, tha se komuna është shërbimin tyre dhe është duke punuar në rritjen e mirëqenies për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës dhe kjo (mirëqenia) është prioritet i qeverisjes në katër vitet e ardhshme.

Kryetari priti palët

Malishevë, 14 shkurt

Duke filluar nga dita e sotme, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka filluar pritjen e palëve në zyrën, sipas orarit të paraparë, çdo të premte nga ora 13 deri në ora 16. Kryetari Begaj, çdo të premte, në këtë kohë, do ti pres të gjithë ata qytetar që kanë nevojë të takohen drejtpërdrejt me kryetarin e komunës, në mënyrë që të dëgjohen hallet dhe brengat e qytetarëve.

Gjatë ditës së sotme, për tri orë të plotë kryetari Begaj, ka pritur dhjetëra qytetar të vendbanimeve të ndryshme të Komunës së Malishevës, ku është njoftuar me hallet dhe brengat e tyre dhe në të njëjtën kohë, ju ka ofruar përkrahjen, duke dhënë këshillat e nevojshme dhe duke ju dhënë sugjerimet e nevojshme, për çështjet e caktuara.

Problemet kryesore të qytetarëve, janë kryesisht të natyrës socio-ekonomike, pastaj ato të problemeve tjera, si kanalizimet për lagjet e caktuara dhe të infrastrukturës në përgjithësi.

Me nderime varroset veterani i luftës së UÇK-së, Sahit Thaçi

Malishevë, 16 shkurt

Sot, me nderime u varros kryetari i degës së shoqatës së invalidëve të luftës së UÇK-së në Malishevë, Sahit Thaçi. Paraprakisht, në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani”, në Malishevë u bënë homazhe dhe u mbajt një mbledhje komemorativë, në kujtim të jetës dhe veprës së veteranit dhe invalidit të luftës së UÇK-së, Sahit Thaçit.

Në homazhet dhe mbledhjen komemorativë, morën pjesë qindra bashkëluftëtar të Sahitit, pastaj deputetët e Kuvendit të Kosovës, z.Halit Krasniqi dhe z.Haxhi Shala, zv/ministri i MPMS-së, z.Fatmir Shurdhaj, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe shumë qytetar të tjerë.



Në mbledhjen komemorativë, i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, duke marrë fjalën, pas ngushëllimeve për familjen dhe shokët, tha se “Këtë nderim Ne po i bëjmë sot një njeriu, i cili gjatë gjithë jetës së tij ishte i angazhuar për çështjen kombëtare. Sado që dhembja është e madhe ne ndihemi krenar për kontributin që dha gjatë luftës për lirinë e atdheut dhe pas luftës si aktivist i devotshëm, ku vdekja e gjeti në krye të shoqatës së invalidëve të luftës”, tha mes tjerash kryetari Begaj.

Në emër të tri shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së në Malishevë, foli Selajdin Sertolli, i cili në formë kronologjike, foli për veprimtarin e Sahit Thaçit, gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ndërsa në Faton Thaçi, bashkëluftëtar dhe bashkëvendës i Sahiti, foli për jetën dhe veprimtarin e tij, që nga arrestimi i tij si gjimnazist, për të vazhduar me luftën e UÇK-së, plagosjen e tij, dhe deri në ditët e sotme, duke vazhduar veprimtarin e tij, në mbrojtje të të drejtave të invalidëve të luftës së UÇK-së.

Sahit Thaçi, u varros në varrezat e fshatit të lindjes në Shkarashnik, me ceremonitë tradicionale dhe fetare.

Malisheva, shënoi gjashtë vjetorin e Pavarësisë

Malishevë, 17 shkurt



Me aktivitete të shumta, Komuna e Malishevës, ka shënuar gjashtë vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Aktivitetet e ditës së sotme, kanë filluar me një mbledhje solemne të mbajtur në Kuvendin e Komunës, pastaj janë bërë nderime para shtatores së Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, homazhe tek varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë, vizitë në Prekaz, tek varrezat dhe në familjen Jashari dhe në fund është mbajtur një koncert i në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinan” në Malishevë.

Të gjitha këtyre aktiviteteve, ju kanë paraprirë një sërë aktivitetesh tjera kulturore dhe sportive, të organizuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në mbledhjen solemne, të mbajtur në KK, në fjalimet e mbajtura nga kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, u kujtuan përpjekjet shekullore të popullit shqiptar, në veçanti të Kosovës,





përpyekje të cilat u finalizuan me luftën e lavdishme të UÇK-së dhe shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

Në vazhdim fjalimi i kryetarit të Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, të mbajtur me rastin e shënimit të 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Jemi mbledhur sot, që së bashku të kremtojmë gjashtë vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, duke mos harruar me këtë rast përpyekjet dhe sakrificat e brezave të tërë, të cilët sollën datën e madhe historike të 17 shkurtit 2008. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës, kurorëzoi ëndrrat dhe aspiratat e popullit tonë që heroikisht gjatë tërë historisë u bëri ballë sfidave.

Kosova, në rrugëtimin e saj qindra vjeçar, gjithmonë ka qenë një njësi administrative, që nga koha e pushtimit turk, kur Kosova ishte vilajet, për të vazhduar të mbetet e ndarë fizikisht nga pjesa tjetër e popullit shqiptar. Pas shumë përpyekjeve, më 1878, u mbajt Lidhja Shqiptare e Prizrenit, me qëllim të formimit të shtetit shqiptar. Lidhja ishte lëvizja e parë e madhe e organizuar politikisht, administrativisht dhe ushtarakisht për të krijuar një rajon të bashkuar shqiptar qysh nga koha e lavdishme e [Skënderbeut](#).

Edhe në vitin 1913, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, Vilajeti i Kosovës, padrejtësisht nga fuqitë e mëdha, përsëri u nda nga pjesa tjetër e kombit, për t'ju dhënë në administrim Serbisë.

Më pas vjen Lidhja e Dytë e Prizrenit, në vitin 1943, që ishte organizim i krerëve nacionalist shqiptar, por që kryeministri i zgjedhur, u internua, dhe sikur herëve tjera, edhe kjo përpyekje nuk e arrin qëllimin final. Më pas vjen edhe Konferenca e Bujanit, dhjetor 1943- janar 1944, ku sipas rezolutës së dalë nga kjo konferencë, pas fitores ndaj fashizmit, populli shqiptar i Kosovës, të ketë të drejtën e realizimit të aspiratave të saj, për tu bashkuar me Shqipërinë. Edhe kjo nuk u realizua në anë atë periudhë.

Edhe pas Luftës së parë dhe të dytë Botërore, Kosova mbeti në administrimin e ish Jugosllavisë, por si një njësi e veçantë administrative. Megjithatë populli shqiptar kurrë nuk hoqi dorë nga përpyekjet për pavarësi dhe bashkim kombëtar. Në vitin 1990, Kosova u shpall republikë dhe në vitin 1991 shtet i pavarur, mirëpo nuk arriti ta jetësonte pavarësinë e vet në rrethanat e pushtimit ushtarak serb që zgjati plot një dekadë (1989-1999).

Qëndresa mbarëpopullore, Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (1997-1999) dhe ndërhyrja ajrore e NATO-s në pranverë të 1999 i dhanë fund gjenocidit të Serbisë mbi popullatën shqiptare të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe u mbajt edhe konferenca e Rambujesë, që për herë të parë, konsiderohet që faktori ndërkombëtar ishte në krah të kërkesave të popullit shqiptar të Kosovës, dhe si rrjedhojë, erdhi deri te intervenimi i NATO-s. Kjo mund të konsiderohet edhe si shumë e rëndësishme politikisht, pasi si rrjedhojë e saj, erdhi edhe deri te Shpallja e Pavarësisë së Kosovës.

Kështu, më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli Pavarësinë dhe sot është e njohur nga 106 shtete të botës demokratike.

Në gjashtë vite të shtet ndërtimit, Kosova ka ndërtuar institucionet e saja demokratike, ka shënuar suksese dhe është bërë faktor i paqes në rajonin dikur të trazuar të Ballkanit.



Ne edhe sot në këtë ditë të shënuar përkulemi para aktit madhorë të flijimit të komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, përkulemi para të rënëve të të gjithë brezave që janë më meritoret për shtetin e Kosovës.

Gjashtë vite pavarësi nuk janë shumë, por ne tashmë jemi dëshmitarë të ndryshimeve rrënjësore pasi Kosova e njohur nga 106 shtetet më të fuqishme të botës është bërë faktor stabiliteti dhe ajo po bëhet pjesë e asaj së cilës i përket gjeografikisht - Evropës së qytetëruar.

Veç kësaj, Kosova tashmë është anëtare e Bankës Botërore, e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e organizatave tjera të shumta kurse është në rrugë të mirë që së shpejti të jetë edhe anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në këtë ecje dhe në këta përvjetor, Malisheva ka të drejtë të mburret për kontributin e saj në lirinë e Kosovës pasi vetëm gjatë luftës së fundit të UÇK-së i dha Kosovës 70 dëshmor, rreth 400 martir, pothuaj tërë pasurinë e krijuar për deçenie e cila u shkatërrua gjatë luftës kurse edhe tash rreth 30 qytetarë të kësaj komune konsiderohen të zhdukur pasi gjatë luftës janë rrëmbyer nga forcat serbe.

Të nderuar pjesëmarrës, zonja dhe zotërinj,

Bashkë me shtetin e Kosovës, në këto gjashtë vite ka ecur edhe komuna e Malishevës e cila pikërisht gjatë kësaj periudhe ka shënuar zenitin e zhvillimit dhe të përparimit të saj pasi për përmirësimin e jetës së qytetarit të kësaj komune krahas infrastrukturës rrugore e cila tashmë është rrumbullakuar, ka shënuar suksese të mëdha edhe në fushat tjera.

Të nderuar qytetar të Komunës së Malishevës.

Për ngritjen e një jete më të mirë për qytetarët e komunës së Malishevës, ju ftoj që të vazhdojmë me punën tonë të përbashkët, pasi të gjithë ne kemi një obligim, sepse na obligojnë sakrificat e mëdha të këtij populli, gjaku i derdhur, lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me në krye komandantin legjendar Adem Jashari.

Konsiderojmë se vlera e Pavarësisë së Kosovës matet në radhë të parë me përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe në këtë drejtim ne do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim dhe pa u ndalur për ngritjen e projekteve tjera, të cilat do të lehtësojnë jetën e qytetarit të Malishevës pasi ne e meritojmë këtë.

Të nderuar pjesëmarrës, më lejoni edhe njëherë t'ju uroj për gjashtë vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Urime !

Kryetari Begaj dhe KFOR-i biseduan për bashkëpunim kundër etheve hemorragjike

Malishevë, 18 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur një delegacion të KFOR-it gjerman në Kosovë, të prirë nga togeri i marinës gjermane Benjamin Rapp, me të cilët biseduan për çështjen e etheve hemorragjike, thumbimin nga rriqrat dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në këtë fushë të sigurisë në shëndetësi.

“Jam i shqetësuar për këtë situatë me ethet hemorragjike, pasi ky virus po merr jetën e njerëzve tanë. Është i formuar këshilli ndërministror që

merret direkt me këtë çështje dhe me masat parandaluese, por ne jemi të shqetësuar për shëndetin e qytetarëve tanë. Unë ju falënderoj për interesimin tuaj dhe kërkoj që të bashkëpunojmë në këtë drejtim, në mënyrë që të zvogëlojmë rastet e infektimit nga ethet hemorragjike, qoftë të qytetarëve tanë, ashtu edhe të pjesëtarëve të KFOR-it”, tha kryetari Begaj.

Ndërsa zyrtarët e KFOR-it, thanë se “po e përcjellin situatën, pasi janë të shqetësuar lidhur me këtë, si për qytetarët, ashtu edhe për ushtarët e KFOR-it dhe jemi të hapur në këtë drejtim”. Ushtarakët e KFOR-it, thanë se do të jenë në kontakt edhe me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, në mënyrë që të bashkëpunojmë në këtë drejtim, për të mbrojtur jetën e njerëzve.

Ushtarakët e KFOR-it dhe kryetari Begaj, u pajtuan për bashkëpunim të ndërsjellë, për ethet hemorragjike dhe pickimit nga rriqrat, si bartës të këtij virusi vdekje prurës.

PZHK prezantoi projektin për zgjerimin e urës në qytet

Malishevë, 19 shkurt

Grupi i punës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), ka bërë prezantim publik të projektit “Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe hapësirave publike në qendrën e qytetit”, në Malishevë, ku përmes këtij prezantimi, janë njoftuar qytetarët pjesëmarrës, me këtë projekt, i cili ka për qëllim zgjerimin e trotuareve në urën mbi lumin Mirusha, urë në të cilën, lëvizshmëria është e kufizuar për shkak të hapësirës.

Në këtë prezantim, ishin të pranishëm edhe kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, përfaqësues të UN HABITAT-it, si bashkë financues dhe bashkë hartues të PZHK-së, si dhe qytetar të Malishevës, e më gjerë, të cilët dhanë kontributin e tyre në finalizimin e këtij projekti.



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, e quajti shumë të rëndësishëm, këtë projekt dhe në tërësi hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, ndërsa zyrtarët e UN HABITAT-it, përgëzuan ekipin komunal, për punën e tyre, në të gjitha fazat e hartimit të këtij plani në përgjithësi dhe këtij projekti në veçanti. “Besoj që komuna e Malishevës do të jetë shembull me këtë projekt, ngase implementimi i këtij projekti është i domosdoshëm dhe i dobishëm për hapësirën e lëvizshmërisë së qytetarëve. Është e nevojshme dhe në interes të banorëve të Malishevës “ tha në mes tjerash kryetari Begaj.

Në këtë prezantim, nga ana e UN HABITAT-it, u bë e ditur se PZHK e Malishevës, është në harmoni të plotë me Ligjin për Planifikim Hapësinor të Kosovës dhe Komuna e Malishevës, është marrë si shembulli më i mirë dhe model për komunitet tjera, në hartimin e këtyre planeve në harmoni me ligjin.

Sipas prezantimit për projektin e zgjerimit të urës në Malishevë, parashihet zgjerimi i trotuareve përgjatë urës, ku mund të lëvizin qytetarët pa problem, sikur edhe personat me aftësi të kufizuara, pastaj dekorimi i urës, kufizimi, hapësira përgjatë lumit Mirusha, ku parashihen trotuare, ulëse dhe mbi të gjitha hapësira të gjelbra.

Kryetari Begaj, takoi banorët e Damanekut, Bublilit dhe Qupevës

Malishevë, 19 shkurt

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtorët e drejtorive komunale, ka takuar sonte banorët e fshatrave të Damanekut, Bublilit dhe Qupevës, me qëllim të njohjes së drejtpërdrejt me hallet dhe problemet që kanë banorët e Komunës së Malishevës, dhe në të njëjtën kohë, për ta sensibilizuar opinionin me problemin e etheve hemorragjike dhe për largimin mbeturinave nga ambienti.



“Unë jam në shërbimin tuaj dhe dua që së bashku të ecim përpara. Dua të punojmë së bashku, si një familje”, ju ka thënë kryetari Begaj, banorëve të këtyre fshatrave. Më tej Begaj, ju ka thënë se në qeverisjen e tij, prioritet ka mbrojtjen e ambientit ku jetojmë, duke ju bërë thirrje banorëve të këtyre fshatrave, që të angazhohen për largimin e mbeturinave nëpër deponitë ilegale dhe për ta ruajtur ambientin.

Ndërsa drejtori i shëndetësisë, z.Hajdin Berisha, i ka njoftuar me masat parandaluese që janë duke marrë institucionet vendore dhe komuna, për zvogëlimin e rrezikut nga thumbimi i rriqrave dhe ethet hemorragjike. “Humbja e jetës së vetëm një personi, është shumë, andaj, edhe ne duhet të bëjmë kujdes ët shtuar, qoftë gjatë punës sonë në fushë, ashtu të bëjmë kujdes për fëmijët tanë. Edhe nëse thumboheni nga rriqrat, mos i largoni vet, por kërkoni ndihmë nga qendrat shëndetësore, sepse vetëm kështu mund të mbrohemi nga ethet hemorragjike”, ka thënë mes tjerash drejtori Berisha. Ai i ka njoftuar me të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të masave parandaluese, si dhe për strategjinë kombëtare për luftimin e etheve hemorragjike.

Nga ana tjetër, banorët e Damanekut, kanë paraqitur si nevojë emergjente për këtë fshat, pastrimin e përroskës në fshat, pasi është shumë e ndotur, pastaj rregullimin e një pjese të kanalizimit të fshatit dhe trotuarin përgjatë rrugës kryesore, deri në shkollë. Trotuari ishte nevojë edhe për banorët e Bublilit dhe Qupevës, sikur edhe rregullimi i kanalizimit në disa lagje, pastaj rregullimi i disa rrugëve në lagjet e Bublilit. Për këto nevoja të këtyre fshatrave, kryetari Begaj, premtoi angazhim maksimal të qeverisë komunale, për zgjidhjen e tyre.

Pensionistët takuan kryetarin

Malishevë, 20 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot kryetarin e shoqatës së pensionistëve të Kosovës, z.Shaban Kajtazi, me bashkëpunëtor, me të cilët është biseduar për gjendjen e pensionistëve të Kosovës në përgjithësi dhe në veçanti të pensionistëve të Malishevës.

Shoqata e pensionistëve të Kosovës, kanë falënderuar kryetarin Begaj, për përkrahjen e pensionistëve të Malishevës, si në të kaluarën, ashtu edhe tani, si dhe për bashkëpunimin e ndërsjellët.

Nga ana tjetër, kryetari Begaj, ju ka ofruar mbështetjen e Komunës së Malishevës, në kuadër të mundësive që ka komuna. “Brenda mundësive që kemi si komunë, ne do të bëjmë çdo gjë, në mënyrë që pensionistët malishevas dhe shoqata e tyre , të kenë mundësi të zhvillojnë aktivitetet në kushte të mira dhe të ndihen rehat”, ka thënë Begaj.

Kryetari Begaj priti zyrtarët e Ministrisë e Forcës së Sigurisë të Kosovës

Malishevë, 20 shkurt



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj ka pritur sot zyrtarët e lartë të Ministrisë të Forcës së Sigurisë të Kosovës (MFSK), z.Hajrush Kurtaj, drejtor i departamentit të bashkëpunimit civilo-ushtarak në MFSK, dhe z.Beqir Beqa, drejtor i departamentit për ndërlidhje në MFSK, ku diskutuan për bashkëpunim dhe koordinim të Komunës së Malishevës me MFSK-në.

Kryetari Begaj, falënderoi zyrtarët e MFSK-së për vizitën dhe u shpreh i gatshëm për bashkëpunim dhe koordinim në çdo fushë, që është në interes të Komunës së Malishevës. ”Besoj që së shpejti do të kem edhe ushtrinë tonë”, tha kryetari Begaj. Ai më pas tha se “ për ne si komunë është shumë me rëndësi përkrahja,

bashkëpunimi dhe koordinimi juaj, rreth shqetësimit apo sëmundjes me ethet hemorragjike që komuna jonë dhe ne po ballafaqohemi”

Nga ana tjetër, z.Hajrush Kurtaj ka falënderuar kryetarin Begaj për mikpritjen. “ Forcat e Sigurisë tani më janë veç në fazën e transferimit, dhe ne do të jemi sa më afër qytetarëve , do të koordinohemi dhe bashkërisht do të zgjedhim problemet që ka komuna juaj” tha z.Kurtaj.

Begaj e Kurtaj, kanë biseduar edhe për çështje të tjera të bashkëpunimit mes komunës dhe MFSK-së.

Malisheva dhe Suhareka shkëmbejnë përvojat në fushën e Informimit Publik

Malishevë, 20 shkurt



Në kuadër të projektit të OSBE-së, zyra rajonale në Prizren, “Përmirësimi i transparencës lokal, përmes qasjes më të mirë në informatat publike”, sot është mbajtur takimi i parë, mes komunave të Malishevës dhe Suharekës, ku janë shkëmbyer përvojat e dy komunave, me qëllim të rritjes së transparencës në nivelin lokal.

Në këtë takim, kanë marrë pjesë, drejtori rajonal i OSBE-së, z.Ulrich Biffar, nënkryetarët e komunave të Malishevës dhe Suharekës, z.Rexhep Mazreku dhe z.Rexhep Kuçi, përfaqësuesit e KDI-së, zyrtarët tjerë komunal të dy komunave dhe zyrtar tjerë të OSBE-së.

Drejtori rajonal i OSBE-së, z.Ulrich Biffar, ka folur për rëndësinë e rritjes së transparencës së komunave dhe prezantimi i komunave në ueb faqet e tyre, përmes së cilës arrin të informohet opinioni i gjerë me punët dhe aktivitetet në komunë.

Edhe nënkryetarët e komunave të Suharekës dhe Malishevës, Kuçi e Mazreku, e vlerësuan rëndësinë e rritjes së transparencës, përmes shkëmbimit të përvojave mes komunave.

Naim Cahani nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), që monitorojnë punën e Komunave dhe Kuvendeve Komunale, ka folu për transparencën në nivelin lokal dhe për ueb faqet e komunave, si një mekanizëm i rëndësishëm për prezantimin e komunave dhe lidhjen me opinionin e gjerë, në mënyrë që qytetari të jetë i informuar dhe të ketë qasje të mjaftueshme në informata.

Pas këtyre prezantimeve, prezantimet e tyre i kanë bërë zyra për informim të dy komunave, ku është prezantuar mënyra e punës, publikimet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen zyrat për informim. Ky prezantim është bërë në formë të debatit.

Kryetari Begaj vazhdon vizitat nëpër fshatra

Malishevë, 20 shkurt



Mbrojtja e ambientit, largimi i mbeturinave dhe masat parandaluese, përkatësisht fushata e vetëdijesimit për mbrojtje nga ethet hemorragjike, janë dy nga temat kryesore që kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe qeveria komunale, po i diskutojmë me qytetarët e Komunës së Malishevës, gjatë vizitave nëpër fshatra dhe takimet e drejtpërdrejta me qytetarët. “Humbja e një jete të një qytetari nga ethet hemorragjike, është humbje

për të gjithë ne. Vdekjen askush nuk mund ta ndal, por bëni kujdes nga thumbimi i rriqrave, të cilat e bartin virusin e etheve “krime kongo”, kontrollojeni veten tuaj gjatë punëve të përditshme, kontrolloni fëmijët dhe mos lejoni që nga pakujdesia të vjen deri të infektimi”, ju ka thënë kryetari Begaj, banorëve të fshatrave Turjakë dhe Gurbardh. “Ne do të jemi 24 orë në shërbimin tuaj, në mënyrë që të mbrohemi nga ky virus. Situata nuk është aq alarmante, por ne vet mund të bëjmë kujdes”, tha Begaj. Po ashtu kryetari Begaj, kërkoi nga këto fshatra, që mos të hedhin mbeturina në ambient të hapur, sidomos në fshatin Gurbardh, ku mbeturinat hidhen në afërsi të burimit të ujit. “Hyni në sistemin e grumbullimit të mbeturinave dhe ejani,



organizohuni, që së bashku ti largojmë mbeturinat, pasi burimi kryesor i shumë sëmundjeve dhe ndotjes së ambientit”, ka bërë thirrje kryetari Begaj.

Drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, i ka njoftuar banorët e këtyre dy fshatrave, për angazhimet e komunës dhe institucioneve shtetërore, për strategjinë e masave mbrojtëse, kundër rriqrave, si masë parandaluese kundër etheve hemorragjike “krime kongo”.

Përveç këtyre temave, janë diskutuar edhe çështje tjera, që lidhen me përditshmërinë e banorëve të Komunës së Malishevës, si infrastruktura, pastaj çështjet sociale dhe të tjera. z.Ekrem Kastrati, drejtor i administratës, tha se “qeveria Begaj i ka katër prioritete, e ato janë: parandalimi ose zvogëlimi i rrezikut nga ethet hemorragjike, ambienti, rregullimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i shërbimeve administrative”.

Ndërsa drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, tha se “hallet e juaja, janë përgjegjësi për ne, ju jeni pjesë e qeverisjes, pasi buxheti është i mbushur nga ju. Ne kemi rreth katër milion euro buxhet për investime kapitale dhe me këto, do të ndërtojmë pesë shkolla, pastaj rregullim të infrastrukturës, për fushatën kundër etheve hemorragjike, dhe besoj që këtë vit do ti zgjidhim këto problemet emergjente”.

Nga ana tjetër, banorët e këtyre fshatrave, e kanë paraqitur si prioritete për këto fshatra rregullimin e kanalizimit, gjegjësisht riparimin e tij, pastaj asfaltimin e disa rrugëve, trotuare, si dhe problemin e rrjetit të dobët elektrik. Në fshatin Gurbardh, nevojë emergjente, ishte pastrimi sa më i shpejt i mbeturinave, në afërsi të burimit të ujit, të cilat janë hedhur nga vet banorët.

Kryetari Begaj, priti palët

Malishevë, 21 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, si çdo të premte, edhe sot ka hapur dyert për qytetarët, duke i dëgjuar hallet dhe problemet e përditshme që kanë banorët e Komunës së Malishevës, qoftë si individ, apo si komunitet, duke ju ofruar kështu ndihmën e institucionit të komunës dhe duke ju dhënë këshillat e nevojshme për çështjet e caktuara.

Si zakonisht, problemet kryesore të shfaqura nga qytetarët , ishin kryesisht ato socio-ekonomike, problemet me infrastrukturën e përgjithshme dhe një çështje shumë preokupuese ajo për punësim dhe nevojat tjera të ndryshme, kryetari Begaj ju premtoi që do të angazhohet dhe do të mundohet ti minimizoj problemet dhe brengat që qytetarët shfaqen tek ai.

Për të gjitha këto brenga kryetari Begaj, ka ofruar përkrahjen e tij maksimale, ku tha “ çdo shqetësim apo breng e qytetarit të Malishevës është edhe shqetësim i imi i cili më prek jashtëzakonisht shumë, dhe do mundohem të ju siguroj një jetë më të mirë dhe të jem i barabartë me ju”, do të jem i hapur dhe i afërt me ju çdoherë, dhe së bashku do të ballafaqohemi me problemet.



U mbajt mbledhja e rregullt e qeverisë komunale

Malishevë, 24 shkurt

Qeveria Komunale e Malishevës, nën udhëheqjen e kryetarit të Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të së hënës, ku janë diskutuar një varg çështjesh, që lidhen me aktivitetet e përditshme të drejtorive komunale, e ku më me rëndësi ishin përgatitjet për shënimet e datave të rëndësishme të marsit.

Fillimisht kryetari Begaj, kërkoi nga drejtorët, që të gjithë punëtorët në drejtoritë komunale, të mbajnë disiplinën dhe të respektojnë orarin e punës, si dhe kërkoi përgjegjësi nga drejtorët në udhëheqjen e drejtorive.

Shënimi i datave të rëndësishme të marsit, si “Epopeja e UÇK-së” më 5,6 dhe 7 mars, pastaj 7 marsi, Dita e Mësuesit, si dhe 8 marsi, dita e gruas, ishin ndër temat e diskutuar dhe përgatitja për shënimin e këtyre datave.

Temë tjetër me rëndësi, ishte edhe çështja e etheve hemorragjike, ku drejtori i drejtorisë për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, tha se “drejtoria e tij, ka shtuar aktivitetet në këtë drejtim, ku janë duke u zhvilluar disa fushata vetëdijesimi me qytetarët, pastaj nga 1 marsi do të fillojnë fushatat e mbajtjes së ligjëratave nëpër shkollat e Komunës së Malishevës, spotet mediale dhe të tjera, dhe të gjitha këto, janë në harmoni me strategjinë kombëtare për luftimin e etheve hemorragjike”.

E angazhuar në këtë drejtim, është edhe drejtoria e bujqësisë, ku drejtori i kësaj drejtorie, z.Hajrullah Mazreku, tha se “ gjatë vizitat që ka pasur gjatë javës së kaluar në teren, i ka njoftuar fermerët për kujdesin e shtuar nga kontakti me rriqra dhe brejtës, si bartës të etheve hemorragjike”.

Në këtë mbledhje, u diskutuan edhe çështje të tjera, që kanë të bëjnë me projektet që do të realizohen, prezantimet para donatorëve të mundshëm, pastaj ndriçimi publik, kërkesat e qytetarëve dhe të tjera.

Kryetari Begaj, priti komandantin e jugut të KFOR-it, kolonelin Topaloğlu

Malishevë, 24 shurt

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën tij, komandantin e detashmentit të Përbashkët Rajonal të Jugut (JRD) të KFOR-it, kolonelin Zorlu Topaloğlu, ku është biseduar për bashkëpunimi e ndërsjellë në fushën e sigurisë, si dhe diskutuan rreth problemeve që ka komuna e Malishevës.

Kryetari Begaj, falënderoi për vizitën, dhe u shpreh për bashkëpunim të ngushtë me KFOR-in, në fushën e sigurisë dhe çështje tjera. ” Ne si komunë kemi probleme, por brenga më e madhe për ne janë ethet hemorragjike, ngase tani kemi 5-së raste që fatmirësisht, janë vetëm



të pickuar , por jo edhe të infektuar, dhe në këtë aspekt kërkoj bashkëpunimin dhe ndihmë më të madhe nga të gjithë, që të jemi sa më aktiv rreth parandalimit të sëmundjes me ethet hemorragjike” Po ashtu kryetari Begaj, e njoftoi ushtarakun , me rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, si dhe me problemet me të cilat përballlet komuna e Malishevës.

Nga ana tjetër, koloneli turk, Topaloğlu tha “ Ne jemi këtu që te ju dalim në ndihmë, në mënyrë që Kosova të i arrin qëllimet, mirëpo çështja kryesore është ajo e sigurisë, dhe që po arrin të jetë shumë e qetë dhe e sigurt”.

Begaj dhe koloneli Topaloğlu, u shprehen të gatshëm për bashkëpunim në fushën e sigurisë dhe në fusha tjera.

Blerina Mazreku kryetare e KVRL në Malishevë

Malishevë, 25 shkurt



Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL) në Malishevë, dje ka mbajtur Kuvendin e tretë zgjedhor, ku edhe ka zgjedhur kryetaren e KVRL-së, si dhe bordin udhëheqës prej shtatë anëtarëve, ka bërë të ditur zyrtari komunal për rini, z.Mehdi Krasniqi. Kryetare e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal, është zgjedhur Blerina Mazreku.

Në punimet e Kuvendit ka marrë pjesë edhe drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Blerta Krasniqi, e cila i ka përshëndetur të rinjtë, përfaqësues të organizatave rinore në Malishevë. “Në emër të Kryetarit të Komunës, z.Ragip Begaj dhe emrin tim, ju dëshiroj suksese në këtë kuvend dhe uroj që në të ardhmen, të punoni shumë dhe të keni sa më shumë aktivitete”, ka uruar drejtoresha Krasniqi.

Kuvendi i KVRL-së, ka vendosur që bordo udhëheqës, të përbëhet prej shtatë anëtarëve, si dhe pas zgjedhjes së kryetares, janë emëruar edhe dy nënkryetar të KVRL-së. Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, përbëhet nga organizata rinore, si Qendra e Rinisë, Këshillat Rinor, të tri shkollave të mesme dhe organizata tjera rinore, që merren me të rinjtë.

Kuvendi i tretë i KVRL-së, është monitoruar nga OSBE dhe Worldvision.

Kryetari Begaj, priti përfaqësuesit e MPB-së

Malishevë, 25 shkurt

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, me bashkëpunëtor, ka pritur në një takim njohës dhe punë njëkohësisht, një delegacion nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), të kryesuar nga z.Imer Thaçi, me të cilët kanë biseduar për sigurinë e përgjithshme dhe rëndësinë e formimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).



z. Imer Thaçi, zyrtar i lartë në MPB, gjegjësisht në divizionin e Sigurisë Publike, tha se qëllimi i këtij takimi, është njoftimi dhe diskutimi për çështje të sigurisë së përgjithshme, si dhe për nevojën dhe rëndësinë e formimit të KKSB-së, përbërjen të cilën duhet të ketë dhe çështje tjera, që lidhen me plotësimin e standardeve në fushën e sigurisë për nivelin lokal.

Nga ana tjetër, komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, e ka vlerësuar të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme në Malishevë dhe kjo situatë është falë bashkëpunimit të mirë, që ka Policia e Kosovës, me pushtetin komunal.

Kryetari Begaj, i ka falënderuar për vizitën dhe këtë takim, përfaqësuesit e MPB-së, si dhe i ka njoftuar me procedurat e deritanishme për formimin e KKSB-së. “Në mbledhjen e ardhshme, besoj se Kuvendi i Komunës, do të miratojë përbërjen e KKSB-së”, tha Begaj, i cili më pas, gjithashtu e vlerësoi të qetë dhe stabile, situatën e sigurisë së përgjithshme dhe për këtë janë meritë të gjitha strukturat e sigurisë në vend.

Komuna vazhdon takimet me qytetar

Malishevë, 26 shkurt



Kryetari i Malishevës, z. Ragip Begaj, i shoqëruar nga disa anëtar të qeverisë komunale, kanë vazhduar edhe mbrëmë takimet e drejtpërdrejta me qytetar, për tu njohur me problemet që kanë fshatrat e Malishevës dhe më e rëndësishmja, për ti njoftuar qytetarët për strategjinë nacionale për luftimin e etheve hemorragjike dhe mbrojtjen e ambientit. Mbrëmë, janë mbajtur takime me banorët e Astrazupit, Shkozës dhe Jançishtit.

“E kemi obligim të dëgjojmë hallet e juaja dhe ti shfaqim planet tona, para juve, pavarësisht se për një kohë të shkurtë, nuk mund ti realizojmë të gjitha nevojat që kemi, por angazhimi



ynë do të jetë maksimal për përmbushjen e nevojave dhe projektet e parapara”, ka thënë kryetari Begaj, para banorëve të këtyre fshatrave. “Po ashtu edhe rastet e rënda sociale, do të ndihmohen nga komuna dhe në asnjë mënyrë, banorët e Komunës së Malishevës”, ka thënë mes tjerash kryetari Begaj.

Drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, i ka njoftuar për buxhetin e vitit 2014, formën e realizimit të projekteve, obligimet që ka komuna në raport me qytetarët, dëgjimet publike dhe mënyrën e futjes së kërkesave të banorëve në planifikimin e buxhetit. “Projektet kapitale, do të bëhen në bazë të kërkesave të juaja”, ka thënë drejtori Krasniqi.

Ndërsa drejtori i shëndetësisë, z.Hajdin Berisha, i ka njoftuar banorët këtyre fshatrave, me strategjinë nacionale për luftimin e etheve hemorragjike dhe për rëndësinë e kujdesit të shtuar që duhet të bëjnë vet qytetarët, gjatë kryerjes së punëve të përditshme, si dhe kujdesin e shtuar ndaj fëmijëve, duke ju bërë thirrje, që në asnjë mënyrë të mos i largojnë rriqrat, nëse vijnë deri të thumbimi, por të shkojnë në QKMF, pasi stafi shëndetësor është profesional dhe zvogëlohet mundësia e infektimit me ethe hemorragjike. “Ne si komunë, jemi maksimalisht të angazhuar në këtë drejtim dhe jemi 24 orë në dispozicion, për t’ju dalë në ndihmë qytetarëve”, ka thënë Berisha, duke i njoftuar gjithashtu për angazhimin e të gjitha institucioneve përgjegjëse në këtë drejtim.

Kërkesat kryesore të fshatit Astrazup ishin: sigurimi i ujit për pije, si problem kryesor dhe elementar për jetën, pastaj rregullimi i kanalizimit në disa lagje dhe ndërtimi i shkollës së fshatit. Kurse Shkoza dhe Jançishti, problem kryesor dhe emergjent e kanë rregullimin e kanalizimit, largimin e mbeturinave nga deponitë ilegale, disa rrugë dhe ndihmën për disa raste të rënda sociale.

“Komuna ka bërë incizimet e nevojshme në teren dhe kemi planifikuar rregullimin me urgjencë të kanalizimit në Jançisht dhe në vende tjera, ku nuk funksionon sistemim i kanalizimit, por edhe projektet tjera të infrastrukturës nuk do të mbeten anash, dhe shumë shpejt, shumë prej kërkesave të juaja, do të realizohen”, ka thënë drejtori i urbanizimit, z.Urim Kastrati.

Konstituohet komiteti për komunitete në Malishevë

Malishevë, 26 shkurt

Sot është mbajtur mbledhja konstituive e komitetit për komunitete, pas përbërjes së re të KK



të Malishevës, të dalë nga zgjedhjet e fundit komunale. Këtë mbledhje konstituive e hapi kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, ndërsa kryesues i komitetit për komunitete u zgjodh z.Fatmir Ademaj, anëtar i KK të Malishevës, nga radhët e LDK-së.

Kryesuesi i KK-së, z.Hoti, paraprakisht i ka njoftuar

anëtarët e komitetit me detyrat dhe përgjegjësitë që kanë, ndërsa ju ka dëshiruar punë të mbarë, me dëshirën që të punojnë në të mirë të komuniteteve të ndryshme në Komunën e Malishevës dhe për këtë punë, i siguroi që do ta kenë përkrahjen e Kuvendit të Komunës.

Unanimisht, z.Fatmir Ademaj, u zgjodh kryesues i komitetit për komunitete, ndërsa pas marrjes së kësaj detyre, ai tha se ka nevojë të punohet më shumë për komunitetet dhe këtë, do të mundohen ta bëjnë.

Anëtarë të Komitetit për Komunitete, janë:

Fatmir Ademaj (LDK)-kryesues

Luan Kryeziu (IQM)

Arlinda Thaçi (PDK)

Donjeta Foniqi (VV)

Naser Malisheva (RAE)

Vera Bytyçi (zyrtare për çështje gjinore)

Shyhrete Sertolli (shoqëria civile)

“The Dreamers” garon në 12 festivale

Malishevë, 26 shkurt



Filmi i parë për fëmijë, i realizuar në Malishevë nga aktorë fëmijë nga Malisheva, regjisor malishevas, nga një produksion malishevas dhe në gjuhën angleze, “The Dreamers”, ka treguar rezultat të mirë duke marrë disa çmime dhe do të garoj në 12 festivale të ndryshme ndërkombëtare në Gjermani, Francë, Britani të Madhe, Suedi, Kroaci, Slloveni,

Holandë, dhe vende tjera, në mesin e një konkurrence prej 400 filmash.

Regjisor i këtij filmi, është Veton Kastrati, ndërsa aktrojnë fëmijët nga SHMU “Ibrahim Mazreku”. Filmi trajton ëndrrat dhe dëshirat e fëmijëve, ndërsa është realizuar nga “Cuciproduction” nga Malisheva.

Ky film kohëve të fundit ka marrë mirënjohje ndërkombëtare nga festivali i fëmijëve në Muni të Gjermanisë dhe është licencuar që të transmetohet në kanalet televizive për fëmijë në këto shtetet: Gjermani, Britani të Madhe, SHBA, Francë, Holandë, Argjentinë, Turqi, Afrikë të Jugut dhe Danimarkë.

Malisheva bëhet me kujdestari të barnatoreve, 24 orë

Malishevë, 26 shkurt

Duke filluar nga nata e kaluar, qyteti i Malishevës, do të ketë kujdestari të barnatores, edhe gjatë natës. Drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha, ka bërë të ditur, se ka arritur marrëveshje me barnatoren “Triti-Pharm”, e cila do të bëjë kujdestari, vullnetarisht edhe pas orarit të paraparë për punë, pas orës 22:00.

Sipas drejtorit Berisha, deri te arritja e kësaj marrëveshje, me këtë barnatore, kanë ardhur pas bisedave me të gjithë pronarët e barnatoreve që veprojnë në Malishevë, por që vetëm “Triti Pharm”, ka pranuar vullnetarisht të punoj gjatë tërë natës.

Kujdestaria e barnatoreve ka qenë nevojë e qytetarëve të Malishevës, ndërsa në Komunë, në vazhdimësi janë paraqitur kërkesa dhe ankesa nga qytetarët, për mos kujdestarinë nga ana e barnatoreve në Malishevë, dhe për këtë qëllim, drejtori i drejtorisë për shëndetësi, ishte angazhuar maksimalisht, deri në arritjen e kësaj marrëveshje me këtë barnatore.

“Triti Pharm”, e ka marrë këtë obligim vullnetarisht dhe nga tani, të gjithë ata që kanë nevojë, mund të shërbehen edhe natës me barna.

Kryetari Begaj, vizitoi bibliotekën e qytetit

Malishevë, 26 shkurt



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtoresha për Kulturë, rini dhe Sport, znj.Blerta Krasniqi, sot kanë vizituar ambientet e reja të bibliotekës së qytetit, për tu njohur me ambientet e reja dhe kushtet e punës. Biblioteka e qytetit, tashmë, është zhvendosur dhe gjendet në objektin e muzeut “Jahir Mazreku”, në qendër të qytetit.

Me këtë rast, kryetari Begaj, ju dëshiro punë të mbarë dhe suksese, bibliotekës së qytetit, duke uruar që të kenë sa më shumë lexues.

“Kushtet janë më të mira dhe tashmë biblioteka gjendet më afër lexuesve, pasi është qendër të qytetit”, tha Hana Bytyçi, përgjegjëse e bibliotekave në Malishevë.

Komuna dhe Caritas Kosova vazhdojnë projektin për pakujdesjen shëndetësore

Malishevë, 28 shkurt

Komuna e Malishevës dhe Caritas Kosova, edhe këtë vit do ta vazhdojnë projektin për “Përkujdesjen shëndetësore shtëpiake-shtretërit shtëpiak”. Vazhdimi i këtij projekti, sot është nënshkruar nga Don Viktor Sopi, drejtor i përgjithshëm i Caritas Kosova dhe Ragip Begaj, kryetar i Komunës së Malishevës.



“Faleminderit për këtë ndihmë shumë të madhe që po jepni për neve, pasi mundësitë buxhetore të komunës, nuk na mundësojnë ofrimin e këtij shërbimi për qytetarët tanë”, ka thënë kryetari Begaj, ndërsa Don Viktor Sopi, sqaroi se ky projekt “ndihmohet nga Caritasi gjerman”. “Qëllimi është që të gjendet gjuhë e përbashkët me organet legjitime vendëse, ndërsa ky shërbim do t’ju ofrohet të gjithë atyre që kanë nevojë”, tha Don Viktor Sopi.

Sipas marrëveshjes, parashihet përmirësimi i shërbimit shëndetësor shtëpiak, për të gjitha familjet në nevojë, përmirësimi i kushteve për personat me regjim dialize, asistencë për disa arsimtar me probleme shëndetësore, përkujdesje për disa persona të sëmurë dhe të moshuar, që kanë nevojë për përkujdesje permanente si dhe rritjen e standardit të jetesës, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve shëndetësore në familjet e tyre.

Në këtë projekt, do të jenë të punësuar 17 persona.

Vlera e përbashkët e projektit është 160 mijë euro dhe do të bashkëfinancohet nga Komuna e Malishevës dhe Caritas Kosova.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

**Nr. 124- Mars 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>
www.malisheva-komuna.org**



Pamje gjatë shënimit
të manifestimit
“Epopeja e UÇK”-së
më: 5,6 dhe 7 mars



Furnizimi me ujë në Malishevë i plotë

Malishevë, 3 mars

Pjesa e dërmuese e ujësjellësve në Malishevë, të cilat menaxhohen nga njësisia e “Hidroregjionit” në Malishevë, po bëjnë furnizim të plotë me ujë për pije, përjashtuar ujësjellësin në Lladroc dhe Shkozë. Kështu u bë e ditur në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, por në disa vendbanime, në të cilat nuk ka sistem të ujësjellësve, kanë probleme me ujë për pije.

Në mbledhjen e sotme të qeverisë komunale, të udhëhequr nga kryetari z.Ragip Begaj, u diskutuan përgatitjet për shënimin e manifestimit “Epopeja e UÇK”-së, me 5,6 dhe 7 mars, ku parashiheni një varg aktivitësh, si mbledhje solemne, pastaj homazhe dhe nderime në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz, si dhe një program artistik. Po ashtu, i njoftua edhe për aktivitetet, që parashihen të mbahen për Ditën e Mësuesit, me 7 mars.

Para kryetarit është prezantuar edhe puna e përditshme e drejtorive komunale, përmes raportimeve nga drejtorët, ku u bë e ditur se numri i të thumbuarve nga rriqrat, ka arritur në gjashtë persona, deri më sot, por asnjë rast nuk është shënuar me infektim nga ethet hemorragjike, pastaj u njoftua për fillimin e mbajtjes së ligjëratave të vetëdijesimit nëpër shkolla dhe përgatitje tjera për fushatën e spërkatjes së zonave endemike.

Nga drejtorja e inspektoratit, u bë e ditur se janë në inspektim të respektimit të orarit të punës nga lokalet afariste, pastaj u njoftua për disa dëme nga zjarret që janë regjistruar, në veçanti për dëmet ndaj fermerëve.

KPF në mbledhjen e parë të saj, i bëri 10 rekomandime për KK

Malishevë, 3 mars

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës, ka mbajtur mbledhjen e saj të parë, pas përbërjes së re të KK të Malishevës, ku dhënë dhjetë rekomandime të ndryshme për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës. Mbledhja e KPF-së, është udhëhequr nga kryesuesi i KK, z.Enver Hoti, ndërsa përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtar, kryesuesi plus katër anëtar nga IQM, 3 të PDK-së dhe 3 anëtar të LDK-së.



Në këtë mbledhje, para anëtarëve të KPF-së, sipas rendit të ditës, në disa pika, kanë dhënë sqarimet e tyre, drejtorët e drejtorive për buxhet dhe financa, për arsim dhe edukim dhe ai për mbrojtje dhe shpëtim.

Për rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, KPF, ka dhënë këto rekomandime: 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhje e kaluar, 2. Deklarimi jashtë rendit të ditës, 3.

Pyetje nga anëtarët e KK për drejtorët e drejtorive komunale, 4. Formimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), 5. Prezantimi i qeverisë komunale, prezantimi i programit qeveritar dhe lista e projekteve kapitale, 6. Shqyrtimi i propozim planit të punës së KK për vitin 2014, 7. Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha komunale për vitin 2014, 8. Miratimi i kërkesës për **destinimin e të hyrave të bartura nga viti 2012 dhe 2013 në vitin fiskal 2014**, 9. **Raporti i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim dhe 10. Të ndryshme.**

Kryetari Begaj, bisedoi me institucionet shëndetësore për ethet hemorragjike

Malishevë/Prishtinë, 4 mars

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha dhe drejtori i QKMF-së, z.Besim Zogaj, gjatë ditës së sotme kanë zhvilluar takime me dy institucionet kryesore të shëndetësisë të vendit, përkatësisht me ministrin e shëndetësisë z.Ferid Agani dhe drejtorin e IKSHP-së, z.Naser Ramadani, me të cilët ka biseduar për përgatitjet dhe masat mbrojtëse që po bëhen, kundër ethet hemorragjike.

Kryetari Begaj i ka njoftuar përgjegjësit e institucioneve shëndetësore, në nivel vendi me përgatitjet që po bën Komuna e Malishevës, në harmoni me strategjinë nacionale, për luftimin e etheve hemorragjike, për fushatat e vetëdijesimit të cilat po bëhen në të shkollat,

pastaj takimet e drejtpërdrejt me qytetar që po zhvillohen nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës, si dhe reklamat mediale përmes radios.

Nga ana tjetër, ministri Agani bëri thirrje për vetëdijesim të qytetarëve si hap të rëndësishëm në mbrojtjen e shëndetit të tyre, ndërkohë që ka siguruar se Këshilli Ndërmnistror për parandalimin dhe luftimin e EHKK, të cilin e kryeson ai, ka bërë përgatitje për të dhënë një përgjigje sa më të mirë preventive dhe për të mbrojtur popullatën e zonave të prekura nga kjo sëmundje.

Edhe drejtori i IKSHP-së, z.Naser Ramadani, bëri thirrje për vetëdijesim të qytetarëve, për masat vetëmbrojtëse, si masa më e mirë për tu ruajtur nga thumbimi i rriqrave dhe shfaqje gatishmërinë e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP), për angazhim maksimal gjatë tërë sezonit.

Ramadani, u shpreh i kënaqur edhe me angazhimin e komunës, për masat e para që janë ndërmarr, përmes fushatave të vetëdijesimit dhe gatishmërisë së komunës për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së qytetarëve të Malishevës.

Malisheva po shënon “Epopenë e UÇK-së”

Malishevë, 6 mars



Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e manifestimit “Epopëja e UÇK”-së, në Komunën e Malishevës, po shënohet me një varg aktivitete, ku përfshihen nderimet dhe homazhet për dëshmorët e kombit, homazhe në Prekaz dhe aktivitete tjera. Komuna e Malishevës, në mënyrë të organizuar, të prirë nga kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe të përcjellë nga zv/ministri i MPMS-së, z.Fatmir Shurdhaj, familje të dëshmorëve, veteran të UÇK-së dhe qeveritar e

zyrtarë komunal, kanë vizituar Prekazin dhe familjen Jashari, në nderim të lavdisë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificës së familjes së komandantit legjendar Adem Jashari.



Fillimisht janë bërë nderime para shtatores së Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, në sheshin e dëshmorëve në Malishevë, për të vazhduar me homazhe tek varrezat e familjes Jashari në Prekaz, vizita në familjen Jashari, pastaj homazhe në varrezat e dëshmorëve në Kleçkë dhe Malishevë.

“Këto ditë na kujtojnë ngjarjen më të dhimbshme, jo vetëm për familjen tuaj, por për gjithë kombin shqiptar, dhe në të njëjtën kohë na kujtojnë edhe krenarinë, pasi sa e dhimbshme, aq edhe krenare ka qenë lufta dhe sakrifica e familjes suaj”, tha kryetari Begaj, në vizitën e tij në familjen Jashari në Prekaz.

“Shtetësia, i jep kuptim sakrificës së të gjithë dëshmorëve të kombit që ranë në luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Vizitat dhe respektin që na bën populli, neve na lehtëson dhimbjen dhe na bën të ndihemi mirë si familje dhe ne ju falënderojmë juve dhe të gjitha ata që na nderojnë me vizitat e tyre në Prekaz”, tha mes tjerash, z.Murat Jashari, në pritjen që i bëri delegacionit të Komunës së Malishevës.

Në orët e pasdites, në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, është mbajtur një koncert.

Aktivitetet vazhdojnë edhe gjatë ditës së premte 7 mars, deri në përfundimin e shënimit të manifestimit “Epopeja e UÇK”-së.

KK në Malishevë, mbajti seancë solemne për nderë të “Epopesë së UÇK”-së

Malishevë, 7 mars

Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka mbajtur një seancë solemne, në kuadër të shënimit të manifestimit “Epopeja e UÇK”-së, në nderim të sakrificës së Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari dhe familjes së tij. Në këtë seancë, përveç anëtarëve të KK të Malishevës, morën pjesë edhe Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, deputetët e Kuvendit të Kosovës nga Malisheva, z.Salih Morina dhe z.Haxhi Shala, një delegacion nga Bashkësia Islame e Kosovës, përfaqësues të organizatave të dal nga lufta e UÇK-së, ish kryetar të Komunës së Malishevës, z.Daut Krasniqi dhe z.Jakup Kastrati dhe të tjerë.

Në këtë seancë, u vlerësua lartë sakrificat e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari, të cilët u sakrifikuan në marsin e vitit 1998, më 5,6 dhe 7 mars, sakrificë e cila lëshoi kushtrimin e Jasharëve, për tu bashkuar në luftë për lirinë e popullit shqiptar. Për



nderë të kësaj sakrifice, shënohet edhe manifestimi i Epopeja e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

“Për herë të parë në historinë tonë, pas Skënderbeut, populli shqiptar, ku do që ishte, ju përgjigj kushtrimin të Adem Jasharit në luftën për liri. Epopeja, ishte vala përfundimtare për çlirimin e vendit, andaj edhe të gjithë shqiptarët ju bashkuan thirrjes së Adem Jasharit”, tha mes tjerash në

fjalën e tij, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti.

Ndërsa Reshat Mexhidi, nga kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i uruar të gjithë me këtë rast, tha se “marsin është muaj i shumë datave të rëndësishme për popullin shqiptar, duke filluar nga Epopeja e UÇK-së, për të vazhduar me Ditën e mësuesit, Ditën e nënave dhe për të përfunduar me marsin e përgjakshëm të demonstratave të vitit 1981”.

Fjalën kryesore në këtë mbledhje, e pati, i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj.

Në vazhdim një pjesë e fjalimit të kryetarit Begaj, mbajtur me këtë rast, i cili në mënyrë kronologjike, foli për komandantin Adem Jashari dhe familjen Jashari, dhe për kontributin e Malishevës në luftën për liri:

Edhe sivjet, në 16 vjetorin e Epopesë së Lavdishme të UÇK-së, po përkujtojmë rënien heroike të komandantit legjendar Adem Jashari, të familjes Jashari dhe të mijëra dëshmorëve të cilët iu kundërvunë armikut të përjetuar serb, për të mbetur përjetësisht në panteonin e pavdekësisë.

Okupimi serb në Kosovë, kishte arritur kulmin dhe populli shqiptar, filloi që të ndryshojë rezistencën e tij, pasi organizimi ushtarak kishte mbetur mënyra e vetme që ne ta fitojmë lirinë. Si rezultat i të gjitha ngjarjeve të deri atëherëshme, u formua Ushtria Çlirimtare e Kosovës, me në krye komandantin Adem Jashari.

Formimi i UÇK-së, sigurisht që e frikësonte shtetin serb, pasi e dinte se nga kjo formë e rezistencës shqiptare, do ta humbte kontrollin e saj mbi Kosovën. Për ta shuar këtë rezistencë,



mes shumë formave që kishte përdorur regjimi serb, mendonte se kapja e kreut të UÇK-së, do ti shuante përpjekjet tona për liri dhe pavarësi.

Ishte mëngjesi i hershëm i 30 dhjetorit 1991, ku armiku me një makineri të tërë policore kishte rrethuar Jasharajt dhe kërkuan dorëzimin e Adem Jasharit dhe Jasharëve tjerë. Adem Jashari me vëllezër e shokë, apelit të armikut për dorëzim iu përgjigj me breshëri armësh nga shumë drejtime. Kështu nisnin aksionet luftarake mbi policinë dhe ushtrinë e armikut, fillimisht në Drenicë, e për t'u përhapur më vonë në Llapushë, Llap, Dukagjin, e kudo në Kosovë.

Pas luftës së 26 nëntorit 1997, në Llaushë të Re, ku mori pjesë Ademi Jashari me çetën e tij, armiku do të bëjë plane për zhdukjen e Adem Jasharit. Kjo do të ndodhë me 22 janar 1998. Një ekspeditë policore-ushtarake serbe, kishte sulmuar familjen Jashari, me qëllim që të zhdukej kjo çerdhe e rrezikshme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, falë gjakftohtësisë e guximit të familjes dhe ndihmës që erdhi nga çeta, armiku u tërhoq pa arritur qëllimin.

Forcat serbe, pas disfatës së 22 janarit, kishin filluar përgatitjet për një sulm të përmasave të mëdha policore dhe ushtarake, dhe ky sulm do të fillojë në mëngjesin e hershëm të 5 marsit 1998, pak ditë pasi policia armike kishte pasur një disfatë në Likoshan. Këtë herë forca të mëdha ushtarake dhe policore e kishin rrethuar Prekazin, me orientim kryesor Lagjen e Jasharëve. Lufta për eliminimin e Jasharëve ishte e rreptë. Armiku Prekazin e kishte vendosur në rreth të hekurt dhe sulmonte nga shumë anë. UÇK-ja aso kohe i kishte mundësitë e kufizuara të sulmit e të depërtimit. Kështu familja Jashari, rezistoi për tri ditë të tëra, duke ju përgjigjur armikut, me plumbin e pushkës. Më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998 bashkë me komandantin legjendar Adem Jashari u vranë edhe 56 anëtarë tjerë të familjes Jashari.

Në histori, jo vetëm në atë shqiptare por edhe në atë evropiane e botërore nuk njihet ndonjë rënie në luftë e komandantit të ushtrisë së bashku me tërë familjen, por kjo ndodhi në Kosovë, në Prekazin e legjendave me 5,6 e 7 mars 1998 kur familja Jashari luftoi deri në vetëflijim me një ushtri dhe polici të armatosur deri në dhëmbë.

Lufta dhe rënia heroike në Prekaz, u bë kushtrim për shtrirjen e Ushtrisë Çlirimtare në tërë Kosovën pasi tashmë shihej qartë se ishte moment final i realizimit të aspiratave të shqiptarëve, realizim i sakrificave të panumërta në krejt historinë tonë të dhembshme.

Kushtrimi i rënies së komandantit Adem Jashari dhe familjes së tij me shpejtësi të rrufeshme u përhap edhe në Malishevë.

Mijëra djem e vajza u rreshtuan menjëherë në radhët e Njësiteve “Lumi” dhe “Çeliku” të UÇK-së për të dhënë kontributin e tyre në lirinë e Kosovës kurse secila shtëpi u bë çerdhe për ushtarët e lirisë.

Në histori do të mbeten qindra beteja të zhvilluara në Malishevë, në Dragobil, Lladroc, Carrallukë, Drenoc, Kijevë, Bubavec, Balincë, Bllacë dhe në të gjitha vendbanimet tjera, të cilat u bënë shembuj të luftës dhe qëndresës për liri. Në këto beteja, Malisheva i dha kësaj toke 70 dëshmorë të kombit

LAVDI komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij! Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit

Bashkësia Islame në Malishevë, shënoi manifestimin “Epopeja e UÇK”-së

Malishevë, 7 mars



Në kuadër të shënimeve të manifestimit “Epopeja e UÇK”-së, organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës në Malishevë, sot, në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, ka mbajtur një akademi përkujtimore dhe mevlud, për nderë të sakrificës së Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, dhe për nderë të të gjithë dëshmorëve të kombit, përfshi edhe hoxhallarët, të cilët ranë dëshmorë në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Në këtë akademi-mevlud, morën pjesë, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, kryesuesit i KK, z.Enver Hoti, deputetët e Kuvendit të Kosovës nga Malisheva, z.Halit Krasniqi, z.Salih Morina dhe z.Haxhi Shala, përfaqësues nga Bashkësia Islame e Kosovës, përfaqësues të jetës politike dhe fetare, të institucioneve vendore dhe qytetar të shumtë.

Në këtë akademi, kryetari Begaj, çmoi lartë sakrificën e familjes Jashari, të komandantit të UÇK-së Adem Jashari, dhe të gjithë dëshmorëve të kombit. “Rrugëtimi ynë, deri këtu është la me gjakun e dëshmorëve dhe të popullit të Kosovës, që asnjëherë nuk i ndalën përpjekjet për

liri, andaj ne sot jemi të obliguar që ta respektojmë atë gjak të derdhur të dëshmorëve”, tha mes tjerash kryetari Begaj.

Ndërsa mulla Xhevat Kryeziu, foli për sakrificën e kombit shqiptar të Kosovës, deri në formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe për sakrificën e familjes Jashari.

Ndërsa një fjalim në këtë akademi e ka mbajtur edhe Reshat Mexhidi, nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK), i cili po ashtu ka folur për luftën e UÇK-së, për dëshmorët e kombit, si në aspektin kombëtar ashtu edhe në aspektin fetar.

Pas fjalimeve, është mbajtur edhe mevlud për të gjithë dëshmorët e kombit, të rënë në luftën për lirinë e Kosovës.

U shënuar Dita e Mësuesit

Malishevë, 7 mars

Përmes aktiviteteve të shumta, të organizuara nga drejtoria komunale për arsim dhe institucionet shkollore të Malishevës, sot është shënuar 7 Marsi, Dita e Mësuesit. Aktiviteti kryesor, është mbajtur në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, ku janë ndarë mirënjohje për mësuesit e dalluar dhe për veteranët e arsimit nga Komuna e Malishevës.



“Ju falënderoj të gjithë arsimtarëve të Komunës së Malishevës dhe në veçanti, juve veteran të arsimit, që keni dhënë aq shumë për arsimin në komunën tonë, për çka ne ju jemi mirënjohës përgjithmonë. Është kënaqësi që sot, arsimi ka ecur shumë”, tha mes tjerash kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, në fjalën e tij, duke i uruar mësuesit me rastin e Ditës së Mësuesit.

Mësuesit malishevas, me rastin 7 marsit, i ka uruar edhe drejtori i drejtorisë për arsim, z.Blerim Thaçi. Drejtori Thaçi, në të njëjtën kohë, i ka falënderuar për angazhimin e tyre dhe për të arriturat në arsimin e Komunës së Malishevës, si dhe për rezultatet e treguara në vazhdimësi.



Në këtë aktivitet, janë dhënë edhe çmimet për recitatorët e të gjitha niveleve, që mbahen tradicionalisht në Malishevë, pastaj janë dhënë mirënjohje për nxënësit më të mirë në matematikë, të cilët e përfaqësojnë Malishevën në garat në nivel vendi.

Mirënjohje janë ndarë për mësimdhënësit më të dalluar dhe shkollat më të suksesshme, që kanë treguar rezultate gjatë vitit të fundit shkollor.

Në fund, mirënjohje ju dhanë edhe veteranëve të arsimit nga Komuna e Malishevës, për kontributin e dhënë në shkollën shqipe në komunën tonë.

Sot, po ashtu në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës, janë mbajtur aktivitete të ndryshme, kryesisht shfaqje artistike, të përgatitura me nxënësit e shkollave përkatëse, në kuadër të shënimeve me rastin e 7 Marsit-Ditës së Mësuesit.

Ka vazhduar realizimi i projekteve në infrastrukturë

Malishevë, 10 mars

Këshilli i drejtorëve, i udhëhequr nga kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot, mbledhjen e rregullt të qeverisë komunale, ku janë trajtuar një varg çështjesh, që lidhen me punët dhe aktivitetet e përditshme të qeverisë komunale, si dhe është njoftuar për fillimin e vazhdimin të disa projekteve në infrastrukturën e vendbanimeve në Komunën e Malishevës.

Fillimisht drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, njoftoi bordin drejtorëve, se vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ulje të buxhetit të komunave për 15 për qind në mallra dhe shërbime dhe komunal, buxheti i Komunës së Malishevës do të dëmtohet për rreth 150 mijë euro, e që në fakt, do të shkaktoj probleme, pasi edhe ashtu buxheti i komunës, është i vogël.

Nga ana tjetër, drejtori për urbanizëm, z.Urim Kastrati, ka njoftuar se ka filluar vazhdimin e ndërtimit të rrugëve në fshati Bellanicë, e që do të vazhdohet në Fshatin e Ri, Turjakë etj..., projekte këto dy vjeçare, si dhe bëri të ditur, se janë në përgatitje për rregullimin-riparimin e kanalizimit në disa fshatra.

Në kuadër të angazhimeve të komunës, në zbatimin e strategjisë nacionale, për luftimin e etheve hemorragjike, përveç ligjëratave për vetëdijesimin e qytetarëve, gjatë kësaj jave (më 13 mars) pritet të mbahet edhe një tribunë profesionale, ku pritet të marrin pjesë ekspert të

kësaj fushe dhe përfaqësues nga komuna, si dhe përfaqësuesit e të gjitha fshatrave të Malishevës, ka bërë të ditur, drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha.

Ndërsa, sa i përket spërkatjes masive, përmes ajrit, drejtori Berisha, bëri të ditur, se janë në pritje të një përgjigje nga ana e organeve kompetente, siç janë ministria e shëndetësisë, e ambientit, këshilli ndërministror për luftimin e etheve hemorragjike dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik.

Begaj takoi Sindikatën e Shëndetësisë së Kosovës

Malishevë, 10 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot një delegacion të Sindikatës së Shëndetësisë së Kosovës (SSHK), të udhëhequr nga kryetari i saj, z.Blerim Sylja, me të cilët kanë biseduar për gjendjen e punëtorëve të shëndetësisë, angazhimin e kësaj sindikate për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në shëndetësi dhe obligimet që ka komuna për punëtorët shëndetësor.

“Jam i përkushtuar për shëndetësinë në përgjithësi dhe në veçanti për punëtorët shëndetësor dhe jam i gatshëm të bëj gjithçka që më lejon ligjin. Unë dua që shëndetësia të fuqizohet dhe jam për zbatim të ligjit dhe krijimit të rregullit në institucionet shëndetësore dhe nuk do të lejoj që ligji të shkelet nga askush”, tha kryetari Begaj.

Nga ana tjetër, z.Sylja, nga SSHK, e njoftoi kryetarin Begaj, me problemet me të cilat përballet shëndetësia, me ligjin për shëndetësi, defektet e këtij ligji, moszbatimin e ligjit nga menaxhmentet e institucioneve shëndetësore, si dhe e njoftoi në përgjithësi, për angazhimin e sindikatës për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Ndërsa, përfaqësuesit e sindikatës së shëndetësisë në QKMF të Malishevës, paraqiten disa ankesa, që siç pretendojnë ata, dallimet në pagesa në pozita të njëjta, pastaj mospagesa për punën shtesë, pastaj kërkuan që punëtorët shëndetësor që punojnë në emergjencë të stimulohen për punën që bëjnë, pasi janë direkt të rrezikuar, sidomos gjatë sezonit të etheve hemorragjike, kur janë në kontakt direkt me rriqra dhe persona të infektuar. Po ashtu, ata kërkuan zbatim të ligjit dhe zgjidhjen e problemeve që ata kanë, ose të kundërtën do ti përdorin format tjera, përmes gjykatave për realizimin e të drejtave të tyre.



Për të gjitha këto probleme, kryetari Begaj, premtoi se të njoftohet drejtpërdrejt nga ana e punëtorëve dhe menaxhmentit të QKMF-së dhe premtoi angazhim maksimal për zgjidhjen e të gjitha problemeve, brenda ligjit dhe mundësive që ka.

Komuna dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ndajnë 700 mijë euro për ujëmbledhësin në Senik

Malishevë, 11 mars

Komuna e Malishevës dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik kanë siguruar 700 mijë euro, për ndërtimin e galerive ujëmbledhëse dhe për ndërtimin e rezervuarit, me infrastrukturën përcjellëse, në fshatin Senik, me qëllim të zgjerimit të ujësjellësve në Komunën e Malishevës, prej ku parashihen të furnizohen 12 fshatra me ujë për pije.

Marrëveshja, është nënshkruar mes Komunës së Malishevës dhe KRU “Hidroregjioni jugor”, gjegjësisht mes kryetarit të Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtorit të Hidroregjionit jugor, z.Besim Baraliu, pasi paraprakisht KRU “Hidroregjioni jugor”, ka siguruar mbështetjen për realizimin e këtij projekti nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Sipas marrëveshjes, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, do të mbështes këtë projekt, në vlerë prej 550 mijë euro, ndërsa Komuna e Malishevës, në vlerën prej 150 mijë euro.

Realizimi i këtij projekti, drejtpërdrejt do të lidhet me projektin e Qeverisë Zvicerane, implementuar nga CDI për mundësinë e ndërtimit të rrjetit magjstral dhe rrjetit dytësor për zonat rurale, konkretisht për 12 fshatra, të cilat do të furnizohen me ujë për pije nga rezervuari i Senikut.

Edhe ky investim, është në kuadër të angazhimeve të Komunës së Malishevës, për rregullimin e infrastrukturës së sistemeve të ujësjellësve, rritjen e mirëqenies për banorët e Komunës së Malishevës dhe krijimin e kushteve më të mira për jetë, përderisa sigurimi i ujit për pije, është elementi kryesor për jetesë.

Kryetari Begaj, ka vazhduar takimet me qytetar në Drenoc

Uji për pije dhe një pjesë e kanalizimit, shqetësimet kryesore të Drenocit

Malishevë, 12 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha, ai i shërbimeve publike, z.Milazim Morina dhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, znj.Blerta Krasniqi, mbrëmë kanë vazhduar takimet e drejtpërdrejta me qytetar, në fshatin Drenoc, ku janë njoftuar me problemet e fshatit dhe mundësinë e zgjidhjes së atyre problemeve, përderisa problem kryesor për Drenocin, si vendbanimi më i madh në Malishevë, është

uji për pije.

Ky takim me qytetar, përveç njohjes me problemet e banorëve të këtij fshati, është realizuar edhe në kuadër të përpjekjeve të komunës, në fushatën e saj, për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike, gjegjësisht për vetëdijesimin e qytetarëve, nga rreziku i thumbimit të rriqrave, si bartës të kësaj sëmundje, si dhe çështja tjetër, është, largimi i mbeturinave nga ambientet ku jetojmë.

“Unë ju bëj thirrje për pastrimin e lagjeve të juaja. Ejani dhe organizohemi bashkë që ti largojmë mbeturinat nga vendet ku ju i hidhni ato. Ta ruajmë shëndetin tonë nga sëmundjet që vijnë si pasojë e grumbullimit të mbeturinave në vendet jo adekuate dhe ku vet ne si banorë, rrezikohemi nga ato”, ka thënë mes tjerash kryetari Begaj.

Ndërsa drejtori Berisha, i ka njoftuar me angazhimet e komunës, në kuadër të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike. “Jemi duke i koordinuar punët dhe angazhimet tona me të gjithë faktorët, sipas strategjisë për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike”, tha Berisha. “Edhe qeveria e vendit, edhe institucionet tjera përgjegjëse, janë më të angazhuara këtë vit, është i formuar këshilli ndërministror për këtë çështje dhe ne jemi duke vazhduar sipas planit operativ, me angazhimet tona”, tha drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha.

Nga ana tjetër, gjatë debatit me qytetar, për çështje të tjera, u vlerësua se uji për pije, është problemi kryesor që ka ky fshat, pastaj rregullimi i kanalizimit në disa pjesë të fshatit, rregullimi i disa rrugëve dhe çështje të tjera.

Për këto, kryetari Begaj, premtoi se do të angazhohet maksimalisht, brenda mundësive të komunës, për zgjidhjen e këtyre problemeve. “Unë shumë besoj se brenda vitit, do të arrijmë të sigurojmë ujin për pije. 1.1 milion euro deri më tani kemi arritur ti sigurojmë për ndërtimin dhe funksionimin e ujësjellësit për Drenoc, kjo sigurisht për fazën e parë, pasi i tërë projekti, për Drenoc dhe 11 fshatra tjerë, kushton mbi tre milion euro, por brenda vitit, besoj shumë, se uji për pije do të arrijë në Drenoc”, ka thënë kryetari Begaj, duke premtuar angazhim e tij dhe të komunës, për zgjidhjen e problemeve të fshatit.

Kryetari Begaj, shikoi nga afër punimet në ndërtimin e një rruge në Gurbardh

Malishevë, 12 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka vizituar sot fshatin Gurbardh, ku ka parë nga afër rregullimin e një rruge në këtë fshat, e cila po zgjerohet dhe do të asfaltohet, me qëllim të krijimit të mundësive për lëvizje më të lehtë të banorëve të këtij fshati.



Kryetari Begaj, u shpreh i kënaqur me punimet që janë duke u zhvilluar në ndërtimin e rrugës së fshatit, rrugë e cila ju ndihmon banorëve të disa lagjeve të fshatit, të lëvizin me lehtë.

Ndërtimi i kësaj rruge, është në kuadër të përpjekjeve të Komunës së Malishevës, për rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Rruga që po ndërtohet, është e gjatë 500 metra dhe kosto e ndërtimit të saj, është

25 mijë e 60 euro.

U mbajt tribuna profesionale për etheve hemorragjike

Malishevë, 13 mars

Nën përkujdesjen e kryetarit të Malishevës, z.Ragip Begaj, sot në Malishevë, është mbajtur një tribunë profesionale, me temën ***“Masat që duhet të ndërmerren në parandalimin dhe luftimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo”***, ku morën pjesë ekspertët më të mirë kosovar të kësaj fushe, si Dr.Isuf Dedushaj, Dr. Salih Ahmeti, Dr.Nurishahe Hulaj si dhe mjekë e infektolog nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Klinika Infektive e QKUK-së, pastaj përgjegjësit e shëndetësisë në Malishevë, të cilët u paraqitën para kryetarëve të fshatrave dhe pjesëmarrësve të tjerë në këtë tribunë.



Fillimisht kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i ka falënderuar të gjithë ata që janë të angazhuar në luftimin e etheve hemorragjike dhe parandalimin e përhapjes së këtij virusi, për punën e palodhshme që po bëjnë për mbrojtjen e shëndetit të popullatës.

Dr.Isuf Dedushaj, ka folur për përhapjen e sëmundjes, për historinë e këtij virusi dhe për kuptimin e problemit të etheve hemorragjike. “Për herë të parë, rasti i parë në Kosovë, është regjistruar 60 vite më parë në Nishor të Suharekës, ndërsa tani tek ne llogaritet si sëmundja më vrastare”, tha Dedushaj, i cili bëri thirrje që qytetarët të kenë kujdes të shtuar, në mënyrë që ti shmangen mundësisë së infektimit nga ky virus.

Nga ana tjetër, Dr.Salih Ahmeti, foli për trajtimin e pacientëve të prekur nga ky virus, sëmundje, e cila sipas Ahmetit, “i duhet një menaxhim multidisiplinar”. “Vitin e kaluar, janë regjistruar 11 raste të vdekjeve nga virusi i etheve hemorragjike, krime kongo, ndërsa gjashtë prej tyre kanë qenë nga Komuna e Malishevës”, tha Ahmeti.

Dedushaj e Ahmeti, më pas janë përgjigjur në pyetjen e audiencës, ku sqaruan se ende nuk ka ndonjë vaksinë kundër këtij virusi, përderisa, sipas Dedushajt, janë në rrugë të mirë të zbulimit të vaksinës, për këtë virus, që për infektologot dhe epidemiologët, është një lloj i virusit i izoluar në Kosovë dhe quhet “Kosova Hoti”.

Mjekët, panelist, kanë bërë thirrje për kujdes të shtuar nga vet qytetarët, sidomos gjatë punëve të përditshme në ara, fusha, stalla, kopshte, etj..., në mënyrë që të mos bien në kontakt me rriqra. Megjithatë, nëse thumbohen nga rriqrat, kanë bërë thirrje, që në asnjë mënyrë të



mos i largojnë vet rriqrat, por të kërkojnë ndihmë në QKMF të Malishevës, e cila ka një staf shumë profesional, për trajtimin e këtyre rasteve.

Prilli muaji i pastrimit të ambientit

Malishevë, 17 mars

Si çdo të hënë edhe sot Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të qeverisë komunale, ku janë trajtuar një varg çështjesh, që lidhen me punët dhe aktivitetet e përditshme të qeverisë komunale, ku dhe u bë e ditur nga kryetari Begaj që muaji prill do të jetë muaji i pastrimit të ambientit.

Në këtë mbledhje të bordit të drejtorëve, kryetari Begaj, ka kërkuar që të shqyrtohet mundësia, që punëtorët që punojnë si ofiqarë, të punojnë pa ndërprerje, duke mos e shfrytëzuar pushimin të gjithë menjëherë, në mënyrë që qytetarët të mos presin për nxjerrjen e dokumenteve.

Nga ana tjetër, të gjithë drejtorët, kanë raportuar për aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe për aktivitetet që i kanë në javën në vazhdim. Në këtë mbledhje, sipas drejtorëve përgjegjës, janë duke u realizuar disa projekte, kryesisht në infrastrukturë.

Ndërsa sa i përket situatës me ethe hemorragjike, u bë e ditur, se faza e parë e fushatës së vetëdijesimit ka përfunduar, përderisa, deri më sot janë regjistruar 16 raste të thumbimit nga rriqrat, të cilët janë trajtuar në QKMF të Malishevës.

Kryetari Begaj inspektoi punimet në disa projekte

Malishevë, 17 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori i arsimit, z.Blerim Thaçi dhe drejtori për urbanizëm, z.Urim Kastrati, kanë inspektuar punimet në ndërtimin e një shkollë dhe një kanalizimi në fshatrat e Komunës së Malishevës, përkatësisht në Vërmicë dhe Turjakë.

Ishte interesimi i kryetarit, për të parë nga afër, vazhdimin e ndërtimit të shkollës në fshatin



Vërmicë, pasi ajo shkollë, megjithëse, ishte paraparë që të fillonte me procesin mësimor, ende nuk ka përfunduar rregullimi i brendshëm i saj, për shkak të punimeve shtesë që janë duke u bërë. Fillimi i procesit mësimor në këtë shkollë, planifikohet të fillojë në shtator, kur edhe fillon viti mësimor 2014-2015, edhe pse shkolla, pritet të jetë gati brenda dy muajve.

Po ashtu, është vizituar edhe fshati Turjakë, ku ka filluar ndërtimi i kanalizimit në lagjen e Berishajve, të këtij fshati. Ndërtimi i këtij kanalizimi, kishte dalë si nevojë emergjente gjatë takimeve me banorët e këtij fshati. Ky rrejt i kanalizimit ka një gjatësi prej 1000 metrash dhe ka një kosto prej 9369 euro.

Mbahet ligjëratë për parandalimin e etheve hemorragjike, me nxënësit e Qendrës së Kompetencës

Malishevë, 19 mars



Në kuadër të strategjisë kombëtare, për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike “krime kongo”, drejtorja për shëndetësi, në bashkëpunim me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), sot në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani”, kanë mbajtur një ligjëratë me të gjithë nxënësit e Qendrës së Kompetencës në Malishevë, të cilët i kanë njoftuar me masat parandaluese që duhen të

merren, si masa kryesore mbrojtëse. Në këtë ligjëratë, ka marrë pjesë edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj.

Fillimisht, kryetari Begaj, ju ka bërë thirrje nxënësve, që ato që i mësojnë dhe i dëgjojnë sot nga mjekët, ti përcjellin në familjet dhe rrethin e tyre, për ruajtjen e shëndetit, për çka edhe Komuna e Malishevës, është e angazhuar maksimalisht. Kryetari Begaj, po ashtu ju bëri thirrje që ta ruajnë ambientin, pasi grumbullimi i mbeturinave, është burim i shumë infeksioneve dhe sëmundjeve. “Ta ruajmë ambientin dhe ta krijojmë një pasqyrë të mirë për vendin tonë dhe në të njëjtën kohë, ta ruajmë shëndetin tonë. E këtë, më së miri e bëni ju rinia shkollore, ju e ardhmja jonë”, tha mes tjerash kryetari Begaj, duke ju drejtuar nxënësve të Qendrës së Kompetencës.

Mjeku i QKMF-së, Fejzë Hoti, ju ka mbajtur ligjëratën rreth 500 nxënësve të ndërrimit të parë, të Qendrës së Kompetencës, të cilëve ju ka shpjeguar për sëmundjen e etheve hemorragjike, e njohur si “krime kongo”, historinë e kësaj sëmundje vdekjeprurëse, zhvillimin e saj, format e infektimit dhe ajo që është më kryesore, për masat parandaluese që duhet ti bëjnë vet qytetarët. “Kjo sëmundje, bartet fillimisht tek njeriu, nga thumbimi i rriqrave, të cilët janë bartës të sëmundjes, nga kafshët tek njeriu, andaj, zvogëloni në maksimum mundësinë e kontaktit me rriqra, përmes kujdesit tuaj. Të punohet toka, të kositet bari, të vishemi me rroba adekuate gjatë punëve të përditshme në ara, fusha e male, të mos i largojmë vet rriqrat nga trupi, nëse eventualisht thumbohemi nga ata, por të kërkojmë ndihmën e mjekut për largimin e tyre, pasi mundësia e infektimit është shumë e lartë”, ju ka thënë mes tjerash, mjeku Hoti.

Më pas, mjeku Hoti dhe përgjegjësit tjerë, janë përgjigjur në pyetjet e nxënësve, për masat mbrojtëse dhe çështje tjera, lidhur me ethet hemorragjike “krime kongo”.

Kryetari Begaj, takoi banorët e fshatit Vërmicë

Malishevë, 20 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga përgjegjësit e drejtorive komunale, në kuadër të vizitave në terren me banorët e fshatrave të Malishevës, mbrëmë është takuar me banorët e fshatit Vërmicë, me të cilët ka biseduar për nevojat e fshatit, si dhe për masat mbrojtëse kundër etheve hemorragjike dhe largimin e mbeturinave nga ambienti.

Përfundimi i ndërtimit shkollës, ndërtimi i rrugës për lagjen e Ukajve dhe përfundimi i kanalizimit në lagjet e fshatit, ishin



kërkesat kryesore të banorëve të fshatit, të prezantuara si kërkesa dhe nevojë emergjente, kërkesa të cilat edhe morën premtimin e kryetarit Begaj, për realizimin e këtyre kërkesave, brenda këtij viti.

“Deri në shtator, shkolla do të jetë e gatshme për fillimin e procesit mësimor, ndërsa edhe rruga për lagjen e Ukajve, po ashtu do të ndërtohet, sikur edhe përfundimi i kanalizimit të mbetur në gjysmë”, ka thënë kryetari Begaj, duke premtuar angazhim maksimal për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Nga ana tjetër, me banorët e fshatit, sikur edhe në vendet tjera, është biseduar për masat mbrojtëse që qytetarët duhet të kenë, si preventivë kundër prekjes eventuale nga virusi i etheve hemorragjike, të cilat përcillen nga rriqrat tek njeriu. Kjo fushatë e informimit, është në kuadër të strategjisë kombëtare për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike.

Po ashtu, një çështje tjetër e kryetarit të komunës, e debatuar me banorët e Vërmicës, ishte edhe largimi i mbeturinave dhe mbrojtja e ambientit, kërkesë kjo e cila mori mbështetjen e banorëve, për organizimin e një aksioni të përbashkët, për largimin e mbeturinave nga ambientet ku jetojmë dhe për ruajtjen e ambientit.

“Ejani ta pastrojmë vendin tonë, pasi janë ndotur me fusha, me hapësira të gjelbra, me pyje, është ndotur gjithçka që na rrethon, andaj, ejani dhe ta pastrojmë këtë ambient, që të kemi një vend të pastër, dhe të mos jetojmë me këso vendgrumbullime të mbeturinave, të cilat janë edhe burim i infeksioneve të shumta, si dhe burim për shumimin e rriqrave dhe brejtësve të cilët bartin sëmundje të ndryshme”, tha mes tjerash kryetari Begaj, i cili premtoi se komuna do të siguroj të gjithë makinerinë e nevojshme për bartjen e mbeturinave dhe largimin e tyre.

Kryetari Begaj, takoi banorët e fshatit Guncat

Guncat me shumë nevoja emergjente

Malishevë, 22 mars

Në kuadër të vizitave në fshatrat e Komunës së Malishevës, i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, mbrëmë ka vazhduar takimin e radhës me banorët e fshatit Guncat, ku është njoftuar me hallet me problemet me të cilat ballafaqohen banorët e këtij fshati, sikur edhe është bërë sensibilizimi i banorëve për mbrojtje nga ethet hemorragjike dhe për largimin e mbeturinave nga fshati.

Grumbullimi i shumë mbeturinave në luginat e fshatit, ujësjellësi jo funksional, mos përfundimi i kanalizimit, vazhdimi i asfaltimit të disa rrugëve në lagjet e fshatit, largësia e shkollës për disa lagje, rastet sociale, trotuari në fshat dhe rrjeti i dobët i shpërndarjes së energjisë elektrike, janë disa nga nevojat, siç thanë banorët e fshatit, më emergjente për këtë fshat.



Për të gjitha këto kërkesa, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, premtoi se angazhimi i komunës dhe i tij personalisht nuk do të mungoj, për zgjidhjen e këtyre problemeve. “Me seriozitetin më të madh do ti shqyrtojmë të gjitha këto kërkesa dhe gradualisht, do të bëhet zgjidhje për të gjitha, por jo brenda një viti, ka thënë Begaj, para banorëve të fshatit Guncat.

Sikur edhe në takime tjera, edhe banorët e këtij fshati janë njoftuar me masat parandaluese, nga thumbimi i rriqrave, insekte të cilat e bartin sëmundjen e etheve hemorragjike, për masat që është duke marrë komuna dhe institucionet e vendit. Po ashtu, edhe këtu, drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, ju bëri thirrje banorëve, që në asnjë rast të mos i largojnë rriqrat, nëse eventualisht thumbohen, por të kërkojnë ndihmën e mjekut në QKMF në Malishevë, ku menjëherë ju bëhen edhe analizat.

Ndërsa kryetar Begaj, kërkoi nga banorët, që të marrin një aksion të përbashkët me komunën, për largimin e mbeturinave, në mënyrë që ta pastrojmë ambientin përreth ku jetojmë. “Ato deponi të mbeturinave, janë burim i infeksioneve dhe sëmundjeve të ndryshme, andaj është tepër e nevojshme ti largojmë, por pastaj kërkoj nga ju që ta ruani ambientin”, tha mes tjerash kryetari Begaj.

Kryetari Begaj prezantoi qeverinë dhe programin e tij, para anëtarëve të KK-së

Malishevë, 22 mars

Në mbledhjen e tretë të radhës së Kuvendit të Komunës së Malishevës, i pari i komunës, z.Ragip Begaj, me kërkesën e anëtarëve të KK-së, ka prezantuar para tyre, përbërjen e qeverisë komunale, programin qeverisës dhe projektet kapitale. Paraprakisht, KK i Malishevës, mori një mirënjohje nga OSBE, për bashkëpunimin e ndërsjellë mes KK të Malishevës dhe OSBE-së.



Gjatë seancës së KK në Malishevë, Shefi i Zyrës Rajonale së OSBE-së në Prizren, z. Ulrich Biffar gjatë adresimit ka uruar anëtarët e ri të kuvendit komunal duke theksuar bashkëpunim të mire midis OSBE-së dhe komunës, ai gjithashtu theksoi se “OSBE-ja do të vazhdon me përkrahjen për komunën”. Në fund z. Ulrich Biffar i dhuroi kryesuesit të KK të Malishevës, z.Enver Hoti, një mirënjohje për

bashkëpunim të mirë me OSBE-në.

Më pas, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, para anëtarëve të KK-së, prezantoi drejtorët e drejtorive komunale, përgatitjen e tyre profesionale, si dhe prezantoi programin e tij qeverisës dhe projektet kapitale për vitin 2014. “Drejtorët janë përgjegjës për punën e tyre dhe së bashku me mua, besoj se fuqishëm se do t’ia dalim me sukses”, tha Bega, duke e prezantuar me pas, një nga një secilën drejtor, planin e punës dhe objektivat. Sipas listës së projekteve kapitale, të prezantuara para anëtarëve të KK-së, përveç së paku pesë shkollave, planifikohen edhe ndërtimi i katër rrugëve të reja, ujësjellësi për fshatin Drenoc dhe fshatrave tjera, përfundim të kanalizimeve, investime në bujqësi, angazhim maksimal kundër etheve hemorragjike dhe të tjera.

Në mbledhjen e sotme të KK të Malishevës, u morën një sërë vendimesh me rëndësi, duke filluar vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), u miratua Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014, Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale për vitin 2014, pastaj është miratuar kërkesa e drejtorisë për buxhet dhe financa, për destinimin e të hyrave të bartura nga viti 2012 dhe 2013, në vitin fiskal 2014, si dhe u mor vendim për funksionalizimin e komisionit të aksionarëve të Komunës së Malishevës.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, u mor vendim edhe për formimin e komisionit për ndryshimin e statutit të Komunës së Malishevës, komisioni i cili do të përbëhet nga tetë anëtar dhe udhëhiqet nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti.



Java që shkoi me shumë zjarre në malet e Malishevës

Malishevë, 24 mars

Java e kaluar, ka qenë një javë e ngjeshur me zjarre, kryesisht pyjet në territorin e Komunës së Malishevës, ku janë djegur rreth tridhjetë hektar në pyjet tona, u bë e ditur në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të mbajtur sot. Për këtë qëllim, drejtorja komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim, planifikon angazhim shtesë të ekipeve mobile, të cilët do të ndihmojnë zjarrfikësit në Malishevë.

Këtë njoftim, e ka dhënë sot, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, i cili dha edhe arsyeshmërinë e angazhimit të ekipeve mobilizuese, pasi sipas tij, numri i zjarrfikësve është i vogël, përderisa rastet për intervenim janë shtuar dukshëm. “Nga 1 prilli, planifikojmë të angazhojmë edhe ekipet mobilizuese”, tha Morina, i cili bëri thirrje që të bëhet kujdes dhe të mos shkaktohen zjarre.

Po ashtu edhe në sektorin e shëndetësisë, përkatësisht situata me thumbime nga rriqrat, ka filluar të rëndohet dhe deri më sot, 33 pacient kanë kërkuar ndihmë në QKMF të Malishevës, për largimin e rriqrave, insekte të cilat përcjellin tek njeriu virusin e etheve hemorragjike, ka bërë të ditur drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha.

Edhe drejtorët tjerë raportuan për punët e kryera gjatë javës së kaluar dhe për projektet që janë duke u realizuar, kryesisht në infrastrukturë.

Bizneset në Malishevë, lirohen nga taksat komunale

Malishevë, 24 mars

Në mbledhjen e fundit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, anëtarët e kuvendit, me shumicë të votave, kanë miratuar Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba mandatore. Sipas kësaj rregullore, të gjitha bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Malishevës, do të lirohen nga taksat komunale, për vitin 2014.

“Për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, qeveria komunale, ka kërkuar që bizneset të lirohen nga taksat komunale, në mënyrë që sadopak, t’ju lehtësohet ushtrimi i veprimtarisë dhe të funksionimit të tyre”, tha për Zyrën për Informim të Komunës së Malishevës, drejtori për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi.

“Deri te ky vendim, kemi ardhur, pasi kemi bërë analiza të detajuara për gjendjen e përgjithshme të bizneseve në Malishevë, por edhe për ndikimet që heqja e taksës komunale, ka për buxhetin e komunës dhe në fund e kemi parë si shumë të nevojshme dhe të arsyeshme heqjen e taksave komunale, për vitin 2014, për bizneset”, tha drejtori Krasniqi. “Me këtë rast ne kemi analizuar edhe planifikim buxhetor për vitin 2014 nga taksat komunale”, tha Krasniqi.

Drejtori Krasniqi, sqaroi se heqja e taksave komunale, është vetëm për vitin 2014 dhe kjo nuk nënkupton edhe shlyerjen e borxheve paraprake, që kanë bizneset në Malishevë. Bizneset që ushtrojnë veprimtari në territorin e Malishevës dhe kanë obligime të mëhershme, janë të detyruara ti shlyejnë ato obligime.

U varros me nderime veterani i luftës Atdhe Hoti

Malishevë, 25 mars

Sot në varrezat e fshatit Carrallukë, me nderime u varros, veterani i luftës së UÇK-së, Atdhe Alush Hoti (1976), i cili tragjikisht humbi jetën ditë më parë në Austri, ku punonte dhe jetonte me familjen e tij. Në ceremoninë e varrimit, morën pjesë veteranë të luftës, bashkëfshatar nga Carralluka, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, zv/ministri i MPMS-së, z.Fatmir Shurdhaj, deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Halit Krasniqi dhe qytetarë të shumtë nga rrethina e Malishevës e më gjerë.



Fillimisht, në objektin e shkollës fillore “Hilmi Hoti” në Carrallukë, u bënë homazhe, e më pas u mbajt një akademi mortore, ku u kujtua dhe u vlerësua jeta dhe vepra e Atdhe Hotit.

Ranmiz Hoti, në emër të fshatit Carrallukë, foli për jetën e Atdhe Hotit. “Atdhe Hoti, rrjedh nga një familje atdhetare, ku u rrit në frymën e patriotizmit dhe kombëtarizmit, për çka, ju dha edhe emri Atdhe”. Ndërsa për veprimtarin e tij ushtarak , foli kryetari Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, në Malishevë, z.Enver Hoti, ku tregoi për angazhimin e Atdheut në UÇK, që nga ditët e para, në Luzhnicë, për të vazhduar aktivitetin tij ushtarak, deri në përfundimin luftës dhe çlirimin vendit.



Ndërsa, një fjalim, në këtë akademi mortore mbajti edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj. Në vazhdim, fjalimi i kryetarit Begaj:

E nderuara familje e Atdhe Hotit, të nderuar veteran të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familje të Dëshmorëve, invalid të luftës.

Të nderuar përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të jetës politike dhe ju të nderuar pjesëmarrës.

Më lejoni, që në emër të Komunës së Malishevës, ti shprehi ngushëllime Familjes Hoti, farefisit, fshatit Carrallukë dhe të gjithë bashkëluftëtarëve të veteranit të luftës Atdhe Hotit, i cili në moshën më të mirë të tij, u nda fizikisht nga ne.

Atdhe Alush Hoti, i lindur më 17 prill 1976 nga Carralluka, sikur shumë djem e vajza të popullit shqiptar, më moshën më të mirë të tij, në lulen e rinisë, ju bashkua kushtrimit të Komandantit Legjendar Adem Jashari, për të luftuar kundër okupatorit serbo-sllav dhe për të dhënë kontributin e tij në çlirimin e vendit.

Atdheu, sikur mijëra djem e vajza tjerë nga Malisheva, ju bashkua këtij kushtrimi, qysh në fillimin e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të luftuar deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës, duke treguar kështu përkushtimin e tij për atdheun dhe duke kryer detyrimin e tij ndaj atdheut dhe kombit. Edhe pse me gjendje jo të mirë shëndetësore, Atdheu, nuk e ndali luftën e tij, por krahas shokëve luftoi pandërprerë, duke e bërë veten e tij, familjen dhe rrethin e tij, të ndihen krenar për kontributin e dhënë.

Këtë nderim, Ne po i bëjmë sot një njeriu, i cili qysh në moshë të re u angazhua për çështjen kombëtare. Sado që dhembja është e madhe ne ndihemi krenar për kontributin që dha gjatë luftës për lirinë e atdheut

Kjo gjendje jo e mirë shëndetësore, e detyroi Atdheun, të kërkoj shërim jashtë vendit, sikur edhe shumë bashkëluftëtar të tij. Përveç shërimit, Atdheu, në Austri gjeti edhe punën,..... por fatkeqësisht gjeti edhe vdekjen.

Atdheu, sot ndahet vetëm fizikisht nga ne, pasi jeta dhe vepra e tij, kontributi i dhënë në luftën çlirimtare, Atdheun, e bëjnë të pavdekshëm dhe e bëjnë të mbetet në zemrat dhe mendjet tona, sikur edhe në historinë e popullit shqiptar, përgjithmonë.

Lavdi jetës dhe veprës së Atdhe Hotit.

Në fund, babi i veteranit, Alush Hoti, i ka falënderuar të gjithë të pranishmit për pjesëmarrje dhe nderimin që i bënë për djalin tij, Atdhe Hoti.

Për herë të parë, pas 100 viteve u kujtua “Kryengritja e Banjës”

Malishevë/Banjë, 29 mars



Nën përkujesjen e Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot në Banjë, u shënuar 100 vjetori i kryengritjes së njohur të Banjës dhe fshatrave të Llapushës, kundër okupatorit serbo-malazez, në vitin 1914. Me këtë rast, u zbulua edhe pllaka përkujtimore, e vrasjes së 20 martirëve gjatë asaj kryengritjeje.

Në këtë shënim, krahas qytetarëve të shumtë, morën pjesë edhe kryetari i subjektit politikë “Nisma për Kosovën” dhe deputeti i Kuvendit të

Kosovës, z.Fatmir Limaj, deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Haxhi Shala, zv/ministri i MPMS-së, z.Fatmir Shurdhaj, intelektual dhe historian të shumtë, nga të gjitha trevat shqiptare.

“Sot pas 100 viteve, po e kujtojmë një histori të pashkruar dhe e pashënuar deri më sot, andaj sot është koha, që historia jonë të shkruhet. Po e përkujtojmë këtë ngjarje të pashkruar, sikur edhe shumë ngjarje të tjera që kanë mbetur pa u shkruar, për shkak të rrethanave të kohës, apo të shkruara e të shtrembëruara. Por, neve këto ngjarje, na janë përcjellë nga baballarët tanë, brez pas brezi, në odat tona”, tha kryetari Begaj, me rastin e hapjes së Akademisë, të mbajtur me këtë rast.



Për rëndësinë historike të kësaj ngjarje të madhe, foli historiani Xheladin Shala. Sipas tij dhe dokumenteve të siguruar të asaj kohe, në arkivat e ndryshme, “kjo është njëra prej kryengritjeve më të mëdha, ku janë zhvilluar betejat të ashpra, mes kryengritësve shqiptar, të prirë nga Sadri Bytyçi, nga Lacët e Drenocit, etj, ku pas betejave të përgjakshme, forcat serbo-malazeze e maqedone, kanë pësuar humbje të mëdha. Si pasojë e këtyre humbjeve, okupatori serbo-malazez, ishte organizuar në shuarjen e kësaj kryengritjeje, ku janë zhvilluar betejat të ashpra në Kërvasari, Drenoc, Senik, Banjë e vende tjera. Në këtë kryengritje, thuhej se kanë marrë pjesë rreth 800 kryengritës të armatosur, të mbështetur nga më shumë se një



mijë të tjerë të gatshëm, dhe nga gjashtë mijë kryengritës nga Shqipëria. Pas masave të ashpra, përmes granatimeve të vendbanimeve dhe përdorimi i artilerisë së rëndë, një pjesë e kryengritësve u vranë, një pjesë u arrestuan, disa tjerë lëshuan vendin, ndërsa një pjesë u shpërnda në çeta të vogla, për ta vazhduar luftën për çlirimin e trojeve shqiptare”.

Kurse, historiani tjetër, Agon Rrezja, lexoi një kumtesë shkencore, lidhur me kryengritjen e Banjës, ku në mënyrë kronologjike, paraqiti përpjekjet e popullit shqiptar të Kosovës, për çlirimin e vendit, që nga koha e pushtimit turk, deri në këtë kryengritje të përmasave të mëdha, jo vetëm me pjesëmarrjen e kryengritësve, por edhe me jehonën e kësaj kryengritjeje.

Kryetari i “Nisma për Kosovën” dhe deputet i Kuvendit të Kosovës, z.Fatmir Limaj, shprehi mirënjohjen e tij, për angazhimin e historianëve, që u munduan ta pasqyrojnë historinë e luftës së Banjës. “Le të shërbej ky kujtim, për t’u ndier krenar edhe 100 vite pas kësaj lufte”, tha Limaj. “Jemi krenar që po përkujtojmë historinë e stërgjyshëve dhe baballarëve tanë dhe unë i porosisë mësimdhënësit tanë, që këtë histori t’ju përcjellin brezave”, tha mes tjerash Limaj.

Ndërsa, zv/ministri i MPMS, z.Fatmir Shurdhaj, duke marrë fjalën, përshëndeti në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe tha se, “Qeveria e Kosovës, është angazhuar për mbrojtjen e këtyre vlerave të kombit”. “Kjo histori e shkruar jo drejt në të kaluarën, duhet të shkruhet drejt nga historianët tanë”, porositë zv/ministri i MPMS-së, z.Fatmir Shurdhaj.

Në fund, në vendin e vrasjes, u zbulua edhe pllaka përkujtimore, e vrasjes së 20 personave, në mars të vitit 1914 në Banjë.

Nesër fillon muaji i pastrimit në Komunën e Malishevës

Malishevë, 31 mars

Duke filluar nga dita e martë, më 1 prill, fillon edhe muaji i pastrimit në territorin e Komunës së Malishevës. Kjo u bë e ditur, nga kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në mbledhjen e rregullt të së hënës, të Këshillit të Drejtorëve, ku u paraqit edhe orari i pastrimit të ambientit nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës, të përgatitur nga drejtoria komunale e shërbimeve publike.

Fillimisht, nesër më 1 prill, duke filluar nga ora 09:00, do të filloj pastrimi i ambientit në qytetin e Malishevës, ku janë të përfshirë, të gjithë punëtorët e administratës komunale, shkolla të mesme dhe filllore dhe të institucioneve tjera që janë në Malishevë.

Në mbledhjen e sotme, kryetari Begaj, ka kërkuar nga drejtoritë komunale, që të vazhdojnë me punët e tyre të përditshme dhe vazhdimin e realizimit të projekteve, sikur edhe raportimin e punëve të kryera deri më tani.

Begaj e Ibishi, biseduan për koordinimin kundër etheve hemorragjike

Malishevë, 31 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot, në një vizitë pune, zëvendës ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), z.Ismet Ibishi, ku qëllimi i vizitës ishte mbështetja dhe bashkëpunimi rreth reagimit të planit të veprimit të shkaktuar nga ethet hemorragjike. Begaj e Ibishi, kanë biseduar për hapat në vijim, në kuadër të strategjisë kombëtare, për luftimin dhe parandalimin e etheve

hemorragjike “Krime Kongo” (EHKK) dhe për organizimin në nivelin komunal, në kuadër të kësaj strategjie.

Kryetari Begaj, pasi e ka falënderuar zv/ministrin, për vizitën dhe interesimin e tij dhe të grupit ndërministror, në luftimin dhe parandalimin e EHKK, kërkoj nga institucionet qendrore që të japin një përgjigje më të shpejt, për formën e spërkatjes së zonave endemike, kundër rriqrave, si bartësit kryesor të virusit vdekjeprurës EHKK. “Mos dhënia e përgjigjes, është shqetësuese për ne dhe kërkojmë që sa më shpejt, ta marrim një përgjigje për këtë çështje”, tha Begaj.

“E kuptoj brengën dhe shqetësimin tuaj, rreth përgjigjeje mirëpo janë masat konkrete së vepruarit dhe shpresoj që së shpejti do të bëhet zgjedhja e duhur. Ne jemi të gatshëm dhe mendoj që është koha që të grisim qendrën e bashkuar të koordinimit, në hartimin e planit të veprimit, ku reaguesit e parë do të jenë shëndetësia, emergjenca, policia dhe së bashku të startojmë të bashkuar në luftimin e kësaj sëmundje” tha zv/ministri i MPB-së, z. Ibishi.

Nga ana tjetër, përgjegjësit komunal të drejtorive për mbrojtje dhe shpëtim dhe asaj të shëndetësisë, Ahmet Morina dhe Hajdin Berisha, e kanë njoftuar zv/ministrin Ibishi, për ecurinë e zbatimit të strategjisë. Përderisa drejtori Morina, e njoftoi se është formuar shtabi, apo qendra koordinuese, si dhe janë angazhuar edhe personeli shtesë, drejtori Berisha, e njoftoi se strategjia kombëtare, për luftimin dhe parandalimin e EHKK, deri më tani, është realizuar njëqind për qind dhe presim vetëm përgjigje nga institucionet qendrore, për formën e spërkatjes.

U përkujtuan të vrarët në masakrën Burimit

Malishevë, 31 mars

Me homazhe, të bëra nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe nga qindra qytetarët të Dragobil, Astrazupit dhe vendeve tjera, u përkujtua masakra e Burimit, e cila është masakra më e madhe në Komunën e Malishevës, gjatë luftës së fundit, e ndodhur 15 vite më parë, tek Vrella e Mëhillit në fshatin Burim. Nderime, janë bërë edhe në vendin e vrasjes.



Me këtë rast, kryetari Begaj, i ka ngushëlluar familjarët e 42 viktimave të kësaj masakre.

Më 31 mars 1999, në vendin e quajtur “Vrella e Mëhillit”, në periferi të fshatit Burim, ishin ekzekutuar 38 shqiptarë, ndërkohë që katër të tjerë ishin djegur. Kjo ka qenë masakra më e madhe që ka ndodhur gjatë kohës së luftës së fundit për liri në komunën e Malishevës.

Kryetari Begaj, priti përfaqësuesit e UNMIK-ut

Malishevë, 31 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot, në një takim njoftues zyrtarë për komunitete në UNMIK, znj.Lilia Galieva, me të cilën kanë biseduar për zhvillimet e përgjithshme dhe aktivitetet, që lidhen me komunitetet, problemet me të cilat ballafaqohet Malisheva.



Fillimisht kryetari Begaj, i falënderoi për vizitën dhe interesimin e tyre për Malishevën, si dhe i ka njoftuar me gjendjen e përgjithshme në Komunën e Malishevës, arritjet, problemet me të cilat përballet, ku sipas kryetarit Begaj, papunësia, është bregua kryesore, duke mos lënë anash as problemet tjera.

Ndërsa, zyrtarja për çështje të komuniteteve në UNMIK, znj. Lilia Galieva, e ka falënderuar kryetarin Begaj, për pritjen, duke u interesuar më pas, për zhvillimet e përgjithshme në Malishevë, si dhe për komunitetin RAE.

Kanalizimi dhe ujësjellësi nevoja emergjente për Bubavecin dhe Kijevën

Malishevë, 31 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtorët komunal, në kuadër të takimeve të drejtpërdrejta me qytetarë, gjatë mbrëmjes së djeshme, është takuar me banorët e fshatrave Bubavec dhe Kijevë, ku është njohur me problemet me të cilat përballen banorët e këtyre dy fshatrave.

Qëllimi i takimeve me qytetarët e Komunës së Malishevës, është edhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje kundër thumbimeve nga rriqrat dhe mbrojtja e ambientit, sikur edhe njohja me problemet që kanë banorët, por edhe për angazhimet e komunës, në realizimin e projekteve të ndryshme, që lidhen direkt me mirëqenien e qytetarëve.



Ndërtimi i shkollës në Bubavec, dhe ndërtimi i ujësjellësit duke kaluar në disa faza Bubavec dhe Kijevë, janë dy nga angazhimet maksimale që është duke bërë aktualisht komuna, por nuk do të lihen anash as investimet në infrastrukturën tjetër, të dy fshatrave, ku prioritet do të ketë kanalizimi, sidomos në Kijevë.

Në Bubavec, problem kryesor ishte ndërtimi i objektit të ri të shkollës së fshatit, uji për pije,

kanalizimi dhe disa rrugë në lagjet e fshatit, kërkesë tjetër me rëndësi, ishte ndërtimi i trotuarit nga Bubaveci deri në Kijevë, për shkak se të gjithë nxënësit shkojnë në shkollën e mesme në Kijevë dhe janë të rrezikuar seriozisht gjatë lëvizjes.

Ndërsa në Kijevë, problem kryesor është kanalizimi i fshatit dhe grumbullimi i ujërave të zeza, nga vendbanimet tjera në Kijevë, që është tepër shqetësuese për banorët e këtij fshati. Uji i pijes, gjithashtu është problem i madh me të cilin përballen banorët.

Ndërsa shqetësim i përbashkët i të dy fshatrave, ishte edhe rrejtja e dobët e energjisë elektrike, për çka kërkuan nga kryetari Begaj, ushtrimin e ndikimit të tij për rregullimin e kësaj çështje, edhe pse kjo nuk është kompetencë e komunës.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 125- Prill 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>
www.malisheva-komuna.org



Pamje nga shënimi i muajit të ambientit, largimi i mbeturinave dhe pastrimi i rrugëve nga bora

Filloi muaji i pastrimit në Malishevë

Malishevë, 1 prill



Me një aksion simbolik, duke pastruar parqet dhe ambientet tjera në qytetin e Malishevës, edhe zyrtarisht, sot ka filluar muaji i pastrimit të ambientit në Malishevës. Aksioni i sotëm, është prirë nga i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ndërsa aksionit i janë përgjigjur, të gjitha institucionet në Malishevë, përfshi edhe nxënësit. Gjatë ditës së sotme, përveç largimit të mbeturinave, janë mbjellë edhe drunj dekorativ, në parkun kryesor të qytetit.

Muaji prill, nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, është shpallur muaj i pastrimit të ambientit, ku planifikohet të pastrohen të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës dhe largimin e mbeturinave, ku janë regjistruar deponi ilegale të grumbullimit të mbeturinave.

Aksionin mujor për pastrimin e ambientit, e organizon drejtorja komunale e Shërbimeve Publike dhe sipas orarit të përcaktuar, aksionet do të zhvillohen në të gjitha fshatrat e Malishevës, ndërsa ky aksion ka filluar nga sot, në ditën ndërkombëtare të pastrimit, në qytetin e Malishevës.

Përndryshe, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, tash e një muaj, është duke zhvilluar takime me qytetar, në të gjitha fshatrat, me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve, për largimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e ambientit.

Ministria e Mjedisit, kërkon mbrojtjen e monumenteve natyrore

Malishevë, 1 prill



Malishevës.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot zyrtarët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjegjësisht drejtorin e Institutit të Kosovës për mbrojtje të natyrës, z.Fadil Bajraktarin dhe udhëheqësin e departamentit të mbrojtjes së natyrës, z.Sami Beharmin, të cilët kërkuan që Kuvendi i Komunës, të marr vendim për mbrojtjen e monumenteve të natyrës në territorin e Komunës së

Kryetari Begaj, i falënderoi për vizitën dhe angazhimin e tyre, në mbrojtjen e monumenteve natyrore në Malishevë, si dhe i njoftoi se Kuvendi i Komunës së Malishevës, vite më parë, ka miratuar listën e monumenteve të natyrës, por kërkoj që edhe institucionet qendrore të jenë të angazhuara në këtë drejtim, dhe premtoi që brenda një kohe të shkurtë, do ta shtron këtë çështje në Kuvendin e Komunës për miratim, në mënyrë që edhe ligjërisht, monumentet natyrore, si një pasuri e veçantë e Malishevës, të mbrohen.

Zyrtarët e MMPH-së, thanë, se këto zona, janë të identifikuara si zona të veçanta natyrore dhe është shumë e nevojshme që të mbrohen. Në listën e monumenteve natyrore, janë të identifikuara 17 zona. Zyrtarët e kësaj ministrie, po ashtu kërkuan që Shpella e Flladit në Panorc, të mbyllet përkohësisht, deri në rregullimin e plotë të saj për vizitorë, në mënyrë që të mbrohet nga dëmtimi që po i bëhet nga personat e papërgjegjshëm.

Në Drenoc, u prezantua projekti ideor i ujësjellësit

Malishevë, 3 prill



Mbrëmë në Drenoc, është bërë prezantimi i projektit ideor për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatin Drenoc, i hartuar nga USAID, e cili do të bashkëfinancohet nga USAID dhe Komuna e Malishevës. për nda numri i banorëve, Drenoci, është fshati më i madh në Komunën e Malishevës, ndërsa është edhe fshati që ka më shumti problem, për sigurimin e ujit për pije.

Qëllimi i prezantimit, sipas përfaqësuesve të IRD-së, të cilët implementojnë fondet e USAID në fushën e infrastrukturës së ujësjellësve, ishte njohja me projektin, shtrirjen e planifikuar të rrjetit dhe më e rëndësishmja, të eliminohen defektet e mundshme gjatë hartimit të projektit ideor, para hartimit të projektit final.

Sipas zyrtarëve të IRD-së, ndërtimi i ujësjellësit është në proces dhe deri në muajin qershor, pritet të finalizohet shtrimi komplet i rrjetit, në tërë fshatin.

Në këtë prezantim, krahas zyrtarëve të IRD-së, ishin edhe kreu i Malishevës, z.Ragip Begaj, me bashkëpunëtor, i cili shprehi kënaqësinë për fillimin e procesit të ndërtimit të ujësjellësit për Drenoc, si një prej projekteve më me rëndësi, pasi uji është elementi kryesor i jetës.

Djegia e gomave për furrat e gëlqeres problemi kryesor për Bardhin

Malishevë, 3 prill

Në kuadër të takimeve të drejtpërdrejta me banorët e vendbanimeve të Malishevës, mbrëmë është takuar me banorët e fshatit Bardh, me qëllim të informimit rreth etheve hemorragjike, largimit të mbeturinave, si dhe për të dëgjuar për hallet dhe problemet që kanë banorët e këtij

fshati, prej doli se djegia e gomave në furrat e gëlqeres, është shqetësimi më i madh për banorët e këtij fshati.

Fillimisht kryetari Begaj, ka kërkuar nga banorët e Bardhit, që të kenë kujdes të shtuar, në mënyrë që të zvogëlojnë mundësinë e infektimit nga ethet hemorragjike, duke i ikur kontaktit me rriqrat, ndërsa kërkoi që edhe Bardhi, sikur edhe vendet tjera, ti bashkohen aksionit për largimin e mbeturinave.



Ndërsa drejtori i drejtorisë për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, i njoftoi banorët, me masat që është duke marrë Komuna e Malishevës, për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike “krime kongo”, duke kërkuar në të njëjtën kohë, edhe kujdes të shtuar nga vet banorët. “Brenda kësaj jave presim përgjigje përfundimtare për formën e spërkatjes, masive apo selektive, por sidoqoftë,

Komuna e Malishevës dhe shërbimi shëndetësor, do të jenë 24 orë në shërbim të banorëve, andaj, në asnjë mënyrë, nëse thumboheni nga rriqrat, mos i largoni, por kërkoni ndihën e mjekut”, ka bërë thirrje drejtori Berisha.

Nga ana tjetër, banorët e fshatit Bardh, shprehën shqetësimin e tyre, për ndotjen e ambientit nga furrat e gëlqeres, pasi në ato furra, viteve të fundit, po përdoren gomat e vjetra për djegie dhe rrjedhimisht, janë duke e ndotur ambientin në shkallë të lartë, për çka kanë kërkuar marrjen e masave për eliminimin e kësaj dukurie. Tradicionalisht, banorët e kësaj, kanë jetuar nga përfitimi i gëlqeres, si burim i jetës për ta.

Probleme tjera, me të cilat përballen banorët e këtij fshati, janë edhe kanalizimi, nevoja për shtrimin e disa rrugëve dhe meremetimin apo ndërtimin e shkollës, pasi objekti aktual, edhe pse i ndërtuar viteve të fundit, është punuar jo mirë dhe jashtë standardeve, përderisa rrezikohen edhe nxënësit nga rënia e tavanit. Të rinjtë e këtij fshati kërkuan ndërtimin e një fushe sporti, e cila do të shërbente për nevojat e tyre dhe të shkollës.

“Angazhimi ynë për realizimin e kërkesave të juaja nuk do të mungoj dhe ne do ti shytojmë të gjitha mundësitë, për realizimin e kërkesave të juaja, përdërisa një rrugë, brenda pak ditëve do të shtrohet, sikur edhe një pjesë e kanalizimit”, tha mes tjerash Begaj.

Seminar për rritjen e bashkëpunimit mes KKSB-së, KLSP-së dhe Policisë

Malishevë, 3 prill



Organizuar nga OSBE misioni në Kosovë, dhe përkrahur nga Komuna e Malishevës, sot është mbajtur një seminar, me temën “Rritja e bashkëpunimit në mes të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), Komiteteve Lokale të Sigurisë Publike (KLSP) dhe Policisë së Kosovës”, e ku morën pjesë, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, me zyrtarët përkatës, pastaj Erduan Gjiglli nga OSBE, Rifat Marmullaku-OSBE,

Fatmir Limani nga Policia e Kosovës, Ganimete Gerboci nga MPB-ja, dhe komandanti dhe zv/komandanti i stacionit policor në Malishevë, Halil Morina dhe Bekim Begaj.

Në këtë seminar, u fol për zhvillimet në sektorin e sigurisë, në veçanti bashkëpunimin mes KKSB-së me organizmat tjerë, si dhe për nevojën e formimit të Komitetit Lokal për Sigurinë Publike. Përdërisa siguria e përgjithshme, u vlerësua e mirë në Malishevë, u tha se parandalimi është masa më e mirë për ruajtjen e sigurisë.

“Është shumë e nevojshme rritja e këtij bashkëpunimi, pasi kemi nevojë që siguria të rritet edhe më shumë në Komunën e Malishevës dhe ndarja e praktikave të mira është shumë e nevojshme” tha në fjalën e tij kryetari Begaj.

Ndërsa për Erduan Gjiglli, nga OSBE, gjithashtu tha se “Ndarja e praktika të mira është me rëndësi sikur edhe rritja e bashkëpunimit mes personave profesional në fushën e sigurisë”.

“Siguria është një problem kompleks, pasi pa bashkëpunim të mirë me komunitetin, nuk mund të arrihet edhe nivel i lartë i sigurisë në bashkësi”, tha Fatmir Limani nga Policia e

Kosovës, i cili më pas edhe paraqiti disa nga faktorët që ndikojnë në prishjen e sigurisë dhe nevojën për formimin e KLSP-ve.

Për qëllimin e seminarit, për forcimin komunikimit mes KKSB-ve, KLSP-ve dhe policisë, si dhe për rolin e KLSP-ve dhe EVSB-ve në KKSB, ka folur, Rifat Marmullaku, nga OSBE-ja.

Begaj priti, zyrtarët e LMT-së

Malishevë, 3 prill



Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën tij kapitenin zviceran Patric Masshardt, KFOR-it (LMT), në një takim lamtumirës, i cili ka vepruar në Malishevë dhe ka pasur bashkëpunim të ndërsjellët në fushën e sigurisë, si dhe aspekte tjera të përgjithshme rreth fushës së sigurisë në Malishevë.

Kryetari Begaj, falënderoi për vizitën, dhe për bashkëpunimi të ndërsjellët që kanë (LMT) KFORI me Komunën e Malishevës dhe vlerësoi lartë punën e KFOR-it në përgjithësi jo vetëm në Malishevë. Në mes tjerash kryetari Begaj, tha “ Unë ju falënderoj ju për bashkëpunimin e mirë dhe gatishmërin tuaj që keni pasur rreth çështjes së sigurisë në komunën tonë, dhe po besoj që veç për të mirë do të keni në kujtesë Malishevën, dhe juve ju dëshiroj suksese në misionin e juaj”.

Kapiteni zviceran Patric Masshardt, falënderoi Kryetarin Begaj për mikpritjen dhe bashkëpunimin ku në mes tjerash tha “ Kamë kënaqësinë që ju kamë shërbyer këtu, shqetësimet dhe interesat e Malishevës i kamë paraqitur edhe në njërën nga revistat në atje në Zvicër”

Gjendja e sigurisë së përgjithshme, si nga ana e LMT-së, po ashtu edhe nga Kryetari Begaj u vlerësua më e qeta ndër të gjitha komunat dhe pa incidente të cilat mund ta prishin sigurinë e përgjithshme në Komunën e Malishevë, Kryetari Begaj u shpreh i gatshëm edhe për bashkëpunim të më tejshëm si nga ana e Komunës po ashtu edhe nga ana e KFOR-it (LMT).

QMF e Kijvës, prej tani punon në dy ndërrime

Malishevë, 4 prill



Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) në Kijevë, ka filluar të punoj në dy ndërrime, do të thotë nga ora tetë e mëngjesit deri në ora 23 e natës. Për këtë qëllim, gjatë pasdites së djeshme këtë qendër mjekësore, e ka vizituar edhe Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar edhe nga drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha dhe drejtori i QKMF-së në Malishevë, z.Besim Zogaj.

Kryetari Begaj në koordinim me drejtorin e shëndetësisë, pas shqyrtimit të kërkesave të banorëve të kësaj ane, kanë marrë vendim që QMF në Kijevë, të filloj të punoj në dy ndërrime, pasi rreth Kijeva dhe fshatrat përreth, kanë nevojë për këto shërbime shëndetësore, për shkak të largësisë që kanë me qendrën komunale.

Qëllimi i vizitës së djeshme, ka qenë fillimi i punës në ndërrimin e dytë, por edhe njohja me kushtet punës dhe problemeve që mund ti kenë stafi mjekësor dhe pacientët në këtë qendër mjekësore. Kryetari Begaj, ka premtuar angazhim maksimal, në përkrahje të punës për këtë QMF, në mënyrë që banorëve të kësaj ane, t'ju ofrohen shërbime sa më të mira shëndetësore.

Vazhdon aksioni i pastrimit të ambientit

Malishevë, 4 prill



Aksioni i pastrimit të ambientit, gjegjësisht largimi i mbeturinave nga deponitë ilegale, ka filluar më 1 prill, ku është pastruar një pjesë e Malishevës, pastaj Golluboci, dhe është duke vazhduar në vendbanimet tjera, sipas orarit të përcaktuar nga drejtoria e Shërbimeve Publike. Për këtë qëllim, gjatë pasdites së djeshme, kryetari Begaj, i ka vizituar Mleqanin dhe Plloqicën, dy vendbanime, ku ka vazhduar aksioni gjatë ditës së djeshme.

Duke parë nga afër zhvillimin e këtij aksioni, i cili do të zgjasë, jo vetëm gjatë muajit prill, por deri në largimin e të gjitha këtyre deponive, Kryetari Begaj, ka ofruar mbështetjen e tij, në përkrahje të këtij aksioni. Begaj, gjatë bisedave me banorët e këtyre fshatrave, ka thënë se “nëse arrij ti largoj mbeturinat dhe ta shoh këtë vend të pastër, gjatë këtij mandati, nuk dua asgjë me tepër në jetën time”.

Muaji prill, ishte shpallur nga ana e kryetarit Begaj, ishte shpallur muaj i pastrimit, ku përmes aksioneve nga Komuna, kompania e grumbullimit të mbeturinave “Eko regjioni”, njësia në Malishevë dhe banorët e të gjitha vendbanimeve, pritet të largohen mbeturinat nga ambienti. Kryetari Begaj, këtë aksion është duke e promovuar edhe në të gjitha takimet me qytetar, që po i mbanë në vazhdimësi, nëpër fshatrat e Malishevës.

Komiteti për Komunitete, mbajti mbledhjen e dytë

Malishevë, 4 prill

Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendit të Komunës në Malishevës, drejtuar nga kryetari i këtij komiteti, z.Fatmir Ademaj, ka mbajtur mbledhjen e dytë të radhës, ku me vota unanime, kanë miratuar planin e punës së komitetit, për vitin 2014. Në mbledhja ka marrë pjesë edhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z.Enver Hoti.



Komiteti për komunitete ka diskutuar një varg çështjesh që lidhen me punën e tyre, në bazë të kompetencave që ka komiteti dhe për angazhimet, në bazë të planit të punës, për vitin 2014, ku parashihen një varg aktivitete, që lidhen me komunitetet e ndryshme në shoqërinë tonë.

Komiteti ka diskutuar edhe për plotësimin edhe me një anëtar të komitetit nga komuniteti rom, përderisa anëtar i komitetit, është edhe një përfaqësues nga komuniteti ashakli, duke e shtuar numrin e përfaqësimit të komuniteteve në dy anëtar.

Kryetari Begaj priti përfaqësuesen e Këshillit të Evropës

Malisheve, 04 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyraren nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Prishtinë, znj.Sirje Poder, menaxhere e Projektit të ARDA SOUTH/Zhvillimit Ekonomik Rajonal Jug si dhe ARDA/Asociacionit të zyrave rajonale, ku diskutuan rreth statutit të ri për zyrën e ARDA-s si dhe për të gjithat zyrat e ARDA-s.

Kryetari Begaj falënderoi për vizitën znj.Sirje Poder, për ndihmën dhe bashkëpunimin që kanë me Komunën e Malishevës dhe biseduan rreth çështjeve të ndryshme të agjencioneve të Asociacionit të zyrave rajonale, dhe për ekonominë në përgjithësi për Komunën e Malishevës.

Po ashtu znj. Poder falënderoi Kryetarin Begaj për mikpritjen dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, si dhe për kontributin e dhënë të Malishevës, në këtë asociacion, i cili kryesohet tani nga kryetari Begaj.

Dita e shëndetësisë, u organizua në Malishevë

Malishevë, 7 prill



Dita Botërore të Shëndetësisë, në Kosovë, u shënuar në Malishevë, ku kjo ditë këtë vit ju i është përkushtuar parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve që përhapen përmes vektorëve (bartësve). Me qëllim të shënimit të kësaj dite, Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Zyra e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në bashkëpunim me Komunën e Malishevës organizojnë shënimin e

kësaj dite në mënyrë simbolike në Malishevë, duke trajtuar çështjen e Etheve Hemorragjike Krime -Kongo.

Pjesëmarrës në këtë shënim do të jenë zyrtarë të MSH-së, IKSHP-së, QKUK-së, spitaleve rajonale, anëtarët e Këshillit Ndërministror për parandalimin dhe luftimin e Etheve Hemorragjike, autoritetet lokale të komunave që shquhen me më shumë raste të EHKK, mediat dhe të tjerë.

Fillimisht kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, i ka falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në këtë shënim, përderisa shprehi “besimin se tani po konkretizohen gjërat për punë më të mirë në fushën e luftimit dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo”.

“Në Kosovë, ka pasur arritje premtuese, për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore”, tha ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, Ferid Agani, duke i përmendur ligjet e miratuara që kanë të bëjnë me shëndetësinë. “Jam i kënaqur që sot kemi një plan operacional për luftimin e EHKK”, tha ministri Agani, duke folur për temën.

Epidemiolog Isuf Dedushaj, foli për sëmundjen EHKK, historinë, format e përhapjes dhe për rriqrat si bartësit kryesor të EHKK dhe për situatën epidemiologjike në vend.

Skënder Sylja, nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në Kosovë, foli për sëmundjen që barten përmes vektorëve, ndërsa Naser Ramadani nga IKSHP-ja, dhe folësit tjetër, folën për ethet hemorragjike, për mënyrat mbrojtëse dhe për planin operativ, për strategjinë kombëtare për luftimin e theve hemorragjike Krime Kongo (EHKK).

Në këtë tryezë dhe në prononcimet për medie, nga shumica e folësve u theksua, se ende në strategjinë për luftimin dhe parandalimin e EHKK, është spërkatja selektive. Përderisa në përfaqësues i kompanisë, e cila mendohet se do të bëjë spërkatjen masive (nga ajri), mbrojtja formën e kësaj spërkatje, shumë prej pjesëmarrësve, hodhën poshtë këtë mundësi. AUV dhe epidemiologët, thanë se përderisa nuk ka praktika të tilla, askund në botë, nuk mund të lejohet të bëhet këtu, ndërsa ministri i shëndetësisë, z.Agani, tha se ende sipas strategjisë, spërkatja do të bëhet selektive.

Deri te kjo përplasje për formën e spërkatjes, erdhi, pasi ekzekutivi i Komunës së Malishevës, kërkoi sqarim dhe dhënie të mendimit për formën e spërkatjes dhe kohën.

Vazhdon aksioni i pastrimit në Komunën e Malishevës

Malishevë, 8 prill



Muaji prill shpallur si muaj i pastrimit, po vazhdon që nga data 1 prill, duke u pastruar disa nga fshatrat e Komunës së Malishevës, ku po largohen deponitë e mëdha të mbeturinave. Gjatë ditës së djeshme aksioni, i pastrimit ka vazhduar në fshatin Drenoc, ku janë larguar disa nga këto deponi, brenda dhe jashtë fshatit.

Për këtë qëllim, edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka inspektuar gjatë pasdites së djeshme, aksionin e largimit të mbeturinave në këtë vendbanim, duke u shprehur i kënaqur me punën dhe duke kërkuar që edhe banorët e fshatrave ti përgjigjen këtij aksioni dhe bashkërisht të pastrohet i tërë ambienti.

Muaji prill, është shpallur muaj i pastrimit të ambientit në Malishevë, ndërsa kryetari Begaj, në çdo takim me banorët e fshatrave të Komunës së Malishevës, dhe në të gjitha mundësitë tjera të paraqitjes publike, ka bërë thirrje për pastrimin dhe ruajtjen e ambientit.

Begaj: Për 100 ditë, kemi zvogëluar shpenzimet dhe kemi rritur aktivitetet

Malishevë, 8 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka prezantuar para medieve, 100 ditët e para të qeverisjes së tij, ku përmes fakteve, ka thënë se ka ulje të shpenzimeve dhe rritje të aktiviteteve të komunës. “Jam i bindur se janë shtuar aktivitetet në shkallën 90 për qind dhe kemi zvogëluar shpenzimet, por kemi rritur edhe të hyrat”, ka thënë Begaj, para përfaqësuesve të medieve.

“Janë rritur të hyrat dhe janë zvogëluar shpenzime dhe kemi shtuar aktivitetet, jam i bindur se kemi 90 për qind me shumë aktivitete, kemi organizuar takime në fshatra, takime të përditshme me qytetar në zyre, dhe jo vetëm të premtëve kur është i caktuar termi, pasi nuk mund ti refuzoj qytetarët. Jam zotuar dhe do ta jap maksimumin që unë dhe qeveria komunale, të jemi në shërbim të qytetarëve të Komunës së Malishevës”, tha Begaj

Më pas kryetari Begaj, i ka prezantuar të gjitha shpenzimet dhe të hyrat, në bazë të raportit të drejtorisë për buxhet dhe financa, për tremujorin e parë të qeverisjes së tij, si dhe për projektet që janë duke u realizuar apo që janë në procedurë e sipër për realizimin e tyre.

Në vazhdim, e keni prezantimin e kryetarit Begaj, para medieve për punën tremujore, të hyrat, shpenzimet, dhe aktivitetet e tij:



“Të hyrat, krahasuar me tremujorin e parë të viteve të kaluara, p.sh. 2012 kanë qenë 115 mijë euro të hyra, më 2103 kanë qenë 129 mijë euro të hyra, ndërsa këtë vit janë 158 euro të hyra vetanake, ose 29 mijë euro më shumë se viti paraprak, edhe pse i kemi hequr taksat komunale për bizneset.

Shpenzimet operative për mallra dhe shërbime, për vitin 2013 kanë qenë 35 për qind, ndërsa për vitin 2014 janë vetëm 12 për qind shpenzime. Shpenzimet e udhëtimit për vitin 2013 kanë qenë 42 mijë euro, këtë vit janë ulur në 8 mijë euro. Shpenzime kontraktuese kanë qenë 43 mijë euro në 2013, tani janë 25 mijë euro. Furnizimi për zyre, kanë qenë 19 mijë më 2013, tani janë 6 mijë euro, krahasuar me periudhën e njëjtë. Shpenzime të karburantit, prej 36 mijë në vitin e kaluar, kanë rënë në 5 mijë në këtë vit. Drekat zyrtare, në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kanë qenë 14 mijë euro, tani janë 2 mijë euro. Të gjitha këto janë krahasime me vitin paraprak, ndërsa ju vet mund ta bënë krahasimin apo dallimin me periudhën e njëjtë të vitit 2013.

Sa i përket projekteve, ne kemi intervenuar në riparimin e disa kanalizimeve, në disa fshatra, si në Marali, Turjakë, Panorç, Drenoc, dhe të tjera, ku ka qenë emergjente intervenimi, për ta larguar kontaminimin e ujit për pije dhe ka qenë rrezikshmëri e lartë nga dalja e ujërave të zeza në sipërfaqe.

Pastaj, janë projektet e shkollave në proces e sipër, si në Gurishtë, Golluboc, Bubavec, Carrallukë, Shkozë, Damanek dhe ajo në Vërmicë. Brenda dy viteve, të gjitha do të përfundojnë. Rrugët e parapara për këtë vit, në procedurë e sipër, si ajo e Ukajve në Vërmicë, e Lagjes Muhaxhirëve në Tërpezë, ajo e Kirrellëve në Bardh dhe ajo e Kodralive në Kërvasari. Të gjitha këto do të përfundojnë brenda këtij viti. Janë hapur tenderët dhe janë bërë paramasat për kanalizime në 20 fshatra. Kanë përfunduar procedurat për ndërtimin e çerdhes për fëmijë, në Malishevë dhe kjo brenda pak ditëve do të fillojë të ndërtohet.

Projekti më madh, në realizim e sipër, është projekti i ujësjellësit për fshatin Drenoc, i cili pritet të finalizohet brenda këtij viti, pjesa e rrjetit dhe pjesa tjetër e ujëmbledhësit në Senik, ku kemi ndarë mjete së bashku me Hidroregjionin, ku edhe është duke u punuar.

Në bujqësi kemi ndarë mjete për fermerët, dhe do të ndajmë përsëri mjete për fermer, në perimtari dhe blegtori. Kemi mbështetur fermerët me 0.05 cent për litër të qumështit. Synojmë të mbështesim edhe bletarinë.

Kemi mbështetur të gjitha ekipet sportive që veprojnë në Malishevë. Skamnorët i kemi mbështetur me 10 mijë kilogram miell, por edhe me ndihma të kohëpaskohshme, ku vetëm muajin e kaluar kemi ndarë rreth 5 mijë euro ndihma, si dhe kemi ndarë 75 bursa për studentë.

Do të përpiqemi në maksimum të mbështesim të gjithë që kanë nevojë dhe të realizojmë të gjitha synimet tona edhe pse është shkurtuar buxheti i komunës.

Të gjitha që i thash, i kam premtuar gjatë fushatës elektorale, madje të gjitha që kam menduar ti kryej gjatë mandatit katër vjeçar, do të kryhen shumica dërmuese gjatë këtij viti. Për vitet e ardhshme i mbetet kuvendit të vendos për projekte, pasi unë gati i kam përfunduar të gjitha që i kam premtuar.

Këto janë shifra dhe fakte konkrete, se si kemi vepruar në këtë tremujor”.

KKSB mbajti takimin e parë të punës

Malishevë, 10 prill



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), mbajti sot takimin e parë të punës, ku u shqyrtuan një varg çështjes me rëndësi për punën e këtij këshilli, si organ i Kuvendit të Komunës dhe për sigurinë e përgjithshme në Komunën e Malishevës, ku u vlerësua se situata e sigurisë së përgjithshme, është e qetë dhe stabile, dhe pa indikacione për prishjen e sigurisë së përgjithshme.

Takimin e parë të KKSB-së, e udhëhoqi nënkryetari i komunës, z.Rexhep Mazreku, i cili, pasi i falënderoi për pjesëmarrje, anëtarët e këtij këshilli, uroi që “ puna e KKSB-së të ecën mirë dhe kërkoi që të gjithë të japin kontributin e tyre në krijimin e sigurisë në Malishevë”. Më pas nënkryetari Mazreku, i njoftoi anëtarët e KKSB-së, me vendimin e KK të Malishevës për formimin e këtij këshilli dhe për emërimin e anëtarëve të tij, si dhe me udhëzimin administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, që ka të bëjë me formimin dhe funksionimin e KKSB-së.

KKSB, në këtë mbledhje, diskutoi edhe për planin e punës për vitin 2014, ku dhanë mendimet dhe propozimet e tyre, lidhur me punën e tyre për këtë vit.

Në pikën diskutimit për vlerësimin e sigurisë së përgjithshme në Malishevë, anëtarët e KKSB-së, e vlerësuan në nivel situatën sigurisë së përgjithshme, dhe pa indikacione për prishjen e kësaj situatë.

Ministria e Shëndetësisë, ndihmon QKMF-në me një autoambulancë

Malishevë, 10 prill

Ministria e Shëndetësisë, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira shëndetësore, ja ka dhuruar Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familje (QKMF) “Dr.Shpëtim Robaj” në Malishevë, një autoambulancë. Kështu ka bërë të ditur për Zyrën për Informim, drejtori i shëndetësisë z.Hajdin Berisha.

Me këtë rast, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha dhe QKMF e Malishevës, e falënderojnë Ministrinë e Shëndetësisë, për këtë autoambulancë, e cila realisht, është shumë e nevojshme, për ofrimin e shërbimeve më të mira shëndetësore, për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Komuna e Malishevës, është njëra prej komunave, e cila ka largësinë më të madhe me qendrat spitalore në vend dhe ndihma e dhënë, ka qenë shumë e nevojshme. Kjo ndihmë është mirëpritur, sidomos tani, që Komuna e Malishevës, përballen edhe me endeminë e etheve hemorragjike, krime kongo, dhe kjo autoambulancë, do të lehtëson ofrimin e shërbimeve më të mira dhe më të shpejta për qytetarët, të cilët kanë nevojë.

Drejtoria e bujqësisë në përkrahje të fermerëve

Malishevë, 12 prill



Drejtoria komunale për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, është duke u angazhuar maksimalisht në përkrahje të fermerëve të Komunës së Malishevës, pasi bujqësia është dikasteri më me rëndësi për zhvillimin ekonomik të Malishevës. Për këtë qëllim, kjo drejtori dhe kryetari Begaj, janë të përkushtuar që këtë sektor ta ndihmojnë, në mënyrë që të rriten kapacitetet prodhuese, tha drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku.

“Qysh në fillim të marrjes së detyrës, bashkë me kryetarin Begaj dhe qeverinë komunale, kemi vendosur, që ti përkrahim kultivuesit e lopëve qumështore, që për sasinë e prodhuar të qumështit, të subvencionohen me 0.05 cent për litër të qumështit”, tha drejtori Mazreku.

Sipas tij, gjatë kësaj kohe, janë vizituar dhjetëra ferma në Komunën e Malishevës dhe brenda pak kohësh, planifikohet që të vizitohen të gjitha fermat, në mënyrë që të njihen direkt me fermerët në tërë territorin e Malishevës.

Sa i përket aplikimit për subvencionim në grurë, misër dhe luledielli, këtë vit kanë aplikuar 730 fermer nga Malisheva. Në Komunën e Malishevës, këtë vit janë mbjellë 3722 hektar me grurë dhe planifikohet të mbillen 802,77 hektar me misër, si dhe kultura tjera pranverore.

Në kuadër të përpjekjeve për ti ndihmuar fermerët, planifikohet të përkrahen edhe bletarët e Komunës së Malishevës. “Mision i drejtorisë sonë, është rritja e kapaciteteve të fermave ekzistuese, përkrahja për fermerët të sektorëve të ndryshëm, përmes subvencioneve dhe dhënies së këshillave profesionale për rritjen e kapaciteteve të fermave, si në blegtori, shpezëtari, bletari, pemëtari dhe të tjera”, tha drejtori Mazreku.

Edhe pyllëzimi i hapësirave pyjore, parashihet të bëhet së paku për 30 hektar për këtë vit.

Kryetari u takua me zyrtarët e IRSHP-së

Malishevë, 11 prill



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj ka pritur sot në zyrën e tij drejtoreshën e Institutit Rajonal të Shëndetit Publik (IRSHP) në Prizren, Dr.Nurishahe Hulaj, me bashkëpunëtor, ku biseduan për përkrahjen nga ana e IRSHP-së dhe për fillimin e spërkatjes selektive kundër etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), e cila

pritet të filloj nga java e ardhshme.



Fillimisht kryetari Begaj falënderoi për përkrahjen e vazhdueshme që kemi nga Instituti Rajonal i Shëndetit Publik, dhe pastaj biseduan, rreth gjendjes së sensibilizimit dhe planit operativ me të cilin pritet të veprohet në javën e ardhshme, varësisht nga koha, apo kushtet atmosferike.

Po ashtu Dr.Nurishahe Hulaj falënderoi kryetarin Begaj për bashkëpunimin dhe ofroi gatishmëri e saj dhe të Institutit Rajonal të Shëndetit Publik, gjatë sezonit të spërkatjes në të gjitha zonat endemike në Malishevë.

Nga ana tjetër, drejtori komunal për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, shprehi pakënaqësinë e tij, nga ana e institucioneve përgjegjëse, për mos dhënien e një përgjigje definitive për formën e spërkatjes, selektive apo masive, sikur edhe për kohën e fillimit të spërkatjes, pasi situata në teren tregon se data e planifikuar për 15 maj, është tepër e vonë.

Përndryshe, në QKMF të Malishevës, deri më sot, janë regjistruar 104 raste të thumbimit nga rriqrat, prej tyre 95 nga Komuna e Malishevës dhe nëntë persona nga komunat tjera. Prej tyre 8 persona janë udhëzuar për klinikën infektive, ku deri më sot ka rezultuar një person i infektuar me EHKK.

Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë qenë 15 persona të thumbuar nga rriqrat, këtë vit janë shënuar 104 raste. Numri i madh i rasteve të thumbimit nga rriqrat, dhe një rast i infektuar, kanë shtyrë përgjegjësit komunal të Malishevës, të kërkojnë spërkatja selektive, të filloj më herët se që është planifikuar, sipas planit operativ nga strategjia kombëtare për luftimin dhe parandalimin e EHKK.

Krasniqi: Taksat komunal për biznese, lloj i “haraqit”

Malishevë, 11 prill

“Marrë parasysh krizën ekonomike dhe vështirësitë, nëpër të cilat po kalon biznesi i vogël dhe i mesëm, dhe duke marrë parasysh se bizneset paguajnë tatim në qarkullim, ngarkimi edhe me taksë komunale, është lloj i haraqit me të cilin ngarkohen bizneset”, ka thënë sot, drejtori për ekonomi, buxhet dhe financa në Komunën e Malishevës, z.Vesel Krasniqi.

Krasniqi, këtë deklaram, e bëri sot në programin e mëngjesit në Radio “Malisheva”, duke arsyetuar heqjen e taksës komunale për bizneset e Malishevës. Drejtori Krasniqi, ishte i ftuar në radio, për të debatuar për të hyrat dhe shpenzimin e buxhetit për tre mujorin e parë të vitit 2014.

Sipas të dhënave Komuna e Malishevës ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi për vitin fiskal-2014 në shumën prej **11,615,235.66€**, për të gjitha departamentet, pa të hyrat e bartura nga viti **2013**, të cilat nuk janë buxhetuar deri me **31.03.2014**. Sipas shënimeve që janë në librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar sipas programeve për periudhën **Janar-Mars-2014** është **1,839,308.04/5,580,177.51**, ose **32.96%**.

Plani i realizimit të të hyrave vetanake për periudhën janar-mars 2014 nga të hyrat e rregullta, është: **154,801.06€**. Këto të hyra janë të futura në sistem dhe gjithashtu janë alokuar, kurse të hyrat të cilat arkëtohen nga gjobat e gjykatave për këtë periudhë nuk ka sepse ato arkëtohen dy herë në vit.



Drejtori Krasniqi, po ashtu bëri të ditur se janë ulur shpenzimet e përgjithshme në mënyrë radikale, duke filluar nga mallrat dhe shërbimet, ku shpenzimi nga 35% në vitin paraprak, në këtë vit është në shkallën 12%. Sipas

të dhënave në këtë tremujor, drejtori Krasniqi, përmendi disa shembuj, siç janë drekat zyrtare, ku nga 13 mijë euro, sa kanë qenë në vitin paraprak, këtë vit janë ulur në 2 mijë euro, pastaj shpenzime në karburant, nga 36 mijë sa kanë qenë janë ulur në 5 mijë, shpenzime të udhëtimit, nga 42 mijë sa kanë qenë një vit më herët, këtë vit janë ulur në 8 mijë euro, ka thënë drejtori Krasniqi, duke përmendur edhe shembuj tjerë.

“Edhe pse janë ulur shpenzimet, janë rritur aktivitetet dhe shërbimet ndaj qytetarëve, dhe kjo ulje e shpenzimeve komunale, nuk ka ndikuar në ofrimin e shërbimeve, por përkundrazi”, tha Krasniqi. Më pas drejtori, foli edhe për investimet kapitale, të cilat janë në realizim e sipër, apo që pritet të realizohen, siç janë shkollat, dhe infrastruktura në përgjithësi. “Projekti më kapital, që është duke u realizuar dhe lirisht them projekti më jetik, është ujësjellësi për fshatin Drenoc, për të cilin deri më tani, nga fondet komunale dhe donacionet tjera, janë siguruar mbi një milion euro, e që do të vazhdohet të zgjerohet ky sistem edhe për fshatrat tjerë”, tha mes tjerash, Vesel Krasniqi, drejtor për ekonomi, buxhet dhe financa në Komunën e Malishevës, në emisionin e mëngjesit në Radio Malisheva.

RTV21 fitues i TEB Kupës së Kosovës në basketboll për junior

Malishevë, 13 prill

Sot në Palestrën e Sporteve “Habib Zogaj” në Malishevë, janë zhvilluar finalet e TEB Kupa e Kosovës në basketboll për moshat e reja, ku ekipi i basketbollit “RTV21”, doli fitues i kësaj kupe, duke mposhtur në finale, ekipin e juniorëve të “Sigal Prishtinës”, me rezultat 88:77.

TEB Kupa e Kosovës në basketboll, u zhvillua për tri kategoritë reja, për pionier, kadet dhe junior. Në konkurrencën e pionierëve, vendin e parë e zuri “Vushtriabasket”, duke e mposhtur ekipin e “RTV21” me rezultat 64:40, ndërsa në konkurrencën e kadetëve “RTV21” mposhti ekipin e “Megasport” nga Prizreni me rezultat 65:54.



Gara kryesore ishte ajo për junior, ku ekipi i “RTV21”, fitoi ndeshjen, pas një paraqitje të mirë, sidomos në dy çerekët e parë të lojës, ku krijuan një diferencë prej 21 pikësh. Përkundër këndelljes në dy çerekët e fundit të “SigalPrishtina”, nuk arritën të përmbysin epërsinë krijuar dhe në fund “RTV21”, fitoi me 11 pikë diferencë, 88:77.

Për vendet e para janë ndarë kupat nga ana e Federatës së Basketbollit të Kosovës. Në ndeshjen kryesore për junior, ekipit fitues, të “RTV21”, kupën ja dorëzoi i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj.

Federata e Basketbollit të Kosovës, me qëllim të masivizimit të sportit dhe nxitjes së të rinjve të Malishevës, që të merren me sport, në bashkëpunim me Komunën e Malishevës, ka organizuar fazën gjysmëfinale dhe finale të TEB Kupa e Kosovës, në basketboll për moshat e reja.



Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Këtë javë pritet të filloj spërkatja kundër rriqrave

Malishevë, 14 prill

Kanë filluar përgatitjet për fazën e dytë të zbatimit të strategjisë kombëtare për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), dhe këtë javë, varësisht prej kushteve atmosferike, pritet të filloj spërkatja e zonave endemike, kundër rriqrave si bartësit kryesor të virusit të etheve hemorragjike. Kështu u deklarua në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, nga përgjegjësit e drejtorive për shëndetësi dhe për mbrojtje dhe shpëtim.

Spërkatja do të kryhet nga kompania e caktuar nga Ministria e Bujqësisë, ndërsa do të mbështetet nga Komuna e Malishevës, edhe me numër të personave të cilët do të jenë të angazhura në këtë fushatë të spërkatjes selektive.

Në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, janë paraqitur aktivitetet e drejtorive përkatësve gjatë javës që lamë pas, dhe planet për javën në vijim. Sipas drejtorisë për arsim, të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës, tashmë janë pajisur me internet dhe komunikimi mes drejtorisë dhe shkollave, do të jetë i vazhdueshëm përmes linjës së internetit, si dhe janë vendosur kamerat e vëzhgimit në dy shkollat e mesme, duke i kompletuar kështu të gjitha shkollat e mesme, me kamera vëzhgimi, për sigurinë në shkolla.

Në fushën e investimeve, sipas drejtorisë së urbanizimit, kanë përfunduar kanalizimet në tri fshatra, Marali, Dragobil dhe Turjakë, aty ku kanë mbetur në gjysmë, do të vazhdohet me ndërtimin rrjetit të kanalizimit në fshatrat tjerë, ndërsa brenda kohës do të fillohet edhe me shtrimin e disa rrugëve me asfalt, ndërsa gjatë javës, planifikohet edhe debati publik për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), i cili është në përfundime sipër.

Gjatë javës që lamë pas, ka vazhduar aksioni për pastrimin e ambientit në vendbanimet e Komunës së Malishevës, aksion i cili vazhdon edhe këtë javë dhe deri në përfundim të largimit të mbeturinave.

Edhe drejtorja e inspektoratit, ka bërë disa inspektime me inspektorët në nivel vendi, në furrat e gëlqeres, ku është konstatuar gjendje jo e mirë dhe veprimtari ilegale, ku digjen kryesisht gommat, si lëndë djegëse, duke shkaktuar edhe ndotje të ambientit.

KPF mbajti mbledhjen e dytë

Malishevë, 15 prill

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i kryesuar nga kryesuesi i KK, z.Enver Hoti, ka mbajtur sot mbledhjen e dytë të radhës, ku ka shqyrtua një varg çështjesh dhe ka dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e mes tjerash edhe raportin financiar për të hyrat dhe shpenzimet e buxhetit komunal, për tre muajt e parë të vitit 2014.

KPF, rekomandoi për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, shqyrtimin e raportit të të hyrave dhe shpenzimeve komunale, për periudhën janar-mars 2014, ku sqarimet rreth raportit i dha drejtori për ekonomi, buxhet dhe financa.

Rekomandimet tjera të dhëna për mbledhjen e ardhshme, janë edhe vendimi për mbrojtjen e monumenteve të natyrës në territorin e Komunës së Malishevës, pastaj shqyrtimin e kërkesës së kryetarit për dhënien me qira të pishinave në Banjë, raportet e punës të kompanive Hidroregjioni jugor dhe Ekoregjioni.

Po ashtu për mbledhjen e KK-së, u rekomandua edhe formimi i komiteteve jo obligative, pastaj formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Malishevës, pastaj kërkesa për diskutim në KK e çështjes së pronave të fshatit Bellanicë, si dhe janë dhënë edhe disa rekomandime tjera.

Bora në Malishevë, përcillet me dëme

Malishevë, 16 prill

Rënia e borës dje dhe sot, ka shkaktuar mjaft telashe në territorin e Komunës së Malishevës, duke bërë dëme në rrjetit elektrik, pastaj dëme në pemëtari, pasi pesha e borës ka thyer degët e pemëve, ndërsa të gjitha rrugët janë të lira për qarkullim, përfshi edhe rrugët në fshatrat e Maleve të Berishës, ku kompania ka intervenuar në pastrimin e borës nga rruga.



Si pasojë e dëmeve në rrjetin e shpërndarjes së rrymës, nga mbrëmë Komuna e Malishevës, pothuajse në tërësi ka qenë në terr, dhe rrjedhimisht ka mbetur edhe pa furnizim me ujë për pije nga sistemet e ujësjellësve, ka bërë të ditur drejtorja komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Sipas drejtorit të drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, zyrtarët e kësaj drejtorie, janë në terren duke vëzhguar situatën, pasi në disa rrugë ka ujë, sikur edhe në Malet e Berishës, ku sasia e madhe e borës, ka vështirësuar qarkullimi, por kompania për pastrimin rrugëve, ka intervenuar dhe bora është larguar nga rruga, dhe të gjitha rrugët janë të kalueshme.

Dëme janë vërejtur edhe në bujqësi, sidomos në pemëtari, pasi sasi e madhe e borës dhe pesha e saj, kanë dëmtuar pemët në disa raste, duke i thyer degët. Megjithatë, në drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, nuk ka pasur thirrje nga qytetarët, për ndonjë rast emergjent dhe situata është nën kontroll.

Pensionistët e Malishevës, mbajnë kuvendin vjetor të punës

Begaj: Premtoj vazhdimin e përkrahjes për organizatën e pensionistëve

Malishevë, 17 prill



Organizata e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, në Malishevë, po mban kuvendin vjetor të punës. Në këtë kuvend, ku ishin të pranishëm edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, pastaj kryetari i Lidhjes së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës së Kosovës, z.Shaban Kajatazi, u shpreh pakënaqësia për mos miratimin e ligjit për pensione, në mënyrë që të mbrohen të drejtat e pensionistëve me ligj.



z. Shaban Kajtazi, kryetar i Lidhjes së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, në Republikën e Kosovës, tha se “ edhe pas plot 14 vitesh, po shkelen të drejtat e pensionistëve të Kosovës. Fillimisht kjo e drejtë u shkel nga shteti serb, për ta vazhduar me shkelje nga ana e UNMIK-ut”. Më pas, Kajtazi, tha se përpjekjet e shtetit nuk kanë munguar, sikur nuk ka munguar as angazhimi ynë dhe ne po përpiqemi që ti kthejmë të drejtat që na takojnë. “Nga viti 2008, pas shtetësisë së Kosovës, kemi disa herë rritje të pensioneve, por jo rritje të mjaftueshme. Ne duam që çështja jonë të rregullohet me ligj, njëherë e përgjithmonë”, tha Kajtazi.

Nga ana tjetër, kryetari i Malishevës, z. Ragip Begaj, duke marrë fjalën, tha se “Komuna e Malishevës, me mundësitë e saj, është munduar ta përkrah këtë organizatë, e cila për dallim nga komunat tjera, nuk ka trashëguar asgjë nga e kaluara”. “Ne si komunë, ju premtojmë se brenda mundësive, do t’u përkrahim vazhdimisht, por kjo nuk është e mjaftueshme, pasi munda juaj nuk paguar dhe besoj që shteti dhe qeveria do të kujdeset më shumë, edhe pse duhet pasur parasysh se jemi shtet i ri. Megjithatë mendoj se nuk është bërë sa duhet për juve, sikur nuk është bërë as për kategoritë tjera. Përderisa kuvendarët dhe qeveritarët tanë, marrin paga 2- 3 mijë euro, duhet të angazhohen më shumë për këto kategori”, tha kryetari Begaj. “Ne i kemi përkrahur prej formimit dhe do të vazhdojmë ti përkrahim organizatën e pensionistëve në Malishevë”, tha në fund kryetari Begaj.

Pensionistët e Malishevës, shprehën pakënaqësinë për gjendjen e tyre dhe kërkuan që çështja e pensionistëve dhe invalidëve të punës, të rregullohet me ligj dhe pagesa e pensioneve të jetë e kënaqshme, pasi me këto pensione, në asnjë mënyrë nuk mund të jetohej. “Kemi kontribuar për këtë shoqëri dhe duam edhe trajtim adekuat”, thanë pensionistët malishevas.

Më pas kuvendi ka vazhduar me punën e tij, sipas rendit të paraparë për mbajtjen e kuvendit vjetor të punës.

Begaj: Komuna e Malishevës, do të jetë e para, që do ta zhduk korrupsionin

Korrupsioni do të zhduket dhe Malisheva do të jetë komuna e parë që do të bëjë këtë, ka thënë kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, në një intervistë për Radio Kosova e Lirë (RKL). “Unë jam shumë i bindur që korrupsioni në komunën e Malishevës do të zhduket, ky në të vërtetë ka qenë edhe premtimi im gjatë fushatës. Kërkoj ndihmën e të gjithëve në këtë drejtim. Ju garantoj se komuna e Malishevës do të jetë e para që ka për ta zhdukur korrupsionin, Malisheva do të jetë model për komunat tjera për një mirë qeverisje pa dukuri negative e pa korrupsion”, ka thënë Begaj.



Në vazhdim, intervista e plotë e kryetarit Begaj, dhënë për Radio Kosova e Lirë (RKL):

RKL: Kryetar keni filluar qeverisjen komunale para disa muajsh cilat kanë qenë problemet me të cilat jeni përballur?

Begaj: Të gjitha komunat por edhe komuna e Malishevës ka probleme me të cilat ballafaqohet. Ndër problemet kryesore është varfëria e skajshme, papunësia e rëndon dukshëm komunën tonë ngase nuk ka ndonjë fushë-veprimtari e cila punëson njerëz. Këto janë probleme që kërkojnë qasjen edhe të nivelit qendror, prandaj Qeveria e Kosovës duhet të ketë një program adekuat, ngase ne si komunë vetëm nuk mund ta zgjidhim këtë çështje. Me ardhjen tonë në qeverisje, ne në komunë kemi ndryshuar shumë gjëra, duke filluar nga kontaktet nëpër fshatra që nga ditët e para të qeverisjes me ç'rast shohim se cilat projekte duhet të kenë prioritet.

RKL: Prej kur keni ardhur në qeverisje keni shkurtuar edhe shpenzimet?

Begaj: Po, ne kemi bërë shkurtime të shpenzimeve të panevojshme. Kemi arritur që 80%, të shpenzimeve të panevojshme t'i shkurtojmë si shpenzimet e derivateve dhe gati në të gjitha kategoritë janë bërë zvogëlimet. Por krahas kësaj kemi arritur të rrisim punën. Në krahasim me qeverisjen e kaluar ne punojmë me shumë përkushtim.

RKL: Problem në komunën tuaj janë edhe ethet hemorragjike “Krime Kongo”, cilat janë angazhimet në këtë drejtim?

Begaj: Është një situatë brengosëse jo vetëm për Malishevën por për gjithë Kosovën. Kjo epidemi po e rëndon Malishevën më së tepërmi, ne e kemi pasur një fat të keq ngase prania e rriqrave në zonën e Malishevës është më shumë e përqendruar. Ne po bëjmë maksimumin e përpjekjeve tona për parandalimin e tyre aq sa kemi mundësi, por preventivë kryesore është edhe ruajtja e vetë personave nga pickimi i rriqrave. Qeverisja jonë komunale ka pasur një sërë takimesh. Kemi zhvilluar takime nëpër njëzet fshatra, pastaj në çdo shkollë të komunës sonë kemi pasur takime ku kemi biseduar rreth Etheve hemorragjike. Përpjekjet tona nuk po mungojnë, por edhe Qeveria e Kosovës është më aktive sivjet ku është krijuar një këshill ndërministror, pastaj Instituti i Shëndetit Publik pothuaj çdo javë janë në Malishevë. Aktivë në këtë fushë është edhe faktori ndërkombëtar si Turqia, pastaj edhe KFOR-i gjerman që ka sjellë ekspert për këtë lami. Po shpresojmë se sivjet do të ketë një angazhim shtesë në këtë drejtim. Një gjë e dimë se qytetarët tanë janë të rrezikuar. Vitin e kaluar kemi pasur gjashtë vdekje, e sivjet gjatë këtyre ditëve kemi pasur mbi 100 pickime. Dimri ishte i butë dhe kjo ka ndikuar që rriqrat të jenë aktive edhe gjatë dimrit.

RKL: A ka filluar spërkatja?

Begaj: Janë bërë të gjitha përgatitjet, por për shkak të reshjeve që kanë filluar po shtyhet procesi i spërkatjes. Ne jemi të gatshëm që të përfshijmë gjithë territorin më spërkatje. Në plan ka qenë edhe një spërkatje nga ajri por kjo nuk është pëlqyer nga Instituti i Shëndetit Publik ngase do të kishte pasoja në njerëz. Komuna e Malishevës do të bëjë spërkatjen



selektive nga toka posa të ofrohen kushtet atmosferike, me këtë rast do të bëhet edhe spërkatja e stallave ngase dihet se edhe bagëtia janë bartëse të tyre . Do të bëjmë të pamundurën që të ndërpremë rrugën e tyre.

RKL: Cilat janë prioritete tuaja për këtë vit?

Begaj: Kemi shumë projekte në komunën e Malishevës në realizim e sipër, projekte të cilat kanë mbetur pa u kryer por është duke u punuar për finalizimin e tyre. Janë shpallur tenderë për disa shkolla, të tjerat janë në procedurë e sipër. Fillimisht janë projektet për shkollën e Gollubovcit e cila është në kushte shumë të rënda, shkollën e Damanekut të cilën e ka marrë BE-ja për ndërtim, pastaj shkolla e Carrallukës e Bubavecit, që të gjitha sivjet do të fillojnë së ndërtuari. Nga viti i kaluar janë në ndërtim edhe shkollat e Shkozës dhe Vërmicës, të cilat sivjet do të përfundohen. Projekte tjera janë edhe ujësjellësi i fshatit Drenoc ngase deri tani nuk ka pasur asnjëherë. Është shpallur tenderi dhe faza e parë do të përfundoj deri në qershor, e kemi fazën tjetër nga Seniku ngase me Hidro Regjionin e Prizrenit e kemi një marrëveshje me ç'rast do të investohen një milion e njëqind mijë euro, pra në ujësjellësin e Drenocit. Është marrë vendimi që të tenderohen edhe ujësjellësit për 20 fshatra, pra të përfundohen ato që janë duke punuar por edhe ato që kanë nevojë të përmirësohen, e gjithë kjo shkon në akord me nevojat e bashkë fshatarëve të komunës sonë. Janë katër rrugë në proces e sipër, në Vërmicë një lagje e Ukajve e cila ka qenë shumë larg rrugës së asfaltuar do të asfaltohet këtë vit; rruga e Kodralive në Kravasari, ku është një lagje në gjendje të rëndë nëpër të cilën kalojnë nxënësit, andaj sivjet pritet të përfundohet. Pastaj disa rrugë në fshatin Tërpezë dhe Bardh, katër rrugë do të përfundohen këtë vit. Poashtu edhe ujësjellësi në fshatin Astrazub dhe Pagarushë duhet të rregullohet. Besoj se brenda këtij viti do të finalizohen...

RKL: A ka komuna e Malishevës potenciale të mjaftueshme për një zhvillim ekonomik?

Begaj: Nuk dua t'i bëj qejf vetës dhe askujt tjetër, ngase Komuna e Malishevës është një region i varfër, nuk ka shumë kapacitete zhvillimore por mund të them se synimet tona janë që ne ta mbështesim bujqësinë. Fatkeqësisht këto kohët e fundit kemi pasur disa dëme në pemëtari për shkak të kushteve atmosferike, por ne nga komuna do t'i mbështesim me buxhetin dhe mundësitë që kemi. Buxheti aktual është dyqind mijë euro por shpresojmë se do të rritet buxheti me ndihmën edhe të nivelit qendror. Ata që punojnë në bujqësi për mbajtjen e familjeve të tyre ata e ngritin edhe shtetin tonë, prandaj ata njerëz duhet mbështetur ngase ne ende mbahemi nga importi e tokat tona janë djerrina, kjo është një fatkeqësi që nuk duhet lejuar. Një shtet që jeton nga doganat ai është shtet i varfër.

RKL: Kur flasim për zhvillimin bujqësor a është subvencionuar komuna e Malishevës nga MBPZHR-ja, ose të paktën a keni konkurruar me ndonjë projekt?

Begaj: Po kemi disa projekte, ndërsa pritet që investimet në komunën e Malishevës të jenë rreth pesëqind mijë euro nga niveli qendror, ngase buxheti komunal është i varfër dhe nuk mjafton.

RKL: Cilat janë objektivat tuaja për rininë malishevasve?



Begaj: Ashtu siç është vetë pozita e Malishevës, edhe gjendja e rinisë nuk është e kënaqshme. Ne po përpiqemi t'i mbështesim aktivitetet e tyre, kërkesat e tyre do t'i përkrahim në përputhje me mundësitë që kemi. Për të gjitha kategoritë e sportit është bërë ndarja e buxhetit, si për futboll, basketboll, klubi i femrave që është shumë aktive, pra përkrahja e jonë nuk do të mungoj.

RKL: Komuna e Malishevës deri tani ka punuar disa projekte për kategoritë e dala nga lufta, por ju a mendoni se ka ende për tu bërë në këtë drejtim?

Begaj: Është shumë brengosëse gjendja e disa bashkëluftëtarëve tanë të cilët kanë qenë në vijat e frontit bashkë me ne, e sot janë pa asnjë përkujdesje. Fillimisht kur e ka marrë pushtetin PDK-ja, atëherë në Malishevë u ka ndarë troje e disa lokale ku disa luftëtarë e kanë gjetur mirë vetën, por nuk mjafton kjo. Ne do të jemi gjithmonë në përkrahje të atyre që bënë shumë për këtë liri që po e jetojmë sot. Shoqëria jonë u ka shumë borxh atyre personave. Nuk duhet harruar kontributi i tyre duhet kthejmë kokën pas dhe të dimë ku ishim dje ngase ata janë më meritoret, e të mos flasim për dëshmorët e familjet e tyre ngase ata kanë një përkrahje por ajo është shumë e pakët.

RKL: Kryetar, si është gjendja aktual në fushën e arsimit dhe shëndetësisë?

Begaj: Në fushën e arsimit përmirësimi i infrastrukturës do të jetë prioritet i yni. E kam thënë edhe më herët dhe po e përsëris se shkolla duhet de-politizuar, do të përpiqem të bëjë depolitizimin e tyre, ngase politika e shkollës është arsimimi i brezave. Pa një zhvillim të arsimit nuk ka as zhvillim të vendit, të kemi kuadro sa më cilësore dhe të jemi krahas vendeve në zhvillim. Ne kemi disa nxënës me arsim superior që janë në shtete tjera, ne i kemi mbështetur dhe i mbështesim financiarisht. Sa i përket shëndetësisë edhe këtu po punohet mjaftë mirë, janë kompletuar disa kuadro, por brengosëse për komunën e Malishevës është mungesa e gjinekologëve, e për këtë reparti i gjinekologjisë nuk funksionon si duhet. QKMF në Malishevë qëndron mirë, ku dhe kemi bërë një kontratë me Caritas-in, e cili na ka ndihmuar mjaftë. Në Kijevë është aktivizuar edhe ndërrimi i dytë e kështu me radhë.

RKL: Kryetar cila do të ishte porosia juaj për fund?

Begaj: Unë personalisht brengosem për të papunët e jo për ata që janë në punë dhe i kanë rrogat e vogla. Unë jam shumë i bindur që korrupsioni në komunën e Malishevës do të zhduket, ky në të vërtetë ka qenë edhe premtimi im gjatë fushatës. Kërkoj ndihmën e të gjithëve në këtë drejtim. Ju garantoj se komuna e Malishevës do të jetë e para që ka për ta zhdukur korrupsionin, Malisheva do të jetë model për komunat tjera për një mirë qeverisje pa dukuri negative e pa korrupsion.

18 prill 2014

HAI në ndihmë të fëmijëve jetim

Malishevë, 22 prill

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot përfaqësuesit e organizatës humanitare Human Appeal International (HAI), selia në Kosovë, me cilët ka biseduar për përkrahjen që pritet, që kjo organizatë të jep për fëmijët jetim nga Komuna e Malishevës dhe kanë biseduar për mundësitë e ofrimit të ndihmës në fushat tjera në Komunën e Malishevës.



“Unë ju falënderoj për vizitën dhe interesimin tuaj, për çdo lloj mbështetje që jepni dhe ne e mirëpresim. Në veçanti e mirëpresim ndihmën për këtë kategori të shoqërisë, të cilët vërtetë kanë nevojë për mbështetje në rritjen dhe zhvillimin e tyre”, ka thënë kryetari Begaj, duke ofruar bashkëpunimin e komunës në këtë drejtim.

Human Appeal International (HAI), është organizatë humanitare, e cila vepron edhe në Kosovë dhe kryesisht ndihmon fëmijët jetim, por edhe ofron mbështetje edhe në fusha tjera, të cilat ndikojnë direkt në mirëqenien e banorëve.

Begaj priti përfaqësuesit e OJQ “Jesus Christ”

Malishevë, 22 prill



Kryetari i Malishevës z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij përfaqësuesit e OJQ “Kisha e Jezu Krishtit, e ditëve të vona” nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), në një takim lamtumirës me zyrtarët e kësaj organizate. Ky takim njëkohësisht ishte edhe takim njohës me çiftin, Paul dhe Barbara Nelson, të cilët do të janë nën mbikëqyrje të projektit për ujësjellësin e fshatit Drenoc.

Kryetari Begaj, falënderoi për vizitën dhe bashkëpunimin, “jeni të mirëseardhur deri në përfundim të këtij projekti, dhe shpresoj që të mbesim në kujtesë për të mirë tek ju” tha

Begaj, pastaj kanë diskutuar dhe njohur rreth procedurave në vazhdim, rreth planit dinamik të veprimit për ujësjellësin e Drenocit.

Kjo OJQ amerikane, do të ndihmoj në ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit, për fshatin Drenoc.

Komuna do ta ndihmoj familjen Gegaj, për ndërtimin e shtëpisë së djegur

Malishevë, 23 prill

Komuna e Malishevës, do të ndihmoj familjen Gegaj nga Lladroci, për meremetimin e shtëpisë, pasi një ditë më parë aksidentalisht, shtëpia e tyre është djegur në tërësi. Pas aksidentit, këtë familje e ka vizituar edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, për të njohur me pasojat nga zjarri dhe për ti ofruar mbështetjen institucionale, kësaj familje.



Shtëpia e kësaj familje, është djegur rreth orës dy, pas mesnate, ku për fat të mirë, të gjithë anëtarët e kësaj familje, kanë arritur të evakuhohen, pa pësuar lëndime. Edhe intervenim i njësisë së zjarrfikësve dhe shpëtimit, ka qenë i menjëhershëm, pas marrjes së informacionit për rastin.

Këtë familje, Komuna e Malishevës, fillimisht e ka ndihmuar me gjëra elementare ushqimore, ndërsa në ditët në vijim, brenda mundësive, do ta ndihmoj edhe në riparimin e shtëpisë, në mënyrë që anëtarët e saj, të kthehen të jetojnë në shtëpinë e tyre, sa më shpejt që është e mundur.

Kryetari Begaj, ka shprehur keqardhjen e tij, për djegien e shtëpisë dhe ka premtuar se brenda mundësive, komuna do ta ndihmoj familjen për riparimin e dëmeve nga zjarri.

Si pasojë e zjarrit, është djegur në tërësi kjo shtëpi, duke përfshirë të gjitha dhomat dhe kulmin, ndërsa vlera e dëmit llogaritet rreth pesë mijë euro.

Begaj: Korrupsioni nuk do të përmendet në Komunën e Malishevës

Malishevë, 24 prill

“Fjalën korrupsion nuk do ta dëgjojmë të përmendet në Komunën e Malishevës, sepse do ta zhdukim këtë dukuri, në të gjitha format”, ka deklaruar kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në takimet që ka zhvilluar gjatë mbrëmjes së shkuar, me banorët në fshatrat Lladroc e Senik. “Këtë të keqe, do ta zhdukim, por kërkoj edhe ndihmën tuaj në këtë drejtim”, ka thënë Begaj.

“Çdo rast të mundshëm të korrupsionit, lajmërojeni, më ndihmoni edhe mua që përfundimisht, kjo fjalë të mos dëgjohej në Malishevë. Unë do ta bëj këtë, pasi qëllim i imi është, që njerëzit të mos e drejtojnë gishtin kah komuna, për ta identifikuar institucionin e komunës me korrupsionin, andaj e dua edhe ndihmën e juaj në këtë drejtim”, ju ka thënë Begaj, banorëve të fshatrave Senik e Lladroc.



Edhe mbrëmë, kryetari Begaj, ka vazhduar takimet me banorët e vendbanimeve të Komunës së Malishevës. me qëllim të njoftimit lidhur me angazhimet e komunës, për çështjen e theve hemorragjike dhe pastrimin e ambientit nga mbeturinat, si dhe për tu njohur direkt me problemet që kanë fshatrat e komunë sonë, në mënyrë që nevojat e

fshatrave të hynë në prioritet e komunës.

“Ta pastrojmë ambientin nga mbeturinat. Ne kemi filluar një aksion për largimin e deponive ilegale, po e jani që së bashku ti largojmë ato mbeturina, por edhe ta ruajmë ambientin, që mos të hidhen mbeturina në ambientet ku vet jetojmë”, ka thënë Begaj.

Edhe drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, i ka njoftuar me aktivitetet e drejtorisë për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike, duke kërkuar nga banorët, që në rend të parë të kenë kujdes të shtuar.

Ndërsa drejtori i urbanizimit, z.Urim Kastrati, i ka njoftuar me prioritet e komunës, për investimet në këto dy vendbanime, duke filluar nga ndërtimi i ujëmbledhësit në Senik, dhe ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për këtë fshat, pastaj riparimet në infrastrukturë dhe intervenimin për mbrojtjen e ndërtesës së shkollës së vjetër në fshat. Ndërsa në Lladroc, sipas

drejtorit Kastrati, do të ndërtohen rreth tri kilometra kanalizim, do të intervenohet në riparimin e kanalizimit aktual, si dhe premtoi kujdesin për disa rrugë, me rërë, derisa të hyjnë në prioritet për asfaltim.

Begaj takoi banorët e Kërvasarisë dhe Pagarushës

Malishevë, 25 prill

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në kuadër të aktiviteteve të tij dhe përmbushjes së premtimit, se brenda gjashtë muajve të parë, të zbresë në fshatra për ti takuar banorët, gjatë mbrëmjes së djeshme, ka takuar banorët në fshatin Kërvasari dhe Pagarushë, me të cilët ka biseduar për hallet dhe problemet që kanë si fshatra, si dhe i ka njoftuar aktivitetet e qeverisë komunale.



Fillimisht kryetari Begaj dhe drejtori i shëndetësisë, Hajdin Berisha, i kanë njoftuar banorët e këtyre fshatrave për angazhimin e Komunës së Malishevës, në luftimin dhe parandalimin e Etheve Hemorragjike Krime Kongo (EHKK) dhe rolin e komunës në zbatimin e strategjisë kombëtare për kundër EHKK, si dhe i kanë njoftuar për aksionin e komunës, për largimin e mbeturinave. Me

këtë rast kryetari Begaj, ka kërkuar edhe ndihmën e banorëve për largimin e mbeturinave dhe ruajtjen e ambientit, si dhe ka kërkuar që të futen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Nga ana tjetër, banorët e Kërvasarisë, duke paraqitur kërkesat për nevojat e tyre, thanë se prioritet dhe emergjencë është ndërtimi i kanalizimit, i cili në fakt ka filluar të ndërtohet, pasi punimet janë duke vazhduar, pastaj rruga për lagjen Kodrali, për të cilën po ashtu morën premtimin e kryetarit për ndërtimin e kësaj rruge, si dhe largimi i mbeturinave, sipas banorëve është e domosdoshme.

Edhe në Pagarushë, largimi i mbeturinave doli një prej problemeve kryesore, si dhe ndërtimi i kanalizimit për katër lagje të fshatit, pastaj edhe largimin e derdhjes së kanalizimit në varrezat e fshatit. Nevojë tjetër për fshatin është edhe ekzistimi i një barnatoreje, pasi kanë shërbimin mjekësor, por nuk kanë barnatore.

Një problem jetik për fshatin është edhe sigurimi i ujit për pije, apo ndërtimi i ujësjellësit, për çka morën premtimin e kryetarit Begaj, se shumë shpejt do të bëhen shpime dhe hulumtime për gjetjen e ujit, edhe pse konfiguracioni i fshatit është shumë i vështirë.

Vërshime të mëdha nga uji, në lagjen e Gurit në Malishevë

Malishevë, 26 prill



Shiu i rrëmbyeshëm që ka rënë sonte në mbrëmje, ka shkaktuar vërshime në qytetin e Malishevës, kryesisht në lagjen e Gurit, ku është bllokuar një pjesë e rrugës Malishevë-Rahovec, si dhe uji ka depërtuar së paku në një shtëpi, ku ka shkaktuar dëme të konsiderueshme.

Ekipet e mbrojtjes dhe shpëtimit, Policia e Kosovës dhe zyrtarët komunal, me në krye kryetarin e komunës, z.Ragip Begaj, kanë dalë në vendin e ngjarje, ku janë të gjitha masat, për tu dalë në ndihmë qytetarëve dhe vozitësve, si dhe për të qenë afër qytetarëve.

Rruga Malishevë-Rahovec, e cila është e bllokuar, vozitësit duhet të ndjekin një rrugë alternative brenda lagjes së Gurit.

Begaj takoi banorët e Bellanicës dhe Temeqinës

Malishevë, 27 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar edhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z.Enver Hoti dhe drejtori i shëndetësisë z.Hajdin Berisha, mbrëmë kanë takuar banorët në fshatin Bellanicë dhe ata në fshatin Temeqinë, me të cilët kanë biseduar për çështje të ndryshme, përkatësisht nevojat e banorëve të këtyre dy vendbanimeve.



Ky takim, është vazhden takimeve të kryetarit të komunës, me banorët e fshatrave të Malishevës, për të biseduar me ta, për masat mbrojtëse kundër etheve hemorragjike krime kongo, pastaj për pastrimin e ambientit, si dhe për tu njohur direkt me nevojat e tyre, në mënyrë që këto kërkesa të tyre, të futen në prioritet e komunës, gjatë planifikimit të buxhetit komunal.

Për banorët e Bellanicës, problem kryesor, vazhdon të jetë kthimi i pronave tashmë të privatizuara, e që banorët e Bellanicës pretendojnë të jenë pronar të tokës, e për çka kanë marrë premtimin e Begajt dhe Hotit, se komuna do të jetë përkrahë kërkesave të tyre në aspektin ligjor . Pastaj problem tjetër për fshatin është uji për pije, ku edhe këtu kryetari Begaj, i ka njoftuar se komuna ka ndarë 100 mijë për rritjen e kapacitete të ujit, si dhe Hidroregjioni jugor, po ashtu 100 mijë euro, mirëpo, ujësjellësi i fshatit duhet të futet në menaxhimin e ndërmarrjes së Hidroregjionit, për çka banorët shprehën rezerva dhe kërkuan t'ju ndihmohet në rritjen e kapaciteteve, por duan të menaxhojnë vet ujësjellësin. Dhe kërkesë tjetër për banorët, ishte vazhdimi i kanalizimit në një pjesë të fshatit dhe asfaltimi i rrugicave brenda fshatit.

Ndërsa në Temeqinë, ku sipas banorëve, deri më tani është investuar më së paku, kërkuan asfaltim të rrugëve të fshatit, trotuarin, kanalizimin, rrethja e shkollës dhe çështjet sociale, ndërsa të rinjtë e fshatit kërkuan që t'ju rregullohet fusha e sporti. Kryetari Begaj, premtoi se disa nga problemet e tyre, do të zgjidhen shpejt, kurse brenda mandatit të tij qeverisës, do të zgjidhen këto probleme me të cilat ata ballafaqohen. Ndërsa premtoi se shpejt do ta rregulloj fushën e sportit.

Kryetari Begaj dhe familjet e të pagjeturve, morën pjesë në shënimin e ditës së të zhdukurve

Meje/Malishevë 27 prill



Familjet të pagjeturve nga Komuna e Malishevës, të shoqëruar nga kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe zyrtar tjerë komunal, sot kanë marrë pjesë të Meje të Gjakovës, në shënimin e ditës së të zhdukurve në Kosovë, e cila shënohet më 27 prill, në datën kur u shënuar masakra më e madhe e luftës së fundit, e ku u vranë 376 persona.

Për të nderuar dhe të ndarë dhembjen me familjarët e të pagjeturve nga Malisheva, në këtë shënim mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Komuna e Malishevës, aktualisht numëron 37 persona ende janë të pagjetur, që nga përfundimi i luftës, 15 vite më parë.

Së shpejti do të vlerësohen dëmet e nga vërshimet

Malishevë, 28 prill

“Reshjet e fundit, llogaritet të kenë shkaktuar dëme të konsiderueshme në territorin e Komunës së Malishevës, por vlera e dëmeve do të bëhet e ditur, pasi komisioni për vlerësimin e dëmeve, ta kryej vlerësimin total, megjithëse reshjet po vazhdojnë dhe rrjedhimisht mund të ketë dëme edhe më tutje”, ka thënë të hënën Ahmet Morina, drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Malishevës.

Këtë deklaram, drejtori Morina, e ka bërë në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku sipas tij, shiu përveç turbullirave të ujit, ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekonominë familjare, pastaj në Shtëpinë e Kulturës, ndërsa bora e mëhershme, gjithashtu ka

shkaktuar dëme të konsiderueshme në bujqësi, por të gjitha këto dëme, do të vlerësohen nga komisioni i formuar për vlerësimin e dëmeve.

Vlerësimin e dëmeve e ka kërkuar edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj. “Dua të dihet me saktësi vlera e dëmeve të shkaktuar, pavarësisht se kemi fonde të kufizuara për kompensim”, ka thënë Begaj.

Në mbledhjen e sotme të qeverisë komunale, nga ana e drejtorëve, është njoftuar për punët në vazhdimësi nga ana e drejtorive dhe planifikimi i aktiviteteve gjatë javës në vijim, ku u bë e ditur se janë duke u realizuar disa projekte kapitale, ndërsa brenda javës, pritet të fillojnë punimet edhe për ndërtimin e çerdhes në Malishevë.

Disa projekte janë duke u realizuar në Komunën e Malishevës

Malishevë, 28 prill

Aktualisht në Komunën e Malishevës, janë duke u realizuar një mori projektesh, kryesisht në infrastrukturë, me qëllim të rritjes së mirëqenies për banorët e Komunës së Malishevës, projekte të cilat janë jetike. Në mesin e projekteve që janë duke u realizuar, janë rrugë, kanalizime, shkolla dhe të tjera.



Sipas drejtorit për urbanizëm, z.Urim Kastratit, i cili gjatë këtyre ditëve, i ka inspektuar punimet në disa nga këto projekte, tha se “momentalisht janë u realizuar së paku tri projekte në ndërtimin e rrugëve, në Fshat të Ri, Llapqevë dhe Turjakë, përderisa kanë përfunduar punimet në disa vende tjera”. Sipas drejtorit Kastrati, punimet po ecin mbarë dhe po realizohen sipas planifikimit dhe sipas parametrave të parapara.

Po ashtu, është duke u ndërtuar kanalizimi në Kërvasari dhe Drenoc, ndërsa kanë përfunduar kanalizimet në disa fshatra të Malishevës.



Sa i përket infrastrukturës shkollore, momentalisht është drejt përfundimit shkolla në fshatin Vërmicë, përderisa shumë shpejt pritet të fillojnë edhe ndërtimi i shkollave në Golluboc dhe Goriq, sikurse edhe ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Malishevë, punimet e së cilës, pritet të fillojnë gjatë kësaj jave.

Investimet nuk do të mungojnë as në shëndetësi, ku së bashku me drejtorinë për shëndetësi, do të bëhen riparimet e nevojshme për të gjitha punktet shëndetësore në vendbanimet e Malishevës, në mënyrë që t'u ofrohen qytetarëve shërbime më të mira shëndetësore.

Lendrit Jonuzaj, merr pjesë në olimpiadën botërore të biologjisë

Malishevë, 28 prill

Gjashtëmbëdhjetë vjeçari nga Seniku i Malishevës, Lendrit Jonuzaj, do të merr pjesë në olimpiadën botërore të biologjisë, që do të mbahet në Texas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Lendriti, është pjesë e ekipit kombëtar nga Kosova, që do të përfaqësohen në këtë olimpiadë botërore.

Për pjesëmarrje në këtë olimpiadë, Lendriti, është përkrahur edhe nga Komuna e Malishevës. “Ne i përkrahim të gjithë nxënësit e mirë nga Malisheva, dhe në këtë rast edhe Lendrit Jonuzajn, dhe urojmë që të na përfaqësojë mirë dhe të ketë sukses, pavarësisht se vet arritja deri në këtë olimpiadë është sukses në vete, duke treguar kështu, se Malisheva ka talent në fusha të ndryshme”, ka thënë drejtori komunal për arsim dhe edukim, Blerim Thaçi.

Lendrit Jonuzaj, është në mesin e më të mirëve në vend, për moshën e tij, në fushën e biologjisë, për çka edhe ka arritur të renditet në mesin e më të mirëve.

Komuna e Malishevës, në vazhdimësi ka dhënë nxënës të mirë, të cilët kanë arritur sukses në garat dhe olimpiadat në të gjitha fushat dhe si çdo nxënës tjetër edhe Lendriti, ka përkrahjen e komunës, për ta shprehur dijen dhe talentin e tij.

Bashkatdhetarët ndihmojnë sportin malishevas

Malishevë, 28 prill



Bashkatdhetarët tanë, që punojnë dhe jetojnë në vendet evropiane, vazhdojnë të mbështesin vendin e tyre në të gjitha format e mundshme, përfshi edhe sportin. Kështu, bashkatdhetari Hamdi Zogaj, nga Bellanica, i cili jeton dhe punon në Itali, ditëve të fundit, ka ndihmuar shkollën e futbollit në Malishevë, me rekuizita sportive.

Në ceremoninë e kësaj përkrahje nga bashkatdhetari Hamdi Zogaj, ka marrë pjesë edhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi, e cila, në emër të Komunës së Malishevës e ka falënderuar Zogajn për përkrahjen që i ka dhënë shkollës së futbollit dhe të rinjve të Malishevës, me rekuizita sportive, në mënyrë që fëmijët – futbollistët e rinj, të kenë më të lehtë ushtrimin e sportit të futbollit. “Në emër të Komunës së Malishevës, e falënderoj bashkatdhetarin Zogaj, të cilin e përkrahim edhe me krijimin e hapësirës institucionale për dhënien e kontributit në sport dhe në rininë e Malishevës”, ka thënë me këtë rast, drejtoresha Krasniqi.

Bashkatdhetari Zogaj, sipas përgjegjësve të shkollës së futbollit, ka premtuar se do të angazhohet maksimalisht në përkrahje të futbollit malishevas, duke u përpjekur të ofroj kontakte me klubet dhe shkollat italiane të futbollit, sidomos për binjakëzimin me ndonjë nga shkollat në Itali. Zogaj, po ashtu, ka premtuar se do të angazhohet të llojoj për futbollistët nga Malisheva, që t’ju bëj të mundur të aktivizohen në klubet italiane. Përndryshe, dy djem të Hamdi Zogajt, janë të angazhuar në klubet italiane të futbollit.

Komuna e Malishevës, merr vendim për mbrojtjen e vlerave të natyrës

Malishevë, 30 prill



Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e katërt të radhës, të udhëhequr nga kryesuesi Enver Hoti, në mesin e disa vendimeve, ka miratuar edhe kërkesën e kryetarit të komunës, për mbrojtjen e vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Malishevës, duke i hapur rrugë mbrojtjes së trashëgimisë së pasur natyrore të Malishevës.

Përndryshe, mbledhja e katërt e KK të Malishevës, në orët e vona të ditës së djeshme, është ndërprerë në gjysmë, pasi anëtarët e opozitës në KK, nuk kanë pranuar që anëtari i KK-së, i cili është edhe përgjegjës për njësinë e “Eko Regjionit” në Malishevë, të paraqes raportin e punës së kësaj njësie për vitin 2013, dhe kanë lëshuar sallën e mbledhjes, duke shkaktuar mungesë të kuorumit.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, me shumicë të votave, ka vendosur që pishinat në Banjë, të mos jepen me qira, por të menaxhohen nga vet komuna. Në mbledhjen e sotme është prezantuar edhe raporti tremujor i të hyrave dhe shpenzimeve komunale, për këtë vit.

Në këtë mbledhje, edhe njësisia e “Hidroregjionit” në Malishevë, ka prezantuar raportin e punës për vitin 2013 dhe planifikimin për vitin 2014.

Para hyrjes në rend të ditës, anëtarët e KK-së, kanë parashtruar shumë pyetje për kryetarin e komunës, i cili, më pas, është përgjigjur në të gjitha pyetjet e anëtarëve të KK-së, të cilat kishin të bëjnë me çështje të ndryshme, lidhur me punën e kryetarit z.Ragip Begaj dhe qeverisë komunale.

Seanca e ndërprerë, vazhdon punimet javën e ardhshme.

Fitues të krosit pranveror në Malishevë, Florian Begaj dhe Mihrie Bacaliu

Malishevë, 30 prill



Nën organizimin e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Malishevës, sot u mbajtën garat tradicionale të krosit komunal për shkolla të mesme të ulëta, të mesme të larta dhe për qytetar. Në këtë aktivitet sportiv, të pranishëm, ishin edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, drejtoresha për kulturë, rini dhe sport,

znj.Blerita Krasniqi dhe drejtori për arsim dhe edukim, z.Blerim Thaçi.

Pjesëmarrës të krosit pranveror, ishin shumica e shkollave të mesme të ulëta, të mesme të larta dhe qytetar të Komunës së Malishevës, ku morën pjesë rreth 220 vrapues.

Pjesëmarrësi më i ri në këtë kros ishte Lorent Mazreku nga shkolla fillore “Ibrahim Mazreku” i cili është vetëm 7 vjeçar. Organizatorët, ndanë shpërblime për fituesit e kësaj gare.

Fitues të krosit pranveror në Malishevë, janë Florian Begaj në konkurrencën e meshkujve dhe Mihrie Bacaliu në konkurrencën e femrave.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 126- Maj 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>
www.malisheva-komuna.org



Fillimi i ndërtimit të ujësjellësit në Drenoc



Fillimi i ndërtimit të çerdhes në Malishevë



Pamje nga punimet në shkollën e fshatit Golluboc



Asfaltimi i rrugës në Fshat të Ri

Komuna përkrahë shoqatën “Gratë e vyera”, në ndërtimin e dy serrave

Malishevë, 2 maj



Komuna e Malishevës, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, ka përkrahur shoqatën e grave “Gratë e vyera” nga Bellanica, në ndërtimin e dy serrave, në të cilat do të punojnë gratë dhe do të merren me kultivimin e perimeve, domate dhe speca. Qëllimi i kësaj mbështetjeje, është zhvillimi i bujqësisë dhe përkrahja për femrat, të cilat merren bujqësi dhe krijimi i vendeve të reja të punës.

Për këtë qëllim, sot, drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, i shoqëruar nga eksperti i bujqësisë dhe shëf i drejtorisë për bujqësi, z.Milaim Morina, pastaj kryetarja e shoqatës “Gratë e vyera”, znj.Sanie Hoxha dhe anëtarja e KK të Malishevës nga Bellanica, znj.Behije Sertolli, kanë vizituar dy serrat, të cilat janë ndërtuar falë përkrahjes nga ana e komunës.

Me këtë rast, kryetarja e shoqatës “Gratë e vyera”, znj. Sanie Hoxha, ka falënderuar Komunën e Malishevës, për përkrahjen e këtij projekti, përmes së cilës, edhe gratë angazhohen në sektorin e bujqësisë dhe merren me kultivimin e perimeve.

Drejtori për Bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, u shpreh i kënaqur me ndërtimin e këtyre serrave dhe shprehi gatishmërinë e Komunës së Malishevës, përkatësisht drejtorisë me të cilën udhëheq, për përkrahjen e bujqve edhe në projekte tjera.

Begaj takoi banorët e Fshatit të Ri, Berishës dhe Tërpezës

Malishevë, 3 maj

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, në kuadër të takimeve të drejtpërdrejta me banorët e Komunës së Malishevës, mbrëmë kanë takuar banorët e fshatrave, Berishë, Fshat i Ri dhe Tërpezë, me të cilët kanë biseduar për problemet me të cilat ballafaqohen banorët e këtyre fshatrave dhe nevojat që kanë si fshat, në mënyrë që më lehtë të bëhet planifikimi për investime.



Fillimisht Begaj e Berisha, kanë biseduar me banorët për rrezikun nga thumbimi i rriqrave, të cilët janë bartës të etheve hemorragjike kringe kongo (EHKK), edhe pse këto fshatra janë më pak të rrezikuara nga virusi i EHKK, për shkak të lartësisë mbidetare, por nuk do të thotë se nuk janë të rrezikuara, për shkak të lëvizjeve që bëhen.

Një temë tjetër, që është biseduar me banorët e këtyre tri fshatrave, është edhe çështja e ambientit, përkatësisht ndotja e ambientit, për çka banorët e këtyre fshatrave, shprehën gatishmërinë e tyre, që t'i bashkohen aksionit për largimin e mbeturinave dhe ruajtjes së ambientit.

Në debat me qytetarët, si nevoja të fshatit dolën, ujësjellësi dhe kanalizimi për fshatin Berishë, trotuaret për nxënësit, pastaj disa rrugë brenda fshatit dhe trajnimi i rasteve sociale, ndërsa në Fshat të Ri, nevojë emergjente është zgjerimi i hapësirës së shkollës, rrethoja e shkollës, pastaj ujësjellësi dhe kanalizimi për fshat. Për këto nevoja, kryetari Begaj, trajtim të drejtë dhe brenda mundësive, zgjidhjen e këtyre problemeve, në kohë sa më të shkurtër.

Ndërsa në Tërpezë, shtrimi i tri rrugëve, në tri lagje, sipas banorëve është nevojë emergjente, ndërsa shprehën gatishmërinë e tyre, për tu futur në sistemin e menaxhimit të ujësjellësit dhe grumbullimit të mbeturinave, ndërsa një shqetësim i madh i banorëve, ishte edhe prerja pa kontroll dhe ilegale e pyjeve (pronë shoqërore), prerje e cila po e dëmton malin seriozisht dhe rrjedhimisht edhe ekosistemin në këto fshatra në Malet e Berishës.

Kryetari Begaj, premtoi se në Tërpezë, do të shtrohen së paku 1500 metra rrugë, për të vazhduar më pas me investime tjera dhe brenda mandatit të tij si kryetar i Malishevës.

Kryetari Begaj, nderoi dëshmorët e fshatit Kleçkë

Malishevë, 3 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me ftesën e organizatorit, ka marrë pjesë në shënimin e ditës së dëshmorëve të fshatit Kleçkë, ku janë bërë nderime në varrezat e dëshmorëve në Kleçkë, ndërsa i ka falënderuar organizatorët për ftesën, në shënimin e kësaj dite me rëndësi për këtë fshat.

“Jam i nderuar që marr pjesë në shënimin e ditës së dëshmorëve të fshatit Kleçkë, në këtë

15 vjetor të çlirimit të venit. Ndihem i nderuar që jam sot këtu, në vendin ku është shkruar një pjesë e historisë së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në vendin që ka dhënë shumë për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, ka thënë mes tjerash kryetari Begaj.

Fshati Kleçkë, që administrativisht është me Komunën e Lipjanit, ishte një nga vendet më me rëndësi strategjike gjatë luftës së lavdishme të UÇK-së, ndërsa në aty, përveç personaliteteve më të rëndësishme të UÇK-së, kanë dhënë kontribut edhe shumë djem e vajza nga Komuna e Malishevës, të rreshtuar në Brigadën 121.

Spërkatja kundër rriqrave, filloi një ditë para planifikimit

Malishevë, 4 maj



*F*ushata e spërkatjes kundër rriqrave, në kuadër të luftimit dhe parandalimit të etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), ka filluar një ditë para planifikimit. Sipas drejtorit të drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, sot ka filluar spërkatja, në fshatin Kijevë, gjegjësisht në oborrin e një familjeje, me kërkesën e kryefamiljarit.

Shkak për fillimin e parakohshëm, ka qenë kërkesa e një familjeje në Kijevë, pasi anëtarët e kësaj familjeje, në vazhdimësi, janë thumbuar nga rriqrat, dhe pas kërkesës, drejtoria komunale për mbrojtje dhe shpëtim dhe kompania e angazhuar nga Ministria e Bujqësisë, për spërkatjen e zonave endemike në Malishevë, “Trulli Nollen”, kanë bërë dezinfektimin kundër rriqrave në oborrin e kësaj familjeje në Kijevë.

Përndryshe, spërkatja e zonave endemike, kundër rriqrave, në kuadër të strategjisë kombëtare për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), do të vazhdojë të hënën në fshatin Senik, ku edhe regjistruar rasti i parë dhe i vetëm deri më tani, për këtë vit, me ethe hemorragjike.

Sipas drejtorisë komunale për mbrojtje dhe shpëtim, pas dezinfektimit në Senik, sipas planit të paraparë, do të vazhdojë me spërkatjen në zona tjera dhe opinioni do të lajmërohet me

kohë. Në të njëjtën kohë, ju bëhet thirrje bletarëve, që të bëjnë kujdes me bletët, që mos ti lëshojnë apo ti largojnë, pasi preparati që përdoret kundër rriqrave, ndikon edhe tek bletët.

Këtë javë fillojnë të realizohen edhe disa projekte

Malishevë, 5 maj

Gjatë kësaj jave edhe zyrtarisht do të fillon ndërtimi i çerdhes në Malishevë. Kështu ka njoftuar drejtori i urbanizimit Urim Kastrati, në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, të mbajtur sot nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, e ku u bë e ditur se përveç çerdhes janë edhe disa projekteve tjera të cilat fillojnë ose do të realizohen gjatë kësaj jave.

“Përveç çerdhes, gjatë kësaj jave, varësisht prej kushteve atmosferike, pritet të asfaltohet edhe rruga në fshatin Golluboc dhe ndërtimi i kanalizimit në Janqisht, ndërsa jemi në përgatitje të fillimit të disa projekteve, kryesisht në infrastrukturë”, tha drejtori Kastrati.

Kushtet atmosferike nuk kane lejuar vazhdimin e spërkatjes kundër rriqrave, edhe pse përgatitjet janë bërë nga drejtoritë përkatëse komunale.

Në këtë mbledhje drejtorët e drejtorive, kanë raportuar për aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe për aktivitetet e planifikuara për javën në vijim.

Kryetari Begaj u takua me drejtoreshën e zyrës rajonale të OSBE-së

Malishevë, 06 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj ka pritur sot në zyrën e tij, në një takim njohës drejtoreshën e zyrës rajonale të OSBE-së në Prizren, znj.Jasna Hodžič dhe zyrtarin e lartë të OSBE-së George Katcharava.

Kryetari Begaj, i mirëpriti dhe falënderoi për vizitën. “Bashkëpunimi jonë ka qenë çdo herë i mire me OSBE-në dhe besoj që do të vazhdoj të jetë i tillë edhe më tutje”, tha Begaj, i cili e vlerësoi punën dhe angazhimin e OSBE-së me

Kuvendin dhe Komunën e Malishevës.

Nga ana tjetër drejtoresha e zyrës rajonale të OSBE-së znj. Jasna Hodžić, falënderoi kryetarin Begaj dhe e përgëzoi për prioritetet dhe angazhimet që po ndërmerr rreth projekteve dhe veprimtarinë e tij në përgjithësi, e sidomos rreth problemit me ethet hemorragjike, vizitat nëpër fshatra. Në mesë tjerash diskutuan dhe shpalosën edhe disa nga prioritetet të misionit të tyre.

KK formoi katër komitete jo obligative

Malishevë, 6 maj

Kuvendi i Komunës së Malishevës, të hënë, në vazhdimin e mbledhjes së katërt (të ndërprerë gjatë javës së kaluar), e cila dje zgjati deri në orët e mbrëmjes, ka marrë vendim për formimin e katër komiteteve jo obligative, Komitetin për arsim, kulturë, rini dhe sport, Komitetin për diasporë, Komitetin për shëndetësi, mirëqenies sociale, familjeve të



dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftë, si dhe personave me aftësi të kufizuara dhe Komitetin për mbrojtje të mjedisit, turizmit, planifikimit urban, kadastrës dhe monitorim të projekteve publike.

Në vazhdimin e kësaj seance, para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, është paraqitur edhe raporti i punës së Drejtorisë Komunale për Arsim dhe Edukim, për vitin 2013-2014, ndërsa më pas KK mori vendim edhe për formimin e komisionit për emërtimin e

rrugëve në Komunën e Malishevës.

Një çështje e ndjeshme në këtë mbledhje ishte edhe shqyrtimi i kërkesës së banorëve të fshatit Bellanicë, për çështjen e pronave, për të cilat banorët pretendojnë të jenë të tyre, të cilat janë privatizuar nga ish AKM-ja (tani AKP), ku pas shumë diskutimeve, Kuvendi i Komunës së Malishevës, u deklarua në mbështetje të kërkesave të banorëve të fshatit Bellanicë dhe fshatrave tjera, lidhur me çështjen e pronave tashmë të privatizuara.

Me kërkesën e anëtarëve të KK-së, në këtë mbledhje u debatua edhe për çështjen e ndërprejres së kujdestarisë në maternitetin e QKMF-së në Malishevë, ku sipas drejtorit komunal për shëndetësi, kujdestaria është ndërprerë për shumë arsye, por kryesorja është

mungesa e gjinekologëve për punë në kujdestari dhe derisa të bëhet një zgjidhje për këtë çështje, kujdestaria do të vazhdojë të mbetet e ndërprerë, por anëtarët e Kuvendit të Komunës në Malishevë, kërkojnë që shërbimi i kujdestarisë në maternitet të kthehet në 24 orë në ditë.

U shënua 10 vjetori i ditës së shkollës në Turjakë

Malishevë, 06 maj



Sot në fshatin Turjakë, u shënua 10 vjetori i hapjes së shkollës “Fehmi Agani”, si dhe u përkujtua në 15 vjetorin e rënies altarin në lirisë, të akademikut Fehmi Agani, emrin e të cilit e mbanë kjo shkollë. Në këtë 10 vjetor, mori pjesë edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, me bashkëpunëtor.

”Jam shumë i nderuar që sot gjendem në këtë gëzim tuajin, dhe do të dëshiroja që të bashkëngjitem përherë në gëzimet e

gjeneratave të reja. Kam kënaqësi të veçantë kur marrë pjesë në ditët e shkollave, dhe kur dëgjoj himnin kombëtar, duke u kënduar, pasi që ne e dimë që më herët nuk kemi qenë të lirë, dhe ka qenë i ndaluar në këto troje, ndërsa tani e kemi këtë mundësi, e kjo fal atyre që ranë dëshmor për këtë vend. Duhet ti kujtojmë, mendojmë për ta dhe të punojmë në rrugën e tyre, për arsye se ata na bënë të mundshme që ne sot të flasim lirshëm, dhe ti kujtojmë lirshëm. Pres shumë nga ju mësimdhënës, që të punoni më këto gjenerata të reja, për arsye se pa një arsim cilësor nuk do të kemi një të ardhme të ndritshme, dhe ju me një arsim cilësor do të ndritni të ardhmen e tyre, dhe që të jenë gjeneratë me kulturë, me arsimim të lartë ngase Malishevës i duhen këto gjenerata”, tha mes tjerash kryetari Begaj, në fjalën e tij.

Drejtori i shkollës z.Jakup Kastrati, pasi falënderoi të gjithë pjesëmarrësit, në 10 vjetorin e ditës së shkollës “Fehmi Agani foli rreth historikut dhjetë vjeçar të shkollës, si dhe për jetën dhe veprën e akademik Fehmi Aganit.

Komuna mbështet shoqatën e shurdhë-memecëve në Malishevë

Malishevë, 07 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj priti në zyrën e tij përfaqësuesit e Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve, përkatësisht zyrtarin ndërlidhës të Shoqatës së të Shurdhërve të Kosovës, z.Ramadan Gashi, ku dhe bënë marrëveshje rreth mbështetjes financiare të këtij komuniteti.

Kryetari Begaj i mirëpriti në zyrën e tij, përfaqësuesve të këtij komuniteti, dhe ju dha mbështetjen

e kërkesave dhe nevojave që kjo kategori e shoqërisë ka. Begaj e Gashi, biseduan rreth mbështetjes financiare për këtë komunitet ku dhe ranë në ujdë që Komuna ti mbështet me një shumë prej rreth 3000 euro si institucion, dhe pjesën tjetër prej 1500 euro nga interpretët e Shoqatës Kosovare të të Shurdhërve.

Filloi spërkatja kundër rriqrave në Senik

Malishevë, 7 maj

Organizuar nga drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe drejtoria për Shëndetësi, në bashkëpunim me kompaninë e kontraktuar nga Ministria e Bujqësisë, “Truly Nolen”, ka



filluar spërkatja kundër rriqrave, në kuadër të masave për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), masa të cilat janë të planifikuara nga Këshilli Ndërmintor për luftimin e EHKK.

Kompania në bashkëpunim me organet komunale të Malishevës, ka angazhuar punëtorët dhe makinerinë për spërkatjen selektive të zonave endemike në Malishevë, ndërsa arsye për fillimin e spërkatjes në Senik, ka qenë një rast i

regjistruar në Komunën e Malishevës, gjatë këtij viti me EHKK, i cili fatmirësisht është shëruar.

Pas Senikut, spërkatja e zonave endemike, do të vazhdoj sipas planit të hartuar, për spërkatjen, sipas zonave, ku ka më shumë raste të regjistruara të thumbimeve nga rriqrat, gjatë këtij viti.

Fillimin e spërkatjes në Senik, sot e ka përcjell edhe kryetari i Malishevës Ragip Begaj, me drejtorin e shëndetësisë Hajdin Berisha dhe drejtorin për mbrojtje dhe shpëtim Ahmet Morina. Begaj, ka kërkuar nga kompania, seriozitet gjatë spërkatjes në të gjitha zonat, përderisa nga banorët ka kërkuar bashkëpunim të mirë, në mënyrë që rreziku nga thumbimi i rriqrave të zvogëlohet.

Begaj, mori pjesë në shënimin e katër ditëve të shkollave dhe përkujtime për dëshmorët

Malishevë, 8 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot mori pjesë në disa raste të shënitit të ditëve të dëshmorëve dhe ditëve të shkollave, ku ka shprehur mirënjohjen e tij për sakrificën e dëshmorëve dhe të gjithë rënët e tjerë, gjatë luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa në shkollë i ka uruar për sukseset e arritura deri më tani dhe për suksese të tjera në vijim.

Fillimisht, kryetari Begaj, mori pjesë në shënimin e ditës së dëshmorëve të fshatit Balincë, ku janë bërë nderime në varrezat e fshatit, ku gjendet varret e martirëve dhe dëshmorëve të këtij fshati, për të vazhduar me shënimin e ditëve të shkollave në Lladroc dhe Bardh, e për ta përfunduar me shënimin e ditës së shkollës dhe dëshmorëve të fshatit Guncat. Në Guncat, kanë marrë pjesë edhe kryetrari i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, z.Muharrem Xhemajli dhe zv/ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z.Fatmir Shurdhaj.

“E kemi me borxh që ti përkujtojmë dhe ti nderojmë dëshmorët e kombit, të cilët dhanë më të shtrenjtën për lirinë që sot gëzojmë, andaj as ne dhe as gjeneratat që vijnë më pas, nuk duhet ti harrojnë, lavdinë e luftës së UÇK-së dhe sakrificën e dëshmorëve. Ne me krenari i mbajmë emrat e tyre në institucionet tona, si në shkolla, shtëpi të kulturës, palestra sportive e stadione, me emrat e dëshmorëve i emërtojmë rrugët, pasi ata dhanë jetën që ne të ecim në këto rrugë, të shkollohemi në këto shkolla dhe të punojmë në këto institucione. Lavdi jetës dhe veprës së dëshmorëve të kombit”, ka thënë mes tjerash gjatë këtyre shënimeve, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj.

Malisheva, për herë të parë do të bëhet me çerdhe për fëmijë

Malishevë, 8 maj



Qyteti i Malishevës, shumë shpejt, do të bëhet me çerdhe për fëmijë, pasi deri më sot, ky qytet dhe kjo komunë, nuk ka trashëguar asnjë çerdhe për fëmijë. Sot, edhe zyrtarisht ka filluar ndërtimi i çerdes për fëmijë, në lagjen “Mirëdita” në Malishevë, ndërsa vendosjen e gurëthemelit të çerdes, e bëri i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj.

Në vënien e gurëthemelit, përveç zyrtarëve komunal, kanë marrë pjesë edhe shumë gra të punësuar dhe që punojnë në Malishevë, në sektore të ndryshme, si mësuese, në shëndetësi, administratë, organizata joqeveritare dhe të tjera.

“Të gjitha ato nëna që punojnë, tani do të kenë kushte më të mira për rritjen dhe kujdesin për fëmijët. Ka qenë e domosdoshme kjo për Malishevën, qysh moti, pasi asnjëherë këtë nuk e ka pasur Malisheva. Ne e kemi ndërprerë tenderin e parë, pasi ka qenë e paraparë me kapacitet për 50 fëmijë, ndërsa tani e kemi rritur për 80 fëmijë, e nëse është nevoja do ta rrisim dyfish kapacitetin, në mënyrë që ju nëna e motra tona, të keni mundësi më të mira dhe të mos pengesa në punë”, tha mes tjerash kryetari Begaj, në ceremoninë e vënies së gurëthemelit të çerdes për fëmijë në Malishevë.

Sipas drejtorit për urbanizëm, z.Urim Kastrati, kjo çerdhe ka një hapësirë prej 500 metrash katror të objektit, ndërsa hapësira me gjithë oborr, është katërdhjetë ari. Kapaciteti i çerdes është për 80 fëmijë dhe planifikohet të përfundoj, sipas planit dinamik të punës për 90 ditë.

Ndërtimi i çerdhes finançohet nga Komuna e Malishevës dhe ka një shumë prej 130 mijë euro. Punëkryes është N.T.P. “Beli”.

Kryetari Begaj, bisedoi me zyrtarët e Hidroregjionit për rritjen e kapaciteteve të ujit

Malishevë, 8 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me bashkëpunëtor, ka zhvilluar një takim në zyrën e tij, me zyrtarët e Hidroregjionit, përkatësisht drejtorin e kësaj kompanie, z.Besim Baraliun, me bashkëpunëtor, për ecurinë e mëtutjeshme të projektit për ujëmbledhësin në Senik dhe rritjen e kapaciteteve të ujit për disa vendbanime të Malishevës.

Përfaqësuesit e Hidroregjionit, siç thanë, ecuria e mëtutjeshme e projektit për ndërtimin e ujëmbledhësit në Senik, i cili parashihet të furnizoj rreth 12 fshatra të Malishevës, po planifikohet të ndërtohet në mënyrë që të ketë sa më pak shpenzim të energjisë elektrike.

Në këtë takim u bisedua edhe për rritjen e kapacitetit të ujit në ujësjellësin e fshatit Bellanicë dhe futjen e këtij ujësjellësi në menaxhim të kompanisë së Hidroregjionit.

Po ashtu u bisedua edhe për mundësitë e gjetjes së burimeve të ujit dhe ndërtimin e ujësjellësve edhe për disa fshatra të Malishevës, si në Pagarushë, pastaj Atsrazup dhe fshatra të tjerë.

Lendrit Jonuzaj, zë vendin e tretë në olimpiadën botërore të biologjisë

Malishevë, 12 maj



16 vjeçari, Lendrit Jonuzaj nga Seniku i Malishevës, i cili mori pjesë në Olimpiadën Botërore të biologjisë, në Texas të SHBA-ve, ka treguar sukses të mirë, duke zënë vendin e tretë dhe medaljen e bronzit në këtë olimpiadë, dhe kështu edhe njëherë dëshmoi për arriturat në arsimin e vendit tonë.

Lendrit Jonuzaj, fillimisht u rendit i treti në olimpiadën në nivel vendi, për të siguruar pjesëmarrjen në olimpiadën botërore, që u mbajt në Texas të SHBA-ve. Kosova ishte pjesëmarrëse në mesin e 59 shteteve të ndryshme të botës, ndërsa rezultati i angazhimit të tij në fushën e biologjisë, ishte vendi i tretë në botë.

Pjesëmarrjen e Lendritit në këtë olimpiadë, e kishte përkrahur edhe Komuna e Malishevës.

KKSB: Malisheva vazhdon të jetë komuna më e sigurt

Malishevë, 12 maj

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i udhëhequr nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e dytë të radhës, ku u vlerësua se situata e sigurisë së përgjithshme është e qetë dhe Komuna e Malishevës, vazhdon të mbetet njëra prej komunave më të sigurta në vend.

Problem në aspektin e sigurisë së përgjithshme, paraqesin ethet hemorragjike krime kongo (EHKK), qentë endacak, mirëmbajtja e ambientit dhe shenjat në rrugë.

Sa i përket situatës me EHKK, drejtori i drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, paraqiti, para anëtarëve të KKSB-së, angazhimet e Komunës së Malishevës, në



fushatat e vetëdijesimit, pastaj fillimit të spërkatjes selektive dhe angazhimet tjera, që është duke bërë komuna, në luftimin dhe parandalimin e EHKK. Drejtori Morina, po ashtu njoftoi edhe për angazhimet tjera të drejtorisë, në kuadër të mbrojtjes së qytetarëve, gjatë situatave emergjente, jo vetëm nga EHKK por edhe rastet e vërshimeve, pastaj zjarreve, dhe të tjera.

Nga ana tjetër, komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni policor Halil Morina, bazuar në raportet policore, e vlerësoi të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme në Malishevë, dhe pa indikacione për prishjen e kësaj situatë.

Përfundon spërkatja kundër rriqrave në Banjë dhe nesër vazhdon në Malishevë

Malishevë, 12 maj

Spërkatja selektive, kundër rriqrave, si bartës të virusit të etheve hemorragjike krime kongo, ka vazhduar edhe sot në fshatin Banjë, ndërsa prej nesër kjo spërkatje do të vazhdojë në qytetin e Malishevës. Spërkatja e zonave endemike, bëhet në kuadër të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK).

Sipas drejtorit të drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Ahmet Morina, spërkatja e zonave endemike po vazhdon me dinamikën e paraparë dhe në këtë fushatë janë të angazhuar mbi 50 persona, që bashkë me kompaninë e përzgjedhur nga ministria e bujqësisë, “Truly Nolen”, do ta bëjnë spërkatjen e të gjitha zonave të cilat cilësohen endemike.

Drejtori Morina, ka bërë me dije, se sot përfundon spërkatja në fshatin Banjë dhe ajo nesër (e marte) do të vazhdojë në qytetin e Malishevës. Morina, ju ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve për bashkëpunim gjatë spërkatjes, si dhe i njofton bletarët për kujdes të shtuar për bletët, pasi preparati kundër rriqrave, ndikon negativisht tek bletët.



Komiteti për komunitete zgjodhi nënkryetarin e saj

Malishevë, 13 maj

Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur dje, ka zgjedhur nënkryetarin e saj. Nënkryetar i këtij komiteti, me vota unanime u zgjodh Naser Malisheva, nga komuniteti RAE, ndërsa ky komitet ka shtatë anëtar, ku katër anëtar janë Kuvendi i Komunës dhe tre të tjera nga komuniteti RAE dhe shoqëria civile.

Në këtë mbledhje, ka raportuar edhe zyrtarja për komunitete dhe kthim, znj. Edona Krasniqi, për punën njëvjeçare të zyrës së saj, ndërsa në këtë mbledhje, anëtarët e këtij komiteti kanë marrë vendim për organizimin e dy debateve për rolin e komiteti për komunitete, në raport me institucionet, si dhe për organizimin e një debati për çështjen e largimit të mbeturinave, i cili parashihet të mbahet më 24 maj, në kuadër të aksionit “Ta pastrojmë Kosovën”.

Në këtë mbledhje, janë diskutuar edhe çështje tjera që lidhen me punën dhe aktivitetet e këtij komiteti.

MASHT dhe GIZ, në përkrahje të rritjes së nivelit në arsimin profesional në Malishevë

Malishevë, 12 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës z. Ragip Begaj, ka pritur dje, në një takim përfaqësuesit e organizatës GIZ, të shoqëruar nga zyrtarët e lartë të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës. Temë e takimit ishte përkrahja e GIZ-it për komunën e Malishevës, veçanërisht mbështetja në ngritjen profesionale të stafit arsimor dhe nxënësve të shkollave të mesme profesionale, përkatësisht të Qendrës së Kompetencës.

Fillimisht, kryetari Begaj i ka falënderuar përfaqësuesit e GIZ-it gjerman dhe Drejtorin e Përgjithshëm të MASHT-së, z. Ragip Gjoshi, për gatishmërinë e tyre për përkrahjen e avancimit të mësimin profesional. “Për neve projekti më madhor në Malishevë ka qenë investimi në Qendrën e Kompetencës, dhe i jemi mirënjohës ambasadorit Norvegjez, Sverre Johan Kvale, për këtë projekt, dhe ne kemi kërkuar nga Ministria e Arsimit që në bashkëpunim të vendosim për këtë shkollë, për profilet në të cilat do ta orientojmë këtë shkollë, dhe me ju kërkoj bashkëpunim të sigurtë rreth arsimin profesional” tha Begaj.



Ndërsa përfaqësuesit GIZ-it përkatësisht z.Christoph Heil, falënderoi Kryetarin Begaj, dhe shpalosi planin e ngritjes së mësimin profesional para tij, në fokus në ngritjen e sistemit të mësimdhënies dhe përafrimit të këtij sistemi me atë të sistemit të shkollave profesionale evropiane, projekt ky që zgjatë dy vite dhe menaxhohet nga organizata GIZ-it, për ngritjen e cilësisë së arsimit në Qendrën e Kompetencës

Përfaqësuesit e GIZ-it gjerman, thanë se kanë hulumtuar nivelin e deritanishëm dhe kanë gjetur se ka nevojë, që të rritet niveli dhe përshtatja me tregun e ekonomisë, për çka edhe kanë marrë model shkollimin e tillë, nga qyteti i Hamburgut.

Ndërsa Ragip Gjoshi, nga MASHT, tha se “për të rritur këtë nivel të mësimin profesional, ministria ka formuar agjencionin për aftësimin në arsimin profesional”.

Filloi ndërtimi i shkollës në Gollubovc

Malishevë, 14 maj

Sot në fshatin Gollubovc të Malishevës, edhe zyrtarisht ka filluar ndërtimi i objektit të shkollës fillore në këtë fshat. Gurëthemelin e ndërtimit të shkollës, e vendosi i pari i



Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili bashkë me drejtorin e arsimit, z.Blerim Thaçi dhe drejtorin e urbanizimit, z.Urim Kastrati, morën pjesë në fillimin e punimeve të objektit të ri të shkollës.

“Unë para marrjes së mandatit për udhëheqjen e Komunës së Malishevës, kam dhënë një premtim, të cilin po e mbaj, e premtim i imi ishte, se do të investoj në zonat më të thella të komunës sonë, në ato zona ku kanë munguar investimet”, tha kryetari Begaj, në ceremoninë e fillimit të punimeve për ndërtimin e shkollës së fshatit.

“Urime për shkollën e re, në veçanti për ju nxënës shumë urime, e trashëgofshi shkollën”, tha mes tjerash Begaj, e më pas i porositi mësimdhënësit, që të punojnë në arsimimin e fëmijëve.

Kjo shkollë, ka një hapësirë prej 1300 metra katrorë dhe objekti do të ketë dhjetë klasa për mësim, ndërsa ndërtimi i saj, sipas kontratës është me kohëzgjatje dy vjeçare. Ndërtimi i shkollës do të bëhet nga buxheti i Komunës së Malishevës dhe kap një shumë 298 mijë euro. Punëkryes i punimeve është N.N.P. “Sinani ING” nga Prishtina.

Fshati Gollubovc, është prej fshatrave më të largëta nga qendra komunale e Malishevës.

SHMU “I.Mazreku” fituese e garave të futbollit në nivel të shkollave

Malishevë, 14 maj



Sot kanë përfunduar garat komunale në futboll të vogël në nivelin e shkollave të mesme të ulëta (SHMU), të organizuara nga drejtorja komunale për Arsim dhe Edukim. Vendin e parë në këto gara e ka fituar Shkolla e Mesme e Ulët (SHMU “Ibrahim Mazreku” nga Malisheva, vendin e dytë SHMU “Imer Krasniqi” nga Carralluka dhe vendin e tretë SHMU “Ruzhdi Gjyliqi” nga Maralia.

Në finalen e këtyre garave, mori pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Blerim Thaçi dhe zyrtar tjerë komunal, të cilët edhe i kanë ndarë shpërblimet për vendet e para dhe lojtarët më të mirë të këtyre garave.

Garat komunale, në futboll të vogël, në nivel të shkollave të mesme të ulëta, organizohen nga Drejtorja për Arsim dhe Edukim dhe mbahen çdo vit shkollor.

KDI me vlerësim pozitiv për punën e Komunës së Malishevës

Malishevë, 15 maj

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në një konferencë për medie, të mbajtur gjatë ditës së djeshme, e cila është transmetuar në portalet informative vendore, lidhur me monitorimin e punës së Kuvendeve Komunale të regjionit të Prizrenit, ka dhënë disa nota pozitive për Komunën e Malishevës, e që lidhen me transparencën komunale.

Fillimisht, KDI ka vlerësuar se Komuna e Malishevës, përkatësisht kryetari i Komunës, ka raportuar para Kuvendit të Komunës, për raportin financiar tre mujor, janar-mars 2014, duke e respektuar afatin ligjor për raportim, e që është njëra prej dy komunave të regjionit të Prizrenit, që ka respektuar këtë afat ligjor.

Po ashtu me notë pozitive, KDI e ka vlerësuar edhe respektimin e afatit ligjor për përgjigje në kërkesat për qasje në dokumentet publike. “Një respektim kohor të kthimit të përgjigjeve për qasje në dokumente publike kanë kryer vetëm katër nga gjashtë komunat e regjionit të Prizrenit dhe komuna e cila i është përgjigjur më shpejtë kërkesës për qasje në dokumente publike ka qenë Komuna e Malishevës”, thuhet në raportimin e KDI-së.

Këto të dhëna janë marrë nga raportimet e gazetarëve, për portalet informative, të botuara gjatë ditës së djeshme.

Malisheva dhe Suhareka nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi në sport

Malishevë, 15 maj



Komuna e Malishevës dhe Komuna e Suharekës, në kuadër të bashkëpunimit të mirë në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë, sot kanë nënshkruar një marrëveshje, për shfrytëzimin e aseteve të Komunës së Malishevës, në fushën e sportit, në mënyrë që të ndihmohet palestra sportive në Suharekë, për zhvillimin e aktiviteteve në basketboll.

Këtë marrëveshje e kanë nënshkruar sot, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Malishevës, znj. Blerta Krasniqi dhe homologu i saj nga Suhareka, z. Nuhi Llugaxhiu. Sipas

marrëveshjes, Suhareka merr në shfrytëzim dy kosha të nivelit profesional dhe standard, për nevojat e palestrës sportive në Suharekë.

“Bashkëpunimi i mirë që ka ekzistuar, duhet të vazhdohet edhe në të ardhmen, edhe përmes projekteve të përbashkëta, në kulturë, rini e sport si dhe për shfrytëzimin e përvojave të përbashkëta në të gjitha fushat”, tha drejtoresha Krasniqi.

Ndërsa homologu i saj nga Suhareka, z.Llugaxhiu, tha se është “ithtar për bashkëpunim regional në këtë fushë, sikur në rastin konkret edhe për shfrytëzimin e asetëve të përbashkëta në sport, rini dhe kulturë”. Drejtori Llugaxhiu, falënderoi Komunën e Malishevës, për dhënien në shfrytëzim të këtyre koshave, të cilët janë modern dhe sipas standardeve që kërkohen në basketboll.

Kryetari i klubit të basketbollit “Malisheva”, z.Adrian Mazreku, i cili mori pjesë në këtë takim, tha se dikur “edhe klubi i Malishevës, ka shfrytëzuar palestrën e Suharekës për zhvillimin e garave”.

Përgjegjësit e drejtorive për kulturë, rini dhe sport, nga Malisheva e Suhareka, znj.Krasniqi dhe z.Llugaxhiu, u pajtuan që në kuadër të aktiviteteve sportive për shënimin e 16 Qershorit-Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Malishevës, dy klubet e basketbollit, “Ylli” nga Suhareka dhe “Malisheva” nga Malisheva, të zhvillojnë një ndeshje miqësore.

Drejtoria e arsimit organizoi koncert për masantët e Malishevës

Malishevë, 16 maj



Organizuar nga drejtoria komunale për Arsim dhe Edukim, mbrëmë në palestrën e sporteve “Habib Zogaj” në Malishevë, ka organizuar një koncert për masantët e këtij viti shkollorë, të cilët po e përfundojnë shkollimin e mesëm, me qëllim për tu përshëndetur me masantët dhe për ti uruar suksese në shkollimin e mëtutjeshëm dhe në jetë në përgjithësi.

Në këtë mbrëmje, ka marrë pjesë edhe i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili i ka uruar masantët malishevas. “Përshëndetje për ju masant të shkollave të mesme. Me kënaqësi të veçantë kam marrë kërkesën për organizimin e këtij koncerti për ju. Ju jeni në pjesën më të mirë të jetës suaj. Uroj që ju si kuadro të reja që do të dilni nga studimet e juaja,

ti ktheheni Malishevës. Të jeni shembull i dijes, i kulturës dhe i suksesit”, tha mes tjerash, kryetari Begaj, në fjalën e tij drejtuar maturantëve malishevas.

Maturantët, i ka përshëndetur edhe drejtori i drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Blerim Thaçi.

Në këtë koncert, kanë marrë pjesë këngëtar dhe artist të humorit të estradës kosovare.

Malisheva shpalli fermerët më të mirë të vitit

Malishevë, 16 maj



Drejtorja për Bujqësi e Pyltari dhe Zhvillim Rural (BPZHR) në Komunën e Malishevës, ka për zgjedhur sot, tre fermerët më të mirë. Zgjedhje e tre fermerëve më të mirë, është bërë në shpalosjen e aktiviteteve të kësaj drejtorie, në njëqind ditshin e parë, të qeverisjes Begaj.

Në këtë takim të organizuar nga Drejtorja për Bujqësi e Pyltari dhe Zhvillim Rural (BPZHR), mori pjesë edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj. “Ju uroj suksese fermerëve që u dhanë mirënjohjet, dhe shpresoj që në të ardhmen të kemi edhe më shumë fermer që plotësojnë kushtet edhe janë aktiv në detyrat dhe punët e tyre. Neve shumë na intereson që të kemi prodhime vendore si nga ana e qumështit, mishit dhe nga ana e prodhimeve tjera, për arsye se jemi vend konsumues dhe neve kemi bërë një hap drejt subvencionimit të qumështit edhe do mundohemi që të bëjmë edhe hapa tjerë në mbështetjen e kategorive të tjera”, tha kryetari Begaj, duke folur në këtë ceremoni.

“Unë u jam mirënjohës për punën e juaj që po bëni, dhe Drejtorja për Bujqësisë do të jemi në përkrahjen tuaj, ngase jeni lëmia e vetme, bujqësia dhe blegtoria që mundet të na nxirri nga situatat dhe kriza jo të mira që has komuna jonë, në aspektin e zhvillimit ekonomik” tha Begaj.



Ndërsa drejtori për BPZHR-së z.Hajrullah Mazreku, shpalosi para fermerëve 100 ditshin e parë të aktiviteteve të kësaj drejtorie. “ Ne kemi vizituar 50-të stalla me lopë qumështore, ku dhe kemi dëgjuar për problemet dhe hallet e juaja, i kemi evidentuar probleme që keni, kemi ndihmuar fermerët në prodhimtarin e qumështit, ku përfitues kanë qenë 57 fermer, pastaj kemi ndihmuar në ngritjen e serave, dhe në ardhmen, të gjithë sektorët do të përfshihen në ndihëm dhe përkrahjen e komunës, pa dallim, por kjo do të bëhet gradualisht” tha drejtor Mazreku.

Ndërsa fermer më të mirë të vitit, të cilëve ju ndanë mirënjohje, janë: Islam Halitaj nga fshati Senik, Shqipe Kastrati nga Turjaka dhe Zejadin Paçarizi nga Lumnishta, mirënjohje ju dha edhe përfaqësuesve të TEB- Bankës për përkrahjen e vazhdueshme për fermerët.

Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e tretë të radhës

Malishevë, 16 maj

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës në Malishevë, drejtuar nga kryesuesi i KK, z.Enver Hoti, ka mbajtur mbledhjen e tretë të radhës, ku janë diskutuar një varg çështjesh dhe janë dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

KPF, pas shqyrtimit ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, shqyrtimin e raportit të punës së zyrës së kryetarit dhe qeverisë komunale për vitin 2013. Po ashtu një çështje tjetër e rekomanduar për kuvend, ishte edhe informimi i anëtarëve të KK, nga ana e Kryetarit të Komunës për rendin dhe qetësinë në Malishevë.

Për kuvend është rekomanduar edhe raporti i punës së zyrës së tatimit në pronë për vitin 2013 dhe plani i punës për këtë vit, pastaj për shqyrtim në KK është dërguar edhe rregullorja për transportin e udhëtarëve me auto-taksi.

Ndërsa një çështje tjetër me rëndësi, që KPF e ka dërguar për mbledhjen e ardhshme të KK, është edhe formimi i Këshillit Organizativ, për shënimin e 16 Qershorit- Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Malishevës.

Banorët e Bubavecit kërkuar ndihmën e kryetarit për mosprivatizim të pronave

Malishevë, 19 maj



Një grup prej disa dhjetëra banorëve të fshatit Bubavec, sot në orët e para të mëngjesit, kanë ardhur në oborrin e Komunës së Malishevës, për të kërkuar ndihmën e komunës dhe të kryetarit të komunës, për parandalimn e shitjes së pronave të këtij fshati, të uzurpuara nga ish sistemi i atëhershëm, ndërsa tani të futura në procesin e privatizimit nga AKP-ja.

“Unë jam kundër privatizimit të pronave, të cilat janë të qytetarëve dhe u takojnë atyre, dhe jam në mbështetje tuajën dhe jam përkrah juve në çdo mënyrë që ju mendoni se unë mund t’ju ndihmoj”, ju ka thënë kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, banorëve të fshatit Bubavec, të cilët pretendojnë se pronat të tyre.

“ E keni në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që gjendet në komunë dhe e keni përkrahjen time në këtë drejtim. Jam i gatshëm të vij me juve, kudo që ju shkoni, deri në AKP”, ju ka thënë Begaj, banorëve të fshatit Bubavec.

Nga mbledhja e Këshillit të drejtorëve

Po zhvillohen një varg projektesh në Malishevë

Malishevë, 19 maj

Si çdo të hënë edhe sot Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të qeverisë komunale, ku janë trajtuar një varg çështjesh, që lidhen me punët dhe aktivitetet e përditshme të qeverisë komunale, e ku u bë e ditur se sot do të filloj ndërtimi i shkollës në fshatin Gurishtë.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, përkatësisht drejtori z.Ahmet Morina njoftoi që sot ka vazhduar spërkatja e zonave endemike kundër rriqrave, si bartës të virusit të etheve hemorragjike në qytetin e Malishevës pasi që nuk ishte mundur të bëhet siç është paraparë, për shkak të reshurave atmosferike.

Nga ana tjetër, të gjithë drejtorët, kanë raportuar për aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe për aktivitetet që i kanë në javën në vazhdim. Në këtë mbledhje, sipas drejtorëve përgjegjës, janë duke u realizuar disa projekteve kapitale, kryesisht në infrastrukturën shkollore, rrugore, pastaj rrjete kanalizimi, dhe po ashtu pritet që në këtë javë të fillojnë asfaltimet në disa fshatra të Malishevës, si në Vërmicë dhe në fshatin Bardh, bëri të ditur drejtori për Urbanizëm z.Urim Kastrati.

Filloi ndërtimi i shkollës në Gurishtë

Malishevë, 19 maj



Sot në fshatin Gurishtë të Malishevës, ka filluar ndërtimi i objektit të ri të shkollës në këtë fshat. Në ceremoninë e fillimit të punimeve, mori pjesë i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, zyrtar të qeverisë komunale, deputeti i deritanishëm i Kuvendit të Kosovës, z.Haxhi Shala, anëtar të Asamblesë Komunale dhe qindra qytetar e nxënës të fshatit Gurishtë.

Fillimin e punimeve në themelin e shkollës, e bëri kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili uroi banorët dhe nxënësit e fshatit Gurishtë, për shkollën e re dhe tha se “po e mbaj premtimin tim, për investime në fshatrat më të thella dhe që kanë qenë të lënë anash deri më sot”.

“Ju përgëzoj për shkollën e re që sot po fillon të ndërtohet. Ju uroj të gjithëve, e në veçanti nxënësit dhe fëmijët e fshatit. Fshati juaj ka qenë gjithmonë, njëri prej fshatrave që ka dhënë shumë në periudha të caktuara të historisë dhe me plot bindje e them, se e meritoni një shkollë të tillë. Kjo shkollë, e cila mban edhe emrin e dëshmorit të kombit, ish mësuesit të kësaj shkolle Nuhi Mazrekut, e meriton që të ketë një objekt të mirë dhe këta fëmijë, meritojnë të kenë një objekt sipas standardeve për mësimnxënie”, the mes tjerash kryetari Begaj, duke i uruar për ndërtimin e shkollës së re.



Objekti i Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët (SHMU) “Nuhi Mazreku” në Gurishtë, ka një hapësirë prej rreth 1300 metra katrorë, me dhjetë klasa mësimi. Kohëzgjatja e ndërtimit të këtij objekti është me kontratë dy vjeçare dhe ndërtohet nga buxheti i komunës. Çmimi i ndërtimit të këtij objekti shkollor, është 288 888 euro dhe punëkryes është kompania “Standar Plus”.

Tri komitete dhe komisioni për emërtimin e rrugëve zgjedhin kryesuesit e tyre

Malishevë, 20 maj

Tri komitete jo obligative dhe komisioni për emërtimin e rrugëve, kanë mbajtur mbledhjet e para konstituive dhe kanë zgjedhur kryesuesit e tyre, të cilët do të udhëheqin këto organe në katër vitet e ardhshme, e që puna e tyre lidhet me rritjen e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Malishevës. Të gjitha këto mbledhje, janë thirrur dhe janë udhëhequr nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti.

Me vota unanime, kryesues i Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, është zgjedhur anëtari i KK të Malishevës, z.Januz Kastrati nga radhët e LDK-së.

Po ashtu unanimitisht, është zgjedhur anëtari i KK-së, Muhamet Bytyçi nga radhët e VV, për ta udhëhequr Komitetin për Planifikim Urban, Mbrojtje të Mjedisit, Kadastër, Turizëm dhe Monitorim të projekteve publike.

Ndërsa kryesues i Komitetit për Diasporë (Bashkatdhetar), është zgjedhur Besnik Hoti nga LDK-ja, i cili është anëtar i këtij komiteti, i ardhur nga subjekti i tij politik, jashtë Kuvendit të Komunës.

Komisionin për emërtimin e rrugëve në Komunën e Malishevës, do ta udhëheq Ahmet Rrahmanaj nga radhët e PDK-së, i cili u zgjodh unanimitisht si kryesues i këtij komisioni, por që do të ndihmohet nga zëvendësi i tij, Driton Krasniqi, i cili është anëtar i komisionit nga qeveria komunale.

Sot është dashur të mbahet mbledhje konstituive edhe Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Familje të Dëshmorëve, Invalid dhe Veteran të Luftës, si dhe për persona me aftësi të kufizuara, por në mungesë të kuorumit, është shturë konstituimi i këtij komiteti.

Në Vërmicë filloi hapja e rrugës, ndërsa në Gollubovc asfaltimi

Malishevë, 21 maj



Sot në fshatin Vërmicë, përkatësisht në lagjen e Ukajve, ka filluar zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës, për rreth 40 shtëpi që jetojnë në këtë lagje, e që sipas banorëve të lagjes, për herë të parë, po e shohin dorën e shtetit në këtë pjesë. Në fillimin e punimeve mori pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, drejtori për urbanizëm, z.Urim Kastrati dhe zyrtar tjerë komunal.

“Ne e kemi dhënë një premtim për rregullimin e kësaj rruge, zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës dhe këtë po e bëjmë. Ndërtimi i rrugës do ta t’jua lehtësoj qarkullimin e banorëve të kësaj lagje dhe lidhjen e lagjes jo vetëm me fshatin, por edhe me qendrën komunale” tha mes tjerash nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, duke i uruar banorët për fillimin e punimeve në këtë rrugë.

Nga ana tjetër, banorët e kësaj lagje dhe të fshatit Vërmicë, pasi falënderuan komunën për angazhimin e saj në ndërtimin e rrugës dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve të kësaj lagje, tha se “për herë të parë po e ndiejnë dorën e shtetit në raport me krijimin e kushteve më të mira për jetën e tyre”.

Lagjja e Ukajve është njëra nga lagjet e fshatit Vërmicë, ka qenë e ndarë nga fshati për shkak të rrugës dhe ka një konfiguracion të veçantë dhe natyrë shumë piktoreske. Ndërtimi i rrugës së gjatë 1 835 metra, u mundësua nga buxheti komunal i Malishevës.

Po ashtu sot në fshatin Gollubovc, ka filluar edhe asfaltimi i rrugës në një pjesë të fshatit, me një gjatësi prej 900 metrave. asfaltimin e rrugës në këtë fshat sot e ka parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, ku është ndarë i kënaqur me cilësinë e punimeve dhe i ka uruar banorët për asfaltimin e rrugës.

Kryetari Begaj, mori pjesë në ceremoninë e nderimit të Fatmir Limajt me titullin “Doctor Honoris Causa”

Tiranë, 21 maj

Universiteti i Tiranës, me një ceremoni të organizuar, i ka dhënë titullin “Doctor Honoris Causa” z. Fatmir Limaj, duke e vlerësuar, për kontributin e tij në çështjen kombëtare. Z.Fatmir Limaj, është personaliteti i parë nga Komuna e Malishevës, që nderohet me këtë titull. Në këtë ceremoni, ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me bashkëpunëtor, e që më pas, së bashku me z.Limaj, janë pritur edhe nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, z.Lulzim Basha.



Limaj, është vlerësuar për kontributin e tij që prej viteve studentore për lirinë e Kosovës, si udhëheqës i formacioneve të UÇK-së, se ka mbrojtur moralin e UÇK-së, duke u shpallur i pafajshëm nga akuzat për krime luftime. Limaj u vlerësua edhe si njëri prej deputetëve më të votuar në Parlamentin e Kosovës, njëri ndër themeluesit e PDK-së, si nënshkrues i Deklaratës së

Pavarësisë së Kosovës, si negociues për shpalljen e pavarësisë, ndërsa si jurist Limaj u vlerësua për kontributin në krijimin e shtetit të së drejtës.

Me këtë rast z. Limaj dhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, janë pritur nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z.Lulzim Basha, i cili e ka uruar z. Limaj, për titullin e akorduar nga Universiteti i Tiranës. Basha, e ka falënderuar edhe kryetarin e Malishevës, z.Begaj për pjesëmarrjen e tij në këtë ceremoni dhe vizitën në Bashkinë e Tiranës.

Banja dhe Tërpeza shënuan ditët e shkollave të tyre

Malishevë, 22 maj

Sot në fshatrat Banjë dhe Tërpezë të Komunës së Malishevës, përkatësisht SHFMU “Naim Frashëri” në Banjë dhe “Hasan Prishtina” në Tërpezë, kanë shënuar ditët e shkollave të tyre. Në këto dy shënime mori pjesë nënkryetari i Komunës së Malishevës, z. Rexhep Mazreku dhe drejtori i DKA-së z. Blerim Thaçi me stafin e tij.

Fillimisht nënkryetari Mazreku, përcolli aktivitetin në SHFMU “Naim Frashëri” në Banjë, ku u shënuan 86 vjetori i ditës së shkollës. “Sot këtu para jush i sjell përshëndetjet dhe urimet nga Komuna e Malishevës, përkatësisht nga Kryetari Begaj, i cili për arsye objektive nuk mundi të marr pjesë në këtë urim”, tha nënkryetari Mazreku. “Banja si fshat ka një hisë të suksesit dhe të arsimit për arsye se kjo shkollë është ndër shkollat më të vjetra në komunën e Malishevës, dhe nga kjo shkollë kanë dalë kuadro të shumtë dhe veteran të arsimit të cilët kanë dhënë kontribut gjatë kësaj periudhe”, tha Mazreku.

Ndërsa në 66 vjetorin SHFMU “Hasan Prishtina” në Tërpezë po ashtu i uroi sukses nxënësve dhe mësimit të kësaj shkolle. Në këtë shënim morën pjesë edhe përfaqësuesit e SHFMU “Hasan Prishtina” nga Prishtina, shkolla këto të binjakëzuara.

Filloi ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Drenoc

Malishevë, 22 maj



Sot edhe zyrtarisht kanë filluar punimet në ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Drenoc të Malishevës, përkatësisht të fazës së parë të ujësjellësit për këtë fshat. Në ceremoninë e fillimit të punimeve, mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, me bashkëpunëtor, ku i uruan banorët e Drenocit, për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit.

“Ky ka qenë një projekt i domosdoshëm, ndoshta edhe më herët, por mundësitë e komunës janë tani. Ja kemi borxh fshatit më të madh në komunën tonë, që të investojmë, ndërsa ujësjellësi është i domosdoshëm”, tha mes tjerash kryetari Begaj.

“Unë besoj se projekti do të përfundoj brenda afatit të paraparë dhe cilësia e punimeve të jetë e mirë, dhe jam i gëzuar po aq sa ju, për ndërtimin e ujësjellësit për ju, pasi nuk është thjesht projekt, por është jetike për ju”, tha Begaj, i cili kërkoi nga kryetari i fshatit dhe komisioni i fshatit, të bashkëpunojnë gjatë kryerjes së punimeve, në mënyrë që projekti të përfundoj me sukses.

Nga ana tjetër, kryetari i fshatit Drenoc, z.Nuhi Morina, falënderoi komunën, për investimin në rrjetin e ujësjellësit dhe për përpjekjet e komunës në këtë drejtim, pasi Drenoci si njëri prej fshatrave, me mungesë të madhe të ujit për pije dhe nga ana tjetër, është fshati me më së shumti banor.

Edhe punërkyesi, firma “Muratori”, ka thënë, se nëse punët ecin sipas planit dhe nuk ka pengesa të mëdha, brenda 60 ditëve, do të përfundoj ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit, përkatësisht të kësaj faze.

Rrjeti i ujësjellësit, është rreth 30 kilometra, ndërsa faza e parë, e cila përfshin rrjetin brenda fshatit, është rreth 18 kilometra. Rrejtji prej 30 kilometrave, kushton rreth 300 mijë euro dhe kryesisht mbulohet nga buxheti i Komunës së Malishevës, ndërsa pjesëmarrës do të jetë edhe Hidroregjioni jugor, me pjesën e saj, në ndërtimin dhe funksionalizimin e rrjetit.

Kryetari Begaj, i shikoi nga afër realizmin e katër projekteve

Malishevë, 22 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot ka vizituar fshatrat Gollubovc dhe Vërmicë, ku ka shikuar nga afër ecurinë e punimeve në së paku katër projekte të ndryshme, të cilat janë duke u realizuar në këto dy fshatra, ose janë në përfundim e sipër, siç janë shkolla, rrugët dhe kanalizime.

Kryetari Begaj, fillimisht vizituar fshatin Vërmicë, duke parë nga afër fillimin e punimeve të rrugës në këtë fshat, e cila filluar të ndërtohet gjatë ditës së djeshme, si dhe një segmenti tjetër të kësaj rruge, ku janë duke vazhduar punimet në përgatitjen e saj deri në asfaltim.

Pas kësaj Begaj, ka vizituar fshatin Gollubovc, ku ka parë nga afër asfaltimin e një rruge në këtë fshat, e cial ka përfunduar dje, ndërsa tani duke përfunduar punimet anësore pas asfaltimit. Më pas, kryetari Begaj, ka vizituar edhe shkollën e fshatit, punimet në ndërtimin e së cilës kanë filluar tetë ditë më parë. Kryetari Begaj u shpreh i kënaqur me ecurinë e punimeve në ndërtimin e shkollës. Po ashtu në Gollubovc, është inspektuar edhe ndërtimi i kanalizimit për një pjesë të fshatit.

Filloi ndërtimi i rrugës Bellanicë-Bardh

Malishevë, 23 maj



Sot ka filluar ndërtimi i rrugës, që lidh disa lagje të fshatit Bellanicë me lagjet e fshatit Bardh, të Komunës së Malishevës dhe rrjedhimisht edhe bëhet lidhja e këtyre lagjeve të dy fshatrave me shiritin kryesor rrugës dhe me qendrën komunale. Në fillimin e punimeve të kësaj rruge, mori pjesë edhe Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i Urbanizimit, z.Urim Kastrati.

“Unë ju uroj juve për rrugën, e cila ka filluar të ndërtohet sot dhe uroj që ju ta trashëgoni këtë rrugë, e cila ju ndihmon juve banorëve të këtyre lagjeve në të dy fshatrat, e në veçanti nxënësit që vijnë në mësimin në shkollën e Bellanicës”, tha mes tjerash Begaj, para banorëve të Bellanicës dhe Bardhit.

Kjo rrugë, shkurton dhe lehtëson lëvizjen e këtyre lagjeve, me qendrën e Bellanicës dhe lidhjen me shiritin kryesor të rrugës, që lidhet me qendrën komunale. Deri më tani këto lagje, kanë kaluar nëpër këtë rrugë të ngushtë, të pa rregulluar dhe qarkullimi i banorëve ka qenë i vështirësuar, sidomos gjatë kohës së reshjeve atmosferike.

Kjo rrugë është e gjatë 1750 metra me gjerësi katër metra. Ndërtimi i rrugës, ku përfshihet edhe një urë e vogël, mundësohet nga buxheti komunal i Malishevës. Punimet është duke i kryer kompani “Jehona”.

Edhe Malisheva i bashkohet aksionit “Ta pastrojmë Kosovën”

Malishevë, 24 maj



Sot në Malishevë, është organizuar aksioni në nivel vendi, me moton “Ta pastrojmë Kosovën”, ku qindra nxënës të shkollave të mesme, pjesëtar të Forcës së Sigurisë së Kosovës, zyrtar komunal të Malishevës, Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi dhe të tjerë, ju kanë bashkuar aksionit për pastrimin e ambientit. Aksionit i ka prirë, nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku.

Ditës së 24 majit, ditë në të cilën “pastrohet” Kosova nga mbeturinat, edhe Komuna e Malishevës, tradicionalisht i bashkohet këtij aksioni, duke e pastruar ambienti nga mbeturinat dhe në të njëjtën kohë, duke bërë vetëdijesimin e qytetarëve, që të mos hedhin mbeturina në ambientin ku jetojmë.

Përndryshe, në Malishevë, që nga muaji i kaluar, ka filluar aksioni për pastrimin e Malishevës, duke i larguar deponitë ilegale të mbeturinave, aksion i cili po vazhdon ende, përderisa kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, largimin e mbeturinave, e ka njërin prej prioriteteve kryesore.

Deri më tani, janë spërkatur rreth 1660 hektar hapësirë kundër rriqrave

Malishevë, 26 maj

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të kryesuar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, drejtorët komunal kanë raportuar për aktivitetet e tyre, ku më e rëndësishmja ishte edhe paraqitja e situatës epidemiologjike në Komunën e Malishevës, ku u bë e ditur se në kuadër të masave mbrojtëse, deri më tani janë spërkatur rreth 1660 hektar.

“Në kuadër të masave mbrojtëse në luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike kringe kongo (EHCC), deri më tani janë spërkatur rreth 1660 hektar sipërfaqe, ndërsa spërkatja e selektive e zonave endemike, është duke vazhduar”, ka thënë drejtori komunal për mbrojtje dhe shpëtim, z.Ahmet Morina.

Nga ana tjetër, drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, ka bërë të ditur se numri i personave të thumbuar nga rriqrat, është në rritje e sipër. “Deri mbrëmë, në QMKF të Malishevës, janë paraqitur 650 persona të thumbuar nga rriqrat, ndërsa numri po shtohet vazhdimisht, për shkak të kushteve të përshtatshme klimatike”, ka thënë Berisha. Nga numri prej 650 personave, 606 janë nga Komuna e Malishevës, ndërsa 44 raste janë nga komunat tjera që kanë kërkuar ndihmë në QKMF të Malishevës.

Sipas drejtorit Berisha, në QKMF të Malishevës, janë duke u trajtuar të gjitha rastet e thumbimeve dhe po bëhen analizat e nevojshme dhe përcjellja e rasteve të dyshuara.

KK formoi Këshillin Organizativ për shënimin e 16 Qershorit

Malishevë, 26 maj



Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur sot, e ku ka trajtuar vetëm një pikë të rendit të ditës, prej 16 pikave të tjera të parapara, ka formuar Këshillin Organizativ për shënimin e 16 Qershorit- Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Vendimi është marrë unanimisht nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Sipas këtij vendimi, Këshilli Organizativ do të udhëhiqet nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ndërsa anëtar të keshillit do të jenë edhe kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, nga një përfaqësues i të gjashtë subjekteve që marrin pjesën në KK të Malishevës, pastaj një përfaqësues nga tri shoqatat e dala nga lufta dhe një përfaqësues nga OJQ-të lokale në Malishevë.

Pas këtij vendimi, KK i Malishevës, ka ndërprerë punimet, në shenjë pakënaqësie për trajtimin jo të mirë për anëtarët e Kuvendeve Komunale, nga ana e institucioneve qendrore.

Anëtarët e KK të Malishevës, bojkotojnë mbledhjen, kërkojnë rritjen e pagave dhe trajtim më të mirë

Malishevë, 26 maj



31 anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, sot kanë bojkotuar seancën e rregullt, të pestën me radhë, me vetëm një pikë të trajtuar, të rendit të ditës. Bojkotimi i seancës, ka ardhur si rezultat e pakënaqësisë së shprehur nga ana e kuvendarëve malishevas, në raport me institucionet qendrore dhe mos dhënies së përgjigjes nga ana e MAPL-së, për statusin e anëtarëve të kuvendeve komunale.

Shqetësimin e pari e ka ngritur anëtari i KK të Malishevës, z.Januz Kastrati, nga radhët e LDK-së, e që kjo është përkrahur nga të gjitha grupet që janë të përfaqësuar në KK të Malishevës. “Mos ngritja e pagave për anëtarët e kuvendeve, ndërsa ngritja e pagave për kryetarin dhe kryesuesin e KK, është e pakuptimtë. Përveç kësaj ne nuk kemi as një definim të statusit tonë, si anëtar të kuvendit dhe as vet zyrtarët e MAPL-së, nuk kanë mundur të na japin sqarim për këtë”, ka thënë mes tjerash në fjalën e tij, z.Januz Kastrati.

Më pas, pas një konsultimi mes përfaqësuesve të grupimeve politike të përfaqësuara në KK të Malishevës, unanimisht, kanë vendosur ta bojkotojnë seancën e pestë të radhës.

Në një deklaratë të përbashkët, të të gjithë anëtarëve të KK të Malishevës, e dhënë para MAPL-së, e cila i përcjellë mbledhjet e kuvendeve komunale, përmes video transmetimit direkt, dhe para opinionit të gjerë, u tha se “ky veprim, është reagim ndaj gjendjes materiale dhe trajtimit jo të mirë, që po u bëhet anëtarëve të kuvendeve komunale”.

Komuna dhe MAPL financojnë ndërtimin e kanalizimit Banjë-Bellanicë

Malishevë, 26 maj

Komuna e Malishevës dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), sot kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, në bashkëfinancimin në projektin e ndërtimit të rrjetit të kanalizimit Banjë-Bellanicë. Projekti, është vazhdim i ndërtimit të rrjetit kryesor të kolektorit të ujërave të zeza, që parashihet të lidhen rreth tetëdhjetë përqind të fshatrave të Malishevës.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, ky projekt kap një shumë prej 146 584 euro, ku sipas marrëveshjes, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) merr përgjegjësinë e financimit të pjesë më të madhe të projektit, në vlerë prej 100 mijë euro, ndërsa pjesa tjetër prej 46 584 euro, do të financohet nga Komuna e Malishevës.

Ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza, është njëri prej projekteve më të mëdha që është duke u realizuar dhe ka një shtrirje të gjatë nga lindja në perëndim të Malishevës, përkatësisht nga fshati Temeqinë, deri në fshatin Bubël, ku pjesa më e madhe e këtij kolektori, tashmë është ndërtuar, ndërsa në këtë rrjet të kanalizimit, pritet të lidhen shumica e fshatrave të Malishevës, që kanë rënie në kolektorin, i cili shtrihet përreth lumit Mirusha.

Topa futbollit për fëmijët në Ploçicë

Malishevë, 26 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerta Krasniqi, sot kanë vizituar fshatin Ploçicë (lagjet afër Mleqanit), ku kanë takuar fëmijët e këtij fshati, të cilëve, kryetari Begaj, ju kishte premtuar se do t'ju bënte dhuratë topa futbollit, sepse fëmijët, kishin marrë pjesë vullnetarisht në aksionin e pastrimit në këtë fshat, sikur edhe po e mbajnë pastër ambientin në mes të fshatit.



Kryetari Begaj, gjatë vizitës në ditën e pastrimit në këtë fshat, kishte parë fëmijët e këtij fshati, tek pastronin ambientin dhe vet fëmijët kishin premtuar se do kujdeseshin për atë

pjesë, ku ishte larguar një deponi e madhe e mbeturinave, dhe do ta përdornin atë pjesë për të luajtur futboll.

Fusha ku luajnë fëmijët, edhe tash pas një muaji është e pastër dhe për këtë qëllim, kryetari Begaj dhe drejtoresha Krasniqi, ju kanë dhuruar topa futboll, këtyre fëmijëve, të cilët janë shembull i mirë, për kujdes ndaj ambientit ku jetojnë dhe luajnë.

Filloi asfaltimi i rrugës në Guncat

Malishevë, 27 maj



Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale, në infrastrukturën rrugore të Komunës së Malishevës, sot filloi asfaltimi edhe i një rruge të gjatë një kilometër, në fshatin Guncat. Në fillimin e asfaltimit të kësaj rruge, mori pjesë edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizimit në Komunën e Malishevës, z.Urim Thaçi, të cilët i kanë uruar

banorët e fshatit Guncat.

“Ju uroj për rrugën dhe uroj ta gëzoni këtë rrugë. Ne po mundohemi si komunë, që të përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve të Komunës së Malishevës, përmes investimeve të ndryshme, përfshi edhe rregullimin e rrugëve, në mënyrë që banorët, të kenë lehtësi në qarkullimin e tyre”, ju tha mes tjerash kryetari Begaj, banorëve të Guncatit.

Nga ana tjetër, Guncatasit, kanë falënderuar Komunën e Malishevës dhe kryetarin Begaj, për angazhimin, në krijimin e kushteve më të mira dhe për asfaltimin e kësaj rruge një kilometërshe, e cila i lidh me qendrën e fshatit, dhe me rrjetin kryesor të rrugës, për qendrën komunale dhe rrugën e kombit.

Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e UN-HABITAT-it

Malishevë, 27 maj



Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj, ka pritur sot përfaqësuesen e UN-HABITAT-it znj.Catarina Camarioas, ku biseduan rreth aktiviteteve dhe bashkëpunimit në mes të UN-HABITAT-it dhe Komunës së Malishevës.

Kryetari Begaj e mirëpriti, znj.Catarina Camarioas dhe e falënderoi për vizitën dhe angazhimin rreth projekteve të Komunës së

Malishevës, përfshi hartimin planit zhvillimor komunal, si dhe tani rreth projektit të urës në qytet. “Unë dëshiroj që të vazhdojmë të bashkëpunojmë edhe në projekte të tjera dhe sugjerimet e juaja rreth realizimit të këtyre projekteve janë të pranueshme për ne çdoherë” tha Begaj.

Nga ana tjetër znj.Catarina Camarioas prezantoi aktivitetet e UN-HABITAT-it që kanë rreth komunës së Malishevës e sidomos rreth këtyre projekteve si ai i Planit Zhvillimor Komunal-ku prezantoi përkrahjen që bën UN-HABITAT-i, pastaj prezantoi një projekt tjetër i cili pritet të filloj, e që është në bashkëpunim me shtetin e Estonisë, projekt ky që synon komponentët mjedisore, trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave.

Po ashtu, Begaj e Camarioas, diskutuan edhe rreth projektit për investime kapitale- projektit të lumit Mirusha, për korridorin e gjelbër, përmbledhjen e zhvillimeve të deritanishme dhe mundësit e vazhdimit të më tejshëm.

Funksionalizohet komiteti për shëndetësi

Malishevë, 28 maj

Komiteti për shëndetësi, mirëqenie sociale, familje të dëshmorëve, invalid dhe veteran të luftës, si dhe për persona me aftësi të kufizuara, organ jo obligativ i Kuvendit i Komunës, ka mbajtur sot mbledhjen e parë konstituive, ku ka zgjedhur kryesuesen e komitetit.

Me shumicë të votave, kryesuese e këtij komiteti u zgjodh anëtarja e Kuvendit të Komunës, nga radhët e IQM-së, znj.Arbëreshë Krasniqi, e cila do ta udhëheq këtë komitet në katër vitet e ardhshme.

Me rastin e zgjedhjes si kryesuese, znj.Krasniqi, tha se “ky komiteti është i rëndësishëm në raport me qytetarët dhe besoj që bashkërisht dhe me një përkushtim, do të arrijmë t’ia dalim”

Asfaltohen edhe tri rrugë në Bellanicë

Malishevë, 28 maj



Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore, në fshatin Bellanicë të Komunës së Malishevës, sot ka filluar asfaltimi i tri rrugëve brenda fshatit, duke i lidhur kështu lagjet e këtij fshati me rrugën kryesore. Fillimin e asfaltimit të këtyre rrugëve, e kanë parë nga afër, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizimit, z.Urim Kastrati.

Begaj e Kastrati, kanë parë nga afër punimet gjatë asfaltimit, dhe në të njëjtën kohë janë takuar me banorët e këtij fshati, të cilët i kanë uruar për rregullimin e rrugëve, duke ju lehtësuar edhe më shumë jetën e këtyre banorëve, pasi tani qarkullimin e kanë më të lehtë, pa baltë e pluhur.

Banorët e Bellanicës, e kanë falënderuar kryetarin Begaj dhe Komunën e Malishevës, për investimet që janë duke u bërë në fshatin Bellanicë, në infrastrukturën në përgjithësi.

Pas kësaj, kryetari Begaj dhe drejtori Kastrati, kanë inspektuar punimet edhe në rrugën Bellanicë-Bardh, e filluar ditë më parë.



Kryetari Begaj refuzon ftesën e AKP-së dhe kundërshton privatizimin e pronave

Malishevë, 29 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, përmes një shkrese drejtuar Agjencionit Kosovari të Privatizimit (AKP), ka refuzuar ftesën e saj, për pjesëmarrje në hapjen e ofertave të valës së gjashtëdhjetë të privatizimit dhe shitjen përmes likuidimit 26, dhe në të njëjtën kohë, edhe njëherë kryetari Begaj, ka shprehur kundërshtimin e fuqishëm për privatizimin e pronave bujqësore të qytetarëve të Malishevës.

“Ne çdo ditë kemi vërejtje dhe pakënaqësi të qytetarëve në lidhje me këtë proces dhe ne asnjëherë nuk kemi pasur qasje në këtë proces. Qytetarët e Malishevës, janë të bindur se kanë pronësi mbi ato prona, që ju tashmë i keni privatizuar dhe në ato që po i futni në procesin e privatizimit, përmes procedurës së likuidimit, andaj ne përkrahim parazervë kërkesat e ligjshme të qytetarëve të Komunës së Malishevës, për mosprivatizimin e pronave të tyre, të cilat ju morën në mënyrë të kundërligjshme nga pushteti jugosllav”, thuhet mes tjerash në shkresën e kryetarit Begaj, drejtuar AKP-së, ku kërkohet edhe ndihma e të gjitha institucioneve për ndërprerjen e këtyre padrejtësive ndaj qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Në vazhdim shkresa e plotë e Kryetarit të Malishevës, drejtuar AKP-së:



REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

REPUBLIC OF KOSOVO
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE

ACCEPTED ON: 28.05.2014
PRILUJENO:
Nr.No.Br. 01/990

Kryetari Komunës
Nr.01/_____
Datë: 27.05.2014

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Për: Agjensionin Kosovare të Privatizimit
Bordit të Drejtorëve të AKP-së.
Departamentit të Shitjes
z.Ramë Zagragaj

Kopje: Arkivit të komunës.

Lënda: Njoftim në lidhje me ftesën tuaj, të datës 23 maj 2014.

I nderuar z.Zagragaj,

Me anë të kësaj shkrese ju njoftojmë se, duke u bazuar në ftesën tuaj e cila mbanë datën 23 maj, 2014, për pjesëmarrjen në ceremoninë e hapjes së ofertave për valen e gjashtëdhjetë (60) të privatizimit dhe shitjen përmes Likuidimit 26, ne si përfaqësues të komunës së Malishevës, nuk do të marrim pjesë.

Njëkohësisht ne kundërshtojmë fuqishëm, këtë proces të privatizimit të pronave bujqësore të qytetarëve të komunës së Malishevës. Si e dini edhe ju të nderuar, ne kemi trashëguar probleme të shumta të pazgjidhura me këtë proces në lidhje me pronat bujqësore të cilat u privatizuan në një proces jo ligjor, (rastet e pronave bujqësore të banorëve të fshatrave Bellanicë, Banjë, Senik, Lladroc) të komunës së Malishevës.

Ne, çdo ditë kemi vërejtje dhe pakënaqësi në lidhje me këtë proces, nga qytetarët e komunës së Malishevës, edhe pse ne asnjëherë nuk patëm çasje në atë privatizim!

Qytetarët e Komunës së Malishevës, janë të bindur se kanë pronësinë mbi ato pronat, që tash më ju keni privatizuar si dhe në ato që ju po i futni në procesin e privatizimit përmes procedurës së Likuidimit, andaj ne përkrahim parzërvë kërkesat e ligjshme të qytetarëve të komunës së Malishevës, për mos privatizimin e pronave të tyre të cilat ju morën në mënyrë të kundërligjshme nga pushteti jugosllav.

Ne kërkojmë ndihmën e juaj dhe të gjitha institucioneve të shtetit që të ndërpriten këto padrejtësi ndaj qytetarëve të komunës së Malishevës.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj, ne mbesim të hapur për bashkëpunim, në emër të realizimit të së drejtës së shfrytëzimit të pronësisë në mënyrë të pa penguar nga qytetarët të cilët unë i përfaqësoj, e drejtë kjo e cila është e garantuar me të gjitha aktet ligjore të Republikës së Kosovës si dhe akteve tjera ndërkombëtare që e rregullojnë këtë lëmi.!

Me respekt,

Zyra e Kryetarit të Komunës në Malishevë



Begaj e Hulaj, biseduan për situatën nga thumbimi i rriqrave

Malishevë, 29 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha, kanë pritur sot drejtoreshën e Institutit Rajonal të Shëndet Publik në Prizren, znj.Nurishahe Hulaj, me të cilën kanë biseduar rreth situatës nga thumbimi i rriqrave dhe etheve hemorragjike krime kongo(EHKK), e ku u konstatua se kjo kohë është shumë e rrezikshme, për shkak të kushteve klimatike dhe për nevojën e vazhimit të spërkatjes, jo vetëm nga ajri, por edhe nga toka.

“Unë e falënderoj IRSHP-në për aktivitetet tuaj në vetëdijesimin dhe në kujdesin në raport me ethet hemorragjike, por kërkoj më shumë angazhim dhe nga ana e institucioneve qendrore, të cilat janë përgjegjëse direkte për menaxhimin e situatave të tilla”, ka thënë Begaj.

“Institutit Rajonal i Shëndetit Publik (IRSHP), është e gatshme të vazhdoj jo vetëm me vetëdijesimin e qytetarëve, por edhe për mbikëqyrjen e fushatave të spërkatjes, në veçanti nga toka, të të gjitha zonave endemike”, tha Hulaj.

Komisioni për emërtimin e rrugëve, takohet me kryetarët e fshatrave

Malishevë, 29 maj

Në kuadër të punës së tij, komisioni komunal për emërtimin e rrugëve në vendbanimet e Komunës së Malishevës, i ta takuar sot, të gjithë kryetarët e fshatrave të Komunës së Malishevës, të cilët i kanë njoftuar me procesin e emërtimit të rrugëve, rëndësinë e emërtimeve dhe kriteret për emërtimin e rrugëve, si një standard, i cili duhet të plotësohet, në kuadër të regjistrimit të adresave në territorin e Kosovës.

Fillimisht, nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, i ka përshëndetur kryetarët e fshatrave, e më pas ka folur për rëndësinë e emërtimit të rrugëve, si një lehtësim për regjistrimin e rrugëve dhe adresimin. Për këtë rëndësi dhe për punën e komisionit ka folur edhe kryetari i komisionit, z.Ahmet Rrahmanj, ndërsa për kriteret e emërtimit dhe për procesin e deritanishëm, ka folur anëtari i komisionit nga qeveria komunale, z.Driton Krasniqi.

Pas prezantimit të kriteret e emërimit të rrugëve dhe për procesin në tërësi, anëtarët e komisionit, janë përgjigjur në pyetjet dhe paqartësitë që janë shfaqur, para se kjo të kaloj në debat me qytetarët, pasi vet qytetarët e vendbanimeve, do të bëjnë emërtimin e rrugëve.

Fillimi i punës në teren, është paraparë pas përfundimit të procesit zgjedhor të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, pas datës 8 qershor, dhe takimet do të mbahen në të gjitha fshatrat, ku do të merren propozimet e vet banorëve të fshatrave, para se ato propozime të miratohen në Asamblenë Komunale.

Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e parë

Malishevë, 30 maj



Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevë, i formuar ditë më parë nga Kuvendi i Komunës dhe i udhëhequr kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e parë të punës, ku është biseduar me të gjithë anëtarët e këtij këshilli për organizimin e datës më të rëndësishme për Malishevën.

“Kryetari dhe Qeveria Komunale, do të jenë të angazhuar maksimalisht, gjatë këtyre ditëve, për organizimin sa më të mirë të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, ndërsa nga ju kërkoj që të jepni propozimet dhe mendimet e juaja, për formën e organizimit, për çmimet tradicionale dhe për çështje tjera që kanë të bëjnë me organizimin e kësaj date”, tha mes tjerash kryetari i Malishevës dhe kryetari i Këshillit Organizativ, z.Ragip Begaj.

Nga ana tjetër, të gjithë anëtarët e këtij këshilli, që ishin prezent në mbledhjen e parë, u dakorduan që të angazhohen maksimalisht, në mënyrë që organizimi të jetë sa më madhështor, për ditën më të shenjtë për Malishevën, ditë e cila lidhet me datën e rënies së dëshmorit të parë më 16 qershor 1998, ditën e çlirimit të Malishevës më 16 qershor 1999 dhe rënies së dëshmorit të fundit më 16 qershor 1999.

Ndërsa përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, tha se policia do të jetë e angazhuar dhe e përkushtuar që çdo gjë të shkojë mirë dhe të mos prishet atmosfera festive.

Anëtar të këshillit organizativ, janë: kryetari i Komunës së Malishevës, kryesuesi i KK të Malishevës, përfaqësues të partive politike, të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, shoqëria civile dhe Policia e Kosovës.

Qendra e Kompetencës shënon katër vjetorin e saj

Malishevë, 30 maj



Nënkryetari i Komunës së Malishevës z.Rexhep Mazreku, dhe përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit (DKA), morën pjesë në shënimin e ditës së shkollës së Qendrës së Kompetencës “ Abdyl Frashëri” në Malishevë, shkollë kjo që funksionon që katër vite me radhë.

Nënkryetari Mazreku , përcjelli urimet dhe përshëndetjet nga kryetari Begaj në pamundësi të i bashkëngjitet këtij shënimi, ku më pas në fjalën e tij tha, ”sot është një ditë e madhe për shkollat e komunës së Malishevës në përgjithësi, ndërsa për Qendrën e Kompetencës në veçanti, kjo shkollë ka një përvojë të shkurtër, dhe ka nevojë për mbështetje, nga strukturat përgjegjëse profesorët, intelektualët, arsimtarët, dhe natyrisht edhe drejtoria komunale si dhe ministria për arsim, për arsye se kërkohet angazhim dhe mobilizim në mënyrë që kjo shkollë të luaj rolin e saj, për çka edhe është themeluar”, tha Mazreku.

” Kjo shkollë është jashtëzakonisht mirë e pajisur, dhe unë do të kërkoja nga të gjithë punëtorët edhe nga ana e drejtorisë, që të përdoret në mënyrë të duhur, në mënyrë që të kemi rezultate të nxënësve dhe të ngritje të vazhdueshme” tha Mazreku me rastin e shënimit të katër vjetorit të kësaj shkolle.

Në mes tjerash Drejtori i Qendrës së Kompetencës z. Besim Dobruna falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe të gjitha bizneset që kontribuuan në këtë shkollë, ku dhe më pas së bashku me nënkryetarin e Komunës së Malishevës z.Rexhep Mazreku, kanë ndarë disa mirënjohje.

Pas kësaj, është hapur edhe panairi tradicional me ushqime tradicionale, që janë pjesë e demonstrimit të të arriturave nga ana e nxënësve, për prezantimin e produkteve, shitjes dhe shërbimit, nga ana e drejtimeve përkatëse.

Filloi ndërtimi i shkollës në Damanek

Malishevë, 30 maj



Sot, ka filluar ndërtimi i objektit të shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Ramadan Morina” në fshatin Damanek të Komunës së Malishevës. në vënien e gurë themelit të shkollës së re, ishin kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, me zyrtarët tjerë komunal, zyrtari i lartë i Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, z.Luc Faber dhe qytetarë të shumtë të fshatrave, Damanek, Bubël dhe

Qupevë, pasi kjo shkollë shërben për nxënësit e këtyre tri fshatrave.

“Jam shumë i kënaqur që po e ndaj gëzimin me juve banorë të Damanekut, Bublilit dhe Qupevës. Jam i kënaqur që po krijojmë kushte më të mira për arsimimin e fëmijëve, gjeneratave të reja. Nga ju mësueses kërkoj cilësi në mësimdhënie, për arsimimin e gjeneratave të reja “, ka thënë mes tjerash Kryetari i Komunës së Malishevës, në ceremoninë e vënies së gurë themelit të shkollës.

Ndërsa z.Luc Faber nga zyra e BE-së në Prishtinë, shprehi “kënaqësinë që po merr pjesë në fillimit e ndërtimit të shkollës”. “Kjo shkollë, është në mesin e 20 shkollave, që BE po ndërton në Kosovë, projekte të cilat janë nga viti i kaluar. Kosova është shtet me popullsinë më të re në Evropë dhe është e domosdoshme ndërtimi i shkollave, për ngritjen e cilësisë në arsimimin e breza të rinj, për krijimin e një mjedisi më të shëndosh për mësimdhënie dhe mësimnxënie”, tha zyrtari i lartë i zyrës së BE-së në Prishtinë, z.Faber.

Më pas, Begaj e Faber, kanë vënë gurë themelin në ndërtimin e objektit të ri për shkollën në fshatin Damanek, ku vijojnë mësimin nxënësit e tri fshatrave. Objekti i shkollës, do të jetë sipas standardeve evropiane dhe financohet nga Agjencioni Evropian. Shkolla ka një hapësirë prej 1500 metrash katrorë, ku parashihet të jetë dy katërshë, me dhjetë dhoma mësimi dhe e përcjellë me sallën e sporteve. Vlera e projektit është rreth një milion euro.

U ndërtua edhe një rrugë në Lumnishtë

Malishevë, 30 maj



Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore, në bazë të nevojave të vendbanimeve, ka përfunduar ndërtimi i një rrugë në fshatin Lumnishtë të Malishevës, dhe për këtë qëllim, sot, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizimit, z.Urim Kastrati, kanë vizituar sot Lumnishtën, saktësisht kanë qëndruar në rrugën e cila tashmë është asfaltuar, për ta parë nga

afër.

Me këtë rast, kryetari Begaj, i ka uruar banorët e lagjes, të cilët lëvizin në këtë rrugë, të cilëve, në veçanti fëmijëve, ju është lehtësuar qarkullimi nga shtëpitë e tyre, për në shkollën fshatit.

Kjo rrugë, lidh në lagje të Lumnishtës, me shkollën e fshatit, me dy shiritat kryesore të rrugëve dhe rrjedhimisht me rrugën e cila i dërgon drejt qendrës komunale të Malishevës. Kjo rrugë e gjatë mbi 500 metra.

Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e parë

Malishevë, 30 maj

Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevë, i formuar ditë më parë nga Kuvendi i Komunës dhe i udhëhequr kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e parë të punës, ku është biseduar me të gjithë anëtarët e këtij këshilli për organizimin e datës më të rëndësishme për Malishevën.



“Kryetari dhe Qeveria Komunale, do të jenë të angazhuar maksimalisht, gjatë këtyre ditëve, për organizimin sa më të mirë të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, ndërsa nga ju kërkoj që të jepni propozimet dhe mendimet e juaja, për formën e organizimit, për çmimet tradicionale dhe për çështje tjera që kanë të bëjnë me organizimin e kësaj date”, tha mes tjerash kryetari i Malishevës dhe kryetari i Këshillit Organizativ, z.Ragip Begaj.

Nga ana tjetër, të gjithë anëtarët e këtij këshilli, që ishin prezent në mbledhjen e parë, u dakorduan që të angazhohen maksimalisht, në mënyrë që organizimi të jetë sa më madhështor, për ditën më të shenjtë për Malishevën, ditë e cila lidhet me datën e rënies së dëshmorit të parë më 16 qershor 1998, ditën e çlirimit të Malishevës më 16 qershor 1999 dhe rënies së dëshmorit të fundit më 16 qershor 1999.

Ndërsa përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, tha se policia do të jetë e angazhuar dhe e përkushtuar që çdo gjë të shkoj mirë dhe të mos prishet atmosfera festive.

Anëtar të këshillit organizativ, janë: kryetari i Komunës së Malishevës, kryesuesi i KK të Malishevës, përfaqësues të partive politike, të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, shoqëria civile dhe Policia e Kosovës.

U zbulua memoriali për varrezat e veteranëve të UÇK-së

Malishevë, 31 maj



Sot në fshatin Carrallukë të Komunës së Malishevës, me iniciativë të veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga fshatrat Carrallukë, Tërpezë e Ulët dhe Shkarashnik, është ndarë një pjesë e veçantë e varrezave, për veteranët e luftës, si dhe sot, është ngritur një memorial, për këto varreza.

Në ceremoninë e zbulimit të memorialit, përveç veteranëve të luftës, morën pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me bashkëpunëtor dhe pjesëmarrës të shumtë, për nderuar veprën e veteranëve të luftës së UÇK-së.

“Kjo është një ditë e shenjtë, për njerëzit që kanë pasur vizion dhe ju kanë prirë proceseve për në luftën për lirinë e vendit. Kjo vepër e juaja, le të jetë një mësim edhe për vendet tjera, pasi veteranët e luftës, meritojnë respekt, meritojnë përkujdesje të veçantë dhe duhet të çmohet



vepra e tyre. Ky memorial, do të jetë një mësim, një histori për gjeneratat e reja”, tha mes tjerash kryetari Begaj, në fjalën e rastit.

“UÇK bëri luftë të shenjtë për lirin e popullit shqiptar të Kosovës dhe ky memorial është respekt për veprën e veteranëve të luftës”, tha z.Habib Zogaj, në emër të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së në Malishevë.

Ndërsa prof.Dr. Ramiz Hoti, në emër të veteranëve të luftës së fshatrave Carrallukë, Shkarashnik dhe Tërpezë e Ulët, foli për idenë e ndarjes së një pjese të varrezave për veteranët e luftës së UÇK-së dhe për ngritjen e memorialit për varrezat e veteranëve të luftës së UÇK-së.

Zbulimin e memorialit e bënë, Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, pastaj kryetari i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, dega në Malishevë, z.Enver J. Hoti dhe veterani i luftës së UÇK-së, z.Hazir Thaçi.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 127- Qershor 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë shënimit të 16 Qershorit- Ditës së Çlirimit dhe
Ditës së Dëshmorëve



Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, mbajti takimin e dytë

Malishevë, 2 qershor

Këshilli Organizativ, për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, i udhëhequr nga kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur takimin e dytë të radhës, ku është biseduar rreth organizimit të kësaj dite, me rëndësi për Malishevën.

Anëtarët e Këshillit Organizativ, të përbërë nga subjektet politike në Malishevë, shoqatat e dala nga lufta dhe OJQ-të lokale, kanë dhënë mendimet e tyre rreth organizimit, pastaj për çmimet tradicionale, që ndahen në këtë datë, sipas statutit të Komunës së Malishevës.

Takimi i ardhshëm i Këshillit Organizativ, do të mbahet pas dy dite.

U varros veterani i luftës Mazllum Krasniqi

Malishevë, 2 qershor

Me nderime nga të larta, u varros sot, veterani i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga fshati Drenovc, Mazllum Isuf Krasniqi, i cili dje ka ndërruar jetë në moshën pesëdhjetë vjeçare. Në ceremoninë e varrimit morën pjesë, qindra bashkëluftëtarë, bashkëvendës dhe familjar të të ndjerit, si dhe zyrtarët më të lartë komunal të Malishevës.

Në ceremoninë e varrimit, pasi paraprakisht u bënë homazhe, në shkollën e fshatit, për jetën dhe veprimtarin ushtarakë në UÇK të Mazllum Krasniqit, foli, Enver J. Hoti, në emër të Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dega në Malishevë.

Ndërsa në emër të Komunës së Malishevës, ngushëllime për familjen dhe bashkëluftëtarët, shprehi i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj.

Asfaltohet rruga e Fshatit të Ri

Malishevë, 3 qershor



Sot ka filluar asfaltimi i rrugës së fshatit në Fshat të Ri, të Komunës së Malishevës, fshat i cili renditet prej vendbanimeve më të largëta në raport me qendrën komunale. Në fillimin e asfaltimit të rrugës, mori pjesë edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili i uroi banorët e këtij fshati në Malet e Berishës.

“Unë ju uroj juve rregullimin dhe asfaltimin e rrugës, dhe uroj ta gëzoni këtë rrugë, e cila juve ju ndihmon në qarkullimin tuaj drejt fshatrave përreth dhe qendrës komunale. Po ashtu kjo rrugë, përveç që ju ndihmon në kohë, ju ndihmon edhe në amortizimin e makinave dhe rrjedhimisht ju zvogëlohen edhe shpenzimet”, ju ka thënë mes tjerash Begaj, banorëve të këtij fshati.

Nga ana tjetër, banorët nga Fshati i Ri, falënderuan komunën dhe kryetarin Begaj, për ndërtimin e rrugës, gati dy kilometërshe, rrugë e cila i ndihmon në qarkullimin e tyre.

Ndërtimi dhe asfaltimi i kësaj rruge, gjithashtu pengon edhe largimin e banorëve nga trojet e tyre, pasi shumë banorë deri më tani, për shkak të rrugës dhe largësisë me qendrën komunale, kanë lëshuar trojet e tyre.

Rruga brenda Fshatit të Ri, ndihmon edhe në zhvillimin e turizmit në Malet e Berishës, pasi ky vend njihet për ajrin e pastër, lartësinë mbidetare dhe peizazhin e mrekullueshëm, si dhe ky vendbanim njihet edhe për vlerat e saja historike gjatë luftës së fundit të UÇK-së, si vend i Radio Kosovaelirë dhe agjencia e lajmeve Kosovapress, vendqëndrimet e pjesëtarëve të UÇK-së dhe të tjera.

KO për shënimin e 16 Qershorit, caktoi agjendën

Malishevë, 4 qershor



Këshilli Organizativ, për shënimin dhe kremtimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, i udhëhequr nga kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot takimin e tretë të radhës, ku është diskutuar për agjendën e shënimit të kësaj date me rëndësi për Komunën e Malishevës.

Këshilli Organizativ, sot në mbledhjen e tretë, ka diskutuar rreth agjendës për shënimin e 16 Qershorit, ku kanë përcaktuar agjendën, në të cilën përfshihen nderimet dhe homazhet tek varrezat e dëshmorëve dhe vendet tjera me rëndësi, pastaj takimin qendrorë dhe aktivitetet tjera që parashihen të mbahen më 16 qershor.

Të gjitha këtyre aktiviteteve, do t'iu paraprijnë aktivitete të tjera kulturore dhe sportive, që pritet të përfundojnë deri më 16 qershor.

Filloi asfaltimi i rrugës Bardh-Bellanicë

Malishevë, 4 qershor

Sot ka filluar asfaltimi i rrugës e cila i lidhë një lagje të fshatit Bardh me fshatin Bellanicë dhe me rrugën kryesore, për në qendrën komunale. Në fillimin e shtrimit të asfaltit në këtë rrugë, mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizimit, z.Urim Kastrati.

“Unë ju përgëzoj juve për rrugën, e cila është zgjeruar dhe sot po asfaltohet, e cila realisht ka rëndësi jetike për banorët e kësaj lagje në Bardh, por edhe për banorët e një pjese të Bellanicës”, ju ka thënë kryetari Begaj, banorëve të këtyre fshatrave.



Kjo rrugë, shkurton dhe lehtëson lëvizjen e këtyre lagjeve, me qendrën e Bellanicës dhe lidhjen me shiritin kryesor të rrugës, që lidhet me qendrën komunale. Deri më tani këto lagje, kanë kaluar nëpër këtë rrugë të ngushtë, të pa rregulluar dhe qarkullimi i banorëve ka qenë i vështirësuar, sidomos gjatë kohës së reshjeve atmosferike.

Kjo rrugë është e gjatë 1750 metra me gjerësi katër metra. Ndërtimi i rrugës, ku përfshihet edhe një urë e vogël, u mundësua nga buxheti komunal i Malishevës. Punëkryes është kompani “Jehona”.

Begaj, priti kolonelin turk Topaloğlu

Malishevë, 4 qershor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot, komandantin e Detashmentit të Përbashkët Rajonal të Jugut (JRD) të KFOR-it, kolonelin Zorlu Topaloğlu, me të cilin për situatën e përgjithshme në Malishevë diskutuan për situatën e sigurisë, situatën me ethet hemorragjike dhe çështje të tjera me rëndësi që kanë të bëjnë me Malishevën.



Kryetari Begaj e ka njoftuar komandantin e JRD-së, kolonelin Topaloğlu me situatën e përgjithshme në Malishevë, e ku të dytë, u pajtuan se situata e sigurisë në Komunën e

Malishevës, është e qetë dhe stabile. Edhe fushata elektorale, në aspektin e sigurisë së përgjithshme, u vlerësua e mirë, pa incidente.

Më pas, kryetari Begaj, e njoftoi ushtarakun turk, edhe me situatën epidemiologjike në Komunën e Malishevës, sa i përket etheve hemorragjike, krime kongo (EHKK), e njoftoi me angazhimin e komunës në këtë drejtim, pastaj me numrin e të infektuarve, ku sipas të dhënave, deri më tani, gjatë këtij viti janë infektuar dy persona, por për fatin e mirë të tyre, të dytë janë jashtë rrezikut për jetë.

Begaj e Topaloğlu, biseduan edhe për bashkëpunimin mes Komunës së Malishevës dhe KFOR-it, bashkëpunim i cili u vlerësua i mirë.

Filloi asfaltimi i një rruge në fshatin Turjakë

Malishevë, 5 qershor



Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës në Komunën e Malishevës dhe krijimit të kushteve më të mira për jetë, sot ka filluar asfaltimi i një rruge në fshatin Turjakë, përkatësisht rruga e lagjes së Kajtazëve, e gjatë rreth tetëqind metra, rrugë e cila e lidhë këtë lagje me pjesën tjetër të fshatit dhe me shiritin kryesor të rrugës që e lidh fshatin me qendrën komunale.

Në fillimin e punimeve të kësaj rruge, mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtorët komunal, me ç'rast i ka uruar banorët e kësaj lagje për rrugën e re, si dhe qëllim i vizitës ishte vëzhgimi nga afër i kryerjes së punimeve.

Edhe kjo rrugë, sikur edhe të tjerat që janë duke u ndërtuar, po realizohen nga buxheti komunal i Komunës së Malishevës.

Komuna e Malishevës, nga fillimi i këtij viti dhe muajt në vazhdim, është duke realizuar shumë projekte që lidhen me infrastrukturën në përgjithësi, si atë rrugore, kanalizime, ujësjellës, pastaj investime në objektet shkollore dhe në fusha tjera, investime të cilat ndikojnë në krijimin e mirëqenies më të mirë të qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Kryetari priti palët

Malishevë, 6 maj

Kryetari Begaj, hapi dyert për qytetarët e Malishevës, si edhe çdo të premtë tjetër, ku i dëgjoi hallet dhe problemet me të cilat qytetarët e Malishevës po ballafaqohen, dhe për të ju dhënë ndihmë dhe këshillat e nevojshme në zgjedhjen e këtyre problemeve.

Ajo çka e preokupon qytetarin e Malishevës më së shumti janë çështjet, çështjet socio-ekonomike, ndërsa problemi me infrastrukturë veç është në përmirësim të vazhdueshëm pasi që Kryetari Begaj dhe qeveria komunale, janë të angazhuar në rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme në Malishevë.

Kryetari Begaj, ju ofroj mbështetjen e institucionit të kryetarit dhe u premtoj atyre ndihmën në ballafaqimet me problemet dhe shqetësimet të cilat i shprehën para tij në takimet e sodit

Filloi asfaltimi edhe i një rruge në Gurbardh

Malishevë, 7 qershor

Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore në fshatrat e Komunës së Malishevës, sot ka filluar asfaltimi edhe i një rruge në fshatin Gurbardh, rrugë e cila i ndihmon banorët e këtij fshati, të qarkullojnë më lehtë dhe më shpejt.

Rruga e cila sot është asfaltuar është e gjatë rreth 600 metra dhe financohet nga buxheti komunal i Malishevës.

Edhe kjo rrugë, është në mesin shumë rrugëve, nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës, që janë duke u ndërtuar dhe asfaltuar, duke e krijuar kështu një infrastrukturë më të mirë në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës.



Pas përfundimit të ndërtimit të rrugëve kryesore, në të gjitha fshatrat e Komunës së Malishevës, tani po rregullohen edhe rrugët brenda vendbanimeve, duke i lidhur kështu të gjitha lagjet me rrugët kryesore.

Punëtorët e kompanisë “Beni” ankohen të kryetari, pasi nuk kanë marrë pagat e muajit të kaluar

Malishevë, 9 maj



Punëtorët e kompanisë së shërbimit të pastrimit “Beni”, e cila merret me mirëmbajtjen e objektit të komunës dhe QKMF-së, janë ankuar sot të kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, për siç thanë, mos pagesën e pagave në formë të rregullt, nga ana e kompanisë. Punëtorët e kësaj kompanie, janë ankuar dhe kanë kërkuar mbështetjen e

kryetarit, që të ushtroj autoritetin e tij, tek kompania, e cila ka kontratë me komunën, për mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Kryetari Begaj ju ofroi mbështetjen e tij morale, për punëtorët. “Unë jam i interesuar që të zgjidhet ky problem, mirëpo nuk kam mundësi të ndërhyrjes tek kompania, por ju mbështes në të drejtën e juaj, për marrjen e pagave, ashtu siç parashihet me ligj”, tha mes tjerash Begaj në takim me punëtorët e kësaj kompanie.

Sipas 13 punëtorëve të kësaj kompanie, të cilët ishin sot në zyrën e kryetarit, kompania “Beni” nga Suhareka, nuk bën kryerjen e obligimeve në raport me punëtorët, duke mos ju dhënë në formë të rregullt pagat mujore, por me vonesa të mëdha, ndërsa gjendja sociale e këtyre punëtorëve, është e rëndë.

KO për 16 Qershorin, mbajti takimin e radhës

Malishevë, 10 qershor

Këshilli Organizativ, për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, i kryesuar nga kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur takimin e radhës së këshillit, ku janë njoftuar me përgatitjet e deritanishme, për shënimin e 16 Qershorit në Malishevë.

Në këtë mbledhje, u njoftua edhe për agjendën e planifikuar për datën 16 qershor, ku parashihen të mbahen: një mbledhje solemne e Kuvendit të Komunës së Malishevës, pastaj nderime dhe homazhe pranë Shtatores së Komandantit Legjendar të UÇK-së në “Sheshin e dëshmorëve” në Malishevë dhe plakës me emrat e dëshmorëve të Komunës së Malishevës, për të vazhduar me homazhe tek varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë.

Pas këtyre, në mesditë, parashihet të mbahet Akademia solemne, apo manifestimi qendror në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, ndërsa pasdite parashihet një koncert i madh në parkun e qytetit në Malishevë, që do të zgjas deri në orët e vona.

Të gjitha këtyre aktiviteteteve, gjatë tërë javës, ju paraprijnë aktivitete të planifikuara nga drejtoria komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, si në sport dhe kulturë, ku parashihen, ndarja e çmimeve në kulturë, ekspozita, turne të ndryshme në sport, një ndeshje miqësore në basketboll, shfaqje filmi, pastaj shfaqje teatrale për fëmijë, ekspozita të ndryshme, dhe aktivitete tjera.

KK i Malishevës, vendosi për çmimet tradicionale të 16 Qershorit

Malishevë, 11 qershor



Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur sot, e ku u trajtua vetëm një pikë, vendosi për ndarjen e çmimeve tradicionale, të cilat sipas statutit të Komunës së Malishevës, jepen për trimëri e heroizëm, për kontribut në arsim dhe kontribut në shëndetësi, ndërsa çmimet mbajnë emrat e figurave të njohura nga Malisheva.

Për çmimin për trimëri dhe heroizëm “Imer Krasniqi”, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ja ndanë veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Selman Hoti nga Carralluka dhe Habib Zogaj nga Turjaka.



Çmimin për kontribut në fushën e arsimit “Hamdi Berisha”, KK vendosi ti nderoj mësuesin Qerim Krasniqi-post mortum nga Drenoci dhe profesorin Qemajl Morina nga Astrazupi.

Çmimin për kontribut në shëndetësi, KK i Malishevës e ndau për Sanije Deskun nga Malisheva dhe Milazim Kryeziu nga Bubaveci.

Ndarja solemne e çmimeve bëhet me 16 Qershor, me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Kryetari Begaj priti monitoruesit e BE-së për zgjedhjet

Malishevë, 12 qershor

Kryetari i Komunës së Malishevës z. Ragip Begaj, priti në zyrën e tij monitoruesit e BE-së të cilët kanë monitoruar procesin e zgjedhjeve në territorin e Komunës së Malishevës, ku dhe biseduan rreth mbarëvajtjes së zgjedhjeve se si kanë rrjedhur në Malishevë, e ku u vlerësua se procesi ka shkuar mirë.

Kryetari Begaj me këtë rast, tha se “ unë çka kisha kërkuar rreth zgjedhjeve në të ardhmen është që personat të cilët nuk jetojnë më, të largohen nga lista e votuesve dhe mos të jemi ë vendi që të ketë sa banor aq edhe votues, ngase kjo është e pamundur, dhe gjithsesi që duhet të përmirësohet.”

Kryetari Begaj i falënderoi për bashkëpunimin monitoruesit e BE-së që kanë vëzhguar dhe monitoruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në Malishevë.

U mbajt testi i maturës në Malishevë

Malishevë, 14 qershor

Më shumë se 940 maturant malishevas, sot i janë nënshtruar testit të maturës. Gjatë zhvillimit të testit të maturës, i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqërar nga drejtori i arsimit z.Blerim Thaçi dhe kryetari i komitetit për arsim, z.Januz Kastrati, i kanë vizituar qendrat e mbajtjes së maturës, ku ju kanë dëshiruar suksese nxënësve.



“Kam ardhur vetëm t’ju shikoj dhe t’ju uroj shumë suksese të gjithëve që i jeni nënshtruar testit të maturës. Uroj që ta përfundoni me sukses, të tregoni rezultate të mira dhe ju dëshiroj shumë suksese në të ardhmen” ju ka thënë Begaj maturantëve malishevas.

Begaj, Thaçi e Kastrati, gjatë vizitës në të gjitha qendrat e mbajtjes së testit të maturës, kanë biseduar edhe me personelin e angazhuar, ku janë interesuar për mbarëvajtjen e testit të maturës.

Sot u zhvilluan disa aktivitete për në kuadër të shënimit të 16 Qershorit

Malishevë, 14 qershor

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës, sot janë zhvilluar disa aktivitete kulturore dhe sportive. Sot është hapur edhe ekspozita e pikturës në kuadër të aktiviteteve kulturore, si dhe janë shpallur fituesit e konkursit artistik, ndërsa në orët e pasdites, është shfaqur edhe filmi “Heroi”.



Në hapjen e ekspozitës, e ku mori pjesë edhe kryetari Begaj, i uroi artistët që kanë marrë pjesë në këtë ekspozitë nga të gjitha viset e Kosovës. “Piktura flet vet, ajo e shpreh më së miri atë çfarë ju si artist e thoni, mua më mbetet vetëm t’ju dëshiroj suksese në karrigen e juaj si artist, ndërsa të gjithë qytetarëve të Malishevës, ju uroj ditën e çlirimit”, tha mes tjerash kryetari Begaj.

Më pas juria e përbërë nga Mehmet Kryeziu, Mehdi Krasniqi dhe Fatos Kabashi, bën publike edhe rezultatet e konkursit artistik. Sipas jurisë, në poezi, vendi i parë i takoi shifrës “Shkoza R”, i dyti shifrës “Sh.A.Jasahri” dhe vendi i tretë shifrës “Loti i Vajzërisë”. Në pikturë vendi i pari i takoi Agron Kastratit, i dyti Avni Rexhepit dhe vendi i tretë Merita Krasniqit. Në këngë, vendi i parë i takoi Beqir Telakut, i dyti Sinan Gashit dhe i treti Murat Berishës.

Vazhdojnë aktivitetet në kuadër të shënimeve për 16 Qershorin

Malishevë, 15 qershor



Në kuadër të shënimeve për 16 Qershorin, Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, po vazhdojnë aktivitetet e ndryshme, të organizuara nga Komuna e Malishevës. Sot janë zhvilluar disa aktivitete sportive dhe kulturore, si shfaqje teatrale dhe gara të ndryshme sportive, përfshi edhe ndeshjen miqësore në basketboll, mes KB “Malisheva” dhe KB “Ylli” nga Suhareka.

Sot në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani”, ka dhënë një shfaqje për fëmijë, teatri i kukullave “Dodona”.

Ndërsa kanë vazhduara garat në sport, ku janë mbajtur finalët në volejboll për meshkuj dhe në futboll të vogël.

Po ashtu gjatë ditës së sotme, është zhvilluar edhe një ndeshje miqësore në basketboll, mes KB “Malisheva” dhe KB “Ylli” nga Suhareka, në kuadër të vazhimit të bashkëpunimit mes dy komunave.

Malisheva po shënon Ditën e Çlirimit

Malishevë, 16 qershor

Komuna e Malishevës, përmes aktiviteteve të ndryshme, sot po shënon 16 Qershorin- Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve. Fillimisht, është mbajtur një seancë solemne e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ndërsa më pas janë bërë nderime pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, për të vazhduar me nderime dhe homazhe në varrezat e Brigadës 122 në Malishevë dhe të Brigadës 121 në Kleçkë dhe më pas janë bërë nderime dhe homazhe në Prekaz.





Aktiviteti qendror, është mbajtur në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, ku është mbajtur një akademi solemne, si dhe janë dhënë çmimet tradicionale. Sipas vendimit të KK të Malishevës, çmimin “Imer Krasniqi” për trimëri dhe heroizëm, ju nda veteranëve të luftës Selman Hoti dhe Habib Zogaj, të propozuar nga shoqata e veteranëve të UÇK-së në Malishevë, pastaj çmimi “Hamdi Berisha” për kontributin e dhënë në arsim, ju nda i Qerim Krasniqit-post mortum dhe profesorit Qemajl Morina . Ndërsa çmimi i tretë “Shpëtim Robaj” e që jepet për kontribut në shëndetësi, ju nda Sanije Desku dhe Milazim Kryeziu.

Aktivitetet e ditës së sotme, do të përfundojnë me një koncert në sheshin kryesor të Malishevës, e ku pritet për marrin pjesë artist të shumtë nga estrada jonë.

Në vazhdim fjalimi i kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, mbajtur në Akademinë Solemne me rastin e shënimit të 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Malishevës.

Të nderuar të pranishëm.

E kthejmë kujtesën pesëmbëdhjetë vite pas nga momenti që po e përjetojmë sot, kujtojmë që atëbotë Kosova në përgjithësi e Malisheva në veçanti ishte në luftë.

Këtu ishte pushtuesi serb që me gjithë aparaturën shtetërore po bënte terror dhe gjenocid të paparë, duke djegur e shkatërruar, duke vrarë e masakruar njerëz të moshave dhe gjinive të ndryshme pa dallim, burrat po ndaheshin nga gratë, nënave po ju merrnin fëmijët nga duart, populli po depërtohej dhunshëm, Kosova po zbrazej, e tëra ishte në flake. Ky ishte realiteti i ndodhur atë kohë, nuk është teori, nuk është tregim i sajuar, por realitet të cilin e kanë përjetuar nënat, etërit, motrat, vëllezërit e fëmijët tanë.

Në këto momente shumë të vështira, populli jonë vuajtjen e kishte shndërruar në forcë, dhimbjen kishte vendosur ta kthente në krenari, duke ju rezistuar denjësisht të gjitha mundimeve.

Shpresa dhe mbështetja e popullit ishte e përqendruar tek Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Kushtrimi i Komandantit Legjendar, Adem Jashari, jehona e luftës për liri, bëri që djem dhe vajza ti përgjigjeshin këtij kushtrimi dhe i ngjeshën radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Të nderuar të pranishëm, nuk ka e as nuk mund të ketë moment më historik dhe më fisnik se sa momenti kur është veshur uniforma e UÇK-së, dhe kur është ngjeshur arma në krah e për tu drejtuar në frontin e luftës.

Guximi i shfaqur, heroizmi i treguar i pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është vepër unike dhe në saje të këtij guximi, heroizmi dhe gatishmërisë për flijim, sot jemi këtu duke e shënuar Ditën e Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Ju, familjarë të dëshmorëve, krenohuni me bijtë dhe bijat tuaja që i rritët, i shkolluat dhe i përgatitët që ata ti dalin zot atdheut.



Ju, veteran dhe invalid të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të jeni krenarë gjatë gjithë jetës, për faktin se e keni kryer misionin e juaj duke dhënë gjithçka nga vetja e juaj, duke i dhënë edhe gjymtyrët e trupit, vetëm e vetëm që ky popull të shijoj lirinë, që ky vend të frymoj lirshëm pas okupimit shekullor.

Sot, ne bartësit e funksioneve në institucionet publike, frymojmë, punojmë dhe angazhohemi drejtë sendërtimit të idealit të dëshmorëve.

Sot, kur po e shënojmë këtë ditë festive, jemi krenar për të arriturat, dhe marrim obligim dhe zotohemi për përgjegjësi në punë dhe të ecim me hapa të sigurt drejt të ardhmes prosperuese për brezat e tashëm dhe të ardhshëm.

Urime për këtë ditë të shënuar, urime për të gjitha të arriturat dhe gjithë të mirat, njëkohësisht faleminderit që ishit prezent sot këtu me ne.

Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 17 qershor

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi z.Enver Hoti, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të saj, ku janë trajtuar pikat për rendin e ditës për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e ku dominojnë pikat nga mbledhja e fundit e ndërprerë.

Anëtarët e KPF-së, kanë miratuar shumicën e pikave që ishin të parapara për diskutim në mbledhjen e kaluar të KK të Malishevës, mbledhje e cila ishte ndërprerë, pasi anëtarët e KK, kërkojnë që MAPL t'ju jap sqarime për statusin e tyre si anëtar të asamblesë komunale dhe kërkojnë rritjen e pagave, krahas rritjes që është bërë nivelin lokal, në të gjitha sektorët, përfshi edhe stafin politik.

Për mbledhjen e ardhshme, pikë e re e rendit të ditës do të jetë, edhe miratimi i planit të punës së komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport, ndërsa nuk kaloi për shqyrtim në KK, qarkorja e parë buxhetore, për kornizën buxhetore afatmesme 2015-2017.

Komiteti për komunitete takoi komandën e stacionit policor në Malishevë

Malishevë, 17 qershor



Anëtarët e Komitetit për Komunitete, Fatmir Ademaj, kryesues, Luan Kryeziu dhe Arlinda Thaçi, anëtar, kanë takuar sot komandantin e stacionit policor në Malishevë, Halil Morina dhe zëvendëskomandantin Bekim Begaj, me të cilët biseduar për çështje të ndryshme, lidhur me komunitetet, sigurinë dhe bashkëpunimin e ndërsjellë mes këtij komiteti dhe Policisë së Kosovës.

Sipas kryesuesit të Komitetit për Komunitet, Fatmir Ademaj, ky takim, është në kuadër të planit të punës së komitetit, ndërsa interes si komitetit është siguria e përgjithshme në Komunën e Malishevës dhe e komuniteteve të caktuara në veçanti.

Sipas komandantit Morina, në Komunën e Malishevës, pavarësisht se numri i komuniteteve pakicë është i vogël, asnjë rast nuk është i regjistruar që ka të bëjë me incidente ndëretnike, ndërsa siguria e përgjithshme, është shumë e mirë, stabile dhe pa tendencë të prishjes së sigurisë së përgjithshme.

Morina tha se “bashkëpunimi me të gjitha institucionet është shumë i mirë, por rritja e bashkëpunimit edhe me komitetin për komunitete, do ti ndihmonte këtij funksionimi të mirë edhe me sektorët e caktuar”.

Më pas u bisedua për çështje të ndryshme, për bashkëpunim të ndërsjellë mes Komitetit për Komunitete dhe Policisë së Kosovës.

Ka filluar dezinfektimi i stallave

Malishevë, 18 qershor

Në kuadër të strategjisë për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike “krime kongo” (EHKK), sot në fshatrat e Komunës së Malishevës, ka filluar dezinfektimi dhe derratizimi i stallave, si njëra prej masave parandaluese, për mbrojtje nga thumbimi i rriqrave dhe prekja nga virusi i etheve hemorragjike.



Dezinfektimi i stallave, sipas drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, po bëhet në bashkëpunim me Agjencionin e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës (AVUK), ndërsa këtë fushatë është duke e kryer kompania “Ala-Co”.

Dezinfektimi i stallave ka filluar sot në fshatin Shkozë dhe do të vazhdoj në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës.

Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e KFOR-it zviceran (LMT)

Malishevë, 18 qershor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj ka pritur sot në zyrën e tij përfaqësuesin e KFOR-it zviceran (LMT), kapitenin Rüst Gaudenz, me të cilin biseduan rreth bashkëpunimit të ndërsjellët në fushën e sigurisë, si dhe aspekte tjera të përgjithshme rreth fushës së sigurisë në Malishevë.

Kryetari Begaj, i falënderoi për bashkëpunimin që kanë njësisë e KFOR-it, LMT me komunën e Malishevës. ”Jeni të mirëseardhur çdoherë, mund të them se dhe ju jetojmë në një komunë në një shtëpi, dhe misioni juaj është i dobishëm për ne, si dhe vet prezenca juaj këtu është e mjaftueshme ” i tha Begaj përfaqësuesit të LMT-së.

Gjendja e sigurisë së përgjithshme, si nga ana e KFOR-it (LMT), po ashtu edhe nga Kryetari Begaj u vlerësua e qetë në komunë dhe pa incidente të cilat mund ta prishin sigurinë e përgjithshme në Komunën e Malishevë, Kryetari Begaj u shpreh i gatshëm për bashkëpunim të më tejshëm me KFOR-in (LMT).

U mbajt punëtorja “Të drejtat e viktimave në sistemin e drejtësisë”

Malishevë, 20 Qershor

Sot, së sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Malishevës, organizuar nga ATRC, u mbajt punëtorja me temën, “Të drejtat e viktimave në sistemin e drejtësisë”. Panelistë në këtë punëtori ishin: Ganimete Kitmiri nga Zyra për mbrojtjen e viktimave në Prizren Halime Bytyçi nga Policia e Kosovës dhe Lutfi Shala, gjyqtarë.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte, vetëdijesimi i publikut për të Drejtat e Viktimave në Sistemin e Drejtësisë, për mekanizmat që luajnë rol të rëndësishëm për mbrojtjen e Viktimave të Krimin, dhe prezantimi i mekanizmave të ankesave kundër zyrtarëve, që shkelin përgjegjësitë e tyre për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve.

Panelistët e kësaj punëtorie, janë përgjigjur në pyetjet e pjesëmarrësve, si dhe kanë shpjeguar për rolin dhe punën e tyre në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimin, brenda sistemit të drejtësisë në vend.

“Tourtaste-Turizimi dhe Shija” prezantohet në Malishevë me ushqimet tradicionale

Malishevë, 20 qershor

Sot në Malishevë, në kuadër të projektit “Tourtaste- Turizmi dhe Shija” ka prezantuar ushqimet tradicionale shqiptare, me qëllim të promovimit të turizmit dhe ushqimeve tona tradicionale, si një segment për zhvillimin e turizmit në vendi tonë. Ky projekt qëllim ka zhvillimin e gastronomisë në rajonin e jugut.



“Kjo është pjesë e traditës sonë. Janë ushqime të shëndetshme, natyrale, janë ushqime të cilat i kanë gatuar gjyshet dhe nënat tona, andaj, jo vetëm ti shijoni sot këtu, por kultivoni këto gatime të shëndetshme dhe natyrale, pasi janë edhe pjesë e trashëgimisë sonë të gatimit”, tha i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në këtë prezantim të ushqimeve tradicionale.

Projektin “Tourtaste-turizmi dhe shija” e financon Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ndërsa objektivi i projekti, është zhvillimi i gastronomisë në rajonin e jugut.



Vazhdon spërkatja kundër rriqrave në Llapqevë

Malishevë, 23 qershor

*P*as përmirësimit të kushteve atmosferike, sot vazhdohet me fushatën e spërkatjes kundër rriqrave. Gjatë paradites së sotme, do të përfundoj spërkatja selektive në Mirushë dhe do të vazhdohet me spërkatjen në Llapqevë.

Kështu ka njoftuar sot, drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina. “Kushtet atmosferike e kanë ndërprerë për disa ditë fushatën e spërkatjes së zonave endemike, por me ndërprerjen e shirave, sot vazhdon kjo fushatë e spërkatjes”, ka bërë të ditur Morina.

Spërkatja selektive e zonave endemike, bëhet në kuadër të luftimit dhe parandalimit të etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), ndërsa rriqrat janë bartësit kryesor të këtij virusi.

Situata me ethe hemorragjike e qetë dhe nën kontroll

Malishevë, 23 qershor

Situata epidemiologjike me ethe hemorragjike krime kongo (EHKK), aktualisht është e qetë dhe nën kontroll. Kështu u bë e ditur sot në mbledhjen e rregullt të këshillit të drejtorëve, ku drejtorët komunal raportuan para kryetarit të komunës, z.Ragip Begaj, për punën e tyre gjatë javës së kaluar dhe planet për javën në vijim.

Drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, tha se “gjendja me EHKK, aktualisht është e qetë dhe nga tri rastet e deritanishme të konfirmuara si pozitive, gjendja e tyre është e mirë, ku dy prej tyre tashmë janë në shtëpi dhe një tjetër në përfundim të trajtimit mjekësor dhe në gjendje shumë të mirë”.

Ndërsa drejtori për mbrojtje dhe shpëtim, z.Ahmet Morina, tha se “po vazhdon spërkatja kundër rriqrave, si dhe spërkatja e stallave, ku deri më tani janë dezinfektuar mbi 250 stalla”.

Edhe drejtorët tjerë, raportuan mbi punën dhe aktivitetet e tyre, në realizimin e projekteve kapitale dhe përgatitjeve për projektet tjera. Po ashtu, është shtruar nevoja edhe për marrjen e masave për përgatitjen e shkollave për vitin e ardhshëm shkollor.

Realizmi i projekteve dhe obligimet në raport me qytetarët për kryerjen e shërbimeve më të mira për qytetar, janë arsyet që kryetari Begaj, kërkoi nga drejtorët, që të shtohet edhe më shumë disiplina dhe efikasiteti në punë.

Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e radhës

Malishevë, 23 qershor

Komiteti për Komunitete, sot ka mbajtur mbledhjen e saj të rregullt. Në këtë mbledhje u bisedua dhe njoftuan për çështje të ndryshme të natyrës për punën e deritanishme të këtij komitetit dhe për aktivitetet në vazhdim.

Kryesuesi i këtij komiteti, z.Fatmir Ademaj, njoftoi anëtarët e komiteti për vizitën në stacionin policor, ku sipas tyre, “gjendja e sigurisë së përgjithshme në Malishevë është vlerësuar e qetë dhe pa incidente”.

Komiteti për Komunitete, dha një rekomandim për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, lidhur me rrezikun nga qentë endacak dhe nevojën për hapjen e strehimores për qentë dhe mace.

Punimet në ujësjellësin e Drenocit po vazhdojnë sipas planit

Malishevë, 24 qershor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune, përfaqësuesin e IRD-së, z.Azem Kastratin, me të cilin kanë biseduar për ecurinë e punimeve në ndërtimin e ujësjellësit në fshatin Drenoc, ku u vlerësua se punimet po ecin sipas planifikimit dhe shumë shpejt pritet edhe përfundimi i ndërtimit të ujësjellësit.



Sipas Kastratit, punimet janë duke shkuar shumë mirë, dhe deri më tani është ndërtuar rreth shtatëdhjetë përqind e ujësjellësit në këtë fazë, të shpërndarjes së rrjetit të ujësjellësit brenda fshatit, ndërsa punimet janë zhvilluar sipas planit të paraparë.

Ndërsa kryetari i Komunës, z.Begaj, tha se “edhe komuna të gjitha obligimet e saj gjithashtu i ka kryer dhe do të bëjë çdo gjë që ka nevojë, për lidhjen sa më të shpejt të fshatit Drenoc, me sistemin e ujësjellësit”.

IRD, është implementuese e programit të USAID-it, në këtë fushë të investimeve dhe në bashkëfinancim me Komunën e Malishevës, janë duke e ndërtuar rrjetin e ujësjellësit në fshatin Drenoc.

Komuna ndihmon bletarët vendas

Malishevë, 24 qershor

Drejtoria për Bujqësi e Pylltari dhe Zhvillim Rural (BPZHR) në Komunën e Malishevës, në mesin shumë investimeve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, sot për herë të parë ka ndihmuar edhe sektorin e bletarisë, me mjete konkretizuese. Shuma e ndarë e mjeteve për këtë sektor është në vlerë prej 9700 euro.

Në këtë ceremoni të organizuar nga Drejtoria për Bujqësi e Pylltari dhe Zhvillim Rural (BPZHR), morën pjesë disa nga bletarët të cilët u falënderuan nga drejtori i BPZHR, z.Hajrullah Mazreku, ku në fjalën e tij ai tha, "ne kemi vendosur që këtë vit të përkrahim edhe këtë sektor dhe kemi ndarë 9700 euro, dhe shpresojmë që sa do pak po ju ndihmojmë me këto mjete, për nevojat e juaja në punën e bletarisë, ngase jeni me një sektor shumë profitabil, dhe në vitin e ardhshëm do të keni përkrahje edhe më të madhe nga komuna përkatësisht Drejtoria për Bujqësisë. Ju dëshiroj punë të mbar dhe shumë suksese në punën e juaj", tha Mazreku.

Në këtë ceremoni, mori pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, i cili i përshëndeti bletarët dhe premtoi vazhdimin e përkrahjes nga ana e Komunës, ndërsa përfaqësuesi i shoqatës së bletarëve të Malishevës, z.Agush Gashi, e ka falënderuar Komunën e Malishevës, për këtë përkrahje.

Në këtë projekt janë përfshi bletarët e Komunës së Malishevës, ku përfitues janë 73 prej tyre, gjatë takimit sot u janë shpërndarë 200 koshere bletësh, 300 kg flet dylli dhe 3 centrifuga.

Kryetari Begaj, mbajti takimin e parë publik me qytetar

Malishevë, 25 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot takimin e parë publik me qytetarë, ku i ka njoftuar qytetarët për punën e kryetarit dhe qeverisë komunale në gjashtë mujorin e parë të qeverisjes për vitin 2014, si dhe më pas ka zhvilluar debat me qytetarët, lidhur me punën e deritanishme, si dhe ka dëgjuar edhe kërkesat e



qytetarëve, lidhur me nevojat e tyre dhe mundësisë së futjes së këtyre kërkesave në hartimin e projekteve kapitale në buxhetin komunal për vitin e ardhshëm.

Fillimisht kryetari Begaj, i ka njoftuar të pranishmit, me punët e deritanishme, projektet e realizuara, projektet në realizimin e sipër, ndërsa një pjesë e këtij takimi të parë, ju kushtua edhe situatës epidemiologjike në Komunën e Malishevës, lidhur me ethet hemorragjike krime kongo (EHKK).

“Punët e kryera deri më tani, janë brenda mundësive buxhetore që kemi si komunë. Aktualisht janë në ndërtim e sipër dy shkolla (Vërmicë dhe Shkozë), të cilat janë trashëguar nga viti i kaluar, ndërsa këtë vit kemi filluar punimet në ndërtimin e shkollave në Damanek, Golluboc dhe Gurishtë, ndërsa në përfundim të procedurave për fillimin e ndërtimit, janë edhe shkollat në Bubavec dhe Carrallukë, të cilat do të fillojnë shumë shpejt të ndërtohen”, tha kryetari Begaj, duke folur për investimet kapitale në infrastrukturën shkollore, përderisa është në përfundim e sipër edhe çerdhja për fëmijë në Malishevë.

Ndërsa duke folur për infrastrukturën rrugore, kryetari Begaj tha se “këtë vit kemi shtruar rrugët në Lumnishtë, Turjakë, Fshat i Ri, Bardh, Bellanicë, Vërmicë, Golluboc, Gurbardh, dhe shumë fshatra tjerë, duke e përmirësuar infrastrukturën rrugore në fshatrat e Komunës së Malishevës”. Po ashtu kryetari Begaj tha se “është duke u punuar në ndërtimin e ujësjellësit në Drenoc, pastaj ujëmbledhësit në Senik, që parashihet ti furnizoj 12 fshatra me ujë për pije”. “Edhe rrjeti i kanalizimeve është duke u ndërtuar dhe momentalisht janë ndërtuar ose janë procedurë ndërtimin i kanalizimeve për 30 fshatra”, tha Begaj. Ai po ashtu njoftoi se janë ndarë bursa për studentë, si dhe ndihma në ndërtimin e shtëpive për rastet e rënda sociale, ku janë ndarë rreth 60 mijë euro.

“Bregë e jona, është mbrojtja e jetës së qytetarëve të Malishevës si dhe rritja e mirëqenies sociale, për çka jemi duke punuar maksimalisht”, tha Begaj. “Unë do ti luftoj dukuritë negative në institucione, ku i kam shpallur luftë korrupsionit dhe për këtë kërkoj mbështetjen e të gjithë juve, dhe ju premtoj se të gjithë tenderët do të jenë publik dhe transparent”, tha Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Për situatën epidemiologjike, të pranishmit i njoftoi drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, i cili bëri të ditur se komuna është e angazhuar maksimalisht në luftimin dhe parandalimin e EHKK. “Deri më sot janë regjistruar 1443 raste të thumbimit nga rriqrat, ndërsa tre persona kanë rezultuar pozitiv me ethe hemorragjike, por asnjëri rast prej tyre nuk është paraqitur me kohë në QKMF për largimin e rriqrave”, tha drejtori Berisha, i cili i falënderoi në mënyrë të veçantë stafin e emergjencës në QKMF të Malishevës, për punën e tyre, në këtë fushë.

Ndërsa drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, i ka njoftuar të pranishmit në këtë takim publik, lidhur me shpenzimin e buxhetit komunal. “Ne kemi trashëguar në buxhet prej

rreth 11 milion euro, por vetëm 4 milion janë për investime kapitale, të cilat po shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne jemi duke punuar në hartimin e buxhetit për kornizën afatmesme buxhetore 2015-2017, ku kërkesat e banorëve lidhur me investimet në vendbanimet e tyre, do të shqyrtohen seriozisht dhe do të futen në hartimin e prioriteteve për investime kapitale për vitet në vijim”, tha drejtori Krasniqi.

Pas paraqitjes së këtyre të dhënave, të pranishmit, përveç lëvdatave për investimet e qëlluara, kanë parashtruar edhe kërkesa për investime në vendbanimet e tyre, ku dominuan kërkesat për investime në infrastrukturën në përgjithësi, kjo për shkak të rritjes së nevojave të kohës. Në të gjitha pyetjet dhe kërkesat, janë përgjigjur kryetari Begaj dhe drejtorët përkatës të drejtorive komunale.

Asambleja Komunale e Malishevës nuk e miraton qarkoren e parë buxhetore

Malishevë, 27 qershor

Anëtarët e Asamblesë Komunale të Malishevës, në mbledhjen e gjashtë të rregullt, nuk kanë miratuar qarkoren e parë buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2015-2017. Me 12 vota për dhe 15 kundër, kjo qarkore buxhetore, e cila kishte paraparë një rritje të buxhetit prej 1.5 milion dhe krijimin e 30 vendeve të reja të punës, nuk ka kaluar nga ana e anëtarëve të KK të Malishevës. Për miratimin e saj, ishte vetëm pozita dhe një nga opozita, por që nuk ishin numrat e mjaftueshëm për kalimin e qarkores së parë, pasi 15 anëtar nga opozita, ishin kundër.



Përndryshe në mbledhjen e sotme të KK të Malishevës, është shqyrtuar edhe raporti i punës së zyrës së kryetarit dhe qeverisë komunale, për vitin 2013, raport të cilin e prezantoi kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Në këtë mbledhje është miratuar edhe plani i punës së komitetit për komunitete dhe plani i punës së komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport, pastaj është miratuar një kërkesë e shoqatës së familjeve të dëshmorëve të Komunës së Malishevës, pastaj është miratuar edhe kërkesa e LDK-së drejtuar MAPL-së për kthimin e përgjigjes, lidhur me statusin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

KK, mori vendim në parim edhe një kërkesë të drejtorisë për bujqësi, lidhur me ndërtimin e një strehimore për qenë endacak dhe mace, si dhe ka miratuar kërkesën një qytetari për ndërrim destinimin e pronës së tij, nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

Filloi spërkatja nga ajri kundër rriqrave

Malishevë, 29 qershor

Në kuadër të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), organizuar dhe financuar nga Komuna e Malishevës, sot ka filluar edhe spërkatja masive e territorit të Komunës së Malishevës, kundër rriqrave, si bartësit kryesor të virusit të EHKK. Spërkatja masive po bëhet nga ajri, me aeroplan.



Spërkatjen nga ajri është duke kryer kompania “ALA-CO”, ndërsa sipas drejtorit të drejtorisë komunale për mbrojtje dhe shpëtim, z.Ahmet Morina, spërkatja është ndarë në tri zona, të cilat do kryhen gjatë tri ditëve. “Sot janë spërkatur fshatrat Llapqevë, Panorc, Rud, Garaqevë, Turjakë, Burim, Gurbardh, një pjesë e Dragobilit, një pjesë e Malishevës, Mirushë, Lubizhdë, Damanek, Bubël, Qupevë, Kijevë dhe Burim (ish Stapanica)”, ka bërë të ditur drejtori Morina.

“Spërkatja ka filluar në orët e hershme të mëngjesit dhe çdo gjë ka shkuar mirë deri më tani. Ne jemi në gatishmëri të plotë në mbrojtje të jetës së qytetarëve të Komunës së Malishevës dhe jemi duke e bërë të pamundurën, në marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga EHKK”, tha Morina.

Spërkatja e sotme, është vëzhguar në tërësi nga zyrtarët komunal të Komunës së Malishevës, përkatësisht, nga drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, ku përveç drejtorit Morina, një zyrtar i drejtorisë ka qëndruar në aeroplan gjatë spërkatjes, si dhe në vëzhgim ka qenë edhe drejtori i drejtorisë për shëndetësi, z.Hajdin Berisha.



Për nesër, është paraparë të spërkatën territoret rreth fshatrave Drenoc, Bubavec, Vërmicë, Llozicë, Balincë, Mleqan, dy Plloqicat, Carrallukë, Shkarashnik, dy Tërpezat, Lladroc, Guncat, Senik dhe Bardh.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Kryetari Begaj i falënderon të gjithë që po merren me spërkatjen kundër rriqrave dhe reagon ndaj mos miratimit të qarkores së parë buxhetore

Malishevë, 30 qershor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, i ka falënderuar drejtoritë komunale, të cilat po merren me fushatat e dezinfektimit kundër rriqrave, për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike, si dhe ka reaguar ndaj mos miratimit të qarkores së parë buxhetore nga ana e Asamblesë Komunale të Malishevës, duke e quajtur veprim të paarsyeshëm dhe në dëm të qytetarëve të Malishevës.

Fillimisht kryetari Begaj, i ka falënderuar drejtoritë për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe atë të Shëndetësisë, për angazhimin e tyre në fushatat e dezinfektimit kundër rriqrave, të cilët që nga dita e parë janë duke u angazhuar seriozisht në luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo dhe janë në shërbim të qytetarëve të Malishevës. Drejtori për mbrojtje dhe shpëtim, z.Ahmet Morina dhe drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha, raportuan për angazhimin e drejtorive të tyre në këtë fushatë të dezinfektimit. Sipas tyre, fushata e dezinfektimit me aeroplan do të vazhdojë edhe në ditën e nesërme, për të vazhduar më pas me spërkatjen selektive, si dhe përveç stallave, në dy ditët në vijim, pritet të filloi edhe dezinfektimi i kafshëve shtëpiake.

Mbledhja e sotme e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, nuk ka kaluar edhe pa sqaruar para opinionit, se mos miratimi i qarkores së parë buxhetore, në Asambleshë Komunale, për kornizën afatmesme buxhetore 2015-2017. Mos miratim i cili është, siç u vlerësua në dëm të qytetarëve të Malishevës dhe veprim i paarsyeshëm i anëtarëve të Asamblesë Komunale”. Ndërsa drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, duke e komentuar këtë situatë, e quajti “të paarsyeshëm vendimin e opozitës, vetëm për siç u deklaruan edhe vet, të treguar se janë opozitë, duke mos i llogaritur pasojat e këtij veprimi, pa asnjë arsye”. “Ne sipas planifikimeve tona, tani rrezikojmë të humbim mjete prej 1.2 milion euro, e në kuadër të kësaj edhe rreth 30 persona, të mos mund të punësojmë, e ky mos punësim, rrjedhimisht rrezikon



edhe hapjen e shkollës në Vërmicë dhe rrezikon gjithashtu mos hapjen e çerdhes për fëmijë në Malishevë”, tha drejtori Krasniqi.

Në mbledhjen e sotme, u diktuan edhe çështje të tjera që lidhen me aktivitetet e përditshme të drejtorive komunale, ndërsa kryetari Begaj, ka kërkuar mobilizim të shtuar në ditët në vijim, në sektorin e administratës, kur edhe fillon sezoni i ardhjes së mërgimtarëve, në mënyrë që të gjitha shërbimet të kryhen pa u krijuar vonesa për mërgimtarët. Kur jemi te mërgimtarët, kryetari Begaj, ka kërkuar të organizohet edhe një pritje për mërgimtarët.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 128- Korrik 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Fillimi i spërkatjes nga ajri



Fillimi i zgjerimit të urës së qytetit



Pamje gjatë zbulimit të bustit të dëshmorit Ruzhdi Gjyliqi



Iftari tradicional me familjet e dëshmorëve

Sot përfundoi spërkatja nga ajri kundër rriqrave

Malishevë, 1 korrik



E organizuar dhe financuar nga Komuna e Malishevës, në harmoni me strategjinë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), ka përfunduar spërkatja tre ditore nga ajri (me aeroplan), kundër rriqrave, si bartësit kryesor të virusit të EHKK. Ky projekt,

është financuar nga Komuna e Malishevës, me vlerë prej 200 mijë euro, dhe është realizuar nga kompania “ALA-CO”, ndërsa e tërë spërkatja ka zgjatur tri ditë, ku është përfshirë i tërë territori i pabanuar i Komunës së Malishevës.

Spërkatja kundër rriqrave, përmes ajrit, ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e qytetarëve të Komunës së Malishevës, si rezultat i përhapjes së virusit vdekje prurës i EHKK, ku deri më sot, kanë vdekur 18 qytetar të Komunës së Malishevës. Kjo spërkatje, bëhet krahas spërkatjes selektive të 39 zonave endemike dhe stallave e bagëtime, duke përfshirë 306 kilometra katrorë të territorit të Komunës së Malishevës.

Sipas drejtorit për mbrojtje dhe shpëtim, z.Ahmet Morina, i cili krahas zyrtarëve tjerë të kësaj drejtorie, përveç vëzhgimit nga poshtë, gjatë ditës sotme e ka përcjellë spërkatjen nga aeroplani, “e gjithë kjo fushatë ka shkuar mirë dhe pa probleme dhe është realizuar sipas planit të hartuar për spërkatje nga ajri”. Ndërsa nga ana tjetër, drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha, ka deklaruar se “deri më tani nuk kemi raste me fatalitet nga infektimi me virusin e EHKK, por janë regjistruar tri raste të infektimit dhe të gjitha këto raste e kanë mbijetuar këtë infektim, si rezultat i trajtimit në klinikën infektive në QKUK”.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me këtë rast, e ka përshëndetur kryerjen me sukses të kësaj spërkatje përmes ajri, e që njëherit është edhe hera e parë, që në Kosovë kryhet një fushatë e tillë, që nga paslufta. “Unë e shfrytëzoj rastin të falënderoi të gjithë ata që janë angazhuar në të gjitha fushatat e spërkatjes kundër rriqrave, si nga toka ashtu edhe ajri, duke përfshirë të gjitha organet komunale, IKSHP-në, ministritë përkatëse që janë të

involvuara, pastaj stafin e emergjencës në QKMF të Malishevës, për trajtimin e personave të thumbuar nga rriqrat, si dhe stafin e Klinikës Infektive në QKUK, për trajtimin e rasteve të prekura me EHKK, pasi puna e të gjitha këtyre institucioneve, është heroike në mbrojtje të jetës së qytetarëve të Komunës së Malishevës”, ka thënë mes tjerash kryetari Begaj.

Filloi zgjerim i urës kryesore në Malishevë

Malishevë, 3 korrik



Në kuadër të përmirësimit të lëvizshmërisë në hapësirat publike, sot në qytetin e Malishevës, kanë filluar punimet në zgjerimin e urës në rrugën “Rilindja Kombëtare”, ku parashihet zgjerimi i urës me trotuar, duke e përmirësuar lëvizjen e qytetarëve. Ky projekt financohet nga Komuna e Malishevës dhe UN-HBITAT-i.

Në ceremoninë e fillimit të punimeve, mori edhe kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili përveç vënies së gurthemelit, i uroi të gjithë për realizimin e këtij projekti, shumë të rëndësishëm, pasi pas dy muajsh, qytetarët do të mund të lëvizim lirshëm në urën mbi lumin “Mirusha”, por edhe ngasësit e veturave, gjithashtu do të vozitin lirshëm, pasi nuk do të pengohen nga kalimtarët mbi urë.

Projekti, “Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe hapësirave publike në qendër të qytetit”, është i financuar nga Komuna e Malishevës dhe Programi për Përkrahje të Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP), program i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe implementuar nga UN-HABITAT-i. Vlera e projektit është 74 344 euro dhe financohet pesëdhjetë me pesëdhjetë përqind nga Komuna e Malishevës dhe UN-HABITAT-i dhe pritet të përfundoj brenda dy muajve.

Kryetari Begaj, në përkrahje të rinisë së Malishevës

Malishevë, 4 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerita Krasniqi, kanë pritur sot përfaqësuesit e Këshillit të Veprimit Rinore Lokal (KVRL) në Malishevë, nga të cilët janë njoftuar me punën e KVRL-së dhe aktivitetet e tyre, përderisa morën përkrahje pa rezervë për punën e tyre dhe zhvillimin e aktiviteteve për rininë e Malishevës.

“Malisheva ndoshta është në kushte jo shumë të mira për të rinjtë, edhe pse ka një infrastrukturë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve, por ne si komunë do të mundohemi të mbështesim aktivitetet rinore në përgjithësi. Ne jetojmë me këto kushte, me këtë mentalitet dhe aktivitetet zhvillohen brenda këtyre kushteve, por JU e keni përkrahjen dhe mbështetjen tonë të pa rezervë, brenda kushteve dhe mundësive tona”, ju ka thënë kryetari Begaj, drejtuesve të KVRL-së në Malishevë.

Nga ana tjetër, kryetarja e KVRL-së, Blerina Mazreku, e ka njoftuar kryetarin Begaj, me formimin e KVRL-së, mënyrën e funksionimit dhe aktivitetet që janë duke u zhvilluar nga ky organizim rinor në Malishevë. “Qëllim i yni është aktivizimi i të rinjve të Komunës së Malishevës dhe momentalisht jemi në realizimin të një projekti për aktivizimin e rinisë në fshatrat rurale, ku janë paraparë aktivitete në pesë fshatra të mëdha të Komunës së Malishevës”, tha kryetarja e KVRL-së, Blerina Mazreku. Më pas Mazreku, e informoi kryetarin edhe me planet e KVRL-së, në mënyrë që rinia e Malishevës, të jetë më e aktivizuar.

Nga e hëna fillon dezinfektimi i bagëtisë

Malishevë, 4 korrik

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim, njofton të gjithë fermerët e Komunës së Malishevës, se duke filluar nga java e ardhshme, të hënën me 7 korrik 2014, nis spërkatja e bagëtisë, gjegjësisht repelimi i bagëtisë. Me këtë lutem blektorët që ti mbajnë mbyllur bagëtinë nga 6:00 e mëngjesit, deri në ora 12:00 në mesditë dhe të bëjnë mjeljen e tyre.

Repelimi i bagëtisë bëhet me qëllim të parandalimit nga prekja nga rriqrat, me qëllim të mosbartjes së rriqrave nga fushat në stalla. Edhe kjo fushatë e spërkatjes së bagëtisë, është në



kuadër të luftimit dhe parandalimit të infektimit me ethe hemorragjike krime kongo (EHKK) dhe është në kuadër të strategjisë nacionale kundër EHKK.

Spërkatje, përkatësisht repelimi i bagëtive, organizohet dhe financohet nga Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit në Republikën e Kosovës (AVUK). Fushata, planifikohet të nis të hënën në fshatin Burim, ndërsa varësisht prej ecurisë të saj, fshatrat do të njoftohen me kohë përmes mjeteve të komunikimit dhe nga kryetarët e fshatrave. Lutën qytetarët që të ndjekin udhëzimet, për mbajtjen mbyllur të bagëtive deri në mesditë dhe mjeljen e tyre.

Nga Mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Malishevë, 7 qershor

Si çdo të hënë edhe sot Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të qeverisë komunale, ku janë trajtuar një varg çështjesh, që lidhen me punët dhe aktivitetet e përditshme të qeverisë komunale, ku dhe u bë e ditur, që sot fillon faza e dytë e projektit të ujësjellësit të Drenocit.

Drejtorja për Urbanizëm, përkatësisht drejtori z.Urim Kastrati bëri të ditur në këtë mbledhje që sot fillon faza e dytë e punimeve në projektin e ujësjellësit të Drenocit, në lagjen e Lacajve, po ashtu është duke u punuar edhe në shkollat si Gollubovc, Goriç, Damanek, Panorc në të cilën tani edhe fusha e futbollit veç pritet të përurohet, dhe në Vermicë ku tani përfundon objekti shkollor, ndërsa me kanalizime janë duke ushtruar fshatrat Drenoc, Jancist dhe Burim.

Nga ana tjetër Drejtori për Shëndetësi z.Hajdin Berisha ka njoftuar rreth etheve hemorragjike në përgjithësi ku tha se ” gjendja me ethet hemorragjike është stabile madje shumë më stabile se sa periudhat e njëjta të viteve të kaluara, mobilizimi është në gjendje të njëjtë në QKMF dhe po vazhdon të jetë nën kontroll, ndërsa sot do të fillohet me fazën tjetër të spërkatjes që po bëhet përherë të parë, për repelimin e kafshëve, ku në vitet e ardhshme pritet të fillojmë me repelim më herët ”.

Nga ana tjetër, të gjithë drejtorët, kanë raportuar për aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe për aktivitetet që i kanë në javën në vazhdim .Po ashtu drejtori për Bujqësi z.Hajrullah Mazreku njoftoi që korrje-shirjet kanë filluar në Komunën e Malishevës edhe pse është paraparë që të fillojnë me 10 korrik, rekomandim ky nga ministria, është bërë pa lejen e drejtorisë.

Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e gjashtë të radhës

Malishevë, 7 qershor

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës në Malishevë, drejtuar nga kryesuesi i KK, z.Enver Hoti, ka mbajtur mbledhjen e i VI (gjashtë) të radhës, ku janë diskutuar një varg çështjesh dhe janë dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

KPF, pas shqyrtimit ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, që të shqyrtohet dhe miratohet raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor-2014, ku sqarime për këtë pikë të rendit të ditës, para anëtarëve të KPF-së, ka dhënë Drejtori për Ekonomi dhe Financa z.Vesel Krasniqi.

Për kuvend është rekomanduar pika 3 dhe 4 e rendit të ditës, shqyrtimi i kërkesë për marrjen e vendimit për formimin e komisionit vlerësues, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së pa luajtshme të Komunës, dhe shqyrtimi i kërkesës për marrjen e vendimit për formimin e komisionit të ankesave për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës.

Rekomandim për kuvend KPF dha edhe shqyrtimin dhe miratimin e propozimit të Komisionit komunal për emërtimin e Rrugëve, dhe një çështje tjetër e rekomanduar për KK ishte pagesa e kryetarëve të fshatrave që kanë marr pjesë në këtë komision, pastaj raporti komulativ i punës së Zyrës së Tatimit në Pronë, si dhe kërkesa nga LDK, Plani vjetor i punës Janar-Dhjetor-2014 i Zyrës së Tatimit në Pronë.

Kanë filluar korrje-shirjet në Malishevë

Malishevë, 8 korrik



Drejtorja për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural (BPZHR) në Malishevë, edhe këtë vit ka formuar Shtabin Komunal i dedikuar për korrje-shirje, me përbërje prej pesë anëtarëve, të cilin e drejton zytari drejtorisë për bujqësi, z.Milaim Morina, në ndërsa anëtarët tjerë nga drejtorja e Inspektoriat, Emergjencja dhe Shoqata e fermerëve të Komunës.

Sipas Drejtorisë së BPZHR, përkatësisht drejtorit z.Hajrullah Mazreku, “fushata e korrje-shirjeve në Malishevë, është paraparë të filloj me datën 10 korrik, rekomandim ky nga Ministria e Bujqësisë, për shkak të të reshurave atmosferike që kanë mbretëruar në vend dhe

lagështisë së kallirit të grurit, e cila sillet nga 10.9% deri në 15.7%, por që duhet të jetë 12 deri 13%, për këtë arsye është paraparë që korrje-shirjet të fillojnë me 10 korrik 2014, mirëpo qytetarët kanë filluar pa udhëzimin e Drejtorisë që nga data 5 korrik. Megjithatë rendimentet janë të mira dhe kanë arritur në 3500 deri 4000 kg për hektarë sipas inspektimit të Drejtorisë së BPZHR-së”.

“Çmimi për hektarë është duke u sjell 100 euro, ndërsa për këtë vit nuk është paraparë asnjë subvencion nga Ministria e Bujqësisë, për arsye se i ka subvencionuar bujqit dhe fermerët me nga 125 euro për hektarë, ndërsa shqetësim për fermerët është ai i parave të subvencionit të parashikuar nga qeveria, që është paraparë të jetë 125 euro, e nuk është marr ende”, thonë zyrtarët e drejtorisë për bujqësi.

Marrëveshje mes Komunës dhe MASHT-it për rritjen e cilësisë në mësimin profesional

Malishevë, 9 korrik



Në kuadër të një pilot projekti, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Komuna e Malishevë, përkatësisht kryetari z.Ragip Begaj sot ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPRr) dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ku objekti, hapësirat e shfrytëzuara si dhe pajisjet e Qendrës së Kompetencës, bartën në përgjegjësi dhe administrim të kësaj agjencisë.

Ndërkaq, qëllimi i shkollave të Agjencisë është që ‘Nxënësit e shkollave profesionale të marrin kompetenca, të cilat i duhen për pjesëmarrje të suksesshme në shoqëri dhe në jetën profesionale. Për arsye të shumë risive MASHT ka vendosur që para implementimit të agjencisë të bëjë një fazë pilotuese për ngritjen e strukturave të përmendura më sipër në disa shkolla të përzgjedhura në vend, përfshi edhe Qendrën e Kompetencës në Malishevë.

Përgjegjësitë direkte për shkollat profesionale i takojn komunave. Për të mundur pjesëmarrjen e plotë të Qendrës së Kompetencës duhet të bëhet bartja e përgjegjësisë nga komuna në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPRr), përmes këtij memorandumit të mirëkuptimit për kohën e fazës pilotuese.

Kryetari Begaj inspektoi punimet e fazës së dytë të ujësjellësit në Drenoc

Malishevë, 9 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj, sot ka inspektuar punimet e fazës së dytë të ndërtimit të rrejtit të ujësjellësit i cili është duke u shtruar për kah lagjja e Lacajve në fshatin Drenoc të Komunës së Malishevës.

Pas inspektimit Kryetari Begaj u nda i kënaqur , pasi punimet po shkojnë mirë dhe kërkoi nga punëkryesit që të angazhohen maksimalisht dhe të marrin me përkushtim punën e tyre të cilën janë duke e bërë dhe të përfundoj ashtu brenda afatit të paraparë.

Ekipi i futbollit U11 KF “Malisheva” kampion në Turnirin Ndërkombëtar në Shqipëri

Malishevë, 10 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerta Krasniqi, kanë pritur sot ekipin e futbollit të grupmoshës U11, ekip i cili vepron në kuadër të shkollës së futbollit “Malisheva” në Malishevë, dhe të cilët kanë marr vendin e parë në këtë grupmoshë në Turnirin Ndërkombëtar të mbajtur në Shqipëri.

Kryetari Begaj me këtë rast i ka mirëpritur në zyrën e tij dhe i ka përgëzuar me rastin e fitores së tyre ku më pas tha, ” jam shumë i kënaqur me vizitën dhe me fitoren e juaj që keni marrë atje. Kjo nuk është fitore vetëm e Malishevës, por është edhe e të gjithë Kosovës, dhe është rezultat shumë i madh për ne, me këtë fitore tuajën atje. Dëshira ime është që në të ardhmen ju të avancoheni edhe më shumë dhe të doni futbollin, sportin dhe vendin e juaj ” tha Begaj.

Ky turniri mbahet në Durrës që 10 vite më radhë, organizohet nga Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF), nën mbikëqyrjen e UEFA-së , dhe Shoqata Vllaznimi CUP 2014 “Durrës Albania”, ku në 10 vjetorin e këtij turniri ekipi i futbollit U11 KF “Malisheva” u shpall

kampion në këtë grupmoshë, në të cilin turnir morën pjesë gjithsejtë 35 ekipe të vendeve të ndryshme.

Komiteti për Arsim mbajti mbledhjen e tretë të radhës

Malishevë, 10 korrik



Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini e Sport, i drejtuar nga kryetar i këtij komiteti z.Januz Kastrati, ka mbajtur sot mbledhjen e III (tretë) të radhës, ku janë diskutuar një varg çështjesh të punëve dhe angazhimeve të këtij komiteti.

Gjatë kësaj mbledhje janë shqyrtuar dhe miratuar pikat 2, 3 dhe 4 të renditë të ditës ku për pikën 2 dhe 4 ka raportuar drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim (DKA), z.Blerim Thaçi rreth shqyrtimit të raportit të punës së DKA-së me rastin e përfundimit të vitit mësimor 2013/14, dhe po ashtu ka njoftuar për fillimin e përgatitjeve për vitin shkollor 2014/15, si dhe ka dhënë sqarimet e nevojshme rreth arsimimit në Malishevë.

Po ashtu rreth pikës 3 e cila i referohet Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport ka raportuar Drejtoresha e DRKS-s znj.Blerta Krasniqi, për gjashtë mujorin e parë të punës për vitin 2014 për gjashtë mujorin e parë të vitit 2014, ku dha sqarimet rreth aktiviteteve dhe detyrave të DRKS-s.

Kryetari Begaj inspektoi disa punime të projekteve

Malishevë, 10 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj së bashku me drejtorin për Urbanizëm z.Urim Kastrati dhe drejtoreshën për Kulturë Rini e Sport znj.Blerta Krasniqi, sot kanë inspektuar disa nga punimet që janë duke u realizuar në Malishevë.

Fillimisht kanë inspektuar fushën e sportit në Shkollën fillore “Asim Vokshi” në Panorc, e cila dimensionet e jashtme i ka (21x44)m, dhe prite të përfundoj së shpejti.Kryetari Begaj u nda i kënaqur me punimet e kësaj fushe të sportit dhe pret që të përurohet së shpejti.

Më pas ka inspektuar edhe punimet e zgjerimit të urës mbi lumin “Mirusha” në qytetin e Malishevës e cila është duke u zgjeruar në kuadër të përmirësimit të lëvizshmërisë në hapësirën publike .

Po ashtu pa nga afer edhe fushatën e korrje-shirjeve të kallirit të grurit, në fshatin Damanek, ku sot edhe është dashur të fillohej me korrje-shirje sipas rekomandimit të Ministrisë së Bujqësisë e që kanë filluar më herët Komunën tonë.

Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e OJQ “Jesus Krishti”

Malishevë, 11 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj , ka pritur sot në zyrën e tij përfaqësuesit e OJQ “Kisha e Jezu Krishtit, e ditëve të vona” nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Paul dhe Barbara Nelson, të cilët janë nën mbikëqyrje të projektit për ujësjellësin e fshatit Drenoc, ku edhe kanë inspektuar punimet në teren.

Kryetari Begaj, falënderoi për vizitën dhe bashkëpunim, “jeni të mirëseardhur deri në përfundim të këtij projekti, në inspektim dhe të shihni se ku po investoni parat tuaja ” tha Begaj, dhe më pas kanë inspektuar zhvillimin e punimeve të rrjetit të ujësjellësit në Drenoc.

Fillimisht kanë parë nga afër zhvillimet e punimeve të fazës së parë të këtij projekti, dhe më pas inspektuan punimet e fazës së dytë e cila po vazhdon të shtrohet për kah lagjja e Lacajve. Pas inspektimit të bërë, Kryetari Begaj dhe qifti nga SHBA, Paul e Barbara Nelson, janë ndarë të kënaqur me zhvillimin e punimeve që janë duke u bërë në rrjetin e ujësjellësit të Drenocit.

Kryetari priti palët

Malishevë, 11 korrik

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, si çdo të premtë edhe sot, për tri orë të tëra ka pritur qytetarët në zyrën e tij, duke u njoftuar me problemet dhe shqetësimet e tyre, por edhe duke marrë falënderime për ndihmën dhe kujdesin e tij dhe të komunës, për mirëqenien e qytetarëve.

Si zakonisht, problemet kryesore të shfaqura nga qytetarët , ishin kryesisht ato socio-ekonomike, dhe çështja për punësim dhe nevojat tjera të ndryshme, kryetari Begaj edhe me këtë rast ka ofruar mbështetjen e tij të plotë morale si dhe mbështetjen e mundëshme material



duke u bazuar gjithmonë në atë që është në mundësin e tij dhe duke pasur parasysh mundësi e komunës sonë si institucionit.

Në mesin e qytetarëve të shumtë, që kryetari Begaj ka pritur sot, kishte edhe prej atyre, që shprehnin falënderimet e tyre, për përkrahjen e kryetarit dhe të komunës, dhe po ashtu edhe për këshillat e dhëna për ballafaqimin e halleve dhe problemeve të tyre.

Thumbimi nga rriqrat në rënie

Malishevë, 14 korrik

“Thumbimi nga rriqrat është në rënie e sipër, pasi çdo ditë e më pak ka raste të thumbimeve”, ka thënë sot drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga kryetari Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, e ku u diskutuan çështje të ndryshme që lidhen me aktivitetet dhe angazhimet e drejtorive komunale.

“Përveç rënies së rasteve të thumbimeve, edhe situata epidemiologjike është në kontroll. Aktualisht kemi një rast të shtrirë në klinikën infektive dhe gjendja e pacientit është e mirë dhe jashtë rrezikut për jetë”, tha drejtori Berisha.

Nga ana tjetër, drejtori i administratës, z.Ekrem Kastrati, tha se “është rritur numri i kërkesave të qytetarëve për nxjerrjen e dokumenteve në shërbimin e ofiqarisë, si nga mërgimtarët ashtu edhe nxënësit dhe studentët, por kjo është brenda normales dhe ende nuk është paraqitur nevoja për shtimin e orarit të punës, pasi shërbimet po kryhen me kohë dhe nuk ka vonesa në dhënien e dokumenteve”.

Ndërsa drejtori për buxhet, ekonomi dhe financa, z.Vesel Krasniqi, tha se kanë marrë një shkresë nga ministria përkatëse, për rishikim të buxhetit, dhe tha se rishikimi do të bëhet, duke kërkuar nga Asambleja Komunale, që ta miratoj këtë rishikim, i cili bëhet çdo vit pas përfundimit të gjashtë mujorit të parë të punës.

Edhe rendimentet e grurit, janë të mira, pasi rendimentet sillen 3500-400 kilogram grurë për një hektar, ka bërë të ditur, drejtori i bujqësisë, z.Hajrullah Mazreku, bazuar në raportet ditore të Shtabit për korrje-shirje në Malishevë, ndërsa rekordi për këtë vit, deri më tani është shënuar në Llapqevë ku janë shënuar mbi 6200 kilogram për një hektar.

Në këtë mbledhje, drejtori për urbanizëm, z.Urim Kastrati, tha se janë duke vazhduar me realizimin e projekteve në infrastrukturë në shumë vendbanime të Komunës së Malishevës, ndërsa drejtori i inspektoratit, z.Sejdi Paçarizi, tha se “inspektorët komunal, janë në aksion për parandalimin e veprimtarisë së kombibusëve ilegal, të cilët nuk janë të regjistruar”.

Edhe drejtorët tjerë, kanë raportuar për aktivitet e tyre që janë dukë bërë në vazhdimësi, në realizimin projekteve të ndryshme dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Edhe Malisheva i bashkohet thirrjes për drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës

Malishevë, 14 korrik

Edhe Komuna e Malishevës, i bashkohet nënshkrimit të peticionit për të kërkuar drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë. Sot këtë peticion, përveç shumë qytetarëve të Malishevës, e ka nënshkruar edhe i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj.



Kryetari Begaj vizitoi një shpezëtare që merret me rritjen e zogjve

Malishevë, 15 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori për Bujqësi Pyltari dhe Zhvillim Rural (BPZHR), z.Hajrullah Mazreku, kanë vizituar sot z.Xhavit Morina nga fshati Drenovc, i cili merret me rritjen e zogjve, ku kryetari Begaj i premtoi ndihmë për jetësimin e këtij biznesi.

Kryetari Begaj, vizitoi inkubatorin i cili çel zogj, e të cilin e posedon z.Xhevat Morina nga Drenovci, dhe i cili ka ngecur me çeljen e zogjve në pamundësi të realizimit të këtij projekti që disa vite, ku ky inkubator ka një gjendje të mirë dhe ka një kapacitet që të çel 1200 copë vezë brenda një cikli të çeljes së zogjve për 21 ditë.

Kryetari Begaj premtoi ndihmën e tij dhe të institucionit për dy cikla të çeljes së zogjve, dhe jetësimin e mëtejshëm të këtij projekti.

Begaj e Tahiri, ju bëjnë thirrje malishevasve ta nënshkruajnë peticionin

Malishevë, 16 korrik

Kryetar i Malishevës, z.Ragip Begaj ka pritur sot zëvendëskryeminstren e Qeverisë së Republikës së Kosovës, znj.Edita Tahiri, dhe së bashku ju kanë bërë thirrje malishevasve, që ta nënshkruajnë peticionin me të cilin po kërkohet drejtësi ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë.



Në këtë ngjarje, ishin të pranishme edhe femrat anëtare të Asamblesë Komunale të Malishevës, deputetja e sapozgjedhur në Kuvendin e Kosovës, znj. Shukrie Bytyçi dhe gratë aktiviste të organizatave të ndryshme joqeveritare që veprojnë në Malishevë.

“Jemi të nderuara dhe të fuqizuara nga pritja e kryetarit të komunës dhe me këtë rast ftojmë të gjithë qytetarët e Malishevës dhe rrethinës, që ta nënshkruajnë peticionin. Mendoj se nuk ka nevojë të flitet për peshën e kësaj iniciative. Çështja e dhunimit të grave gjatë luftës, është një tragjedi e të gjithë kombit tonë. Por ajo që ne kërkojmë tash është drejtësia ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftës. Përmes drejtësisë ndërkombëtare kërkojmë që kryesit e këtij krimi të dalin para drejtësisë dhe të marrin dënimet e merituar, me këtë rast ne ju japim mbështetje zonjave tona dhe që jemi me ato”, tha në deklarinimin e saj, zv/kryeministrja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, znj.Edita Tahiri.

“Malisheva ju ka bashkëngjitur këtij nënshkrimi të këtij peticioni. Besoj se është shumë i nevojshëm dhe unë i inkurajoj të gjitha ato nëna e motra që kanë pasur pasoja dhe dëshiroj që drejtësia ndërkombëtare ta thotë fjalën e vet dhe ajo që ju ka ndodh atyre, në fakt na ka ndodh të gjithë neve shqiptarëve dhe ato duhet të jenë krenare, pasi nuk është asgjë e turpshme. Ato duhet të jenë krenare, pasi të gjithë ato janë meritore për lirinë e Kosovës. Ne do t bëjmë maksimumin që përkrahje të jetë sa më e madhe për këtë peticion”, ka thënë mes tjerash, në deklarinimin e tij, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

KK miratoi rishikim e buxhetit dhe kornizën afatmesme buxhetore 2015-2017

Malishevë, 16 korrik



Kuvendi i Komunës së Malishevës, drejtuar nga kryesuesi z.Enver Hoti, ka mbajtur mbledhjen e shtatë të radhës, ku kanë miratuar rishikim e buxhetit për vitin 2014, si dhe kanë miratuar kornizën afatmesme buxhetore 2015-2017. Në mbledhje mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili është përgjegjës në pyetjet e anëtarëve të KK, si dhe ka dhënë sqarime për disa pika të

rendit të ditës.

Fillimisht në mbledhjen e sotme, ka dhënë betimin anëtari i ri i KK të Malishevës, z.Hajro Paçarizi (IQM), i cili zëvendëson anëtarin e deritanishëm z.Nuhi Shala (IQM), pasi ky i fundit ka dhënë dorëheqje nga KK, për arsye objektive.

Më pas, anëtarët e KK, pasi kanë diskutuar rreth çështjes së shërbimit të maternitetit në QKMF, kanë debatuar rreth shpenzimeve dhe të hyrave në periudhën Janar-Qershor 2014, si dhe kanë formuar dy komisione, i pari komision vlerësues për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe i dyti për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale.

Pas shumë diskutimeve dhe sqarimeve të dhëna nga drejtoria për buxhet dhe financa, anëtarët e KK të Malishevës, miratuan rishikimin e buxhetit për vitin 2014, me propozimet e dhëna nga anëtarët e KK-së. Po ashtu sot miratuan edhe kornizën afatmesme buxhetore për Komunën e Malishevës, për vitin 2015-2017.

Kryetari Begaj priti komandanti turk Topaloğlu

Malishevë, 17 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij komandantin e KFOR-it turk, kolonelin Zorlu Topaloğlu, me të cilin biseduan për çështje të ndryshme, që lidhen me sigurinë përgjithshme në Malishevë dhe për bashkëpunimin e institucionit të Komunës me KFOR-in dhe njësinë e LMT-së në Malishevë.



Kryetari Begaj, e falënderoi komandantin turk, kolonelin Topaloğlu, për vizitën e tij dhe për bashkëpunimin e mirë mes KFOR-it dhe Komunës, si dhe me bashkëpunimin e mirët ë njësisë së LMT-së zvicerane në Malishevë, bashkëpunim i cili u vlerësua lartë nga kryetari Begaj dhe koloneli Topaloğlu.

Komandanti turk i interesua për disa çështje që lidhen me sigurinë e përgjithshme, ndërsa sipas kryetarit Begaj, pavarësisht problemeve socio-ekonomike që janë në Malishevë, siguria është në nivel të mirë, me një situatë të qetë dhe stabile, dhe kjo situatë ka qenë në vazhdimësi që nga përfundimi i luftës.

Sa i përket protestave të fshatit Bubavec, lidhur me privatizimin e pronave, kryetari Begaj, e sqaroi kolonelin Topaloğlu, se ky është një proces jo i mirë, pasi qytetarëve, padrejtësisht ju janë marrë pronat nga ish sistemi dhe sot prapë padrejtësisht privatizohen ato prona.

Begaj e Topaloğlu, kanë biseduar edhe për çështje tjera dhe për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë mes KFOR-it dhe komunës.

Malisheva në përgatitje të festivalit folklorik

Malishevë, 21 korrik

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të së hënës, ku drejtorët kanë raportuar për aktivitetet e tyre javore. Në kudër të kësaj u bë e ditur se janë në përgatitje të mbajtjes së festivalit folklorik, i cili synon të jetë tradicional.

Drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, znj.Blerta Krasniqi, ka bërë të ditur se përgatitjet janë drejt përfundimit, për organizimin e këtij festivali folklorik, i cili do të jetë tradicional, ndërsa pritet që numri i pjesëmarrësve të jetë i madh. Krahas festivalit, do të organizohet edhe një panair artizanal, si dhe një turnir i futbollit të vogël, ku pritet që pjesëmarrës të jenë kryesisht të rinj mërgimtar dhe të rinj tjerë nga Komuna e Malishevës dhe më gjerë.

Në këtë mbledhje, janë diskutuar edhe çështje tjera që lidhen me punët e përditshme të drejtorive komunale dhe angazhimet e drejtorive në realizimin e projekteve të ndryshme, që kanë të bëjnë me rritjen e mirëqenies për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Ndërsa, sipas drejtorit të administratës, z.Ekrem Kastrati, me gjithë rritjen e kërkesave për nxjerrjen e dokumenteve të ndryshme, është rritur volumi i punëve në këtë drejtori, por nuk ka vonesa dhe shërbimet po kryhen normalisht, pa u krijuar tollovi para sporteleve të ofiqarisë.

Largohen nga tregu 412 kg djathë

Malishevë, 21 korrik



Me kërkesën e Agjencionit të Veterinës dhe Ushqimit, inspektorët komunal në Malishevë, kanë ndërmarrë një aksion për largimin nga tregu për disa lloje të djathit, pasi ky produkt nuk është në përputhshmëri me ligjet në fuqi. Gjatë aksionit janë larguar nga tregu 411.9 kilogram djathë i llojeve të ndryshme.

Kështu ka bërë të ditur, të hënën në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, drejtori i drejtorisë së Inspektoratit, z.Sejdi Paçarizi, sipas të cilit, nuk kanë pasur pengesa nga ana e pronarëve të marketeve apo dyqaneve, për largimin e këtyre të llojeve të djathit.

“Largimi nga tregu i këtyre llojeve të djathit, është kërkesë e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës AUV), dhe ky djathë i gjetur, është larguar nga shitja, deri në një vendim tjetër nga ana e AUV”, tha drejtori Paçarizi.

Kryetari Begaj, shtroi iftarin tradicional për familjet e dëshmorëve

Malishevë, 22 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, mbrëmë ka shtruar iftarin tradicional, që komuna organizon për çdo vit, në muajin e madhërisëm të ramazanit, për familjet e dëshmorëve të kombit nga Komuna e Malishevës, ku edhe janë bërë lutje për dëshmorët dhe janë kënduar pjesë të Kuranit, nga ana e hoxhallarëve në kuadër të Bashkësisë Islame të Malishevës.

“Është obligim i yni, i të gjallëve, që ti kujtojmë dëshmorët e kombit, pasi falë tyre ne sot gëzojmë shtetin tonë të lirë. Jemi në muajin e shenjtë të ramazanit dhe kam dashur të bëjmë një darkë së bashku dhe të bëjmë lutje për dëshmorët. Shumë respekt për të gjithë dëshmorët dhe familjet e tyre”, tha kryetari Begaj, duke folur më pas për rëndësinë e sakrificës së dëshmorëve dhe veprën e tyre në luftën për liri.

Për sakrificën e dëshmorëve, foli edhe kreu i Bashkësisë Islame në Malishevë, mulla Xhevat Kryeziu, përderisa ka falënderuar edhe Komunën, për këtë organizim tradicional. Pas kësaj, hoxhallarët, kanë bërë lutje dhe kanë kënduar pjesë Kurani.

Në këtë iftar, përveç familjeve të dëshmorëve, ishin të pranishëm edhe krerët e Bashkësisë Islame në Malishevë, hoxhallarë dhe asamblistë të Komunës së Malishevës.

Filloi rregullimi i dy rrugëve në fshatrat e Malishevës

Malishevë, 22 korrik



Sot ka filluar rregullimi i dy rrugëve të reja, njëra në Plloqicë, ndërsa tjetra është ajo në Kërvasari. Fillimin e punimeve në këto dy rrugë, sot e kanë inspektuar edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizmit z.Urim Kastrati, përderisa banorët e këtyre fshatrave e kanë falënderuar komunën për këtë investim.

Në Plloqicë, do të asfaltohen tri rrugë brenda fshatit me një gjatësi prej 1.06 kilometra dhe lagjet e këtij fshati do të lidhen me shirit kryesor të rrugës e cila i lidh me qendrën komunale, përderisa Plloqica, është njëri prej fshatrave më të largët në Komunën e Malishevës.

Po ashtu edhe në Kërvasari, ka filluar hapja dhe më pas asfaltimi i rrugës së lagjes Kodrali, deri në brendi të fshatit, me një gjatësi prej rreth 1.5 kilometra. Ndërtimi i kësaj rruge ka qenë kërkesë dhe nevojë jetike, për banorët, për tu lidhur me pjesën tjetër të fshatit, pasi deri më tani kanë qenë tërësisht të shkëputur, për shkak të rrugës, ndërsa problemi më i madh ka qenë shkuarja në shkollë e nxënësve, si dhe vizita mjekësore në ambulancën, të cilën deri më tani nuk mund ta vizitojnë.

Ndërtimi i këtyre rrugëve, mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.

Po ashtu kryetari Begaj dhe drejtori Kastrati, kanë inspektuar edhe punimet në shkollën e fshatit Gollubovc, e cila është në ndërtim e sipër, ku Begaj e Kastrati, u ndanë të kënaqur me ecurinë e punimeve në ndërtimin e shkollës.

Komitetit për Planifikim urban, kadastër, mbrojtje të mjedisit, turizëm dhe monitorim të projekteve publike hartoi planin e punës

Malishevë, 23 korrik

Komitetit për Planifikim urban, kadastër, mbrojtje të mjedisit, turizëm dhe monitorim të projekteve publike, kryesuar nga kryesuesi Muhamet Bytyçi, ka mbajtur mbledhjen e dytë të saj, ku pikë të rendit të ditës, kishin hartimin e planit të punës për muajt e mbetur të vitit 2014.

Anëtarët e këtij komiteti, kanë dhënë mendimet e tyre për mënyrën e punës, ku janë pajtuar që ky komitet të mbaj nga dy takime brenda muajit, njërin takim të brendshëm, ndërsa tjetri në teren, si dhe secili anëtar, ta merr përsipër nga një sektor, pasi fusha e veprimit të komitetit është shumë e gjerë.

Anëtarët e komitetit, po ashtu paraqitën nevojën e qasjes më të shpejt në dokumentet që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve, në mënyrë që të mos kenë vonesa në monitorimin e realizimit të projekteve, që realizohen nga paraja publike.

U zbulua busti i dëshmorit Ruzhdi Gjyliqi

Malishevë, 24 korrik



bashkëluftëtari i dëshmorit z.Nuhi Hoxha.

Sot në oborrin e shkollës në fshatin Marali, u bë zbulimi i bustit të dëshmorit të kombit, Ruzhdi Gjyliqi, i cili kishte rënë 16 vite më parë në betejën e Rahovecit. Zbulimin e bustit e bënë, nëna e dëshmorit, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, ish kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj (ish komandant i njësisë “Lumi” të UÇK-së), zv/ministri në detyrë në MPMS, z.Fatmri Shurdhaj dhe

Fillimisht për biografinë e dëshmorit, foli z.Avdullah Bekolli, bashkëluftëtar dhe bashkëkohanik i dëshmorit Ruzhdi Gjyliqi. Bekolli foli për angazhimet e dëshmorit në çështjen

kombëtare dhe angazhimin në UÇK, deri në rënien e tij, në betejën e Rahovecit, i rënë me 24 korrik, ku bie për të mos vdekur kurrë.

Më pas, foli edhe kryetar i Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili tha se” kujtimet e dëshmorit, do të jenë gjithherë në mendjen tonë dhe vepra e tyre do të jetë gjithmonë në historinë e popullit shqiptar, ndërsa ju si familje, bëhuni të fortë dhe të jeni krenar për sakrificën tuaj”. Begaj më pas i uroi për skalitjen në bronz të bustit të dëshmorit.

Ndërsa ish komandanti i njësisë “Lumi”, të UÇK-së, z.Isni Kilaj dhe ish kryetar i Malishevës, tha se “është nderë dhe ka qenë nderë të jesh pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”. “Një prej betejave më të mëdha dhe më të rëndësishme ishte ajo e Rahovecit, ku Malisheva dha shumë dëshmorë, në mesin e tyre ka rënë edhe Ruzhdi Gjyliqi”, tha Kilaj.

Kurse zv/ministri në MPMS, z.Fatmir Shurdhaj, foli për veprën e dëshmorit, si dhe për nevojën e mbrojtjes me ligj të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për respektimin e kësaj vlere nacionale.

Edhe kryetari i degës së LDK-së në Malishevë, z.Januz Kastrati, i uroi për bustin, të gjithë banorët e Maralisë dhe bashkëluftëtarët e dëshmorit dhe në veçanti e uroi familjen Gjyliqi.

Asambleja Komunale miratoi emërtimin e të gjitha rrugëve

Malishevë, 24 korrik

Asambleja Komunale e Malishevës, në vazhdimin e mbledhjes së shtatë të rregullt, dje, ka miratuar propozimin e komisionit komunal për emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Malishevës dhe prej dje pasdite, të gjitha rrugët e Komunës së Malishevës, janë me emrat e tyre.

Asambleja Komunale e Malishevës, dje ka shqyrtuar edhe raportin e punës së Zyrës së Tatimit në Pronë për vitin 2013 dhe planin e punës për vitin 2014, ndërsa pika e cila ka zgjatur më së shumti, ishte trajtimi i raportit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, për përfundimin e vitit shkollor 2013-2014.



Po ashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e asamblesë kanë dëgjuar dhe shqyrtuar dhe raportin e auditorit të brendshëm për vitin 2013 dhe planin e punës për vitin 2014.

Kryetari Begaj takoi bizneset e Malishevës

Malishevë, 25 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka takuar sot përfaqësuesit e bizneseve lokale në Komunën e Malishevës, me qëllim të njoftimit me punën e tyre, me angazhimin e komunës në raport me zhvillimin e biznesit në përgjithësi, sikur edhe është njoftuar më problemet që bizneset përballen gjatë zhvillimit të aktiviteteve të

tyre biznesore.

“Ne si komunë, jemi të interesuar që biznesi të zhvillohet dhe brenda mundësive tona, ne kemi hequr taksat për bizneset, pasi kjo edhe ka qenë mundësia jonë. Po ashtu jemi të interesuar edhe në zhvillimin e bujqësisë si një degë e fuqishme e zhvillimin ekonomik në kushtet tona”, tha mes tjerash Begaj. “E di që keni probleme të ndryshme në zhvillimin e veprimtarisë suaj, dhe dëshiroj që ti dëgjoj nga ju direkt ato probleme dhe të shikojmë mundësitë që kemi për eliminimin e atyre problemeve, nëse janë në mundësi dhe në kompetencë të komunës”, ju tha kryetari Begaj, përfaqësuesve të biznesit në Malishevë.

Edhe kryetari i shoqatës së bizneseve në Malishevë, z.Daut Krasniqi, i njoftoi përfaqësuesit e bizneseve me aktivitetet dhe mundësitë që jep Qendra për Mbështetje të Bizneseve, qoftë për thithjen e granteve të ndryshme, qoftë për mundësitë tjera që ju jep kjo qendër, në zhvillimin e aktiviteteve të bizneseve, duke përfshi trajnimet, këshillat e nevojshme për zhvillimin e



biznesit, mundësitë që përmes bankave, të shfrytëzojnë kredi të leverdishme, siç janë tani kreditë për bizneset, që kanë të bëjnë me eficiencën, etj...


Nga ana tjetër, përfaqësuesit e bizneseve u ankuan, sidomos ata të sektorit të bujqësisë, që nuk kanë marrë subvencionet për vitin e kaluar, si dhe shprehën nevojën për përkrahjen e komunës, në ndërtimin e serrave apo fermave. Ndërsa bizneset hoteliere, u ankuan për konkurrencën e padenjë, pasi disa punojnë më arkë fiskale, ndërsa shumë biznese tjera nuk përdorin arkën fiskale dhe rrjedhimisht dëmtohen.

Malisheva e treta në vend për realizimin e të hyrave vetanake për 2014

Malishevë, 25 korrik

Drejtori i drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi, ka njoftuar sot, se bazuar në raportin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokale, përkatësisht departamentit për zhvillimin dhe bashkëpunim regjional, për të hyrat vetanake në gjashtë mujorin e parë të këtij viti, Komuna e Malishevës, është ë renditur në vendin e tretë.

Sipas këtij raporti, Komuna e Malishevës, ka inkasuar 67.05 për qind të të hyrave të planifikuara vetanake, duke u renditur kështu komuna e tretë në nivel vendi. Po ashtu, sipas këtij raporti, Komuna e Malishevës, krahasuar me periudhën e njëjtë të viti të kaluar, ka realizuar shumë më shumë të hyra, apo nga 30.04 për qind, sa kishte realizuar në periudhën e njëjtë të viti të kaluar, këtë vit ka realizuar 67.05 për qind.



Shi e breshër në Malishevë, i përcjellë me dëme

Malishevë, 25 korrik

Sot pasdite, ka rënë një shi i rrëmbyeshëm i përcjellë me breshër, në territorin e Komunës së



Malishevës, me ç'rast janë shkaktuar dëme të konsiderueshme, sidomos në bujqësi, përderisa janë regjistruar edhe vërshime në disa pjesë të Komunës së Malishevës, ndërsa ekipet emergjente, kanë dalë në teren duke ju dalë në ndihmë qytetarëve.

Sipas drejtorit të drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ahmet Morina, shiu i cili ka filluar pas orës 16:00, ka shkaktuar dëme dhe vërshime, sipas informatave të marra nga terreni, ndërsa ekipet emergjente kanë dalë menjëherë në vendngjarje, ku ka pasur thirrje nga qytetarët.

Sipas njoftimeve të para, është bllokuar rruga Malishevë-Rahovec, konkretisht në lagjen e Gurit në Malishevës, ku vozitësit, duhet të përdorin rrugë alternative. Po ashtu vërshime janë regjistruar edhe në disa lokale afariste.

Ekipet e zjarrfikësve dhe shpëtimit, menjëherë kanë dalë në terren, sikur edhe Policia e Kosovës dhe zyrtarët e drejtorisë komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Kryetari Begaj i uron të gjithë qytetarët me rastin e Fitër Bajramit

Malishevë, 27 korrik

Me rastin e përfundimit të muajit të madhërishtëm të ramazanit dhe në prag të festës së Fitër Bajramit, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i uron të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës.

“Më lejoni që tua uroi festën e Fitër - Bajramit të gjithë besimtarëve mysliman në Malishevë dhe të gjithë qytetarëve tanë që punojnë dhe jetojnë në botën e jashtme . Me fat festa e Fitër Bajramit!”- Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevës.

Dëme të mëdha nga breshëri i së premtës

Malishevë, 29 korrik

Breshëri i para tri ditëve, ka shkaktuar dëme të mëdha, sidomos në fshatrat, Pagarushë, Goriq, Dragobil, Marali, Astrazup e Burim, pasi mendohet se janë shkatërruar pothuajse plotësisht pemët dhe perimet në këto fshatra, si dhe misri është dëmtuar në masë shumë të madhe, ndërsa efekti i dëmeve në pemë, pritet të ndihet edhe në vitin e ardhshëm.



Komisioni komunal, i formuar me qëllim të evidentimit të dëmeve nga breshëri dhe vërshimeve, është duke punuar intensivisht, por sipas asaj që shihet në këto fshatra, dëmet

janë të pariparueshme për këtë vit, ndërsa pasojat e dëmit do të ndihen edhe në vitin e ardhshëm, sepse pemët janë aq shumë të dëmtuara, sa që edhe në vitin tjetër nuk mund të japin rendimente të kënaqshme.

Sipas vlerësimit të komisionit komunal, të bërë deri më sot, dëmet janë shumë të mëdha në të gjitha kulturat bujqësore. Perimtaria është e dëmtuar nga 75% deri në 95%, vreshtaria 80% deri në 100%, perimtaria nga 90 % deri në 100% dhe misri nga 70% deri në 100%.

Fshatrat e prekura nga breshëri janë : Gurishtë, Dragobil, Pagarushë, Marali, Astrazup, Burim dhe Gurbardh, ndërsa sipërfaqja e dëmtuar nga breshëri është mbi 900 hektar. Vlera materiale e dëmeve, ende nuk është caktuar, pasi duhet më shumë kohë për evidentimin e plotë të dëmeve.

Begaj priti çiftin Nelson, donator në ujësjellësin e Drenovcit

Malishevë, 30 korrik

Kryetar i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në takim pune, çiftin Barbara dhe Paul Nelson, përfaqësues të OJQ-së “Jezu Krishti” nga SHBA-të në Kosovë, organizatë e cila është prej donatorëve në ndërtimin e ujësjellësit për fshatin Drenovc, me të cilët ka biseduar për ecurinë e punimeve në ndërtimin e ujësjellësit.



Kryetari Begaj, duke i falënderuar për vizitën dhe donacionin e kësaj organizate, i njoftoi përfaqësuesit e kësaj organizate, me ecurinë e punimeve për ndërtimin e ujësjellësit në Drenovc, ku një fazë e ndërtimit të këtij projekti, është financuar nga kjo OJQ amerikane.

Nga ana tjetër, çifti Nelson, e falënderuan Komunën e Malishevës, për transparencën e plotë dhe për njoftimin e vazhdueshëm lidhur me ecurinë e punimeve në ujësjellësin e këtij fshati.

Kjo OJQ amerikane, ndihmon në ndërtimin e ujësjellësit, me një vlerë prej rreth 100 mijë euro.

Komiteti për shëndetësi mbajti mbledhjen e dytë të radhës

Malishevë, 31 korrik



Komiteti për shëndetësi, mirëqenie sociale, familje të dëshmorëve, invalid dhe veteran të luftës, si dhe për persona me aftësi të kufizuara, organ jo obligativ i Kuvendit i Komunës, ka mbajtur sot mbledhjen e dytë të radhës, ku kanë trajtuar një varg çështjesh që lidhen me qëllimin dhe punën e këtij komiteti.

Komiteti për shëndetësi i udhëhequr nga znj. Arbreshë Krasniqi, së bashku me anëtarët e këtij komiteti, diskutuan rreth gjendjes sociale dhe shëndetësisë në përgjithësi, në Komunën e Malishevës, si dhe për nevojën e marrjes së informacioneve më të kompletuara nga organet përkatëse dhe grupet e interesit, në mënyrë që ky komitet të trajtoj të gjitha problemet që mund të ekzistojnë dhe të procedojnë ato tek organet kompetent.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 129-Gusht 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë mbajtjes së festivalit folklorik
"Oda e Llapushës"

U hap panairi artizanal në Malishevë

Malishevë, 1 gusht



Krahas mbajtjes së Festivalit Folklorik “Oda e Llapushës”, në Malishevë, sot është hapur edhe panairi artizanal, ku po prezantohen punimet e dorës si dhe të ushqimeve tradicionale, me qëllim të ruajtjes së traditës dhe njoftimit të gjeneratave të reja me traditën shqiptare.

Krahas veshjeve popullore dhe punimeve tjera zbukuruese, në këtë panair janë të prezantuara edhe çiftelitë dhe punimet nga druri, materiale tjera “jana” e “qilima”, veshje tjera tradicionale, pastaj ushqime tradicionale, si flija dhe ëmbëlsira.

Hapjen e panairit e bëri nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, i cili i inkurajoi ata që merren me zhvillimin e kësaj veprimtarie dhe kultivimin e traditës.

Këtë panairi, po e vizitojnë shumë qytetar, ndërsa më kureshtar duket të jenë mërgimtarët, të cilët edhe janë blerësit kryesor në këtë panair.

Përfundoi nata e parë e festivalit “Oda e Llapushës”

Malishevë, 1 gusht

Sonte në Malishevë, është mbajtur nata e parë e festivalit mbarëkombëtar e festivalit folklorik “Oda e Llapushës”, edicioni i parë. Ky festival organizohet dhe mbahet nën përkujdesjen e Komunës së Malishevës, ndërsa pjesëmarrës në këtë festival janë ansamble, shoqëri kulturore dhe artistike, dhe rapsod nga të gjitha trevat shqiptare.



Këtë festival e ka hapur i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili i uroi të gjithë pjesëmarrësit dhe ju dëshiroi suksese në këtë festival. “Malisheva është njëra prej trevave që më shumti i ka dhënë muzikës shqiptare” tha kryetari Begaj, duke e përmendur këtu rapsodët Salih e Feriz Krasniqi, Sefë Mleqani, e deri te bilbili i këngës shqipe Nexhmije Pagarusha.

Në pas, ne skenë kanë dalë ansamblet dhe grupet artistike të këngëve dhe valleve, si dhe rapsod nga të gjitha trojet shqiptare, të cilët sollën këngët më të bukura nga tradita jonë e folklorit, si dhe këngë të reja, ndërsa nuk kanë munguar as vallet dhe lojërat tradicionale, të cilat i interpretuan SHKA-të dhe ansamblet artistike.

Festivali vazhdon nesër me natën e dytë, ku edhe do të ndahen e çmimet e festivalit.

Përfundoi festivali “Oda e Llapushës”, fitues SHKA “Shote Galica” dhe bijtë e Sefë Mleqanit

Malishevë, 3 gusht



Mbrëmë në orët e vona, ka përfunduar festivali mbarëkombëtar folklorik “Oda e Llapushës”, i organizuar nga Komuna e Malishevës, përkatësisht drejtoria për Kulturë, rini dhe Sport, festival i cili është mbajtur në kuadër të shënimit të Ditëve të Mërgatës. Fitues të këtij festivali, ishin SHKA “Shote Galica” nga Drenasi dhe bijtë e Sefë Mleqanit nga Mleqani i Malishevës.

“Këto dy ditë Malisheva pas gjithë atyre sakrificave e flijimeve sublime e krenare ka festë, ka festën e folklorit burimorë që çdo herë jehoi me bukurinë dhe melodinë e tij në këtë trevë. Ju të gjithë pjesëmarrës nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, nga Lugina e Preshevës e nga Diaspora që çdo herë kontribuoni shumë na zbukuroat qytetin tonë, dhatë dritë me zërin tuaj të bukur e me vallet e mrekullueshme edhe atëherë kur dritat elektrike nuk na punonin mirë”, tha mes tjerash në fjalën e hapjes së natës finale, drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, znj. Blerta Krasniqi, e cila i falënderoi të gjithë për kontributin e dhënë në mbajtjen e festivalit.

Pas paraqitjes në dy netët e festivalit, juria profesionale në përbërje nga prof. Dr. Adem Zejnullahu, prof. Dr. Mehmet Rukiqi dhe Sami Piraj, i kanë vlerësuar rapsodët dhe grupet, ku vendi i parë dhe çmimi kryesor i festivalit “Sali e Feriz Krasniqi”, ju nda SHKA “Shote Galica” nga Drenasi dhe rapsodëve “Bijtë e Sefë Mleqanit” nga Mleqani. Vendi i dytë ju nda



“Vëllezrve Kryeziu” nga Mleqani dhe vendi i tretë po ashtu u nda rapsodëve Bajram Baja me grupin nga Banja dhe SylëNishorit nga Theranda.

Çmimi i “Veterani i folklorit” ju nda rapsodit Sejdi Morina, ndërsa çmimi “BeqirGashi”, për debutuesit më të mirë ju nda Pëllumb Gashit nga Drenasi dhe çmimi i karrierës ju nda rapsodit Ali Krasniqi.

Çmimin kryesor “Sali e Feriz Krasniqi” e ka ndarë, kryetari i Komunës së Malishevës, z.RagipBegaj.

Ky festival, do të jetë tradicional.

Këtë vit asnjë rast me vdekje nga ethet hemorragjike

Malishevë, 4 gusht

“**K**ëtë vit nuk kemi asnjë rast të vdekjeve nga ethet hemorragjike krime kongo, së paku deri më sot dhe unë i falënderoj të gjithë ata që kanë qenë të angazhuar në fushatat për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK)”, ka thënë kryetari i Malishevës, z.RagipBegaj në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve.

Nga ana tjetër, drejtori i shëndetësisë, z.Hajdin Berisha, tha se “pavarësisht numrit të rasteve të thumbuar nga rriqrat, përveç që s’kemi asnjë rast të vdekur këtë vit, momentalisht situata është shumë e mirë dhe nuk kemi asnjë rast të infektuar apo që është duke u trajtuar në klinikën infektive të QKUK-së. Por pavarësisht kësaj ne do të vazhdojmë të jemi në përcjellje të vazhdueshme të situatës dhe shpresoj të mos kemi as raste tjera të infektuara me EHKK”.

Në mbledhjen e bordit të drejtorëve, nga përgjegjësit e drejtorive, u bë e ditur se intervistimi për pranimin e mësimdhënësve do të filloj me 6 gusht, ndërsa u raportua për dëme të konsiderueshme nga breshëri, ku sipas të dhënave janë dëmtuar rreth 900 hektar me kultura të ndryshme. Shiu i këtij viti, ka ndikuar edhe në të hyrat në pishinat e Banjës, ku ka pasur pak vizitor.

Sa i përket investimeve kapitale, u bë e ditur se janë duke vazhduar punimet në disa shkolla, ndërsa brenda javës pritet të filloj ndërtimi edhe i shkollës në Carrallukë, çerdhja për fëmijë në përfundim e sipër, përderisa janë duke vazhduar punimet në asfaltimin e disa rrugëve,

pastaj faza e dytë e ujësjellësit në Drenovc, si dhe pritet që gjatë javës të filloj ndërtim i kanalizimeve në dhjetë fshatra.

Sipas financave, kohëve të fundit, ka filluar të rriten të hyrat vetanake, përderisa sipas MEF-it, Malisheva është komuna e tretë më e mira në inkasimin e të hyrave të hyrave vetanake, këtë vit.

Po ashtu në mbledhje, u vlerësua edhe mbajtja e festivalit mbarëkombëtar të folklorit “Oda e Llapushës”, si dhe u bë ë ditur edhe për përgatitjet e mbajtjes së kampit veror me të rinjtë.

Kryetari Begaj takoi përfaqësuesit e UNHABITAT-it

Malishevë, 5 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune, znj.Catarina Camarinas, zyrtare e zyrës së UNHABITAT-it në Kosovë, me të cilën ka biseduar për dy projekte që janë duke u realizuar në Malishevë, ai i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe zgjerimi i urës në Malishevë.

Me këtë rast kryetari Begaj, e ka falënderuar zyrtaren e UNHABITAT-it, për përkrahjen e kësaj zyre, në hartimin e PZHK. “Hartimi i PZHK-së, është një punë e madhe, por që frytet e saj do të shihen në të ardhmen”, tha Begaj, duke e marrë shembull zgjerimin e urës kryesore në Malishevë. Kryetari Begaj, dha edhe vërejtjet e tij lidhur me vonesat në hartimet e ligjeve dhe udhëzimeve të nevojshme, pasi sipas tij “kjo vonës po ndikon drejtpërdrejt edhe në zhvillimin e komunave”.

Nga ana tjetër, znj, Camarinas, duke lavdëruar PZHK-në, tha se “ Malisheva është komuna e vetme e cila e ka të hartuar planin zhvillimor komunal në përputhshmëri me ligjin për planifikimin hapësinor. Por vonesa në hartimin e këtij ligji dhe tani vonesa në nxjerrjen e udhëzimit administrativ, është duke e vonuar edhe finalizimin e PZHK-së në Malishevë, pasi projekti i përkrahjes së UNHABITAT-it, përfundon këtë vit, ndërsa duke shumë e vështirë nxjerrja e udhëzimit para përfundimit të projektit”.

U vlerësua lartë edhe puna në zgjerimin e urës kryesore në Malishevë, projekt i cili gjithashtu realizohet në bashkëpunim mes Komunës së Malishevës dhe UNHABITAT-it.

Filloi ndërtimi i shkollës në Carrallukë

Malishevë, 6 gusht



Sot, në fshatin Carrallukë, kanë filluar punimet në ndërtimin e objektit të ri, të shkollës fillore dhe të mesme të ulët (SHMU) “Imer Krasniqi. Në ceremoninë e vënies së gurëthemelit morën pjesë kryetari i Malishevës, z.RagipBegaj, drejtori i arsimit z.Blerim Thaçi, dhe qytetarë të shumtë nga fshati Carrallukë.

“Jam i nderuar ta vë gurëthemelin e kësaj shkolle, e cila mban emrin e një njeriu të madh, emrin e Imer Krasniqit, i cili është një emër i madh në historinë më të re të Malishevës. Ne si komunë, kemi obligim të krijojmë kushte më të mira në shkollat tona dhe të rrisim cilësinë, për arsimimin e fëmijëve tanë. Ky objekt që po fillojmë sot ta ndërtojmë, nuk është vetëm meritë e jona, por e të gjithëve së bashku”, tha mes tjerash i pari i Malishevës, z.RagipBegaj, në fjalën e rastit.

Ndërsa drejtoresha e SHMU “Imer Krasniqi”, znj.Fatime Krasniqi (vajza e dëshmorit Imer Krasniqi), duke folur në këtë ceremoni, përveç falënderimeve për Komunën e Malishevës, për ndërtimin e objektit të shkollës, kujtoi me emocione edhe angazhimet e dikurshme të prindit të saj, për ndërtimin e kësaj shkolle, e cila tash mban emrin e tij dhe përpjekjet e dëshmorit Imer Krasniqi, për shkollimin e brezave të rinj.

Pas këtyre fjalimeve, është vënë gurëthemeli i objektit të ri të kësaj shkolle, gurëthemel të cilën e bënte Kryetari i Malishevës, z.RagipBegaj, drejtori komunal për arsim, z.Blerim Thaçi, drejtoresha e shkollës, znj.Fatime Krasniqi dhe veterani i arsimit z.DalipGashi.

Objekti i ri i shkollës do të ketë rreth 1600 metra katrorë dhe do të kushtoj mbi 330 mijë euro. Ndërtimi i shkollës mundësohet nga buxheti komunal i Malishevës dhe është projekt dyvjeçar.



Pritet rehabilitimi i nëntë ujësjellësve në Malishevë

Malishevë, 6 gusht

Krahas investimit në ujëmbledhësin e Senikut, që do të furnizoj dymbëdhjetë fshatra të Malishevës me ujë për pije, pritet që brenda vitit të rehabilitohen edhe nëntë ujësjellës ekzistues. Këto investime do të bëhen në kuadër të një projekti të cilin e zbaton CDI në. Këto janë fonde të qeverisë zvicerane dhe implementohen nga CommunityDevelopmentInitiative (CDI) dhe Dorsch.

Për këtë program që do të investohet në nëntë fshatra të Malishevës, kryetari i Komunës së Malishevës, z.RagipBegaj, së bashku me zyrtarët e Hidroregjionit jugor dhe zyrtarët e CDI-së, kanë mbajtur një takim me përfaqësuesit e nëntë fshatrave, që janë përfitues të këtij projekti për rehabilitimin e ujësjellësve. Rehabilitimi pritet të bëhet për fshatrat Astrazup, Bellanicë, Dragobil, Bardh, Maxharrë, Shkozë, Guncat, Panorç dhe Tërpezë.

Kryetari Begaj, këtë projekt e ka cilësuar si shumë të rëndësishëm. “Përmes rehabilitimit të këtyre ujësjellësve do të rritet cilësia dhe mirëqenia e qytetarëve të Komunës së Malishevës”, tha në fjalën e tij kryetari i Malishevës, z.RagipBegaj.

Ndërsa Lavdim Osmani, nga CDI-ja, i ka njoftuar përfaqësuesit e fshatrave me programin të cilin e realizon CDI. Sipas tij Malisheva ka përfituar në dy projekte shumë me rëndësi, ku njëri prej tyre është rehabilitimi i këtyre nëntë ujësjellësve, të cilët edhe do të futen në sistem të menaxhimit. Sipas tij rehabilitimi do të bëhet i kompletuar nga burimi i ujit, deri tek ujëmatësi.

Edhe zyrtarët e Hidroregjionit, i kanë sqaruar përfaqësuesit e fshatrave për këtë projekt, ku sipas tyre, do të eliminohen të gjitha defektet e mundshme në këta ujësjellës, si dhe do të bëhet edhe rritja e kapaciteteve të ujit dhe cilësia e ujit.

Në këtë takim, u bë e ditur, se për të realizuar këto investime, këta ujësjellës duhet të futen në menaxhim të hidroregjionit jugor.



Nga Mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Malishevë, 18 gusht

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të së hënës, ku drejtorët kanë raportuar për aktivitetet e tyre javore, ku dhe u bë e ditur që në shtator të këtij viti, objekti i ri shkollor në Vërmicë do të hapet zyrtarisht.

Ndër projektet e shumta të cilat janë duke u realizuar në Komunën e Malishevës, si në shkolla, rrugë, kanalizime, ujësjellës etj, drejtori për Urbanizëm z.Urim Kastrati bëri të ditur në këtë mbledhje që shkolla në Vërmicë pritet të finalizohet së shpejti dhe në shtator nxënësit e këtij fshati do të vijon mësimet në objektin e ri shkollor.

Nga ana tjetër drejtori për Shëndetësi z.Hajdin Bersisha tha “Sa i përket situatës me ethet hemorragjike kemi lajme të mira gjithsesi, dhe qysh tash mund të flasim për rezultatet e para të një punë të madhe që është bërë nga shumë faktor nga shumë segmente, ngase në tri ditët e fundit kemi vetëm një rast në Malishevë që është lajmëruar me rriqër në QKMF, dhe nuk kemi asnjë të dyshuar apo të infektuar. Krahasuar me vitin e kaluar kemi rënje të numrit të përgjithshëm të të pickuarve, të infektuarve, të atyre që kanë rezultuar me virus pozitiv, dhe ajo më kryesorja është që kemi zero persona që kanë përfunduar me fatalitet që është dallim i madh me vitin e kaluar ku kemi pasur gjashtë persona të vdekur” tha drejtoi Berisha.

Në këtë mbledhje, janë diskutuar edhe çështje tjera që lidhen me punët e përditshme të drejtorive komunale dhe angazhimet e drejtorive në realizimin e projekteve të ndryshme, që kanë të bëjnë me rritjen e mirëqenies për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e KFOR-it zviceran

Malishevë, 19 gusht

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj ka pritur sot në zyrën e tij përfaqësuesin e KFOR-it zviceran (LMT), kapitenin Rüst Gaudenz, me të cilin biseduan rreth bashkëpunimit të ndërsjellët në fushën e sigurisë, si dhe aspekte tjera të përgjithshme rreth fushës së sigurisë në Malishevë.

Kryetari Begaj falënderoi kapitenin Rüst dhe KFOR-in zviceran (LMT) në përgjithsi, për bashkëpunim të mirë që kanë me Komunën e Malishevës në çështjet e sigurisë së përgjithshme, dhe u shpreh i gatshëm për bashkëpunim të mëtejshëm dhe të ndërsjellët me KFOR-in (LMT).



Gjendja sigurisë së përgjithshme, si nga ana e KFOR-it (LMT), po ashtu edhe nga Kryetari Begaj u vlerësua e qetë në komunë dhe pa incidente të cilat mund ta prishin sigurinë e përgjithshme në Komunën e Malishevë.

Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 19 gusht



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i drejtuar nga kryesuesi z.Enver Hoti, ka mbajtur sot mbledhjen e VII (shtatë) të radhës, ku veç rendit të ditës janë trajtuar disa nga pikat e mbledhjeve të kaluara, janë dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Anëtarët e KPF-së, veç rendit të ditës kanë miratuar dhe rekomanduar për kuvend kërkesën për marrjen e vendimit për dhënien në shfrytëzim të Hapësirave përmbi objektin e Kullës në Qytezën e Malishevës me qëllim të vendosjes së antenave të telefonisë mobile, si dhe raportin financiar Janar-Dhjetor 2013 nga K.R.M “Ekoregjioni” SH.A, njësia operative në Malishevë, raporti vjetor i punës për vitin 2013, dhe Plani operativ i shërbimit të mbeturinave dhe zgjerimi për vitin 2014, pika këto nga mbledhjet e kaluara.

Ndërsa pika tjera të cilat u shqyrtuan dhe u rekomanduan për kuvend ishte raporti i punës për vitin 2013 i Qendrës për punë sociale dhe plani i punës për 2014, pastaj raporti i punës për vitin 2013 i zyrës së prokurimit dhe plani i punës për 2014, kërkesa këto që vijn nga LDK.

Rekomandim për kuvend anëtarët e KPF-së dhanë edhe raportin e DKAE-së për fillimin e vitit shkollor për vitin 2014/15, pik tjetër e rekomanduar ishte edhe shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve nga komisioni komunal për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Malishevës.

AAK dhe Komuna nënshkruan marrëveshje për regjistrimin e pronave

Malishevë, 7 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), z.Murat Meha, kanë nënshkruar sot një marrëveshje mirëkuptimi mes dy institucioneve, për realizimin e projektit të regjistrimit të pronës së paluajtshme në kadastrë.

Me këtë rast kryetari Begaj, i ka falënderuar zyrtarët e AKK-së,

për këtë projekt, duke e quajtur si shumë të rëndësishëm, pasi tek ne mungojnë të dhënat për pronarët faktik të pronave dhe për kompletimin e të dhënave kadastrale dhe regjistrimin e tyre.

Nga ana tjetër kryeshefi ekzekutiv i AKK-së, z.Murat Meha, duke sqaruar këtë projekt, i cili përkrahet nga Banka Botërore, tha se përfitimet janë të dy anshme, si për komunën, ashtu edhe për vet qytetarët, pasi regjistrimi i pronave do të kryhet falas, përjashtuar rastet e trashëgimisë.

Ky projekt, fillimisht do të zbatohet në gjashtë zona kadastrale, për të vazhduar më pas me zonat tjera, ndërsa Komuna e Malishevës, është prej përfitueseve të këtij projekti.

Filloi asfaltim i rrugëve në Plloqicë

Malishevë, 8 gusht

Sot në fshatin Plloqicë, ka filluar asfaltimi i rrugëve brenda fshatit. Në fillimin e punimeve kanë marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar edhe nga drejtori i urbanizmit, z.Urim Kastrati, dhe me këtë rast i kanë uruar banorët e këtij fshati, për asfaltimin e rrugëve brenda fshatit. kryesore.

“Kam premtuar se prioritet i angazhimeve të mia, do të jenë vendbanimet më të largëta, ato vendbanime ku kanë munguar investimet, ose që ka pasur më pak investime, dhe gradualisht jam duke i realizuar këto premtime”, ka thënë mes tjerash kryetari Begaj,



“Unë ju uroj juve të gjithëve për rrugët e fshatit dhe uroj ti gëzoni dhe ti trashëgoni këto investime, të cilat rrisin cilësinë e jetesës dhe mirëqenien e qytetarëve tanë”, tha kryetari Begaj, duke i uruar banorët e Plloqicës.

Rrugët brenda fshatit, kapin një gjatësi prej më shumë se një kilometër dhe përfshin rrugët e disa lagjeve, të cilat lidhen me rrugën. Rruga që ka filluar të asfaltohet gjatë ditës së sotme, pritet të përfundoj brenda dy ditëve, ku përfshihen edhe punët tjera, përgjatë rrugës së asfaltuar.

Qarkorja e dytë buxhetore, minus 600 mijë euro në investime kapitale

Malishevë, 11 gusht

Qeveria komunale e Malishevës, ka shprehur sot pakënaqësinë e saj, lidhur me qarkoren e dytë buxhetore për vitin 2015, të cilën e ka dërguar Ministria e Financave, pasi sipas kësaj qarkore, në investimet kapitale janë paraparë të ndahen mbi 600 mijë euro më pak se në vitin 2014, ndërsa po sipas kësaj qarkore, nuk parashihet as rritja e stafit të punëtorëve, i paraparë për çerdhen e fëmijëve dhe shkollën në fshatin Vërmicë.

Ky shqetësim është ngritur sot nga drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, ku sipas tij, shikuar në vija të trasha, pavarësisht rritjes së vogël të buxhetit për shkak të rritjes së pagave, jemi të diskriminuar në investime kapitale dhe në rritjen e stafit, e kjo e fundit rrezikon seriozisht hapjen e shkollës në Vërmicë dhe çerdhes për fëmijë.

Lidhur me këtë, Kryetari Begaj, shprehi pakënaqësinë e tij. “Kemi menduar për zhvillim e jo për ulje të buxhetit. Kjo është dobësi e qeverisë sonë, pasi për realizimin e rritjes së pagave, na kanë dëmtuar seriozisht në buxhetin e komunës, e ky zvogëlim do të ndikoj seriozisht në punën dhe planifikimet komunale për vitin 2015, pa fajin tonë”, ka thënë mes tjerash Begaj.

Përndryshe në mbledhjen e sotme të qeverisë komunale, u raportua për shumë aksidente, sidomos në rrugën e kombit “Ibrahim Rugova”, ku thajse çdo ditë duhet intervenimi i ekipeve të shpëtimit.

Po ashtu, në këtë mbledhje nga drejtoritë përkatëse, u bë e ditur se dëmtimi i “Tumës ilire”, në Malishevë, duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme, dhe se ekipet vlerësuese, do ta bëjnë edhe incizimin e vendit dhe shkallën e dëmtimit të tumës, e cila është në mbrojtje, përderisa është dëmtuar nga një pronar i një lokali hotelier që gjendet në afërsi, e sipas zyrtarëve komunal, është bërë ndërhyrje pa leje. Po ashtu, u bë e ditur, se reklamat pa leje nëpër qytet, kanë afat ti largojnë ato, deri të martën .

Përndryshe në Malishevë, sipas drejtorive komunale, janë duke vazhduar punimet në realizimin e shumë projekteve, si rrugë, shkolla, ujësjellës dhe projekte tjera, pastaj përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollorë.

Komuna dhe Kryqi i Kuq i Kosovës, vazhdojnë bashkëpunimin e mirë

Malishevë, 11 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim, sekretaren e përgjithshme të Kryqit të Kuq të Kosovës (KKK), znj.Feride Hyseni, ku kanë biseduar për bashkëpunimin e ndërsjellë mes komunë dhe KKK, dhe për vazhdimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen, përderisa bashkëpunimi i deritanishëm ka qenë shumë i mirë dhe i suksesshëm.

Kryetari Begaj, e ka falënderua sekretaren Hyseni, për bashkëpunimin e deritanishëm, sidomos për përkrahjen e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe rolin e tyre, për ndërtimin e

ujësjellësit për fshatin Drenovc, ku KKK, ishte ndërmjetësues me një organizatë amerikane, e cila ka dhënë rreth 100 mijë euro për atë ujësjellës. “Bashkëpunimi nuk ka munguar as në fusha tjera, sidomos, për ti ndihmuar personat dhe familjet në nevojë. Ne në shumë raste, ndihmat apo donacionet që eventualisht marrim, i shpërndajmë përmes Kryqit të Kuq”, tha Begaj.

Nga an tjetër, sekretarja e KKK, znj.Hyseni, e falënderoi kryetarin për gatishmërinë e tij të vazhdueshme, për bashkëpunim të ndërsjellë, me KKK, zyra në Malishevë, por edhe me qendrën e KKK në Prishtinë. “Ne ju jemi mirënjohës për bashkëpunimin e ndërsjellë dhe ne dëshirojmë që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen”, tha Hyseni.

Inspektorët komunal largojnë ndërtimin pa leje mbi “Tumën ilire”

Malishevë, 14 gusht



Drejtorja e Inspektoratit në Malishevë, sot ka filluar largimin e ndërtimit pa leje, mbi “Tumën Ilire”, në afërsi të qendrës së qytetit në Malishevë. Mbi këtë hapësirë, po largohet një fontanë dhe një hapësirë me kubëza betoni, të vendosura nga pronari i një lokali afarist hotelier, ndërsa kjo hapësirë, do të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Në largimin e këtij ndërtimi, inspektorët komunalë, kanë qenë të shoqëruar edhe nga Policia e Kosovës, por nuk ka pasur rezistencë nga ana e pronarit dhe nuk është regjistruar asnjë incident.

Kthimin në gjendjen e mëparshme të “Tumës Ilire” e kishte kërkuar edhe Instituti Arkeologjik i Kosovës (IAK), pas një inspektimi që kishin bërë në këtë hapësirë, në shkresën dërguar në organet përkatëse, kishin kërkuar që urgjentisht, bazuar në ligjin mbi Trashëgimin Kulturore, të largohen kubëzat, fontana dhe tavolinat e vendosura, pasi sipas IAK, pronari ka vepruar jashtëligjshëm.

Po ashtu bazuar në dokumentacionin në drejtorinë komunale për urbanizëm, ai ndërtim në atë hapësirë, është bërë pa leje ndërtimore.

Kjo hapësirë e cila supozohet të jetë “Tumë Ilirie”, në vitin 2000, me vendim të Komunës së Malishevës, është shpallur zonë e mbrojtur, e po ashtu kjo Tumë, është e mbrojtur edhe me ligj dhe është në listën e Trashëgimisë Kulturore të MKRS-së, me numër rendor 161, statusi/nr. vendimit 0301-8000/88, me numër unik të Databazës 003016.

Me këtë rast, mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L-28, Ligjin e Ndërtimit nr.04/L-110, Ligjit mbi Trashëgimin Kulturore nr.02/L-88, Vendimit të Kryetarit të Komunës së Malishevës nr.01.112/00, shkresës së IAK nr.152-03, shkresës nga drejtoria e Urbanizmit nr.05/174, procesverbaleve të inspektorëve, drejtori i Inspektoratit ka dhënë urdhëresë, për kthimin në gjendjen e mëparshme, ku është kërkuar që fillimisht kjo të bëhet nga pronari në mënyrë vullnetare, apo në të kundërtën, konform rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, të veprohet në kthimin e gjendjes së mëparshme të asaj hapësire.

Deri në ditën e premte, hapësira pritet të kthehet në gjendjen e mëparshme.

OSBE do të përkrah komunën në punëtorinë për hartimin e buxhetit

Malishevë, 20 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune, ekipin e OSBE-së, për Komunën e Malishevës, me të cilët ka biseduar për çështje të ndryshme, që lidhen me punën e Komunës, ndërsa OSBE ka ofruar përkrahjen e saj për organizimin e punëtorisë për hartimin e buxhetit komunal, për vitin 2015.

Fillimisht kryetari Begaj, është njoftuar me anëtarin e ri të ekipit të OSBE-së, z.Yusuke Hara, i cili zëvendëson anëtarin e deritanishme, znj.Kristina Jovanovska.



Ekipi i OSBE-së, ka ofruar mbështetjen e saj teknike, për drejtorinë për Buxhet dhe Financa, në organizimin e punëtorisë që ka të bëjë me hartimin e buxhetit për vitin e ardhshëm, në mënyrë që pjesëmarrja përfaqësuesve të fshatrave të jetë sa më e mirë dhe kontributi i tyre në hartimin e buxhetit të jetë sa më i madh, me qëllim të hartimit të buxhetit në harmoni me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, ndërsa është vlerësuar si një hap shumë demokratik dhe shumë transparent, kjo formë e përpilimit të buxhetit, para se ai të dërgohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

“Politikat e mia, janë të orientuar në këtë formë, që qytetari të jetë drejtpërdrejt i kyçur në vendimmarrje, prandaj edhe shqyrtimin e buxhetit e kemi paraparë në këtë formë, që hartimi i buxheti të bëhet nga qytetarët, bazuar në nevojat dhe kërkesat e tyre dhe që termi transparencë të mos përdoret vetëm në deklarata publike, por të transparenca të praktikohet”, tha kryetari Begaj, duke e arsyetuar formën e hartimit të buxhetit, në bashkëpunim me qytetarët.

Begaj dhe ekipi i komunal i OSBE-së, kanë biseduar edhe për punët e përditshme dhe për bashkëpunimin e mirë mes Komunës së Malishevës dhe OSBE-së, pastaj rrjedhat në Asamblenë Komunale dhe çështje tjera.

Me gjithë fluksin e madh, shërbimet komunale kanë qenë në nivel

Malishevë, 25 gusht

Me gjithë numrin e madh të qytetarëve, të cilët kanë pasur nevojë për nxjerrjen e dokumenteve të ndryshme në komunë, gjatë këtyre dy muajve, sidomos në shërbimin e ofiqarisë, shërbimet u janë ofruar pa vonesa dhe nuk ka pasur ankesa. Kështu u tha në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Përgjegjësi në shërbimin e ofiqarisë, z.Agim Morina, tha se me gjithë fluksin shumë të madh të qytetarëve, në veçanti mërgimtarëve, nuk ka pasur vonesa në shërbimin e ofiqarisë dhe shërbimet tjera në administratë.

Fluks të madh, ka pasur edhe në qendrën kryesore të mjekësisë familjare në Malishevë, gjatë muajve të fundit, dhe të gjithëve u janë ofruar shërbimet e nevojshme, tha edhe drejtori për shëndetësi z.Hajdin Berisha.

Ndërsa drejtori i arsimit, z.Blerim Thaçi, raportoi për angazhimet e drejtorisë për arsim dhe edukim, në përgatitje të viti të ri shkollor që duhet të filloj javën tjetër.

Edhe drejtorët tjerë, raportuan për punët dhe aktivitete të drejtorive, ku përfshihen emergjenca, urbanizimi, inspektorati, shërbimet publike, bujqësia, gjeodezia dhe kadastri, etj.

Komuna e Malishevës, është në vllugun e punës edhe për hartimin e buxhetit komunal për vitin 2015 dhe kornizës afatmesme buxhetore 2015-2017. Sipas drejtorit për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, drejtorja që ai udhëheq, është në përgatitje e sipër të buxhetit për vitin e ardhshëm, ndërsa në ditët në vijim do të ketë edhe debate me qytetar, në mënyrë që buxheti, në veçanti prioritetet për projekte kapitale, të jenë në harmoni me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Përkujtohet dëshmorët e Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova”

Kleçkë-Malishevë, 25 gusht

Një delegacion i Komunës së Malishevës, i prirë nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtor të drejtorive komunale, kanë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në fshatin Kleçkë, ku janë përkujtuar dëshmorët e Brigadës 121 të UÇK-së, brigadë e cila mbante emrin e dëshmorit të kombit Ismet Jashari – Kumanova.



K i Malishevës mori dy vendime dhe miratoi disa raporte

Malishevë, 26 gusht



Kuvendi i Komunës së Malishevës, kryesuar nga kryesuesi z.Enver Hoti, ka mbajtur sot mbledhjen e tetë të rregullt, ku mori dy vendime dhe miratoi dy raporte dhe një propozim për disa ndryshime në statutin e Komunës. Në mbledhje mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Në fillimin e mbledhjes së sotshme, ka dhënë betimin edhe anëtarja e re e KK të Malishevës, znj.Florianë Demaj, e cila e zëvendëson ish anëtarën e KK-së, znj. Shurie Bytyçin, e cila tanë është deputete e Kuvendit të Kosovës.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, me shumicë të votave, ka miratuar kërkesën e kryetarit për dhënien në shfrytëzim të hapësirës publike, mbi objektin e sahat kullës në Malishevës, për vendosjen e antenave të telefonisë mobile, me kushtet e parapara nga ana e Kuvendit të Komunës.

Po ashtu KK i Malishevës, mori vendim për ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për tri kërkesa të qytetarëve.

Ndërsa kuvendi sot ka shqyrtuar edhe raportin e punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2013 dhe planin e punës për vitin 2014, por me shumicë të votave nuk e ka miratuar këtë raport, ndërsa ka miratuar raportin financiar për vitin 2013 dhe planin operativ të shërbimit të largimit të mbeturinave nga ana e njësisë së “Ekoregjonit” në Malishevë, përderisa këtu kërkuan që të bëhet kategorizimi i familjeve dhe jo çmimi të jetë për të gjitha familjet i njëjtë, pasi numri i banorëve nuk është i njëjtë në çdo familje.

Kuvendi i Komunës, sot miratoi edhe propozimet e grupit punues për ndryshimet në statutin e Komunës së Malishevës, para se ky projekt propozim, të del në diskutim publik.

Komiteti i arsimit i uron fillimin e vitit të ri shkollor

Malishevë, 27 gusht



“Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, në emër të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport, i urojmë të gjithë nxënësit, mësimdhënësit dhe në veçanti i urojmë ata të cilët për herë të parë ulen në bankat shkollore”, tha kryesuesi i këtij komiteti, z.Januz Kastrati, në mbledhjen e rregullt të komitetit.

Përndryshe në mbledhjen e sotme të komitetit, ka raportuar drejtori për arsim dhe edukim, z.Blerim Thaçi, rreth konkursit për zgjedhjen e drejtorëve dhe kuadrit mësimor, si dhe për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2014/15. Sipas drejtorit Thaçi, drejtorja është munduar që ti përmbahet ligjeve dhe rregullore ne fuqi, për zgjedhjen e drejtorëve dhe të kuadrit mësimor, ndërsa sipas tij, janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e procesit mësimor për këtë vit shkollor.

Sipas drejtorit Thaçi, për 147 vende punë në shkollat e Komunës së Malishevës, kanë aplikuar 1616 kandidat, apo mesatarisht 10.9 kandidat për një vend, ndërsa vetëm në Qendrën e Kompetencës, për 33 vende kanë aplikuar 412 kandidat, apo 12.6 kandidat për një vend.

Komiteti në këtë mbledhje, ka formuar edhe një komision hetimor, për hulumtimin e mënyrës së ndarjes së bursave nga ana e drejtorisë dhe për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave. Komisioni është i përbërë nga tre anëtar: Valon Hoti (VV) kryesues, Veton Telaku (PDK) anëtar dhe Liridona Maloku (IQM) anëtare.

U mbajt Kampi Rinor dy ditor në malet e Berishës

Malishevë, 27 gusht

Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Qendrën e Rinisë së Malishevës, kanë organizuar Kapin Rinor, dy ditor, i cili u mbajt me datë 25 dhe 26 gusht 2014 në Vargmalet e Berishës. Në këtë kamping morën pjesë 30 të rinj.



Gjatë këtyre dy ditëve të aktiviteteve u mbajtën edhe disa ligjërata nga përfaqësuesit e Policisë së Kosovës nga stacioni i Malishevës me temën "Siguria në trafik dhe siguria e përgjithshme" dhe ligjërata nga përfaqësuesit e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), me temën "Sëmundjet seksualisht të transmetueshme". Ndër tjera në meny të organizuar kanë vizituar edhe Kompleksin Memorial në Kleçkë, Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, dhe Shtëpinë Muze të Radios Kosova e Lirë.

Në kuadër të aktiviteteve të kampingut janë zhvilluar edhe lojëra të ndryshme sportive dhe aktivitete tjera argëtuese. Kampi është përkrahur financiarisht nga komuna e Malishevës dhe departamenti i rinisë MKRS-së, ndërsa Kryqin Kuq i Kosovës ka siguruar shatorët dhe gjëra tjera teknike për kamp.

U mbajt punëtorja për hartimin e buxhetit komunal

Malishevë, 29 gusht

Organizuar nga Komuna e Malishevës dhe OSBE, sot është mbajtur një punëtori me kryetarët e fshatrave të Malishevës, me qëllim të hartimit të buxhetit komunal për tri vitet e ardhshme dhe futjen e prioriteteve në investimet kapitale, bazuar në nevojat e fshatrave.

Fillimisht, zyrtarja e OSBE-së, znj. Kristina Jovanovska, tha se qëllimi i organizimit të kësaj punëtorie, është në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit komunal, gjegjësisht qarkores buxhetore 2015/2017, ku ne duam të dëgjojmë prioritetet dhe nevojat e juaja, për vitin e ardhshëm dhe vitet tjera në vazhdim. “Kemi parë që kryetari Begaj është i hapur me qytetarët dhe është i gatshëm të dëgjoj hallet dhe nevojat që ju keni, andaj edhe ne si OSBE, e kemi parë të udhës, që të japin kontributin tonë në këtë drejtim”, tha znj. Jovanovska.



Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, duke marrë fjalën, fillimisht i falënderoi zyrtarët nga ekipi i OSBE-së, për bashkëpunim në organizimin e kësaj punëtorie, e më pas foli për buxhetin komunal dhe arsyet e këtij organizimi, në mënyrë që vet qytetarët të jeni pjesë e hartimit të prioriteteve në investimet kapitale në vitet në vijim. “Ne veç kemi filluar

me këtë formë edhe më herët, kemi vizituar shumicën e fshatrave, për të parë se cilat janë nevojat e fshatit tuaj dhe me i pas si prioritet në projektet tona kapitale, ngase ju i dini më mirë nevojat e fshatrave tuaj, se sa ne nga qendra”. ” Kemi zvogëlim buxhetore në investimet kapital ku dhe kemi reaguar për këtë ngase është e papranueshme që të tërhiqen shtatëqind mijë euro në investimet kapitale nga buxheti i komunës, për vitin e ardhshëm, dhe ato mjete të përdoren për rritjen e pagave”, tha kryetari Begaj.

“Ne kemi filluar me investime në fshatrat më të largëta dhe në fshatrat ku ka pasur më së paku investime në të kaluarën dh kjo është praktika e punës sonë, ndërsa zvogëlimet buxhetore, do të na sjellin telashe në fushën e investimeve, por së bashku ne mund ti hartojmë prioritetet dhe investimet të jenë në harmoni me kërkesat e juaja. Për vitin e ardhshëm do ti kemi rreth 3.5 milion euro për investime”, tha Begaj. Më pas kryetari, i njoftoi me disa nga projektet që janë realizuar dhe janë realizim e sipër.



Ndërsa, drejtori për Ekonomi, Buxhet dhe Financa z.Vesel Krasniqi tha se “praktika e qeverisjes sonë, do të jetë që ne të vijmë tek ju, nëpër fshatrat e juaja dhe do të diskutojmë për hallet, problemet e juaja, dhe jo vetëm për projektet kapitale, por edhe për çështjet të ndryshme sociale të punësimit etj, dhe në mënyrën më të mirë të mundshme ti zgjedhim ato probleme dhe ato projekte që janë me më prioritet për fshatrat e juaj”, tha Krasniqi.

“Për vitin e ardhshëm, buxheti i përgjithshëm është i ndarë për 54 mijë banorë dhe është 12.3 milion euro, e në këtë shumë 3.5 milion janë për investime kapitale”, tha drejtori Krasniqi.

Kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, duke marrë fjalën në këtë takim, tha se “qeveria komunale e drejtuar nga kryetari Begaj, e ka përkrahjen e plotë në punën e saj, sidomos në fushën e transparencës. Kjo punëtori është në kuadër të funksionimit dhe menaxhimit të mirë të buxhetit dhe për rritjen e mirëqenies së qytetarëve”.

Më pas, përfaqësuesit e fshatrave, i kanë paraqitur kërkesat e tyre, të arsyetuara dhe kanë dhënë mendimet e tyre, për prioritetet në hartimin e projekteve kapitale, për vitet në vijim. Bazuar në kërkesat e kryetarëve të fshatrave, ndërtimi i kanalizimeve dhe menaxhimi i ujërave të zeza, del të jetë prioriteti kryesor, pastaj rrugët, shkollat dhe të tjera, që kryesisht lidhen me infrastrukturën. Përndryshe deri të hënën, kryetarët e fshatrave, do ti dorëzojnë me shkrim kërkesat e tyre për së paku tri projekte që janë më me rëndësi për fshatrat e tyre.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 130-Shtator 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Takimi i Kryetarit
Begaj me Ambasadorin e
Shqipërisë, Qemajl Minxhozi



Asfaltimi i rrugëve në
Llapqevë



Artefakti i gjetur në
Banjë

Begaj: Asnjë person nuk është larguar për bindje politike

Malishevë, 1 shtator



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, gjatë ditës sotme, ka sqaruar opinion e gjerë, se asnjë mësimitdhënës, nuk është larguar nga puna për bindje partiake, por sipas konkursit është pranuar stafi mësimit, ndërsa për çdo rast të shkeljeve eventuale, që ka mundur të ketë, do të shqyrtohet.

Këtë deklaram i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, e ka bërë gjatë takimeve që ka pasur me ish kandidat, tani të pakënaqur, që nuk janë pranuar në punë dhe që sot kanë protestuar në emër të të gjithë të pakënaqurve, në veçanti në tri shkollat e mesme të Malishevës.

“Së pari ju sqaroi, se të gjitha 147 vendet e lira në arsim, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, janë shpallur me rekomandim të MASHT-it, dhe të gjitha vendet e shpallura kanë të bëjnë me rastet ku mësimitdhënësit janë pranuar pa konkurs, pa kualifikim, pa procedura dhe te ngjashme, dhe ne kemi zbatuar këtë rekomandim. Përndryshe, në të gjitha rastet ku mendojnë se ju është bërë e padrejtë, unë si kryetar i Komunës, do ti përkrahi maksimalisht për realizimin e të drejtës së tyre. Unë i inkurajoj të gjithë, që ti ndjekin procedurat e mëtutjeshme, deri në gjykatë, në mënyrë që ti realizojnë të drejtat e tyre”, ka thënë kryetari Begaj.

“Ju premtoj se do ta bëj një shikim të kompletuar për të gjitha rastet, do ta shqyrtojmë punën e komisionit vlerësues dhe do të jemi tërësisht transparent”, ka thënë kryetari Begaj, gjatë takimit që ka zhvilluar me z.Jakup Gashi, z.Sedat Sahitaj ish mësimitdhënës dhe z.Shemsi Morina, ish drejtor shkolle. Këto deklarime dhe të gjitha takimet tjera me kandidatët që sot janë ankuar, janë zhvilluar në prani të medieve dhe kamerave.

Përndryshe, sot para komunës, ka protestuar edhe një grup i vogël nxënësish të shkollës së mesme profesionale “Qendra e Kompetencës”, ku me ta biseduar drejtori komunal i arsimit z.Blerim Thaçi, i cili kërkoi që ata ti kthehen mësimit, duke e konsideruar se nxënësit nuk duhet te manipulohen me këto gjëra, ndërsa të shqetësime do të shqyrtohen, në formën më transparente te mundshme.

Kryetari Begaj, i uron nxënësit për fillimin e viti të ri shkollor

Malishevë, 1 shtator

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollorë, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka dërguar një urim për të gjithë nxënësit, arsimtarët dhe drejtorët e shkollave të Komunës së Malishevës, duke ju uruar suksese në këtë vit shkollor.

“Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2014/2015, në emër të Komunës së Malishevës, i uroj të gjithë nxënësit për fillimin e këtij viti. Po ashtu, i urojmë edhe të gjithë mësuesit dhe drejtorët e shkollave. Urojmë, që gjatë këtij viti shkollor të arrini suksese sa më të mëdha, dhe në të njëjtën kohë ju dëshiroj edhe shëndet të mirë të gjithëve. Suksese dhe shëndet të mirë, ju dëshirojmë edhe atyre nxënësve, të cilët për herë të parë ulen në bankat shkollore”.

Kryetari i Komunës së Malishevës

Ragip Begaj

Kryetari Begaj, priti nënkolonelin Mogoliq

Malishevë, 4 shtator



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot komandantin e qendrës koordinuese të njësive të LMT-së, pjesë e KFOR-it, nënkolonelin Mogoliq, me të cilin kanë biseduar për çështje të ndryshme që lidhen me bashkëpunimin mes njësisë së LMT-së dhe Komunës së Malishevës.

Fillimisht kryetari Begaj, i falënderoi zyrtarët e KFOR-it, për vizitën në Malishevë dhe për bashkëpunimin e mirë mes Komunës dhe KFOR-it, përkatësisht LMT-së, si dhe e njoftoi nënkolonelin me zhvillimet e përgjithshme në Malishevë.



Ndërsa eprori i lartë i KFOR-it, slloveni Mogoliq, pasi shprehi kënaqësinë e tij për këtë vizitë, u interesua për rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, për angazhimet e komunës në rritjen e mirëqenies së qytetarëve, pastaj zhvillimi ekonomik, resurset e komunës dhe të tjera.

Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, e informoi komandantin Mogoliq, për punët dhe angazhimet e komunës, përpjekjet e komunës për kryerjen e punëve dhe obligimeve komunale në raport me qytetarët, si dhe për mundësitë që ka Komuna e Malishevës, për joshjen e investitorëve në fushën e bujqësisë, zhvillimit të turizmit, dhe resurset tjera që ka Malisheva, për zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.

Projekt buxheti për vitet 2015-2017 i gatshëm

Malishevë, 8 shtator

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, ka thënë së është hartuar buxheti për vitet 2015-2017, i cili do të dërgohet në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim. “Prioritet e investimeve kapitale, janë hartuar, duke u bazuar në kërkesat e përfaqësuesve të fshatrave, pas takimit që është mbajtur paraprakisht me kryetarët e fshatrave”, ka thënë drejtori Krasniqi.

Nga ana tjetër, drejtori për mbrojtje dhe shpëtim, z.Ahmet Morina, tha se ka filluar dhe po vazhdon projekti për repelimin e kafshëve shtëpiake, projekt i cili realizohet në kuadër të strategjisë kombëtare për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo, dhe realizimi i projektit monitorohet nga drejtorja për mbrojtje dhe shpëtim.

Ndërsa drejtori i shëndetësisë, z.Hajdin Berisha, konfirmoi se numri i personave të prekur nga rriqrat, ka rënë maksimalisht, pasi brenda javës janë regjistruar vetëm dy raste.

Në kuadër të luftimit të etheve hemorragjike, edhe në fushën e bujqësisë pritet të zhvillohet një projekt për punimin e djerrinave, si burime të rriqrave, për çka drejtorja e bujqësisë, ka evidentuar rreth 423 hektar, të cilat duhet të lëvrohen.

Në këtë mbledhje, u bë e ditur se shumë shpejt pritet të hiqen reklamat pa leje në qytetin e Malishevës. Këtë e kanë konfirmuar drejtori i inspektoratit, z.Sejdi Paçarizi dhe ai i shërbimeve publike, z.Milazim Morina.

Ndërsa drejtori i arsimit, z.Blerim Thaçi, tha se mësimi ka filluar në të gjitha shkollat dhe nxënësit janë furnizuar më tekste mësimore.

Në kuadër të shënimit të Ditës së Rinisë, që në Malishevë, pritet të shënohet me 12 shtator, këtij shënimi i kanë paraprirë një varg aktivitete, siç ishte kampi për të rinj, ndërsa aktivitetet e tjera, do të zhvillohen të premten me 12 shtator, kryesisht në qendër të Malishevës.

Ndërsa në objektin e komunës, është duke vazhduar normalisht, kryerja dhe ofrimi e obligimeve në raport me qytetarët. “Fluksi i qytetarëve që kërkojnë dokumentacion në komunë, ka rënë, ndërsa shërbime komunale po vazhdojnë me kryerjen e obligimeve dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët”, ka thënë drejtori i administratës z.Ekrem Kastrati.

Ofrimi i shërbimeve për qytetarët, varësisht prej kërkesave të tyre, po vazhdon normalisht edhe në drejtorinë për gjeodezi dhe kadastër, tha drejtori i kësaj drejtorie, z.Fadil Shala.

Po vazhdon fushata e repelimit të kafshëve

Malishevë, 9 shtator



Në kuadër të strategjisë nacionale për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), në territorin e Komunës së Malishevës, është duke vazhduar fushata e repelimit të kafshëve, si njëra prej masave parandaluese, kundër rriqrave, pasi kafshët konsiderohen si burimi kryesor i zhvillimit të rriqrave.

Kjo formë e masave parandaluese organizohet nga Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit e Kosovës (AVUK) dhe realizohet nga kompania “Fauna”, e cila pritet të bëjë repelimin e të gjitha kafshëve në Komunën e Malishevës, ndërsa realizimi i kësaj fushate, monitorohet nga drejtoria komunale për mbrojtje dhe shpëtim.

Deri më tani, kjo fushatë po ecën mirë dhe nuk ka probleme në realizimin e repelimit të kafshëve, ndërsa edhe banorët-fermerët, po i zbatojnë udhëzimet e drejtorisë për mbajtjen e mbyllur të kafshëve, deri sa të kryhet repelimi.

Sipas të dhënave në drejtorinë komunale për bujqësi, fondi i kafshëve shtëpiake në Komunën e Malishevës, është 16 mijë e 565, ku përfshihen 14 308 gjedhe, 8746 dele dhe 3511 dhi.

Përkujtohen viktimat e 11 shtatorit

Malishevë, 11 shtator



Me nderime para flamurit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, anëtar të Kuvendit të Komunës dhe zyrtarë tjerë komunal, kanë përkujtuar viktimat e 11 shtatorit të vitit 2001, në Qendrën Botërore të Tregtisë në New York të SHBA-ve.

Në aktin terrorist në Qendrën Tregtare Botërore apo Kullat Binjake, në New York, kishin humbur jetën afro tre mijë persona, në mesin e tyre 343 zjarrfikës dhe 60 policë, ndërsa viktimat e tjera ishin civil të 70 kombësive të ndryshme nga e gjithë bota.

Me këtë rast, edhe Komuna e Malishevës, solidarizohet me popullin amerikan dhe familjet e të gjitha viktimave në “Kullat Binjake”.

Përfundoi seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës

Malishevë, 11 shtator



Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës në Malishevë, e iniciuar nga PDK dhe e nënshkruar nga 12 anëtar të Kuvendit të Komunës, e cila në rend dite kishte “Shqyrtimin e situatës në sistemin e arsimit në Komunën e Malishevës, pas protestave të personelit arsimor të larguar nga procesi mësimor”, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, e ka përfunduar, për arsye se nuk kishte

kushte për mbajtjen e seancës.

Në fillim të kësaj seance, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, duke u thirrur në nenin 45.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, propozoi që seanca të mbahet e mbyllur për publikun, propozim i cili u miratua me 20 vota për, 9 kundër dhe 3 abstenime, ndërsa pas kësaj tetë anëtarë të PDK- së dhe dy të VV-së, lëshuan seancën.

Me fillimin e seancës, pas disa minutave, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës nga radhët e PDK-së dhe të VV-së, hynë në sallë duke bllokuar foltoren e kuvendit dhe duke ja ndërprerë fjalën anëtarit të IQM-së, z.Avdi Morina, me arsyetimin se seanca duhet të jetë e hapur.

Në këtë situatë të krijuar, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, ka mbyllur seancën, me arsyetimin se nuk ka kushte normale për vazhdimin e seancës dhe për ti ikur ndonjë incidenti të mundshëm.

Largohen reklammat pa leje në hapësirat publike

Malishevë, 12 shtator



Me qëllim të lirimit të hapësirave publike nga vendosja e reklamave, drejtoria komunale e inspektoratit dhe ajo e shërbimeve publike, kanë filluar një aksion për largimin e reklamave të vendosura nga subjektet e ndryshme afariste pa lejen e organeve përkatëse.

Sipas drejtorisë së inspektoratit aksioni për largimin e këtyre reklamave ka filluar në këtë javë dhe po vazhdon çdo ditë, deri në largimin e tërësishëm të këtyre reklamave, të vendosura vend e pa vend dhe pa leje paraprake.

“Drejtorja e Inspektoratit në bashkëpunim me drejtorin e Shërbimeve Publike ka filluar aksionin për LARGIMIN e të gjitha reklamave, panove, të subjekteve afariste të cilat i kanë vendosur pa pëlqime nga organet Komunale dhe të cilat kanë qenë të vendosura në shtyllat elektrike dhe të ndriçimit”, thuhet në një njoftim të drejtorisë së inspektoratit në Malishevë.

Në Malishevë po shënohet Dita e Rinisë

Malishevë, 12 shtator



Me moton “Rini jepju formë ëndrrave”, në Komunën e Malishevës, është duke u mbajtur Dita e Rinisë, ku me aktivitete të shumta, kulturore, edukative, arsimore, sportive, zbavitëse, dhe të tjera, po shënohet kjo ditë, e ku po marrin pjesë një numër i konsiderueshëm i të rinjve malishevas.

Në fushën e sportit, është mbajtur një turnir futbollit, ndërsa në fushën e kulturës, është mbajtur një shprehje e ideve përmes vizatimit, prej ku do të bëhet një film i animuar në formën “StopMotion”, si dhe është shfaqur një film, prodhim i studentëve malishevas dhe ë tjerë.

Po ashtu, sot organizuar nga të rinjtë, është mbajtur një debat, ku kanë marrë pjesë rreth 50 të rinj, ndërsa nga lojërat zbavitëse, është gjetja e thesarit, ku po ashtu kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i të rinjve.

Gjatë kësaj dite, janë zhvilluar dhe po zhvillohen aktivitete të ndryshme, ndërsa në mbrëmje, aktivitetet e kësaj dite do të përmbillen me një mbrëmje rinore, në ambient të hapur, në parkun në qendër të qytetit.

Dita e Rinisë, organizohet nga MKRS, përkatësisht departament i rinisë, në bashkëpunim me organizatat rinore, gjegjësisht Qendrën e Rinisë në Malishevë, dhe mbështet nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Malishevës.

Nga mbledhja e Këshillit të drejtorëve

Janë hequr reklamimet pa leje në qytet

Malishevë, 15 shtator

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të qeverisë komunale të Malishevës, të drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, u bë e ditur se janë hequr të gjitha reklamimet pa leje në hapësirat publike në qytetin e Malishevës, ndërsa largimi i tyre është bërë nga ana e inspektoratit dhe shërbimeve publike.

Kështu kanë deklaruar në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, drejtorët e drejtorive të Inspektoratit, z.Sejdi Paçarizi dhe i Shërbimeve Publike, z.Milazim Morina, sipas të cilëve nuk ka pas probleme gjatë largimit të reklamimeve pa leje.

Në mbledhjen e sotme, edhe drejtorët tjerë komunal, kanë raportuar për aktivitetet e zhvilluara gjatë javës së kaluar dhe për aktivitetet në javët në vazhdim, ku janë duke u realizuar disa projekte me rëndësi, në të gjitha fushat, si në infrastrukturë rrugore, shkollore, ujësjellës, kanalizime, pastaj investime në shëndetësi, bujqësi, dhe fusha tjera me të cilat menaxhon Komuna e Malishevës.

Dhurohen 15 ari truall për ndërtimin e kullës për Tahir Berishën

Malishevë, 15 shtator



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij, z.Ahmet Berisha nga Berisha, i cili vullnetarisht, para kryetarit të Malishevës ka dhuruar 15 ari e 68 metra truall, për ndërtimin e kullës për Tahir Berishën.

z.Ahmet Berisha, ka kryer të gjitha procedurat në organet përkatëse, në mënyrë që të zyrtarizoj dhënien e këtij trualli, vullnetarisht dhe të hap rrugë për ndërtimin e kullës, për dijetarin dhe veprimtarin Tahir Berisha.

Tahir Berisha njihet si njëri prej dijetarëve dhe veprimtarëve të kohës.

U mbajt mbledhja e tetë të radhës e KPF-së

Malishevë, 16 shtator

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i drejtuar nga kryesuesi z.Enver Hoti, ka mbajtur sot mbledhjen e VIII (tetë) të radhës, ku janë diskutuar pikat e rendit të ditës, dhe janë dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Anëtarët e KPF-së, pas shqyrtimit, rekomanduan për KK, projekt buxhetin për vitet 2015-2017, pasi paraprakisht, sqarimet rreth hartimit të projekt buxhetit, para anëtarëve të KPF-së, i dha drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Karsniqi.



Po ashtu pika tjetër e rekomanduar ishte edhe ajo për shqyrtimin dhe miratimin e Projekt-Rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme.

Për kuvend është rekomanduar edhe Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2013. Edhe çështja e zgjedhjes së kryetarëve të fshatrave, është rekomanduar për mbledhjen e

ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, mbajti mbledhjen e pestë

Malishevë, 18 shtator

Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, si organ i Kuvendit të Komunës, i kryesuar nga kryesuesi i këtij komiteti, z.Januz Kastrati, ka mbajtur mbledhjen e pestë të radhës, ku janë trajtuar një varg çështjesh, që lidhen me punën, kompetencat dhe qëllimin e këtij komiteti.

Në këtë mbledhje, komiteti ka trajtuar raportin e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, për përfundimin e vitit shkollor 2013-2014 dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2014-2015, ku para anëtarëve të komiteti, këtë raport e prezantoi drejtori i drejtorisë për arsim, z.Blerim Thaçi, ndërsa është përgjigjur edhe në pyetjet e anëtarëve të komiteti, lidhur me këtë çështje.



Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, mori vendim për formimin e një komisioni, që do të merret me hulumtimin e mënyrës së përzgjedhjes së stafit mësimor për vitin shkollor 2014-2015.

Drejtori Thaçi, e njoftoi komitetin edhe me përgatitjet e Komunës, për shënimin e 10 vjetorit të tragjedisë së Fushë Arrëz, ku në një aksident komunikacioni, humbën jetën 15 maturant nga gjimnazi i Malishevës.

Në këtë mbledhje, para anëtarëve të komiteti, ka raportuar edhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, znj. Blerta Krasniqi, lidhur me aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive, në këtë fillim të vitit të ri shkollor 2014-2015. Sipas drejtoreshës Krasniqi, gjatë këtij muaji, janë zhvilluar një varg aktivitetesh kulturore, rinore, sportive dhe edukative, aktivitete të cilat kanë rastisur edhe me shënimin e Ditës së Rinisë.

14 raste të dyshuara me “Gjuha e kaltër”

Malishevë, 22 shtator

Në Komunën e Malishevës, dyshohet për 14 raste të deleve të prekura me sëmundjen “Gjuha e kaltër”. Kështu është bërë e ditur në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, ku drejtori për bujqësi, z. Hajrullah Mazreku, ka konfirmuar se në dy ferma janë regjistruar nga shtatë raste të dyshuara.

“Në dy ferma janë regjistruar 14 raste me sëmundjen “Gjuha e kaltër”, tek delet, ndërsa në një tërësi fermë, dy nga shtatë rastet kanë ngordhur, por jemi në pritje të konfirmimit të analizave, nëse këto raste janë me këtë sëmundje, përderisa simptomat janë të asaj sëmundje”, tha drejtori Mazreku. Sipas tij, inspektorët për veterinë dhe ai i shëndetësisë kanë dalë në vend të ngjarjes, ndërsa janë në pritje të rezultateve.

Përndryshe në mbledhjen e rregullt të së hënës, të qeverisë komunale, të drejtuar nga kryetari i Malishevës, z. Ragip Begaj, drejtorët kanë raportuar për aktivitetet e drejtorive të tyre në realizimin e projekteve të ndryshme dhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Në këtë mbledhje, drejtori për shëndetësi, z. Hajdin Berisha, ka deklaruar se “ kohëve të fundit nuk regjistrohen raste të thumbimit nga rriqrat dhe duket që rreziku nga infektimi me EHKK ka kaluar, dhe këtë vit nuk kemi asnjë rast vdekjeje nga EHKK”.

Begaj priti ambasadorin Minxhozi

Malishevë, 24 shtator

Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z.Qemal Minxhozi, ka vizituar sot Komunën e Malishevës, ku është pritur nga Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, me të cilin ka biseduar për çështje të ndryshme të bashkëpunimit në nivelin e komunave dhe më gjerë, në mënyrë të veçantë për fushën e ekonomisë.

Vizita e ambasadorit shqiptar, kishte karakter njohës, pas emërimit të z.Minxhozi ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, në mars të këtij viti.



Fillimisht kryetari Begaj e falënderoi ambasadorin për vizitën e tij në Malishevë, ndërsa ambasadori Minxhozi, tha se kjo vizitë, është në kuadër të njohjes dhe bashkëpunimit mes institucioneve, dhe falënderoi kryetarin Begaj, siç tha edhe vet ambasadori, “për pritjen shumë të përzemërt në Malishevë”.

“Jam shumë i gëzuar që jam këtu dhe besoj fuqishëm që së bashku mund të bëjmë gjëra të mira”, tha ambasadori Minxhozi.

“Ne gjithmonë kemi jetuar bashkë dhe shpirtërisht kemi jetuar bashkë, pavarësisht rrethanave, por tani falë gjakut të derdhur, ne edhe lëvizim dhe e prekim këtë bashkim, por sot ka ardhur koha që ky bashkim të forcohet, sidomos në ekonomitë e dy vendeve tona”, tha kryetari Begaj.

Minxhozi e Begaj, thanë se lidhja shpirtërore mes shqiptarëve, pavarësisht rrethanave, ka qenë gjithmonë, por tani duhet që të rritet bashkëpunimi, në mënyrë të veçantë në ekonomi dhe arsim, ku të dy vendet së bashku, mund të bëhen një fuqi ekonomike.

Ambasadori Minxhozi, është takuar edhe me kryesuesin e KK të Malishevës, z.Enver Hoti dhe më pas, ka takuar edhe drejtorët e drejtorive komunale në Malishevë.

Kryetari Begaj ka vizituar panairin e produkteve bujqësore

Shkabaj, 24 shtator



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, i shoqëruar nga disa drejtor të drejtorive komunale, ka vizituar panairin e produkteve bujqësore në fshatin Shkabaj, afër Prishtinës, ku është takuar edhe me disa nga fermerët malishevas, të cilët kanë prezantuar produktet e tyre në këtë panair.

Qëllimi i vizitës, ishte përkrahja për bizneset lokale të Malishevës dhe inkurajimi i tyre për zhvillimin e kësaj dege të fuqishme të ekonomisë.

Si zakonisht, në të gjitha panairët e tilla, prodhuesit nga Komuna e Malishevës, janë pjesëmarrës aktiv në prezantimin e produkteve bujqësore, ndërsa edhe Komuna e Malishevës brenda mundësive, ka përkrahur bujqësinë, duke i inkurajuar fermerët që të merren me bujqësi, pasi kjo degë ekonomisë, është më e zhvilluar në Malishevë.

Asfaltohen tri rrugë në Tërpezë

Malishevë, 26 shtator

Dje ka filluar asfaltimi i tri rrugëve në fshatin Tërpezë e epërme, të cilat kanë një gjatësi prej rreth dy mijë metrash, por që janë me rëndësi të madhe për banorët e këtyre lagjeve të fshatit. Procesin e asfaltimit të këtyre rrugëve, dje e ka vëzhguar edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z. Rexhep Mazreku dhe drejtori i urbanizimit z. Urim Kastrati.

Nënkryetari i Malishevës z. Mazreku, me këtë rast i ka uruar banorët e fshatit Tërpezë, për rrugët e



rregulluara, duke i siguruara se Komuna e Malishevës, do të angazhohet maksimalisht në rritjen e mirëqenies sociale dhe krijimin e kushteve më të mira, për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës.

Njëra nga tri rrugët në këtë fshat, është edhe ajo për lagjen e “Muhaxherëve”, njëra nga rrugët që më shumti ka pasur nevojë të rregullohet, pasi është lagja më e largët e fshatit, ndërsa banorët e kësaj lagje, për shkak të rrugës, kanë pasur probleme në qarkullim, ndërsa më së shumti problem kanë pasur nxënësit.

Kryetari Begaj mori pjesë në hapjen e panairit ndërkombëtar “Agrobiznesi 2014” në Tiranë

Tiranë, 25 shtator



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i shoqëruar nga disa drejtor të drejtorive komunale, kanë marrë pjesë në hapjen e edicionit të dhjetë të panairit ndërkombëtar të “Agrobiznes 2014”, në kryeqytetin shqiptar në Tiranë, ndërsa moto e këtij edicioni është “Konsumo prodhime vendore shqiptare”.

Në hapjen e panairit, presidenti i këshillit të agrobiznesit shqiptar z.Enver Ferizaj, ka falënderuar në mënyrë të veçantë kryetarët e komunave nga të gjitha trevat shqiptare dhe të gjithë biznesmenët e pjesëmarrësit në edicionin e dhjetë të panairit të “Agrobiznesit 2014” .

Qëllimi i këtij panairi ishte vetëdijesimi i konsumatorëve mbarë shqiptar, për të konsumuar prodhime cilësore dhe vendore shqiptare, si dhe të nxis bashkëpunimin e bizneseve shqiptare nga Kosova, Maqedonia, Mali i zi Presheva, dhe të inkurajojnë zgjerimin e tregut me produkte natyrale shqiptare.

Artefakti i gjetur në Banjë shkon për studim në institutin arkeologjik

Malishevë, 26 shtator

Artefakti i vjetër rreth dy mijë vjet, i gjetur kohë më parë në Banjë të Malishevës, sot është marrë nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, për hulumtim dhe studim, për tu dëshmuar rëndësia e tij historike. Këtë artefakt, sot, drejtoresha për Kutlurë, Rini dhe Sport në Malishevë, znj. Blerta Krasniqi, ja ka dorëzuar u.d. të drejtorit të Institutit Arkeologjik të Kosovës (IAK), z. Enver Rexha.



Paraprakisht, drejtoresha Krasniqi dhe u.d. i drejtorit të IAK, janë dakorduar që të bëhen hulumtime në pjesën e fshatit Banjë për gjetje tjera arkeologjike, pasi kjo gjetje, mendohet të jetë e vjetër diku rreth viteve 250 të para erës sonë, ndërsa në këtë zonë, janë gjetur edhe dëshmi tjera që dëshmon se kjo pjesë ka qenë herët e banuar dhe e zhvilluar.

Artefakti i gjetur, në formë altari, besohet se është një altar kult, kushtuar hyjneshës Nemesis, gjë që e dëshmon edhe mbishkrimi me shtatë rreshta i gdhendur shumë bukur në këtë guri-altar, ndërsa Nemesis, njihet në mitologji si mbretëresha e hakmarrjes dhe drejtësisë.

Studimi i këtij altari, do të sqaroj gjithçka rreth tij, dhe në të njëjtën kohë pritet të zbardh edhe shumë fakte tjera historike. Ky altar, konsiderohet si gjetje shumë e rrallë dhe me rëndësi të madhe historike.

KK shpalli zgjedhjet për zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave të Malishevës

Malishevë, 26 shtator

Kuvendi Komunal i Malishevës, kryesuar nga kryesuesi z. Enver Hoti, ka mbajtur mbledhjen e nëntë rregullt, ku ka marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj. Në këtë mbledhje, mes tjerash, KK i Malishevës, mori vendim për shpalljen e zgjedhjeve në fshatrat e Malishevës, për zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave, gjegjësisht kryetarëve dhe kryesive. Zgjedhjet në fshatra do të fillojnë me 15 tetor 2014.



Kuvendi i Malishevës, sot ka shqyrtuar edhe projekt buxhetin për vitet 2015-2017, ndërsa në fillim të javës së ardhshme, pritet edhe miratimi i buxhetit, pasi të futen në listën e projekteve kapitale edhe propozimet e anëtarëve të kuvendit. KK miratoi edhe draft rregulloren për tatimin mbi pronën e palujatshme, pastaj ka miratuar edhe planin e punës së komitetit për planifikim urban, kadastër, mbrojtje të mjedisit, turizëm dhe monitorim të projekteve publike, për vitin 2014.

Kuvendi i Malishevës, sot ka miratuar edhe rekomandimin e MAPL-së, për formimin e komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara dhe hartimin planeve lokale të veprimit. Po ashtu KK, ka shqyrtuar edhe raportin e auditivit për pasqyrat financiare të Komunës së Malishevës, për vitin 2013.

Kuvendi, mori vendim edhe për formimin e një këshilli organizativ, për shënimin e dhjetë vjetorit të tragjedisë së Fushë Arrëzitet, ku patën humbur jetën 15 maturant të gjimnazit të Malishevës.

Ndërsa KK, nuk e miratoi plotësimin dhe ndryshimin e statutit të komunës, pasi nuk propozimet për këto plotësime dhe ndryshime nuk arritën të marrin dy të treta e votave të anëtarëve të KK.

Kryetari Begaj, inspektoi punimet në katër rrugë

Malishevë, 27 shtator



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, z.Urim Kastrati, kanë inspektuar punimet në asfaltimin e katër rrugëve në Komunën e Malishevës, përkatësisht tri rrugë në Tërpezë dhe një rrugë Turjakë, ku aktualisht janë duke u asfaltuar këto rrugë.

Begaj dhe Kastrati, janë ndarë të kënaqur me ecurinë e punimeve në rregullimin e këtyre rrugëve dhe në asfaltimin e tyre, ndërsa rregullimi i infrastrukturës së përgjithshme vazhdon të mbetet prioritet i qeverisë komunale dhe në të njëjtën kohë përmbushje e premtimeve për rregullimin e rrugëve dhe investimeve tjera të nevojshme, në ato vende ku asnjëherë nuk i kanë ndier investimet e shtetit, për rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Nga ana tjetër, banorët e këtyre dy fshatrave, e kanë falënderuar kryetarin Begaj, jo vetëm për rregullimin e rrugëve, por edhe për përkrahjen që po ju ofron banorëve të këtyre fshatrave

dhe në veçanti të këtyre lagjeve, të cilat deri më tani kanë pasur probleme në lëvizjen e tyre, për shkak të rrugës.

Përderisa në Tërpezë është shtruar rruga për lagjen e Muhaxherëve dhe në dy lagje tjera brenda fshatit, në Turjakë është duke u asfaltuar rruga e lagjes së Berishëve, të cilët po ashtu, deri më sot, kanë pasur problem në qarkullimin e tyre, pasi rruga ka qenë në gjendje të rëndë dhe gati e pakalueshme për makina.

Filloi asfaltimi edhe i 1.5 km rrugë në Llapqevë

Malishevë, 28 shtator

Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës në përgjithësi në vendbanimet e Komunës së Malishevës, sot filloi asfaltimi i rrugëve në brendi të fshatit Llapqevë, me një gjatësi prej 1.5 km rrugë, ndërsa në të njëjtën kohë, po vazhdon edhe rregullimi i rrjetit të kanalizimit në lagjet tjera të fshatit.



Fillimin e asfaltimit të rrugëve në fshat, e ka përcjellë nga afër edhe i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj me bashkëpunëtor, dhe me këtë rast i ka uruar banorët e Llapqevës, për fillimin e përfundimit të këtyre investimeve, e që ndikojnë në rritjen e mirëqenies së banorëve të këtij fshati, ndër më i largëti me qendrën komunale.

Investimet në fshatrat më të thella të territorit të Komunës së Malishevës dhe investimet në zonat, në të cilat kanë munguar investimet, është njëri prej prioriteteve të kryetarit Begaj, në mënyrë që të gjithë banorët e Komunës së Malishevës, të kenë investime të barabarta.

“Ju uroj për këto rrugë dhe uroj ti gëzoni, ndërsa edhe ne si qeveri komunale, jemi të kënaqur kur arrijmë që ti realizojmë këto projekte, të cilat për juve kanë rëndësi jetike, por kjo nuk do të thotë se ne do të ndalemi me vetëm me këto investime”, tha mes tjerash kryetari Begaj.

Nga ana tjetër, banorët e fshatit Llapqevë, e kanë falënderuar kryetarin Begaj dhe Komunën e Malishevës, për këto investime, si në rregullimin e rrugëve, ashtu edhe në ndërtimin e pjesëve të mbetura të rrjetit të kanalizimit.



Krahas investimeve në shumicën e vendbanimeve të Malishevës, edhe në Llapqevë, aktualisht janë duke u asfaltuar mbi 1500 metra rrugë të lagjeve, si dhe 350 metra kanalizim në një lagje të fshatit, që deri më tani i ka munguar rrejtja e kanalizimit.

Begaj kërkon përgjegjësi për projektet e papërfunduara

Malishevë, 29 shtator

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka kërkuar përgjegjësi për mospërfundimin e disa projekteve të filluara kohë më parë, por të cilat, deri më tani është dashur të jenë të përfunduara.

“Unë dua përgjegjësi për të gjitha ato projekte të cilat tashmë është dashur të jenë të përfunduara, prandaj, drejtoritë përkatëse, duhet të gjejnë arsyet, se pse këto projekte ende nuk kanë përfunduar”, tha kryetari Begaj në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve.

“Shkolla e Vërmicës, është dashur të jetë tërësisht në funksion të nxënësve, ajo nuk ka filluar ende, shkolla në Shkozë, gjithashtu është dashur të jetë e përfunduar, e mos të flasim pastaj për rregullimin e lumit Mirusha”, tha Begaj, duke kërkuar gjetjen e arsyes për mospërfundim të këtyre projekteve.

Përndryshe në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, drejtorët kanë raportuar për punën e tyre dhe aktivitetet e rregullta të drejtorive.

Po ashtu në këtë mbledhje, u bë e ditur, se janë në përfundim të përpilimit të listës për investimet kapitale, që do të futet në propozim buxhetin e viteve 2015-2017, propozim i cili pritet të miratohet në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të martën.

Kuvendi i Komunës diskutoi për gjendjen në arsim

Malishevë, 29 shtator



Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka vazhduar sot mbledhjen e jashtëzakonshme, lidhur me gjendjen e krijuar në arsimin e Malishevës, pas shprehjes së pakënaqësisë nga ana e disa ish mësimdhënësve, e për çka një grup i anëtarëve të Kuvendit të Komunës, kishin kërkuar mbledhje të jashtëzakonshme, me datë 11 shtator, por e cila ishte ndërprerë.

Në këtë vazhdim të mbledhjes, disa nga anëtarët e KK, kryesisht të opozitës, shprehën, siç thanë ata “shqetësimin lidhur me largimin e disa mësimdhënësve nga procesi mësimor dhe zëvendësim i tyre me militant partiak, si dhe për mosrespektim të bazës ligjore dhe të disa parregullsive”.

Të gjitha këtyre shqetësimeve, ju janë përgjigju kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtori i arsimit në Malishevë, z.Blerim Thaçi. Fillimisht drejtori Thaçi, sqaroi se “vendet e lira të punës janë shpallur për 148 vende, në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës dhe se konkursi është shpallur në bazë të rekomandimeve nga Ministria e Arsimit, ku nga 1616 aplikantë, janë pranuar 148 prej tyre, dhe të gjithë me kualifikim përkatës”.

Ndërsa kryetari Begaj, duke ju drejtuar anëtarëve të kuvendit, tha se “realisht ka filluar të vendoset një rend në shkollat e Malishevës, dhe qëllimi im është, që ti eliminoj dukuritë negative në shkollat tona, por këtë mund ta bëjë vetëm me ndihëm e juaj. Sa i përket konkursit dhe pranimit të kuadrit në shkolla, ju garantoj se qëllimisht nuk është bërë asnjë shkelje, por në rast se ka ndonjë rast të shkeljesh, gjatë pranimit të kuadrit, jam në krah të tyre, për gjetjen e zgjidhjes, por në mënyrë ligjore”.

KK i Malishevës miratoi buxhetin për vitin e ardhshëm

Malishevë, 30 shtator



Kuvendi i Komunës së Malishevës, me 29 vota për dhe dy kundër, ka miratuar buxhetin për vitin 2015. Ky miratim i buxhetit u bë sot, në vazhdimin e mbledhjes së datës 26 shtator, kur anëtarët e kuvendit, vendosën që buxhetin ta shqyrtojnë në dy lexime, e që sot në rend dite ishte shqyrtimi i listës së projekteve kapitale.

Me këtë rast, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i ka falënderuar për punën e bërë nga ana e anëtarëve të KK të Malishevës, dhe tha se “këtë buxhet dhe këtë listë të projekteve kapitale do ta realizoj. Po ashtu besoj që të ketë edhe investime, nëse arrijmë të fitojmë edhe grante tjera, jashtë planifikimit”.

“Ky projekt është dëmtuar, për 700 mijë euro më pak se buxheti i vitit të kaluar, tek investimet kapitale”, tha kryetari Begaj, në fjalën e tij me rastin e miratimit të buxhetit për vitin 2015.

Përndryshe, buxheti komunal i Malishevës, për vitin 2015 do të jetë, 12 milion e 289 mijë e 280 euro, ndërsa për investime kapitale janë ndarë 3 milion e 495 mijë e 578 euro. Në raport me vitin 2014, tek investimet kapitale, janë rreth 700 mijë euro më pak, pasi në këtë vit, investimet kapitale nga buxheti i komunës ishin 4 milion e 166 mijë e 755 euro.

Përkujtohet dr.Shpëtim Robaj, në 16 vjetorin e rënies

Malishevë, 30 shtator



Në 16 vjetorin e rënies, është përkujtuar sot dr.Shpëtim Robaj, i rënë më 30 shtator të vitit 1998. Me këtë rast sot, është mbajtur edhe një akademi përkujtimore, si dhe janë bërë nderime para bustit të dr.Shpëtim Robajt në oborrin e QKMF-së në Malishevë, emrin e të cilit e mban ky institucion shëndetësor.

Në këtë përkujtim, përveç familjarëve, morën pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, drejtor të drejtorive komunale, asamblistë të Malishevës, znj.Shukrije Bytyçi dhe z.Salih Morina, deputet të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues nga ministria e shëndetësisë, zyrtar nga QKUK, dhe qytetarët të shumtë.

“Malisheva i ka dhënë mbi 70 dëshmorë, Malisheva ka veteranët e saj, ka njerëzit që kanë kontribuar dhe jemi krenar që në mesin tonë kemi edhe dëshmorin Shpëtim Robaj. Ju familje e doktor Shpëtimit, të ndiheni krenar për birin dhe prindin tuaj që ja falët Kosovës, për lirinë e saj”, tha mes tjerash kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në fjalën e tij.

Për jetën dhe veprimtarin e dr.Shpëtim Robajt, foli Aziz Thaçi nga QKMF e Malishevës, duke e prezantuar veprimtarinë e tij, në shëndetësi, pastaj në luftën çlirimtare, deri në ditën e rënies.

Kurse z.Ardian Sejdiu nga Ministria e Shëndetësisë, në fjalën e rastit, tha se “dr.Shpëtimi, është në mesin e zinxhirit të njerëzve të mëdhenj të vendit, një njeri i cili ka lënë dritë”.

Në emër të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, nga Malisheva, fjalën e mori deputetja znj.Shukrije Bytyçi, e cila tha se “nuk ka çmim që e paguan kontributin e dëshmorëve të Malishevës në përgjithësi dhe të doktor Shpëtimit në veçanti, ndërsa Malisheva, gjithmonë ka qenë çelësi në të gjitha zhvillimet në vend”.

Në këtë akademi, kanë folur edhe ish bashkëpunëtor të doktor Shpëtimit, të cilët kanë evokuar ngjarjet e asaj kohe, deri në ditën e rënies tragjike.

Ndërsa drejtori i QKMF-së, z.Besim Zogaj, foli për të arriturat e QKMF-së, e cila mban me krenari emrin e dr.Shpëtim Robaj.

GLV prezantoi projektin “Eko Llapusha”

Malishevë, 30 shtator



Sot në Malishevë u mbajt konferenca për shtyp e Grupit Lokal i Veprimit (GLV), me qëllim të njoftimit për fillimin e projektit “Eko Llapusha”, projekt i cili financohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe implementohet nga GLV “Llapusha nga Malisheva.

Ky projekt ka për qëllim vazhdimin e lidhjes me hartimin e strategjisë të zhvillimit lokal 2015-2020 duke u mbështetur në zhvillimin rural dhe bujqësor në Komunën e Malishevës. Projekti do të orientohet edhe në realizimin e objektivave për ngritjen e kapaciteteve lokale sociale e ekonomike të cilat do të forcojnë, rolin e GLV-së –sonë në realizimin e strategjisë lokale të zhvillimit. Projekti do të jete pjesë e angazhimeve të cilat do të ndikojnë në përmbledhjen strategjike të aktiviteteve tona si Grup Lokal i Veprimit.

GVL “Llapusha”-është Grup Lokal i Veprimit që është krijuar nga bashkëpunimi në mes të institucioneve publike dhe shoqërisë civile. Pra është partneritet publiko-privat. Deri më tani GLV “Llapusha” ka realizuar tri projekte, të cilat kanë ndihmuar në rregullimin e parqeve shkollore dhe atë pran Gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malishevë, rregullimin e oborrit dhe gjelbërimin e tij në SHFMU “Ismail Qemajli” në fshatin Bellanicë, dhe projektin e fundit ‘Rregullimin e parkut në Golesh’-Pranë Shtëpisë së Kulturës “Tahir Sinani” dhe Qendrës Rinore.

GVL “Llapusha është formuar me qëllim të forcoj qasjen e përmirësimit të zonave rurale në ekonominë globale. Kjo më të vetmin qëllim që të forcohet zhvillimi ekonomik lokal, duke ngritur kapacitetet në infrastrukturën e biznesit në bujqësi e blegtori dhe duke ngritur nivelin e kualifikimeve tek personeli, i cili është i orientuar në zhvillimin ekonomik të zonave rurale.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 131-Tetor 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Përkujtimi i dhjetëvjetorit të 15 viktimave të aksidentit të ndodhur në Fushë-Arrëz



Pamje gjatë vizitës në Turqi

U përrua fusha e sportit në shkollën e Panorcit

Malishevë, 2 tetor



Sot në fshatin Panorc, përkatësisht në oborrin e shkollës së fshatit, u bë përrimi i fushës së sportit për këtë shkollë dhe për të rinjtë e fshatit Panorc. Shiritin e përrimit e prenë, i pari i Malishevës, z.Ragip begaj, drejtori i arsimit, z.Blerim Thaçi, drejtori i shkollës, z.Bali Rudi dhe njëri nga mësuesit më të vjetër kësaj

shkolle, z. Ahmet Rexha.

Me këtë rast, Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i ka uruar nxënësit e kësaj shkolle dhe të rinjtë e fshatrave Panorc dhe Rud, për këtë fushë. “Ju tani do të keni mundësi më shumë, jo vetëm për zhvillimin normal të lëndës së edukatës fizike, por edhe për zhvillimin e aktiviteteve të lira sportive. Por unë kam një porosi për ju nxënës, që të mësoni sa më shumë, pasi ju jeni ata të cilët nesër do ti duheni Komunës së Malishevës dhe vendit dhe këtë do ta rrini vetëm me mësim, ndërsa nga ju arsimtarët, kërkoi që të angazhoheni maksimalisht në edukimin e brezave të rinj, pasi ju jeni përgjegjësit kryesor në edukimin e këtyre fëmijëve”, tha kryetari Begaj, ndërsa premtoi se do të vazhdojë angazhimin e komunës në fushën e arsimit, si një nga prioritetet e tij, për rritjen e cilësisë në shkollat tona.

Edhe drejtori i arsimit, z.Blerim Thaçi, i ka uruar nxënësit e kësaj shkolle, ndërsa drejtori i shkollës, z.Bali Rudi, e ka falënderuar Komunën e Malishevës, për realizimin këtij projekti, shumë domethënëse për shkollën, për krijimin kushteve më të mira për shkollën e tyre.

Ndërtimi i fushës sportive në Panorc, u financua nga Komuna e Malishevës.

Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e KFOR-it zviceran (LMT)

Malishevë, 03 tetor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj ka pritur sot në zyrën e tij përfaqësuesin e KFOR-it zviceran (LMT), kapitenin Rüst Gaudenz, në një takim lamtumirës, i cili ka vepruar në Malishevë dhe ka pasur bashkëpunim të ndërsjellët në fushën e sigurisë, si dhe aspekte tjera të përgjithshme në fushës e sigurisë në Malishevë.

Kryetari Begaj, falënderoi për vizitën, dhe për bashkëpunim të ndërsjellët që kanë (LMT) KFOR-i me Komunën e Malishevës dhe vlerësoi lartë punën e KFOR-it në përgjithësi jo vetëm në Malishevë “ Takimet me ju janë të mirëpritura çdoherë për mua, dhe dua që nga Malisheva të merrni vetëm momente të mira nga ne, ngase interes im është që të kemi bashkëpunimi të mire me ju” tha Begaj.

Kapiteni zviceran Rüst Gaudenz po ashtu shprehi falënderimet e tij para Kryetarit Begaj për mikpritjen dhe kohën që ka ndarë me ta.” Është një përvojë e mirë gjashtë mujore, mirëpo për mua do të jetë më shumë një kujtim i mirë koha e qëndrimit tim këtu që nuk do të harroj lehtë dhe që do të marr me vete atje” tha Gaudenz.

Gjendja e sigurisë së përgjithshme, si nga ana e KFOR-it (LMT), po ashtu edhe nga Kryetari Begaj u vlerësua e qetë në komunë dhe pa incidente të cilat mund ta prishin sigurinë e përgjithshme në Komunën e Malishevë.

Kryetari Begaj uron të gjithë qytetarët me rastin e festës së Kurban Bajramit



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me rastin e festës së Kurban Bajramit uron të gjithë besimtarët e besimit islam. “Në emër të Komunës së Malishevës dhe emrin tim personal, i uroi të gjithë qytetarët e Malishevës, me rastin e festës së Kurban Bajramit. Në këtë ditë feste për të gjithë besimtarët myslimanë, le të mbizotërojë solidariteti, paqja, toleranca dhe respekti. Nën frymën e kësaj feste të bekuar, të vazhdojmë të kultivojmë vlerat tona kombëtare dhe fetare, për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për gjeneratat që vijnë pas”.

Kryetari priti palët

Malishevë, 03 tetor

Si çdo të premtë edhe sot, për tri orë të tëra Kryetar Begaj ka pritur qytetarët në zyrën e tij, duke u njoftuar me problemet dhe shqetësimet e tyre, por edhe duke marrë falënderime për ndihmën dhe kujdesin e tij dhe të komunës, për mirëqenien e qytetarëve.

Problem kryesorë i shfaqur nga qytetarët , po vazhdon të jetë ai socio-ekonomik, çështja për punsim dhe disa nevoja tjera nga më të ndryshme, Kryetari Begaj i mirëpriti dhe ju ofroi mbështetjen e tij dhe të komunës si institucionit.

Kryetari Begaj edhe me këtë rast ka ofruar mbështetjen e tij të plotë morale si dhe mbështetjen e mundëshme material duke u bazuar gjithmonë në atë që është në mundësin e tij dhe duke pasur parasysh mundësi e komunës sonë si institucionit.

KKSB në Malishevë, dënon të gjitha llojet e shprehjes së ekstremizmit

Malishevë, 8 tetor



“**K**ëshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Malishevë, dënon të gjitha format e ekstremizmit, përfshirë edhe ekstremizmin fetar. Jemi kundër çfarëdo lloji të shprehjes së ekstremizmit dhe mbështet të gjitha veprimet e institucioneve të vendit, në luftimin e kësaj dukurie”, thuhet në deklarimin e KKSB në Malishevë, në mbledhjen e katërt të radhës, të mbajtur sot, edhe pse kjo dukuri e ekstremizmit

nuk është e shprehur në Komunën e Malishevës.

Këtë deklaram e kanë bërë sot, anëtarët e KKSB-së në Malishevë, në mbledhjen e katërt të rregullt, e cila u drejtua nga kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, e ku marrin pjesë të gjitha strukturat e sigurisë, përfaqësues të OJQ-ve lokale, minoriteteve dhe klerit fetar në Malishevë, e që të gjithë vlerësuan se nuk ka shprehje të ekstremizmit fetar në Komunën e Malishevës. Këtë deklaram e bëri edhe kreu i Bashkësisë Islame në Malishevë, mulla Xhevat Kryeziu, i cili gjithashtu dënoi çdo formë të shprehjes së ekstremizmit, përfshirë edhe atë fetar.

Përndryshe në këtë mbledhje, situata e sigurisë në Komunën e Malishevës, u vlerësua e qetë, stabile dhe pa tendencë të prishjes së situatës së sigurisë së përgjithshme. “Ne vazhdojmë të mbajmë primatin e komunës më të qetë dhe më të sigurt në vend dhe besoj që kjo siguri do të vazhdoj të mbretëroj në Komunën e Malishevës”, tha në fjalën e hapjes i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj. “Me këtë rast, unë i falënderoj të gjithë ata që janë përgjegjës për sigurinë në Komunën e Malishevës, por në të njëjtën kohë, i falënderoj edhe të gjithë ata përgjegjës, që kanë kontribuar që këtë vit, të mbajnë në kontroll situatën epidemiologjike dhe të mos kemi asnjë rast të vdekjes nga ethet hemorragjike krime kongo (EHKK), sikur që këtë vit kemi edhe më pak raste të zjarreve”, tha kryetari Begaj.

Nga ana tjetër, komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, gjithashtu e vlerësoi të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme, dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situatë. Sipas tij, ka rënie të vazhdueshme të rasteve të veprave penale, si dhe të

rasteve të vjedhjeve, ndërsa bashkëpunimi me qytetar është i mirë, gjë që ndikon edhe në rritjen e sigurisë.

Komiteti për komunitete mbajti takimin e rregullt

Malishevë, 10 tetor

Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendit të Komunës në Malishevë, i drejtuar nga kryetari i këtij komiteti, z.Fatmir Ademaj, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt, ku janë trajtuar një varg çështjesh, që lidhen me gjendjen e komuniteteve të caktuara në shoqërinë malishevase.

Drejtuuesi i këtij komiteti, z.Ademaj, i informoi anëtarët e komitetit, për një vizitë të realizuar në Qendrën për Punë Sociale, ku është njoftuar me situatën sociale në Komunën e Malishevës, ndërsa u kërkua që fëmijëve të familjeve që jetojnë me asistencë sociale, e që vijnë në mësimin në shkollat e mesme, t’ju mundësohet udhëtimi nga ana e komunës.

Në këtë mbledhje u planifikuan edhe dy vizita gjatë këtij muaji, njëra në Kijevë, ose në ndonjë lokacion të përshtatshëm me komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas dhe një vizitë tjetër në Qendrën e Rehabilitimit – Handikos në Malishevë.

Begaj takoi amerikanët që ndihmuan ndërtimin e ujësjellësit për Drenovc

Malishevë, 10 tetor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot, fillimisht në zyrën e tij, e më pas edhe në Drenovc, përfaqësuesit e OJQ-së “Jezu Krishti” nga SHBA, çiftin Nelson, të cilët kanë ndihmuar në ndërtimin e ujësjellësit për fshatin Drenovc, e ku sot edhe kanë vizituar dhe kanë parë nga afër rregullimin e sistemit të ujësjellësit në këtë fshat.

Kryetari Begaj, i ka falënderuar këtë organizatë për kontributin e tyre në ndërtimin e ujësjellësit, i cili sot edhe është testuar në fshatin Drenovc, ndërsa banorët e Drenovcit i ka uruar për rregullimin e sistemit të ujësjellësit.

Ish kryetari i Komunës së Malishevës, z.Daut Krasniqi, banor i fshatit Drenovc, i ka falënderuar përfaqësuesit e kësaj organizate, si dhe Komunën e Malishevës, për rregullimin e sistemit të ujësjellësit, duke e cilësuar si projektin më të madh, të realizuar në këtë fshat, për shkak të rëndësisë jetike që ka banorët e fshatit më të madh në Komunën e Malishevës.

Ndërsa çifti Nelson, nga SHBA-të, si përfaqësues të kësaj organizate, shprehën kënaqësinë e tyre, që kanë mundur të kontribuojnë për ndërtimin e ujësjellësit, pasi më parë kanë parë që fshati është përballur në të kaluarën me problemin e ujit për pije.

Homazhe në Fushë-Arrëz për maturantët e Malishevës

Fushë-Arrëz, 13 tetor



Sot në Fushë-Arrëz, janë përkujtuar viktimat e aksidentit të Fushë-Arrëzit, aksident i ndodhur 10 vite më parë, më 14 tetor 2004, ku humbën jetën 16 persona, prej tyre 15 ishin maturantë të gjimnazit të Malishevës. Në homazhin e mbajtur në vendin e aksidentit, morën pjesë familjarë të 15 maturantëve, i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, zyrtar tjerë komunal, zëvendës kryetari i Bashkisë së Fushë-Arrëzit, z.Gjokë Nikolli, maturantë të gjimnazit të përgjithshëm të Fushë-Arrëzit.

Në homazhe morën pjesë edhe drejtor të drejtorive komunale, ish drejtori i gjimnazit, z.Januz Kastrati dhe profesor të gjimnazit “Hamdi Berisha”.

Ky aksident u cilësua si ngjarja më e rëndë që ka ndodhur, jo vetëm për arsimin në Kosovë, por edhe në Shqipëri në përgjithësi dhe aksidenti më i rëndë i trafikut, ku humbën jetën 16 persona.

Kryetari i Komunës së Malishevës, duke folur me këtë rast, tha se “në ato ditë e gjithë shqiptaria ishte me ne, ishte me familjet që kishin humbur më të dashurit e tyre, por sot, kjo ngjarje, të cilën ne e kujtojmë, le të shërbejë për zhvillimin e dy vendeve tona, kjo lidhje krijuar nga kjo fatkeqësi, le të shërbejë për zhvillimin e Malishevës dhe Fushë-Arrëzit”, tha Begaj.



Ndërsa zv/kryetari i Bashkisë së Fushë-Arrëzitet, z.Gjokë Nikolli, shprehi “ngushëllimet e Bashkisë së Fushë-Arrëzitet dhe kujtoi ngjarjen e rëndë, e cila nuk kishte tronditur vetëm Komunën e Malishevës, por të gjithë”. Z.Nikolli, foli edhe në emër të kryetarit të Bashkisë, z.Alfred Qafa, i cili për shkak të obligimeve si kryetar i Bashkisë, nuk ishte sot prezent, por me zemër e me mendje, ishte me familjet që kishin pësuar në këtë aksident.

Pas fjalimeve të rastit, i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, zv/kryetari i Bashkisë së Fushë-Arrëzitet, z.Gjokë Nikolli, përfaqësues të familjeve të maurantëve, përfaqësues të maurantëve tjerë të mbijetuar të aksidentit dhe maurantë të gjimnazit të Fushë-Arrëzitet, vendosën lule në lapidarin e ngritur në vendin e aksidentit.

Komisioni për organizimin e zgjedhjeve në fshatra, filloi punën

Malishevë, 14 tetor

Drejtuar nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, komisioni komunal për organizimin e zgjedhjeve në fshatra, ka mbajtur takim të parë të punës, ku kanë zgjedhur kryetarin dhe nënkryetaren e këtij komisioni, cili do të merret me organizimin e zgjedhjeve, të kryesive dhe kryetarëve të fshatrave të Malishevës. Komisioni përbëhet nga nëntë anëtarë dhe është i formuar me vendim të Kuvendit të Komunës.

Komisioni ka zgjedhur z.Rrahim Morina, si kryetar të komisionit, ndërsa znj.Behije Sertolli, nënkryetari, e cila njëherit edhe apeloj për pjesëmarrje të femrave në procesin e zgjedhjeve në fshatrat e Malishevës.

Takimi i radhës së komisionit do të mbahet të premten më 17 tetor, ndërsa me vendim të KK të Malishevës, zgjedhjet në fshatra duhet të fillojnë të mbahen nga 25 tetor.

10 vjet nga humbja e jetës së 15 maurantëve gjimnazist të Malishevës

Malishevë, 14 tetor

Sot, u bënë dhjetë vite, nga humbja tragjike e jetës së 15 maurantëve të gjimnazit “Abdyl Frashër” (tash gjimnazi “Hamdi Berisha”), të cilët aksidentalisht kishin humbur jetën, në afërsi të Fushë-Arrëzitet, në Republikën e Shqipërisë, përderisa ktheheshin nga një ekskursion të organizuar nga shkolla. Me këtë rast, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës së Malishevës, janë zhvilluar një varg aktivitetesh, në përkujtim të 15 maurantëve.



Në dhjetë vjetorin e kësaj tragjedia, si ngjarja më e rëndë për Malishevën e pasluftës, një ditë më parë, janë bërë homazhe në vendin e rënies, në Fushë-Arrëz, ndërsa sot, është organizuar një Akademi Përkujtimore, janë bërë homazhe në varrezat e maturantëve, si dhe është bërë ribotimi i librit kushtuar “Tragjedisë së Fushë-Arrëzit”.

Më 14 tetor 2004, përderisa ktheheshin nga ekskursioni, njëri nga autobusët ishte aksidentuar, ku si pasojë, vdiqën 15 maturantë, ndërsa u lënduan rëndë e lehtë 34 nxënës dhe profesor të tjerë.

Në akademinë përkujtimore, krahas familjarëve, morën pjesë edhe Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, shkëlqesia e tij Qemal Minxhozi, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, përfaqësues të institucioneve tjera në Malishevë, përfaqësues të klerit, nxënës e profesor të gjimnazit dhe shkollave tjera të mesme dhe qytetar të shumtë.

“Ju prindër të maturantëve. E di që edhe sot e keni të vështirë të pranoni ndarjen e një pjese të zemrës dhe shpirtit tuaj. Të vështirë e kemi edhe ne të gjithë. Të vështirë e patët edhe ju profesor e nxënës të gjeneratës, ku në vend të librave, shikonit lulet e vendosura në bankat e tyre”, tha mes tjerash, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në fjalën e tij në akademinë përkujtimore.

“I nderuar popull i Malishevë, Ju të nderuar familjar, jam sot këtu të ndaj dhimbjen me ju. Në atë kohë isha ambasador në Danimarkë, kur mora vesh lajmin e kobshëm. Ishte një ngjarje tragjike, por që bashkoi të gjithë popullin shqiptar, në një mendje, në një trup. Kjo është një dhimbje e përbashkët e të gjithë neve”, tha ambasadori Minxhozi, duke shprehur solidaritetin e shtetit shqiptar, me familjet të cilat, humbën më të dashurit e tyre dhe duke ju dhënë kurajo familjeve dhe Malishevës në përgjithësi.

Nga ana tjetër, ish drejtori i gjimnazit, z.Januz Kastrati, duke marrë fjalën, i falënderoi të gjithë ata që ishin angazhuar në atë kohë, të dy shteteve tona, që ato ditë ju bashkuan dhimbjes së përbashkët me familjet. “Ngushëllime edhe për ju drejtor, pasi ne kemi humbur nga një, ndërsa ju keni humbur 15 nxënës”, tregoi kujtimet e atyre ditëve, kur familjarët i kishin thënë atij.



Ndërsa në emër të gjimnazit “Hamdi Berisha” (ish “Abdyl Frashëri), foli ushtruesi i detyrës së drejtorit, z.Izet Hoti, i cili e cilësoi si një ngjarje rëndë, e cila i goditi të gjithë popullin shqiptar. “Gjimnazi ynë, gjithmonë do ti kujtoj maturantët e saj”, th anë fund drejtori Hoti.

Në emër të familjarëve të maturantë, i falënderoi të gjithë të pranishmit, Osman Suka.

Më pas janë bërë homazhe në varrezat e maturantëve, ku krahas familjarëve, morën pjesë mijëra qytetar, nxënës të shkollave të mesme të Malishevës, mësimdhënës, zyrtar të të gjitha institucioneve, të prirë nga kryetari Begaj dhe ambasadori Minxhozi.

Në këtë tragjedi, humbën jetën këta maturantë:

Berat Suka, Esat Hajrullahu, Elgadaf Zabelaj, Mefail Morina, Rifat Hoxha, Xhevdet Sertolli, Visar Kafexholli, Agron Berisha, Ajet Rrahmanaj, Esat Rexhaj, Labinot Morina, Lulzim Kastrati, Megëzon Sadiku, rruhi Ulluri dhe Xhevdet Sahitaj.

Në vazhdim fjalimi i kryetarit të Malishevës, Ragip Begaj, mbajtur në Akademinë Përkujtimore:

Siç e dimë të gjithë, Malisheva 10 vite më parë, ishte në zi të plotë, pasi po ju jepte lamtumirën e fundit 15 djemve të saj, të cilët tragjikisht humbën jetën në një aksident trafiku në Fushë-Arrëz, gjatë rrugës së kthimit nga ekskursioni që kishin organizuar në Shqipëri.

Ishim në zi të plotë, pasi po i përcillnim për në banesën fundit, 15 djemtë tanë, në moshën më të mirë të tyre. Ishin maturantë, në pritje që t’ju mësynë dyerve të fakulteteve, e që më pas ti ktheheshin për ta ndërtuar Malishevën e pasluftës.

Humbja e tyre, ishte tragjike, sepse po ktheheshin nga një ekskursion jo i thjeshtë, sepse kishin shkuar ta vizitonin tokën e ndaluar për prindërit dhe gjyshërit e tyre. Kishin shkuar ta vizitonin Nënë Shqipëri.

Kthimi në arkivole na përkujton historinë e dhimbshme, ku rruga për në Shqipëri gjithmonë ka qenë e vështirë, pasi kishim një kufi të vendosur padrejtësisht dhe çdo kalim kufiri ishte sakrificë.

Ju prindër të maturantëve. E di që edhe sot e keni të vështirë të pranoni ndarjen e një pjese të zemrës dhe shpirtit tuaj. Të vështirë e kemi edhe ne të gjithë. Të vështirë e patët edhe ju profesor e nxënës të gjeneratës, ku në vend të librave, shikonit lulet e vendosura në bankat e tyre.

E di që edhe sot mungesa e atyre, është e madhe. Por kur humbja e më të dashurve, bëhet pjesë e dhimbjes së gjithë kombit, atëherë dhimbja nuk është vetëm për familjet, vetëm për

shokët e tyre, apo profesorët, por është dhimbje e të gjithëve dhe kur jemi bashkë, ku jemi afër njëri tjetrit, dhimbja është më e lehtë, pasi të gjithë së bashku e ndajmë atë dhimbje .

Të gjithë ne i kujtojmë ato ditë, kur me neve e ndanë dhimbjen të gjithë. Kur këtu erdhën të gjitha personalitetet vendore e ndërkombëtare. Kur këtu, me neve, erdhën dhe ndanë dhimbjen e edhe përfaqësuesit më të lartë të shtetit shqiptar. E kur jemi të shteti shqiptar, ne nuk mund të mos i falënderojmë për angazhimin e tyre, për shpëtimin e jetëve të të aksidentuarve.

E di që edhe sot, ne të gjithë kemi dhimbje për këtë humbje. Për humbjen më të madhe të Malishevës, së pasluftës dhe kjo ngjarje, përgjithmonë do të mbetet në historinë dhe kujtesën tonë.....

Maturantët le të prehen të qetë, përjetësisht.....

GLV organizoi debat për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal

Malishevë, 15 tetor



Sot në Malishevë, Grupi Lokal i Veprimit (GVL), ka organizuar debat me temën "Rëndësia e pjesëmarrjes së partneritetit publiko-privat në hartimin e strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal". Kjo strategji, pritet të hartohet në kuadër të zbatimit të projektit "Eko-Llapusha" dhe ka për qëllim hartimin e strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal.

Qëllimi i këtij projekti është të vazhdoj lidhjen me hartimin e strategjisë të zhvillimit ekonomik lokal 2015-2020, duke u mbështetur në përkrahjen e zhvillimit rural dhe bujqësor në Komunën e Malishevës. Orientimet strategjike të OJQ-së, do të konsistojnë në forcimin e partneritetit publiko-privat dhe bashkëpunimet me të gjithë mekanizmat, të cilët kanë për synim mbështetjen e projekteve për zhvillimin ekonomik lokal.

Nënkryetari i Komunës së Malishevës z.Rexhep Mazreku, duke marrë fjalën në këtë debat, tha, "është gjë shumë e mire që organizatat jo qeveritare, konkretisht GLV –Llapusha, pas disa viteve po organizon një debat që është mjaft i dobishëm për qytetarët e komunës së Malishevës", tha Mazreku në fjalën e tij.



Koordinatori i projektit “Eko-Llapusha”, z.Enver Mazreku, tha “kjo strategji synon të përkufizon dhe të artikulon, strategjinë tonë për hartimin e projekteve të ndryshme, të cilat shkojnë në të mirë të qytetarëve tanë, me theks të veçantë, në zhvillimin rural dhe ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme ekonomike dhe sociale në Malishevë”.

Kjo strategji do të hartohet në kuadër të zbatimit të projektit “Eko-Llapusha”, i cili financohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, ndërsa do të implementohet nga GLV”Llapusha” nga Malisheva.

Komiteti për shëndetësi jep rekomandime për debat në KK

Malishevë, 15 tetor

Komiteti për shëndetësi dhe mirëqenies sociale, Familje të dëshmorëve, invalid dhe veteran të luftës, mbajti mbledhjen e tretë të radhës, të drejtuar nga kryesuesja e këtij komiteti, znj.Arbëresha Krasniqi, rekomandoi për debat në kuvend, për efektin e ndërrimit të orarit të punës në QKMF.

Ky komitet, në mbledhjen e sotme, ka shqyrtuar raportin gjashtë mujor të punës së drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale, dhe nga gjatë shqyrtimit, doli edhe propozimi për debat në KK të Malishevës, për efektin e ndërrimit të orarit të punës në QKMF dhe orarin e kujdestarisë së barnatoreve në qytetin e Malishevës.

Në mbledhjen e sotme, komiteti ka shqyrtuar edhe çështje tjera që lidhen me punën dhe detyrat e komitetit.

Komisioni për zgjedhje në fshatra, hartoi planin e punës

Malishevë, 17 tetor

Komisioni komunal për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës, kryesuar nga kryetari i komisionit, z.Rrahim Morina, ka mbajtur sot mbledhjen e dytë të radhës, ku në mesin e disa çështjeve të diskutuara, ka hartuar edhe planin dinamik të punës, për zgjedhjen e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave.



Sipas këtij plani, i tërë komisioni do të ndahet në dy grupe, njëri i udhëhequr nga Rrahim Morina dhe tjetri nga Hajdin Berisha, të cilët do ti organizojnë nga dy takime brenda ditës, në dy vendbanime të ndryshme, njëri në ora 17:00 dhe tjetri në ora 19:00.

Paraprakisht, komisioni vendosi që të mbaj një takim me kryetarët e deritanishëm të fshatrave, të cilët do ti njoftoj me organizimin e zgjedhjeve, orarin dhe vendin e mbajtjes së zgjedhjeve, për zgjedhjen e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave.

Takimi me kryetarët e fshatrave, do të mbahet të mërkurën me datë 22 tetor në ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të KK të Malishevës.

Projektet kapitale në fazën përfundimtare

Malishevë, 20 tetor

“Investimet në projektet kapitale kanë hyrë në fazën përfundimtare dhe tani ato projekte duhet të përfundojnë, pasi jemi në fund të vitit buxhetor”, u tha në mbledhjen e fundit të Këshillit të Drejtorëve, mbledhje e cila u kryesua nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku.

Drejtorët e drejtorive, njoftuan se janë në përfundim të projekteve kapitale për këtë vit, pasi edhe jemi në fund të vitit, ndërsa projektet në të cilat eventualisht ka pasur ngecje, duhet të përfundojnë, përderisa u tha se janë realizuar një varg projektesh deri më tani, kurse aktualisht, janë në pritje të pranimeve teknike për disa nga projektet e përfunduara.

Përndryshe, gjatë javës së kaluar, sipas drejtorëve, nuk ka ankesa të qytetarëve, sa i përket ofrimit të shërbimeve në raport me qytetarët, ndërsa po punohet intensivisht në përgatitjet për sezonin dimëror, përkatësisht furnizimin me lëndë djegëse për shkollat dhe institucionet tjera.

Po ashtu, sipas drejtorëve të drejtorive, vërehet edhe ngritje në të hyrat vetanake të komunës.

Komiteti për diasporë kërkon zyre për bashkatdhetarët

Malishevë, 20 tetor

Komiteti për Diasporë (bashkatdhetar), sot ka mbajtur mbledhjen e dytë të radhës. Kjo mbledhje u drejtua nga kryesuesi i këtij komiteti, z.Besnik Hoti, ndërsa në këtë mbledhje, u diktuan një varg çështjesh që lidhen me aktivitet dhe rolin e komitetit, në raport me diasporën, gjegjësisht me bashkatdhetarët tanë që punojnë dhe jetojnë në botën e jashtme.



Anëtarët e Komitetit për Diasporë (bashkatdhetar), thanë se “për komunën e Malishevës roli dhe rëndësia e diasporës e sidomos kontributi nga bashkatdhetarët që jetojnë dhe punojnë në shtetet perëndimore, është mjaft i madh dhe i rëndësishëm që bëhet me dekada në të mirë të ekonomisë së vendit, dhe që ky komitet duhet të jep maksimumin në mënyrë që bashkatdhetarët të kenë lehtësira dhe me shpejtësi në ofrimin shërbimeve”.

Ndërsa për Kuvendin Komunal të Malishevës, ky komitet dha një rekomandim, për “themelimin e një zyre, si pikë referente për bashkatdhetarët, në mënyrë që ata të kenë ku të kthehen më lehtë për adresimin e kërkesave të tyre dhe të kenë një adresë orientimi”.

Ligjëratë për pasojat e përdorimit të narkotikëve

Malishevë, 20 tetor



Organizuar nga drejtoria komunale për shëndetësi, drejtoria për arsim dhe edukim, Policia e Kosovës, QKMF dhe Instituti Rajonal i Shëndetit Publik (IRSHP), sot është mbajtur një ligjëratë për efektet e përdorimit të narkotikëve, me nxënësit e Qendrës së Kompetencës në Malishevë, e ku morën pjesë, nënkryetari i Malishevës, z.Rexhep Mazreku, drejtori i arsimit z.Blerim Thaçi, ai për shëndetësi z.Hajdin Berisha, komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiten Halil Morina, drejtoresha e IRSHP-së, znj.Nurishahe Hulaj, drejtori i QKMF-së z.Besim Zogaj dhe mbi 600 nxënës të Qendrës së Kompetencës.

Ligjëratat për përdorimin e narkotikëve, i kanë mbajtur Valbona Gashi nga QKMF e Malishevës dhe Shaqir Selimi, të cilët kanë folur për përdorimin e narkotikëve, definicionin e drogave, veçoritë e tyre, efektet e përdorimit të drogave, shkallën e lartë të rrezikshmërisë nga përdorimi i narkotikëve, vdekjet dhe të tjera.

Ndërsa zyrtarët e Policisë së Kosovës, kanë ligjëruar për ligjin për poseduesit e narkotikëve, dënimet për poseduesit e narkotikëve si dhe shfaqën një videoklip që lidhet me temën e ligjëratës.

Drejtoresha e IRSHP-së, znj.Nurishahe Hulaj, ka prezantuar një hulumtim për përdorimin e narkotikëve nga nxënësit e shkollave të mesme në regjionin e Prizrenit.

KPF mbajti mbledhjen e nëntë

Malishevë, 21 tetor

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), drejtuar nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, mbajti mbledhjen e nëntë të rregullt. Në këtë mbledhje, janë trajtuar një varg çështjesh dhe u dhanë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, u rekomandua kërkesa e drejtorisë së urbanizmit për aprovimin e taksës administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit, pastaj për kuvend u rekomandua edhe raporti i drejtorisë së bujqësisë, e që ka të bëjë me subvencionet, sikur që edhe raporti për përfundimin e vitit shkollor 2013-2014 dhe fillimi i vitit shkollor 2014-2015, u rekomandua për kuvend.

Për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, u rekomandua edhe kërkesa e kryetarit të komunës për shpalljen zonë me interes publik, të pjesë së oborrit të komunës, si dhe rekomandim tjetër për KK, ishte edhe rregullorja për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit.

Nga java e ardhshme fillon rindërtimi i kadastrit në Malishevë

Malishevë, 21 tetor



Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër, z.Fadil Shala, ka prit sot në zyrën e tij, përfaqësuesin e kompanisë “EMI GRUP”, z.Fatmir Ademi, me të cilin ka biseduar për fillimin e procesit të rindërtimit të kadastrit në Malishevë, përkatësisht në gjashtë vendbanime, në Malishevë, Banjë, Drenovc, Bellanicë, Damanek dhe Kijevë.



Sipas tyre, fillimisht, kompania “EMI GRUP”, e cila do të implemtoi projektin e rindërtimit të kadastrit, do të organizoj takime njoftuese me banorët e këtyre vendbanimeve, me qëllim të njoftimit me rindërtimin informacioneve kadastrale, pasi sipas Agjencionit Kadastral të Kosovës, për shkak të mospërputhjes së të dhënave grafike me ato tekstuale, si pasojë e mosmirëmbajtjes së rregullt të kadastrit dhe marrjes së dokumenteve nga ana e Serbisë, është e domosdoshme kryerja e këtij procesi të rindërtimit të kadastrit.

Orari i takimeve me banorët e këtyre gjashtë vendbanimeve do të jetë, si vijon: me datën 27 tetor 2014, takimi do të mbahet me banorët e fshatit Bellanicë nga ora 17:00 dhe me banorët e Banjës në ora 18:30, pastaj me datën 28 tetor do të mbajnë takim informues me banorët e Damanekut në ora 17:00 dhe me banorët e Malishevës në ora 18:30 dhe me datën 29 tetor, do të mbahen takimet me banorët e Drenovcit në ora 17:00 dhe me banorët e Kijevës në ora 18:30. Takimet do të mbahen në shkollat e këtyre vendbanimeve.

Për informata shtesë, të gjithë të interesuarit mund të drejtohen në zyrën komunale të kadastrit ose në faqen zyrtare të Agjencionit Kadastral të Kosovës: www.kca-ks.org.

Zgjedhjet në fshatrat e Malishevës fillojnë me 3 nëntor

Malishevë, 22 tetor

Komisioni komunal, për monitorimin dhe organizimin e zgjedhjeve në fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës, ka mbajtur sot një takim me kryetarët aktual të fshatrave të Malishevës, të cilët i ka informuar me procesin e organizimit të zgjedhjeve, për zgjedhjen e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave.

Kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, duke e marrë fjalën në këtë takim, në emër të tij personal dhe në emër të kryetarit të Malishevës, z.Ragip Begaj, i falënderoi kryetarët e deritanishëm, që “ gjatë mandatit të tyre janë angazhuar me punën e tyre, në të mirë të komunitetit dhe vendbanimit të tyre”. “Ju keni dhënë një kontribut të madh në komunitetin tuaj dhe ne ju falënderojmë për punën e juaj”, tha kryesuesi Hoti, dhe përkujtoi që këto nuk janë zgjedhje me karakter politik.

Nga ana tjetër, kryetari i komisionit komunal për monitorimin dhe organizimin e zgjedhjeve në vendbanime dhe fshatrat e Malishevës, z.Rrahim Morina, i informoi kryetarët e deritanishëm me procesin e organizimit të zgjedhjeve, pastaj me rregulloret për këto zgjedhje, orarin e përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve, si dhe bëri të ditur, se zgjedhjet do të fillojnë

me 3 nëntor dhe ato pritet të përfundojnë brenda dhjetë ditëve, në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës.

Asfaltohen disa rrugë në fshatin Shkozë

Malishevë, 24 tetor



Sot në fshatin Shkozë të Komunës së Malishevës, ka filluar asfaltimi i disa rrugëve brenda fshatit, me një gjatësi prej 700 metrave. Në fillimin e asfaltimit të rrugëve në këtë fshat mori pjesë, nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku dhe drejtori i urbanizimit z.Urim Kastrati, si dhe deputetja e Kuvendit të Kosovës nga kjo zonë, znj.Shukrie Bytyçi, të cilët i kanë uruar banorët e këtij fshati,

me rastin e asfaltimit të rrugëve.

Nënkryetari Mazreku, i ka uruar banorët e fshatit për asfaltimin e rrugëve dhe ka thënë se “komuna do të vazhdoj të investoj në vendbanimet më të largëta, në mënyrë që banorëve të këtyre vendeve, t’iu krijohet një jetë më e mirë dhe të kenë mundësi të lëvizjes më të lehtë, ndërsa vendbanimet të cilat gjenden në thellësi të territorit të Malishevës, do të vazhdojnë të jenë prioritet i qeverisë komunale”.

Nga ana tjetër, banorët e fshatit Shkozë, kanë falënderuar komunën, për këtë investim në fshatin tyre, ku krahas shkollës së re, tani po rregullohen edhe rrugët. Ata po ashtu thanë se për shkak të pozitës e fshatit, i shtrirë rrëzë bjeshkës, rrugët e fshatit gjithmonë kanë pasur gërryerje nga të reshurat atmosferike dhe rrjedhimisht kanë pasur problem në qarkullimin e tyre, në mënyrë të veçantë fëmijët, ndërsa tani me rregullimin e rrugëve, ata lëvizin shumë më lehtë.

Fshati Shkozë, është njëri nga fshatrat e largët të Komunës së Malishevës, ndërsa nevoja për rregullimin e rrugëve brenda fshatit ka qenë e madhe, dhe për këtë arsye Komuna e Malishevës, i ka dhënë prioritet rregullimit të rrugëve në këtë fshat, sikur edhe në fshatrat tjerë të largët.



“Investimi në fshatrat që gjenden në thellësi të territorit të Komunës së Malishevës dhe investimi në fshatrat ku kanë munguar investimet në të kaluarën, janë prioritet i qeverisjes nga kryetari i komunës, z.Ragip Begaj”, tha nënkryetari Mazreku.

Gjatësia e rrugëve që sot asfaltohen në fshatin Shkozë, është 700 metra dhe kjo mundësohet nga buxheti komunal i Malishevës.

Begaj, takoi kryetarin dhe prefektin e Orhangazit

Orhangazi, 27 tetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe delegacioni nga Malisheva, në kuadër të vizitës në Komunën e vëllazëruar të Orhangazit, sot kanë takuar Kryetarin e kësaj Komune, z.Neset Çaglayan dhe prefektin e Orhangazit, z.Mustafa Selman Yurdaers, si dhe kanë bërë disa vizita në institucionet shkollore të kësaj komune.

“Ndiej kënaqësi që sot këtu kemi kryetarin dhe delegacionin e një komunës simotër të Malishevës. Ne i japim rendësi të veçantë vizitës suaj e sidomos vëllazërimit të komunave tona dhe shpresoj që ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe në të ardhmen. Ne jemi të sigurt në vazhdimin e bashkëpunimit tonë, dhe se së shpejti një delegacion nga Orhangazi, do të vizitojë Malishevën, në mënyrë që të rrisim bashkëpunimin edhe në sektorin e ekonomisë dhe sektorë tjerë”, ka thënë kryetari i Orhangazit, z. Neset Çaglayan, në takim me kryetarin e Malishevës, z.Ragip Begaj.

“Ne jemi të nderuar që jemi të vëllazëruar dhe qëllimi im është që ky vëllazërim të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe të zgjatë me dekada, edhe nga gjeneratat që vijnë. Sot jam këtu me qëllim të vazhdimin të bashkëpunimit dhe takimeve mes komunave tona, dhe besoj që edhe pas gjashtë viteve vëllazërie do të vazhdojë ky bashkëpunim”, tha kryetari Begaj.

Më pas, delegacioni nga Malisheva ka vizituar shkollën e mesme profesionale të Orhangazit, ku me drejtuesit e kësaj shkolle, kanë biseduar për bashkëpunimin e ndërsjellë dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e arsimit profesional.

Delegacioni nga Malisheva ka vizituar edhe zonën industriale, ndërsa me kryetarin e kësaj zone, z.Sukur Çoklar, kanë biseduar për mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e ekonomisë, mes bizneseve të Malishevës Orhangazit. Po ashtu sot, delegacioni nga Malisheva, ka vizituar tri fabrika të përpunimit të gurit natyror dhe atë të pajisjeve të makinave.

Shtrohen rrugët në fshatin Janqisht

Malishevë, 28 tetor

Ka përfunduar asfaltimi i rrugëve në fshatin Janqisht, përkatësisht shtrimi i dy rrugëve kryesore, në brendi të fshatit në gjatësi prej rreth pesëqind metrave. Asfaltimin e rrugëve nga afër e ka përcjellë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Raxhep Mazreku dhe drejtori i urbanizimit, z.Urim Kastrati, të cilët edhe i kanë uruar banorët për rregullimin e rrugëve.



“Ne jemi të përkushtuar në krijimin e jetës më të mirë për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës, përmes rritjes së mirëqenies së tyre dhe krijimit të kushteve më të mira për jetë, përfshi edhe lehtësimin në lëvizjen e qytetarëve, sidomos të vendbanimeve të cilat gjinden larg qendrës komunale”, tha nënkryetari Mazreku.

“Ndërtimi i infrastrukturës rrugore vazhdon të mbetet njëri prej prioriteteve tona, pavarësisht se janë bërë shumë investime në këtë fushë, por modernizimi i jetës, në vazhdimësi krijon edhe nevoja të reja, por ne jemi të përkushtuar maksimalisht, që të sadopak ti krijojmë kushte më të mira për të gjithë banorët”, tha Mazreku, duke premtuar se me këto rrugë që sot janë asfaltuar, nuk do të ndalen investimet në këtë fshat.

“Ndërtimi i infrastrukturës rrugore vazhdon të mbetet njëri prej prioriteteve tona, pavarësisht se janë bërë shumë

Vazhdojnë ligjëratat kundër përdorimit të narkotikëve

Malishevë, 28 tetor

Organizuar nga Drejtoria për Shëndetësi, në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë dhe Policia e Kosovës, stacioni në Malishevë, kanë vazhduar ligjëratat kundër përdorimit të narkotikëve, me nxënësit e shkollës së mesme profesionale, ekonomiko-juridike “Lasgush Poradeci” në Kijevë.





Ligjërata e mbajtur ishte me temën “Narkomania dhe substancat narkotike”, ndërsa ligjëratat për narkotikët, efektet dhe pasojat e përdorimit të tyre, i mbajti Valbona Gashi, nga QKMF e Malishevës, e cila i njoftoi nxënësit e kësaj shkolle, me këtë problem, ku shpesh herë viktimat janë pikërisht të rinjtë e kësaj moshe.

Ndërsa për pasojat në aspektin ligjor, nga ata që shesin, kultivojnë apo ndihmojnë në futjen e narkotikëve, ligjëratën e mbajti Shaqir Selimi nga Policia e Kosovës.

Delegacioni nga Malisheva, vizitoi Bursën

Bursa, 28 tetor

Delegacioni nga Komuna e Malishevës, që është duke qëndruar në Turqi, me ftesë të Komunës së Orhangazit, sot kanë vizituar qytetin e Bursës, përkatësisht Konsullatën e Nderit të Kosovës, në Bursa, ku janë pritur nga stafi i konsullatës kosovare, ndërsa më pas, delegacioni ka vizituar edhe fabrika, qendra profesionale dhe vende tjera, përderisa në Bursa, janë shoqëruar nga kryetari i Shoqatës Kosova-Shkupi, z.Recep Gunduzi.

Delegacioni nga Malisheva, të cilit i prin kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, e ku bëjnë pjesë edhe kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, drejtor të drejtorive komunale, anëtar të KK të Malishevës dhe zyrtar të tjerë, kanë vizituar edhe fabrikën “Ermetal”, fabrikë e cila merret me prodhimet e metaleve, plastikës dhe brumërave, ndërsa janë pritur nga menaxheri i saj, Zaim Turksever, i cili i ka njoftuar me prodhimet e fabrikës dhe mënyrën e funksionimit të këtij lloji të biznesit.

Më pas, delegacioni nga Malisheva, ka vizituar edhe Qendrën e aftësimin profesional, qendër e cila funksionin në kuadër të Odës Ekonomike të Bursës dhe është e themeluar nga biznesmeni shqiptar Fahretin Gulener.

Edhe grupi i medieve Bursa Haber, ka qenë në agjendën e vizitave të delegacionit nga Malisheva, e ku janë pritur nga udhëheqësi i këtij grupi Cuneyt Dizdar, si dhe është vizituar edhe Federata e Rumelit, ku janë pritur nga kryetari i saj z.Selim Yedikardes. Në të gjitha këto takime, është theksuar nevoja e bashkëpunimit mes bizneseve lokale nga Malisheva dhe bizneset ruke.

Vizita në Bursa, është përmbyllur me takimin vëllazëror me emigrantët nga Ballkani dhe në veçanti me emigrantët nga trojet shqiptare, të cilët janë të organizuar në shoqatën “Kosova Uskup Dernegi”.

Komuniteti RAE i integruar në shoqëri

Malishevë, 29 tetor

Në kuadër të realizimit të projektit të OSBE-së për “promovimin e integritit të komunitetit RAE”, sot në Kijevë, u mbajt një takim i përbashkët i këtij komuniteti, me OSBE-në, zyrën për komunitet dhe komitetin për komunitete, ku u diskutua për integrimin e këtij komuniteti, e që u vlerësua, edhe nga vet pjesëtarët e këtij komuniteti, se janë të integruar dhe nuk kanë probleme në aspektin ndëretnik, edhe pse numri i tyre në Komunën e Malishevës, është shumë simbolik.



Përndryshe në këtë takim, fillimisht, zyrtari i OSBE-së, z.Alev Nush, i njoftoi për këtë projekt të OSBE-së, ku në disa komuna, varësisht prej nevojave, janë hartuar edhe strategji veprimi për integrimin e komunitetit RAE, por sipas tij “në Malishevë, numri i këtij komuniteti është fare simbolik dhe nuk ka nevojë për një hartimin e ndonjë strategjie, por që gjithsesi do të përkrahen për realizimin e nevojave të tyre”.

Ndërsa zn.Edona Krasniqi, zyrtare komunale për kthimin dhe komunitete, i njoftoi të pranishmit për punën e kësaj zyre dhe përgjegjësit që ka ajo, si dhe i inkurajoi këtë komunitet, që të vazhdojnë të jenë pjesë e shoqërisë dhe të jenë pjesë aktive në të gjitha zhvillimet.

Edhe kryesuesi i Komitetit për Komunitete, z.Fatmir Ademaj, pasi i njoftoi për obligimet dhe përgjegjësit e komiteti, tha se “ky komitet ka për obligim edhe angazhimin e tyre në raport me komunitetin RAE dhe sa herë që të jetë nevoja, do të trajtojnë problemet e tyre në Asamblenë Komunale”.

Nga ana tjetër, të pranishmit nga komuniteti RAE, thanë se nuk ndihen të diskriminuar në raport me shoqërinë, pasi ka disa prej tyre që punojnë, pastaj fëmijët, e tyre vazhdojnë shkollimin normalisht, por edhe ata kanë probleme, kryesisht sociale dhe ekonomike, sikur të gjithë të tjerët, për të cilat kanë nevojë të përkrahen.



Malisheva pjesë e festimit të Ditës së Republikës së Turqisë

Orhangazi, 29 tetor

Delegacioni nga Komuna e Malishevës, që është duke qëndruar në Turqi, me ftesën e Komunës së Orhangazit, komunë e cila është e binjakëzuar me Malishevën, sot po merr pjesë në festimet e Ditës së Republikës së Turqisë, në këtë qytet. Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, sot ka marrë pjesë në pritjen e organizuar nga prefekti i Orhangazit z.Mustafa Selamn Yurdaer.

Kryetari Begaj, me rastin e urimit për festën e republikës tha: “Kam kënaqësi të veçantë që marr pjesë në manifestimin e festës së Republikës së Turqisë në qytetin e Orhangazit. Në emër timin personal, bashkëpunëtorëve dhe qytetarëve të Malishevës, ju uroj Festën e Pavarësisë dhe ju falënderoj për mikpritjen vëllazërore”.

“Prezenca juaj dhe delegacionit tuaj në këtë ditë këtu, na e madhështon dhe nderon festën tonë. Kosova dhe shqiptarët janë një shtet dhe komb mik. Andaj përmes juve, i përcjelli përshëndetjet dhe respektin tonë tek qytetarët dhe populli juaj”, tha prefekti i Orhangazit z.Yurdaer.

Delegacioni nga Malisheva, i prirë nga kryetari Begaj, së bashku me udhëheqësit e lartë shtetëror dhe lokal, morën pjesë në shënimin e manifestimit, për nder të 91 vjetorit të Republikës së Turqisë. Ky manifestim u organizua në stadiumin e qytetit, ku nga ana e prefektit të Orhangazit, z.Mustafa Selamn Yurdaer, janë nderuar me mirënjohje Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, z.Enver Hoti.

Pas urimeve të kryetarit Begaj për përfaqësuesit më të lartë shtetëror dhe komunal të Orhangazit delegacioni mori pjesë në manifestimin e 91 Vjetorit të Pavarësisë së Turqisë të organizuar në Stadiumin e qytetit. Me këtë rast prefekti i qytetit Yurdaer nderoi me mirënjohje kryetarin Ragip Begaj dhe Kryesuesin e Asamblesë Enver Hotin si dhe ju dhuroi nga një trëndafil të gjithë delegacionit.

Delegacionin malishevas, gjatë qëndrimit në Orhangazi, janë shoqëruar nga kryetari i shoqatës “ORGÖÇ”, z. Ali Durmuş.

Biznesmeni Hoxha nga Stambolli, pritet që shpejt të sjellë një filial të fabrikës në Malishevë

Malishevë, 31 tetor



Biznesmeni Blerim Hoxha, pronar i fabrikës “Myfix”, e cila është njëra prej fabrikave më të mëdha të prodhimit të letrës higjienike në Stamboll, pas takimit me kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtorët komunal Vesel Krasniqi e Blerta Krasniqi, në Stamboll, ka premtuar që shumë shpejt do të hap një filial të kësaj fabrike edhe në Malishevë. Vizita në këtë fabrikë në Stamboll, është realizuar gjatë vizitës së delegacionit nga

Malisheva, në Turqi.

Biznesmeni Blerim Hoxha, është nga Bellanica e Malishevës, ndërsa këtë lloj të fabrikës, vite më parë e kishte hapur në Bellanicë, pro për shkak të politikave fiskale, fabrikën e kishte transferuar në Stamboll të Turqisë, ndërsa tani pritet që shumë shpejt të kthehet me një filial të saj edhe Malishevë. Kështu ka deklaruar ky biznesmen, pas takimit që ka zhvilluar me udhëheqësit e Komunës së Malishevës.

Përndryshe, pronari i kësaj fabrike, është edhe pronar i pijes energjike “Miami beach”, ndërsa para pak javëve, ka arritur të blejë edhe ekipin grek të futbollit “Aris” nga Selaniku.

Drejtori komunal për ekonomi, buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, ka konfirmuar, se edhe ky takim me biznesmenin Hoxha, ka qenë shumë i frytshëm, sikur që kanë qenë shumë të frytshme, edhe takimet tjera, që i kanë zhvilluar në Orhangazi, në Bursa dhe gjatë ditës së djeshme në Stamboll.

KK i Malishevës, miratoi statutin e Komunës

Malishevë, 31 tetor

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e dhjetë të radhës, ka miratuar statutin e Komunës së Malishevës, pasi anëtarët e Kuvendit të Komunës, i kanë shqyrtuar të gjitha propozimet për ndryshime në statutin e komunës. Këto ndryshime, kanë marrë votën e të gjithë anëtarëve të kuvendit.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e saj të rregullt, sot ka miratuar edhe



kërkesën e Kryetarit të Komunës për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronës së paluajtshme në zonën kadastrale të Malishevës, përkatësisht zonën, ku gjenden objektet e Komunës së Malishevës.

Në këtë mbledhje, është miratuar edhe raporti i drejtorisë për bujqësi, lidhur me subvencionet e komunës, si dhe është miratuar edhe taksa administrative për leje

ndërtimi, e cila kap një shumë prej 2.81 euro për metër katror si dhe taksa për rregullimin infrastrukturës e cila kap shumën prej 151.08 euro për kokë banori.

Po ashtu, kuvendi sot ka miratuar edhe rregulloren për Fuqizimin dhe Promovimin e Vullnetarizmit në Komunën e Malishevës, si dhe ka marrë vendim, me kërkesën e një qytetari për ndërrim destinimin e tokës së tij, nga toka bujqësore, e kategorisë së pestë, në tokë ndërtimore.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 132-Nëntor 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Përrurimi i urës kryesore
në Malishevë



Zbulimi i lapidarit të
dëshmorëve në Gurishtë



Shënimi i 28 Nëntorit



Po vazhdojnë projektet për ndërtimin e infrastrukturës

Malishevë, 3 nëntor

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të kryesuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, u bë e ditur, se janë në zhvillimin e sipër disa projekte, kryesisht në infrastrukturë, ku përfshihen asfaltime të rrugëve, kanalizime, pastaj po vazhdon ndërtimi i objekteve shkollore dhe projekte tjera, një dhe dy vjeçare, ndërsa është tejkualuar edhe planifikimi i të hyrave vetanake.

Sipas drejtorisë së urbanizimit, aktualisht është duke u realizuar një projekt i ndërtimit të rrugëve, përkatësisht asfaltimit të disa rrugëve në fshatrat Bubavec, Kijevë, Balincë e Bubël, sikurse edhe është duke u punuar në rregullimin e kanalizimeve në Qupevë e Bubavec. Po ashtu sipas kësaj drejtorie, po vazhdon ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza.

Ndërsa drejtoria për ekonomi, buxhet dhe financa, ka bërë të ditur, se është tejkualuar planifikimi i të hyrave vetanake dhe është e nevojshme një rishikim i buxhetit, pasi janë realizuar më shumë të hyra, se planifikimi komunal për mbledhjen e të hyrave vetanake.

Në këtë mbledhje u bë e ditur, se po vazhdojnë mbjelljet vjeshtore, sikur edhe regjistrimi i pronës bujqësore dhe nuk ka probleme në këtë drejtim, ndërsa është duke vazhduar edhe rindërtimi i informatave të kadastrit.

Sa i përket fushës së arsimit, u bë e ditur se është duke vazhduar ndërtimi i shkollave, ndërsa renovimet, kanë përfunduar në shumicën prej shkollave, e aty ku ka pasur renovime dhe humbje të orëve të mësimi, ato orë po zëvendësohen gjatë vikendeve, si dhe është duke vazhduar furnizimi me lëndë djegëse për sigurimin e ngrohjes për tërë sezonin e dimrit, për të gjitha shkollat.

Nga ana tjetër kryetari i komunës, z.Ragip Begaj, ka kërkuar respektim të orarit të punës nga ana të gjithë punonjësve në administratë, si dhe ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse, që ti kushtohet më shumë kujdes ambientit dhe pastërtisë në hapësirat publike në tërë territorin e komunës.

Kanë filluar zgjedhjet në fshatrat e Malishevës

Malishevë, 4 nëntor

Pas shpalljes së zgjedhjeve nga ana e Kuvendit të Komunës, për zgjedhjet në fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës, prej mbrëmë ka filluar edhe mbajtja e zgjedhjeve, sipas planit të hartuar nga Komisioni Komunal për monitorimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve, ku janë organizuar tri takime, në Guncat, Temeqinë dhe Malishevë, ndërsa zgjedhjet në Mirushë, janë shtyrë për arsye objektive.

Sipas vendimit të Kuvendit të Komunës, zgjedhjet do të mbahen në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës, prej ku do të dalin kryesitë dhe kryepleqtë, pasi sipas rregullores, mandati i kryesive dhe kryepleqve të fshatrave dhe vendbanimeve, përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të Asamblesë Komunale.

Komisioni Komunal për monitorimin dhe organizimin e zgjedhjeve, është i ndarë në dy grupe punuese në terren dhe pritet që brenda dy javëve të përfundoj procesi i zgjedhjes së kryesive dhe kryetarëve të fshatrave dhe vendbanimeve të Komunës së Malishevës.

Shtyrje eventuale të zgjedhjeve, mund të ketë për shkaqe teknike, siç mund të jetë mungesa e energjisë elektrike, ose shkaqe tjera objektive.

Pas përfundimit të zgjedhjeve, komisioni komunal, do të përgatit raportin e plotë lidhur me këto zgjedhje dhe listën e të zgjedhurve, do ta procedoj për miratim në Kuvendin e Komunës.

Begaj priti drejtuesin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK)

Malishevë, 4 nëntor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në Malishevë, kryetarin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) z.Naim Ismailin dhe drejtorin ekzekutiv të AKK-së, z.Sazan Ibrahimini, me të cilët ka biseduar për çështje të ndryshme që lidhen me pushtetin komunal. Kjo vizitë e drejtuesve të AKK-s, është bërë në kuadër të vizitave të rregullta nëpër komuna.

Fillimisht kryetari Begaj, i falënderoi drejtuesit e AKK-së për vizitën, ndërsa i njoftoi ata me të gjitha rrjedhat në pushtetin komunal të Malishevës, si dhe u zotua për vazhdimin e dhënies së kontributit të Malishevës, në këtë asociacion, sikur edhe komunat tjera.

Nga ana tjetër, drejtuesit e AKK-së, Ismaili dhe Ibrahim, biseduan me kryetarin Begaj, për sfidat e pushtetit lokal në tërësi, legjislacionin, harmonizimin e legjislacionit dhe përmirësimin e legjislacionit, pastaj identifikimi i problemeve të ndryshme dhe adresimin e këtyre problemeve në mënyrë që pushteti lokal, të jetë më funksional dhe të fuqizohet roli i komunave.

Për këtë vjeshtë pritet të mbillen 3 722 hektar me grurë në Malishevë

Malishevë, 4 nëntor

Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural, ka hartuar planin operativ për mbjelljet vjeshtore, ku bazuar nga të dhënat në teren, për këtë vit, janë planifikuar të mbillen 3 780 hektar, ku dominon gruri, ndërsa e tërë kjo sipërfaqe, është tërësisht në sektorin privat.

Sipas planifikimit këtë vit pritet të mbillen 3 722 hektar me grurë, ndërsa 35 hektar me tërshërë dimërore, kurse me kultura tjera, pritet të mbillen 14 hektar me elb dimëror, gjashtë hektar me bimë foragjere dhe 3.2 hektar me thekër.

Përndryshe, sipas të dhënave nga terreni, shumica e grurit, tashmë është mbjellë, ndërsa në rastet ku ka vonesa, inxhinierët e bujqësisë, bëjnë thirrje, që të shfrytëzohet koha për mbjellje.

Drejtori i drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural, z.Hajrullah Mazreku, tha për Zyrën për Informim se “mbi tetëdhjetë për qind e hapësirës së planifikuar për mbjellje, ka përfunduar, ndërsa bujqit janë përballur me vështirësi të ndryshme, për shkak të faktorëve klimatik, dhe pavarësisht se ka kaluar koha optimale për mbjellje, megjithatë bujqit duhet ta shfrytëzojnë motin e mirë, pa të reshura, në mënyrë që mbjelljet të përfundojnë”.

Përfundojnë zgjedhjet edhe në katër fshatra

Malishevë, 5 nëntor



Komisioni komunal, për monitorimin dhe organizimin e zgjedhjeve në fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës, ka vazhduar punën e tij, duke mbajtur zgjedhjet në katër vendbanime të Komunës së Malishevës, ku janë mbajtur kuvendet dhe janë zgjedhur udhëheqësit e tyre.

Komisioni komunal, është i përbërë nga nëntë anëtar të saj, ndërsa janë të ndarë në dy grupe dhe gjatë ditës së djeshme, kanë organizuar kuvendet zgjedhore në Bellanicë, Guncat, Lumnishtë dhe Turjakë.

Pas njoftimit me rregulloren e punës nga ana e komisionit komunal, kanë vazhduar me procedurat për zgjedhjet e kuvendeve, kryesive dhe kryepleqve të këtyre fshatrave, ndërsa i tërë procesi ka kaluar pa probleme, në aspektin e mbajtjes së zgjedhjeve, përderisa problem kryesor gjatë mbajtjes së kuvendeve nëpër fshatra, po paraqitet mungesa e energjisë elektrike, pasi fshatrat e Komunës së Malishevës, tash e disa ditë, po përballen me reduktime të ashpra të furnizimit me energji elektrike.

Pas përfundimit të mbajtjes së zgjedhjeve në të gjitha fshatrat, lista me udhëheqësit e ri të fshatrave, do të procedohet në Asamblenë Komunale, për miratim.

Kryetari i Tropojës, Kortoçi vizitoi Malishevën

Malishevë, 5 nëntor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij, Kryetarin e Komunës së Tropojës, z.Ramë Kortoçi, me të cilin biseduan për nevojën e bashkëpunimit të ndërsjellë mes dy komunave, të Malishevës dhe asaj të Tropojës në fusha të ndryshme me interes të përbashkët.



Fillimisht kryetari Begaj, e falënderoi kryetarin e Tropojës z.Kortoçi, për vizitën në Malishevë, si dhe e njoftoi atë me rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, që nga paslufta e deri më sot, si dhe e falënderoi popullin e Tropojës për kontributin e dhënë gjatë luftës në Kosovë, ku kanë gjetur strehë mijëra banorë të Komunës së Malishevës dhe më gjerë.

Nga ana tjetër, kryetari i Tropojës, z.Kortoçi, e falënderoi kryetarin Begaj, për mikpritjen, e më pas biseduan për bashkëpunim e ndërsjellë, për nevojën që kemi për rritjen e bashkëpunimit në të gjitha fushat.

Begaj e Kortoçi, u pajtuan që të vazhdohet bashkëpunimi i ndërsjellë mes Malishevës dhe Tropojës, si në kulturë, arsim, ekonomi, bujqësi dhe fusha tjera me interes.

Shtrohen disa rrugë në Bubavec

Malishevë, 6 nëntor



Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore, nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës, në fshatin Bubavec, kanë filluar dhe janë duke u shtruar disa rrugë, brenda fshatit, me qëllim të lidhjes së lagjeve me rrugë të asfaltuar. Gjatë ditës sotme, punimet në këto rrugë i ka inspektuar edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Me këtë rast kryetari Begaj, i ka uruar banorët e këtyre lagjeve, për rregullimin e rrugëve të tyre dhe ka premtuar se nuk do të mungoj angazhimi i komunës, në rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme, në të gjitha fshatrat e Malishevës.

Përndryshe në Bubavec, aktualisht, janë duke u shtruar rreth 350 metra rrugë brenda fshatit, si dhe është duke u ndërtuar edhe një pjesë e kanalizimit. Të gjitha këto investime mundësohen nga buxheti komunal i Malishevës.

Kryetari Begaj, vizitoi familje e Gegaj, së cilës i është rindërtuar shtëpia

Malishevë, 7 nëntor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka vizituar sot familjen Gegaj nga Ladroci, së cilës, në muajin prill, ju ishte djegur shtëpia, ndërsa komuna, kishte premtuar që ta ndihmoj këtë familje, në riparimin e shtëpisë. Falë kësaj ndihme nga ana e komunës, familja Gegaj, tashmë e ka të riparuar shtëpinë.



Qëllimi i vizitës së kryetarit Begaj, ishte njoftimi me kushtet e jetës që ka kjo familje, e cila jeton në gjendje të rëndë sociale dhe për të shikuar nga afër nëse kanë arritur që të sistemohen brenda në shtëpi, pas riparimit nga dëmet e zjarrit. Me këtë rast, kryetari Begaj, shprehi kënaqësinë e tij, pasi kjo familje ka arritur që sërish të ketë kulm mbi kokë dhe kushte normale për jetë, pas ndihmës së ofruar nga Komuna e Malishevës.

Komuna e Malishevës, e ka ndihmuar familjen Gegaj, në ndërtimin e kulmit të shtëpisë dhe në meremetimin e brendshëm të shtëpisë, e cila muaj më parë, aksidentalisht, ishte djegur në tërësi, si pasojë e zjarrit.

Kryetari i Komunës, viziton shkollat në prag të fillimit të dimrit

Malishevë, 7 nëntor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, është duke i vizituar shkollat fillore të Komunës së Malishevës, me qëllim të njoftimit direkt, nëse shkollat janë të përgatitura me lëndë djegëse, në prag të fillimit të sezonit dimëror, si dhe për procesin mësimor në këto shkolla, me qëllim të evitimit të problemeve dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie.

Kryetari Begaj, dje dhe sot, ka vizituar shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Bubavec, në Lladroc dhe në shkollën “Visar Krasniqi” në Drenoc, me ç’rast i ka takuar drejtorët e shkollave, nga të cilët është njoftuar për furnizimin me dru për ngrohje, si dhe është njoftuar me rrjedhat e përgjithshme të procesit mësimor në këto shkolla.

Po ashtu, kryetari Begaj, gjatë këtyre vizitave, po njoftohet nga ana e përgjegjësve të shkollave, me nevojat që kanë këto shkolla, si dhe me problemet eventuale që mund të kenë. Në të njëjtën kohë, Begaj, i ka takuar edhe nxënësit e këtyre shkollave, nga të cilët ka kërkuar që të jenë të angazhuar në mësim dhe të arrijnë rezultate sa më të mira.

Komandanti i kontingjentit gjerman të KFOR-it, vizitoi Malishevën

Malishevë, 7 nëntor



Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj ka pritur sot komandantin e kontingjentit gjerman të KFOR-it, kolonelin Zeyer, në një takim me karakter njohës, me të cilin kanë biseduar për çështje të ndryshme, e në veçanti për situatën e sigurisë në Komunën e Malishevës.

Fillimisht, kryetari Begaj, kolonelin Zeyer, e falënderoi për vizitën e tij, për bashkëpunim të ndërsjellë, si dhe kontributin e KFOR-it që po jep në Kosovë dhe në veçanti në Komunën e Malishevës. “Unë kam dëshirë që çdoherë të kemi takime, biseda me ju, ngase edhe u jam shumë mirënjohës jo vetëm KFOR-it, por edhe popullit gjerman, për ndihmën e vazhdueshme për Kosovën dhe kosovarët në përgjithësi në të gjitha periudhat” tha Begaj.

Nga ana tjetër komandanti i kontingjentit gjerman të KFOR-it koloneli Zeyer, e falënderoi kryetarin Begaj për mikpritjen, ku më pas ka folur rreth misionit të KFOR-it gjerman në Kosovë, se ku veprojnë në cilat pjesë të Kosovës, ndërsa gjendjen sigurisë e vlerësoi të qetë dhe stabile në përgjithësi.

Kryetari Begaj, me pas dha një pasqyrë të përgjithshme mbi Komunën e Malishevës para Kolonelit Zeyer, e po ashtu e njfotoi edhe për përpjekjet e komunës për kryerjen e punëve dhe obligimeve komunale në raport me qytetarët.

Vazhdojnë investimet kapitale dhe përkrahja për bujqit

Malishevë, 10 nëntor

Edhe sot, sikur çdo të hënë, është mbajtur mbledhja e rregullt e qeverisë komunale të Malishevës, drejtuar nga kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj. Në këtë mbledhje u bë e ditur se janë duke vazhduar punimet në realizimin e disa projekteve, kryesisht në infrastrukturën e përgjithshme, ndërsa vazhdon edhe përkrahja në sektorin e bujqësisë.

Sipas drejtorisë së urbanizimit, janë duke vazhduar punimet në disa projekte, ndërsa po vazhdon edhe asfaltimi i rrugëve, ku sot nga asfaltimi i rrugëve në Balincë, do të vazhdohet me asfaltimin e rrugëve në fshatin Bubël, si dhe gjatë javës do të bëhen edhe pranimet

teknike të disa projekteve të realizuara, përfshi edhe zgjerimin dhe rregullimin e urës në qytetin e Malishevës.

Ndërsa sipas drejtorisë së bujqësisë, gjatë kësaj jave pritet të ndihmohen fermerët e Malishevë, në blegtori, me mjete konkretizuese të punës, përkatësisht me makina mjelëse, projekt i realizuar nga Komuna e Malishevës, ndërsa kjo ndihmë, sipas drejtorisë, planifikohet të vazhdohet edhe në vitin e ardhshëm.

Përndryshe, në mbledhjen e sotme, drejtorët e drejtorive, raportuan për aktivitet e tyre, gjatë javës që shkoi dhe planifikimet për javën në vijim, si dhe për përgatitjet për shënimin e 28 Nëntorit, festës kombëtare të flamurit.

Kryetari Begaj, priti përfaqësuesin e UN HABITAT-it në Kosovë

Malishevë, 10 nëntor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot përfaqësuesin e ri të UNHABITAT-it në Kosovë, z.Ishaku Maitumbi. Ky takim kishte karakter njoftues, pasi z.Maitumbi, ka marrë këtë detyrë, ndërsa Malisheva dhe UNHABITAT-i, bashkëpunojnë në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), si dhe kanë bashkëfinancuar zgjerimin dhe rregullimin e urës kryesore në Malishevë.



Kryetari Begaj, fillimisht e uroi për përgjegjësinë e tij në këtë organizëm me rëndësi të Kombeve të Bashkuara, si dhe e falënderoi për angazhimin e tij, edhe në të kaluarën në UNHABITAT në përgjithësi, si dhe në veçanti në Malishevë, përderisa premtoi bashkëpunim të ndërsjellë në realizimin e projekteve të përbashkëta, si në finalizimin e PZHK-së, ashtu edhe në projekte tjera.

Nga ana tjetër, z.Ishaku Maitumbi, tha se është i informuar me Planin Zhvillimor Komunal, si dhe që ka marrë informacione për shumë zhvillime në Malishevë, siç tha edhe vet, “se është bërë shumë në zhvillimin e Malishevës”. Sipas zyrtarit Maitumbi, dhe kryetarit Begaj, Plani Zhvillimor Komunal është prioritet i dy palëve, dhe pritet që deri në dhjetor të përfundoj.

Kryetari Begaj, e ka informuar përfaqësuesin e UNHABITAT-it, për angazhimet dhe prioritetet e komunës dhe resurset që ka Malisheva për zhvillim.

Mbyllen 12 lokale të lojërave të fatit

Malishevë, 11 nëntor



Sot rreth orës 11:00, është zhvilluar një aksion i përbashkët nga Agjencioni Tatimor i Kosovës (ATK) departamenti i lojërave të fatit, Doganat e Kosovës, Drejtorja e Inspektoratit, të asistuar nga Policia e Kosovës, kanë mbyllur 12 lokale afariste, në territorin e komunës së Malishevës, që kanë zhvilluar aktivitete të lojërave të fatit, të cilat nuk kanë respektuar ligjin në fuqi lidhur me lojërat e fatit.

Më saktësisht, këto lokale, nuk kanë respektuar largësinë nga institucionet publike, e paraparë me ligj, e cila duhet të jetë, me një rreze veprimi prej 500 metra.

Sipas drejtorit të drejtorisë së inspektoratit në Malishevë, z.Sejdi Paçarizi, “ky aksion është zhvilluar nga ATK-ja, e cila është përgjegjëse për lojërat e fatit, ndërsa inspektorët komunal, kanë asistuar gjatë këtij aksioni dhe i kanë ndihmuar zyrtarët e ATK-së”.

Kryetari Begaj, vizitoi tetë shkolla

Malishevë, 11 nëntor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka vizituar sot tetë shkolla, me qëllim të njoftimit nga afër me përgatitjet e shkollave, për sezonin dimëror, si dhe me çështje tjera, në shkollat e Komunës së Malishevës, për rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, ku përveç drejtuesve të shkollave, ka takuar edhe nxënësit dhe personelin mësimor.

Sigurimi i ngrohjes për stinën e dimrit, është obligim i Komunës, ndërsa kryetari Begaj, është interesuar lidhur me këtë çështje, pasi është duke vazhduar furnizimi me lëndë djegëse për të gjitha objektet shkollore.

Kryetari Begaj, në të gjitha takimet me drejtuesit e shkollave, në gjimnazin “Hamdi Berisha”, pastaj shkollat fillore në Dragobil, Astrazup, Shkozë, Marali, Pagarushë, Gurishtë e Kërvasari, është njoftuar edhe me çështjet tjera dhe pajisjen e shkollave njetet konkretizues, si dhe me problemet që kanë këto shkolla, ku ka kërkuar që të rritet cilësia në mësim.

Po ashtu, gjatë këtyre vizitave, kryetari Begaj, ka shikuar nga afër edhe ecurinë e punimeve në ndërtimin e objekteve të reja shkollore në Shkozë dhe Gurishtë.

Kryetari Begaj priti komandantit e kontingjentit turk të KFOR-it kolonelin Demircioğlu

Malishevë, 12 nëntor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot, komandantin e kontingjentit turk të KFOR-it në Kosovë dhe njëherit komandant i Detashmentit të Përbashkët Rajonal të Jugut (JRD-South), kolonelin Faruk Demircioğlu. Takimi kishte karakter njohës, pas marrjes së komandës nga ana e kolonelit Demircioğlu.

Me këtë rast kryetari Begaj, e ka uruar kolonelin Demircioğlu, për detyrën, si dhe e ka falënderuar atë, për bashkëpunimin e mirë mes KFOR-it në përgjithësi dhe në veçanti kontingjentit turk, me Komunën e Malishevës, si dhe për bashkëpunimin e mirë që kanë me njësinë e LMT-së në Malishevë.



Nga ana tjetër, koloneli Demircioğlu, e ka falënderuar kryetarin Begaj, për pritjen, për bashkëpunimin e mirë të deritanishëm me KFOR-in, pastaj me njësinë e LMT-së në Malishevë, si dhe për pjesëmarrjen e vazhdueshme në aktivitetet zyrtare të KFOR-it turk në Kosovë..

Begaj dhe Demircioğlu, e vlerësuan të qetë situatën e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës, si dhe biseduan për zhvillimet e përgjithshme në Malishevë, për zhvillimin e ekonomik, problemet me të cilat ballafaqohet Malisheva dhe çështje tjera me interes të përbashkët.

Kryetari Begaj, e ka njoftuar kolonelin Demircioğlu, edhe me vizitën e delegacionit nga Komuna e Malishevës, në Komunën e Orhangazit në Bursa të Turqisë, për bashkëpunimin me atë komunë, si dhe e falënderoi për pritjen vëllazërore që i është bërë delegacionit nga Malisheva, në Turqi.

Begaj dhe Demircioğlu, u zotuan për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, mes institucionit të Komunës së Malishevës dhe KFOR-it.

Begaj u takua me ambasadorën e Turqisë, Ozan

Malishevë, 13 nëntor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, dje pasdite, është takuar me Ambasadorën e Republikës së Turqisë në Kosovë, znj. Songul Ozan, me të cilën kanë biseduar për çështje të ndryshme të bashkëpunimit dhe kanë shqyrtuar mundësitë e krijimit të lidhjeve të ndryshme të bashkëpunimit mes Malishevës dhe institucioneve turke.

Fillimisht kryetari Begaj, e falënderoi ambasadorën Ozan, për pritjen dhe më pas e njoftoi atë me rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, si dhe me nevojën që ka Komuna e Malishevës për vazhdimin e mbështetjes, pasi Malisheva ka resurse për zhvillim, në fusha të ndryshme të ekonomisë.

Ambasadorja Ozan, tha se “është e njoftuar me Malishevën, si dhe për kontaktet e Malishevës me shtetin turk, përfshi edhe vëllazërimin me Komunën e Orhangazit”. Ambasadorja Ozan, ka thënë se ‘do të angazhohet në krijimin e kontakteve dhe lidhjeve të reja, me qëllim të përkrahjes dhe ndihmës për Komunën e Malishevës, përmes institucioneve dhe ndërmarrjeve me ndikim’.

Kryetari Begaj vizitoi disa shkolla dhe inspektoi disa punime

Malishevë, 13 nëntor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, edhe sot ka vazhduar vizitën në shkollat e Komunës së Malishevës, ku gjatë ditës së sotme ka vizituar gjashtë shkolla, me qëllim të njoftimit direkt me gjendjen në shkollat e komunës sonë, ndërsa ka inspektuar edhe punimet në oborrin e njësisë së zjarrfikësve dhe punimet e një rruge në Astrazup.

Kryetari Begaj, gjatë vizitës në shkollat në Banjë, Temeqinë, Guncat, Bellanicë, Bardh dhe Senik, është njoftuar nga ana e drejtorëve të shkollave, me gjendjen në këto shkolla dhe për arritjet në mësim, ku është konstatuar në përgjithësi një gjendje shumë e mire dhe disa suksese të arritura nga ana e shkollave, përderisa u mësua se SHMU “Naim Frashëri” nga Banja, do të jetë pjesëmarrëse në kuizin 1,2,3, ndërsa dokumentari në RTK, për këtë shkollë, do transmetohet më 28 Nëntor, në Ditën e Flamurit.

Ndërsa gjatë vizitës shkollën e fshatit Guncat, nxënësit e kësaj shkolle, kishin ndërmarrë një aksion pastrimi të mbeturinave, në rrugën kryesore të fshatit, nga shkolla deri tek lapidari në qendër të fshatit, aksion për të cilin, kryetari Begaj, i përgëzoi nxënësit e kësaj shkolle.

Po ashtu gjatë ditës së sotme, kryetari Begaj, ka inspektuar punimet në rregullimin e oborrit të objektit të njësisë së zjarfikësve dhe shpëtimit, si dhe punimet në zgjerimin dhe rregullimin e rrugës në lagjen “Frashëri” në Astrazup, të dyja këto investime të Komunës së Malishevës

KPF mbajti mbledhjen e dhjetë të radhës

Malishevë, 13 nëntor



Komiteti për Politik dhe Financa (KPF), organ i Kuvendi të Komunës së Malishevës, i cili kryesohet nga kryesuesi i KK-së, z.Enver Hoti, mbajti mbledhjen e dhjetë të radhës, ku u dhanë disa rekomandime, për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal, anëtarët e KPF-së kanë dhënë këto rekomandime: Raporti nëntëmujor i buxhetit të këtij viti, pastaj caktimi i grupit të punës për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Po ashtu rekomandim tjetër i KPF-së ishte edhe shqyrtimi i një kërkesë të Komiteti për Diasporë për hapjen e një zyre për diasporën. Një çështje tjetër që u rekomandua për debat në mbledhjen e ardhshme të KK-së edhe çështja e kalimit të kompetencave të disa institucioneve nga regjioni i Prizrenit në regionin e Gjakovës, si dhe raportin e Drejtorisë së Arsimit.

Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi për kuvend, edhe formimin e komisionit për ndryshimet dhe plotësimet në rregulloren e punës së Kuvendit, dhe rekomandim tjetër ishte edhe trajtimi i punës së trupave të Kuvendit të Komunës.

Banorët e Bardhit të shqetësuar nga përdorimi i gomave për djegie

Malishevë, 17 nëntor

Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj ka pritur sot në zyrën e tij kryesinë dhe disa banorë të fshatit Bardh , të cilët kanë shfaqur pakënaqësitë dhe shqetësimet e tyre , lidhur me mbrojtjen e ambientit , ku dhe kanë kërkuar ndihmën e institucionit komunal që të ndalohet ndezja e furrave, ngase kjo edhe po ndotë ambientin e fshatit dhe po rrezikon shëndetin e banorëve, sepse pronaret e furrave përdorin goma për djegie.



Kryetari Begaj me këtë rast ju bashkua shqetësimeve të tyre dhe tha: ” Unë jam për respektim të ligjit, dhe përdorimi i gomave është rreptësisht i ndaluar me ligj, ne duhet të zbatojmë ligjin ngase edhe jemi të obliguar, unë dua ndihmën e juaj në mënyrë që të ju ndihmojmë ne si institucion”tha Begaj.

Kryetari Begaj premtoi që do të ju ndihmoj rreth këtij problemi sa i përket anës ligjore, dhe se do të punon për interesa të përgjithshëm të qytetarëve, dhe që institucioni komunal do të merret me këtë problem dhe të benë angazhime shtesë në këtë drejtim.

Punëtorët e Komunës së Malishevë në ndihmë të 14 vjeçarit Ilir Berisha

Malishevë, 18 nëntor

Ilir Berisha, 14 vjeç nga fshati Gurbardh i Komunës së Malishevës, vuan nga një sëmundje e rëndë e veshkave dhe si pasojë, ai duhet që urgjentisht të bëj transplantim të veshkave. Iliri 14 vjeç, nxënës i klasës së nëntë, aktualisht është në dializë të rëndë dhe po kurohet në një spital jashtë vendit. Për këtë qëllim punëtorët e administratës dhe qeverisë komunale në Komunën e Malishevës, kanë filluar një aksion për ta ndihmuar Ilirin.

Fillimisht, këtë aksion e kanë nisur drejtorët e drejtorive komunale, të përkrahur edhe nga i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, për t'ju bashkuar më pas kësaj iniciative edhe punëtorët e administratës komunale, në mënyrë që sadopak, të riut 14 vjeçar, ti ndihmohet në shërimin e tij, deri në transplantimin e veshkave.

Iniciuesi i këtij aksioni humanitar, Ahmet Morina, tha se punëtorët e administratës dhe drejtorët e drejtorive komunale, e kanë përkrahur aksionin në masë të madhe dhe shuma e grumbulluar është e konsiderueshme, por 14 vjeçarit Ilir Berisha i duhen ende mjete të tjera, ndërsa familja nuk ka mundësi të mbuloj shpenzimet për shërimin e tij, andaj Morina, kërkon mbështetje edhe nga institucionet tjera dhe njerëzit e vullnetit të mirë, që me aq sa kanë mundësi të ndihmojnë në shërimin e Ilir Berishës.

Përndryshe, Iliri, i cili gjendet në regjim të rëndë të terapisë së dializës, pasi veshkat e ka jashtë funksionit përgjithmonë, i duhet të bëjë transplantim të veshkës, nga prindërit e tij, por ky transplantim, është i kushtueshëm dhe plotësisht i papërbalueshëm për familjen e tij, e cila nuk ka asnjë person të punësuar.

Filloi ndërtimi i shkollës në Bubavec

Malishevë, 18 nëntor

Me vënien e gurëthemelit, ka filluar edhe zyrtarisht ndërtimi i objektit të ri të shkollës në



fshatin Bubavec, duke shënuar kështu ndërtimin edhe të një shkolle tjetër në Komunën e Malishevës. Në fillimin e punimeve mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, nënkryetari i komunës z.Rexhep Mazreku, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, drejtori i arsimit z.Blerim Thaçi, stafi i mësimdhënësve të shkollës dhe banorë të shumtë të Bubavecit.

Me këtë rast, kryetari i Komunës së Malishevës, tha “ndihem jashtëzakonisht i kënaqur, që po i vëmë gurëthemelin e shkollës së re dhe po forcojmë dijen e të ardhmes sonë dhe jam i bindur se nga këtu do të dalin kuadro që do ti duhen vendit. Unë po kujtoj “fjalët e qiriut” nga Naim Frashëri dhe po ju bëj me dije se dikush është flijuar për neve, është djegur në zjarrin e luftës, që ne sot të jemi të lirë dhe të ndërtojmë shkolla të reja, në mënyrë që të forcojmë dijen e vendit dhe neve na duhet shumë punë për ta ndërtuar vendin dhe për ta arsyetuar gjakun e derdhur për lirinë e këtij vendi”. Kryetari Begaj, më pas i ka uruar banorët e fshatit Bubavec, për shkollën e re.

Drejtori i shkollës, z.Maliq Kryeziu, duke marrë fjalën, e ka falënderuar Komunën e Malishevës dhe kryetarin Begaj, për këtë investim, në ndërtimin e shkollës.

Ndërtimi i shkollës në Bubavec, është mundësuar nga buxheti i Komunës së Malishevës dhe kap një shumë prej mbi 280 mijë euro.

Asfaltohet edhe një rrugë në Astrazup

Malishevë, 18 nëntor

Në kuadër të investimeve kapitale, me qëllim të përmirësimit të lëvizjes dhe përmirësimit të kushteve më të mira të qytetarëve, sot ka filluar asfaltimi i rrugës “A.Frashëri” në Astrazup, për çka banorët e kësaj rruge, falënderojnë Komunën e Malishevës për këtë investim, me rëndësi për banorët që jetojnë në këtë rrugë.



Zgjerimi, rregullimi dhe asfaltimi i rrugës së gjatë gjashtëqind metra, është bërë në kuadër të investimeve kapitale të Komunës së Malishevës.

Edhe kjo rrugë, sikur edhe shumë të tjera që janë shtruar gjatë këtij viti dhe disa të tjera që planifikohet të punohen deri në përfundim të vitit, janë në kuadër të përmirësimit të kushteve të jetës, në këtë rast, të lëvizjes

më të lehtë të banorëve në fshatrat e Malishevës.

Në këtë investim, nuk ka munguar as gatishmëria e pronarëve të tokave përgjatë rrugës, të cilët nuk kanë penguar zgjerimin e rrugës.

Komuna përmirëson kushtet e punës për zjarrfikësit

Malishevë, 20 nëntor



Në kuadër të përmirësimit të kushteve të punës për shërbimin e zjarrfikësve dhe shpëtimit, Komuna e Malishevës, ka bërë disa investime me rëndësi për këtë shërbim, duke rregulluar hapësirën në oborrin e ndërtesës së këtij shërbimi, pastaj ka rregulluar kulmin dhe do të bëjë edhe rrethojën, duke investuar një shumë prej rreth tridhjetë mijë euro.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Ahmet Morina, “në hapësirat e këtij shërbimi, janë bërë disa investime me rëndësi dhe këto investime janë bërë me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për punë”. Sipas drejtorit Morina, është rregulluar oborri i ndërtesës, ku është shtruar pllaka, përkatësisht asfaltimi i oborrit dhe automjetet e këtij shërbimi, tani lëvizin më lehtë, pastaj është bërë një ndërhyrje në kulmin e objektit dhe tani do të bëhet edhe rrethoja.

“I tërë investimi në këto rregullime, kap një shumë prej rreth tridhjetë mijë eurove dhe tani shërbimi i zjarrfikësve dhe shpëtimit në Malishevë, ka kushte shumë më të mira për zhvillimin e aktiviteteve të tyre”, tha Morina.

Drejtori Morina, po ashtu lavdëroi punën e palodhshme të këtij shërbimi, pasi kanë treguar rezultate të mira në punën e tyre dhe gjithmonë ju kanë dalë në ndihmë qytetarëve, sa herë që është paraqitur nevoja.

Komiteti për arsim mbajti mbledhjen e shtatë të radhës

Malishevë, 20 nëntor



Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, si organ i Kuvendi të Komunës, i kryesuar nga kryesuesi i këtij komiteti, z.Januz Kastrati, ka mbajtur mbledhjen e shtatë të radhës, ku janë trajtuar një varg çështjes, që lidhen me punën, kompetencat dhe qëllimin e këtij komiteti.

Komiteti për arsim, kulturë, rini e sport , sot në mbledhje kanë debatuar rreth përgatitjeve për shënimin e 28 Nëntorit, Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë, në bashkëpunim me

DKA-në dhe DRKS-në, ku më pas për këtë pikë të rendit të ditës raportoi drejtori i DKA-së, z.Blerim Thaqi ku edhe njoftoi për aktivitetet e parapara për shënimin e 28 Nëntorit, festës kombëtare të flamurit.

Ndër të tjera Komiteti për arsim, kulturë, rini e sport pati dy rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale.

Filloi ndërtimi i ujëmbledhësit në Panorç

Malishevë, 21 nëntor



Komuna e Malishevës, ka filluar të realizoj edhe një projekt shumë jetik për qytetarët e saj, e ky projekt është ndërtimi i një dige për të krijuar edhe një ujëmbledhës të kapacitetit të madh, në fshatin Panorç, përmes së cilit synohet krijimi i rezervave të mjaftueshm të ujit, për furnizimin e të gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës, me ujë për pije.

Krijimi i këtij ujëmbledhësi, së bashku me ujëmbledhësin në Senik, rezervat e ujit në Banjë dhe planifikimi për ndërtimin edhe të një ujëmbledhësi në Lladrovç, do të krijonte rezerva të mjaftueshme, që Komuna e Malishevës të siguroj ujë për pije, për të gjitha vendbanimet.

“Jam shumë i kënaqur që kemi arritur deri këtu dhe sot po fillojmë të ndërtojmë digën, për krijimin e këtij ujëmbledhësi, përmes të cilit do të krijojmë rezerva të mëdha të ujit. Përveç kësaj, ky liqen që do të krijohet, do ta shndërroj këtë vend në një zonë mjaft atraktive turistike, pasi afër ka edhe “shpellën e flladit”, sikur ka afër edhe Ujëvarat dhe Kanionin e Mirushës”, ka thënë kryetari Begaj, me rastin e fillimit të punimeve në ndërtimin e digës. “Unë i uroj të gjithë banorët e Panorcit për këtë atraksion dhe këtë mundësi, pasi të parët do të kenë mundësi ta shfrytëzojnë këtë ujë”, tha Begaj, i cili i uroi punë të mbarë edhe kompanisë “Sinani-ing”, e cila do ta ndërtoj digën për këtë ujëmbledhës-liqe.

Ky do të jetë liqeni i dytë artificial, pas atij në Mirushë, ndërsa do të jetë shumë më i madh se i pari dhe pritet të jetë njëri nga vendet më atraktive turistike, për shkak të konfiguracionit të natyrës në atë pjesë, shpellave dhe ujit të ftohtë.

Ndërtim i ujëmbledhësit në Panorc, mundësohet nga Komuna e Malishevës, dhe ndërtimi i digës, kushton rreth 350 mijë euro. Ky liqe, bazuar në studimet dhe projektimin e tij, do të ketë rreth 182 mijë metër kub me ujë, me mundësi të ndërtimit edhe të një liqeni më të vogël shtesë. Lartësia e digës, do të jetë 20 metra, ndërsa ndërtimi i saj, pritet të zgjatë dy vite.

Rregullohen rrugë edhe në Balincë

Malishevë, 21 nëntor



Në kuadër të investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ka filluar asfaltimi i dy rrugëve në Balincë, përkatësisht rruga në lagjen e Kelmendëve dhe një rrugë tjetër që lidhë shkollën e fshatit me rrugën kryesore, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për lëvizjen e qytetarëve, dhe në veçanti të fëmijëve shkollarë.

Fillimin e asfaltimit të këtyre rrugëve e ka përcjellë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili me këtë rast edhe i ka takuar banorët kësaj lagje dhe i ka uruar ata për rregullimin e rrugës së tyre.

Nga ana tjetër, banorët e lagjes së Kelmendëve, e kanë falënderuar Kryetarin dhe Komunën e Malishevës, për këtë investim, pasi banorët kanë pasur shumë vështirësi në lëvizjen e tyre, ndërsa fëmijët gjithmonë është dashur të shkojnë në shkollë, nëpër rrugë me baltë, e tani rregullimi i rrugës, ju ndihmon shumë në lëvizjen e tyre, sidomos gjatë dimrit dhe në kohën e shirave.

Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e nëntë të rregullt

Malishevë, 21 nëntor



Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendit të Komunës në Malishevë, i drejtuar nga kryetari i këtij komiteti, z.Fatmir Ademaj, ka mbajtur sot mbledhjen e nëntë me radhë, ku janë trajtuar një varg çështjesh dhe është njoftuar për aktivitetet e komitetit, që lidhen me gjendjen e komuniteteve . Lidhur me takimin me komunitetin RAE në Kijevë, raportoi drejtuesi i këtij komiteti z.Fatmir Ademaj. “Në takimin që kemi organizuar me komunitetin pakicë

RAE në Kijevë, kemi dëgjuar për shqetësimet dhe hallet e tyre, të cilat janë të përditshme, si e të gjithë qytetarëve tjerë të Malishevës, dhe nuk ka diskriminim në mes komuniteteve” tha z.Ademaj, duke raportuar për atë takim, të ndihmuar nga OSBE.

Këshilli Drejtorëve, bisedoi për përgatitjet për shënimin e 28 Nëntorit

Malishevë, 24 nëntor

Këshilli i Drejtorëve në Komunën e Malishevës, i drejtuar nga kryetari i komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur takimin e së hënës, ku temë kryesore e këtij takimi ishte, përgatitja për shënimin e 28 Nëntorit, si njëra prej datave më të rëndësishme të kombit shqiptar, datë me të cilën lidhen shumë ngjarje.

Për këtë qëllim drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, znj. Blerta Krasniqi, bëri të ditur se “janë planifikuar në varg aktivitetesh, të cilat do të mbahen në kuadër të shënimit të 28 Nëntorit, ndërsa ndër aktivitetet kryesore do të jenë edhe mbajtja e një mbledhje solemne, pastaj homazhe në vendet me rëndësi historike për Malishevën, vizitë në Prekaz dhe një koncert zyrtar”.

Në mbledhjen e sotme, janë trajtuar edhe çështje tjera që lidhen me punët dhe obligimet e përditshme të drejtorive komunale, në raport me realizimin e projekteve, raporteve dhe ofrimi i shërbimeve për qytetarët.

Nga mbledhja e Komitetit për Diasporë

Malishevë, 24 nëntor



Komiteti për diasporë, i drejtuar nga kryetari i saj z.Besnik Hoti, ka mbajtur sot mbledhjen e saj të tretë të rregullt, ku dhe kanë diskutuar për çështje me rëndësi, me të cilat merret ky komitet, si dhe për organizimin e një takimi me bashkatdhetarët tanë, në kohën e pushimeve dimërore.

Thirrja e këtij takimi me bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe punojnë në vende të ndryshme, ishte edhe rekomandim i këtij komiteti për Kuvendin e Komunës së Malishevës, që ta organizoj këtë takim.

Organizimi i këtij takimi, u pa si shumë i nevojshëm nga ana e anëtarëve të këtij komiteti, pasi ka për qëllim “të njoftimit nga afër me mërgimtarët tanë, me nevojat që ata kanë, për problemet me të cilat ballafaqohen gjatë nxjerrjes së dokumentacionit, se sa janë të kënaqur me shërbimet që ju ofrohen, dhe çështje të tjera me rëndësi për ta”.

Kryetari Begaj, inspektoi punimet në dy projekte

Malishevë, 24 nëntor

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot ka parë nga afër realizimin e dy projekteve kapitale, me qëllim të njoftimit direkt me realizimin e këtyre projekteve. Njëra ishte zgjerimi i urës në qytetin e Malishevës dhe tjetra ishte, ndërtimi i rrugëve në Mleqan.



Fillimisht kryetari Begaj, ka vizituar urën në rrugën kryesore në qytetin e Malishevës, ku është bërë zgjerimi i urës, me trotuar, me



qëllim të lëvizjes së lirë të këmbësorëve, projekt i cili është realizuar në kuadër të një bashkëpunimi mes Komunës së Malishevës dhe UNHABITAT-it. Përveç urës, në kuadër të projektit, është rregulluar edhe hapësira përgjatë lumit, me trotuar, muri mbrojtës nga lumi dhe ndriçim.

Më pas, kryetari Begaj, ka vizituar edhe fshatin Mleqan, ku kanë filluar punimet në ndërtimin e disa rrugëve në këtë fshat, e ku punimet po ecin mbarë. Aktualisht, në Mleqan, po bëhet zgjerimi i mjaftueshëm i rrugëve, të cilat do të përgatiten dhe më pas do të asfaltohen.

Kryetari Begaj, është ndarë i kënaqur me ecurinë e punimeve në këto projekte, përderisa ka thënë, se “brenda mundësive buxhetore të komunës, do të vazhdohet me realizimin e projekteve të cilat, lidhen me rritjen e mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Malishevës”.

KK i Malishevës, kundër kalimit nën regjionin e Gjakovës

KK: Të shfrytëzohen të gjitha mundësitë, për kthim me regjionin e Prizrenit

Malishevë, 27 nëntor

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e njëmbëdhjetë të radhës, në mes tjerash ka diskutuar edhe për shqetësimin e qytetarëve të Komunës së Malishevës, pas kalimit të shumicës së institucioneve komunale, në regjionin e Gjakovës, ku anëtarët e KK-së, unanimisht e kanë kundërshtuar këtë, dhe kanë kërkuar fillimin e procedurave për rikthim nën regjionin e Prizrenit, aty ku me mijëra vite, banorët e kësaj rrethina janë të lidhur në çdo formë.

Gjatë diskutimeve të tyre, anëtarët e kuvendit, thanë, se Malisheva, historikisht, tradicionalisht, shpirtërisht, ekonomikisht, pastaj në aspektin e lidhjeve rrugore-komunikacionit dhe për mijëra arsye të tjera, janë të lidhur me Prizrenin, ndërsa me Gjakovën, përveç maltretimt që po u bëhet qytetarëve, nuk na lidh asnjë gjë, madje nuk ka as lidhje të autobusit dhe është shumë më larg Malishevës, se Prizreni.

Duke folur rreth këtij shqetësimi të qytetarëve, kryesuesi i KK të Malishevës, Enver Hoti, mes tjerash tha: “Malisheva ka asetet e saj në Prizren, sepse aty jetojnë një përqindje e madhe e qytetarëve nga Malisheva, dhe jo në Gjakovë. Ke qindra apo me mijëra vite, përveç lidhjeve miqësore e shpirtërore, qytetarët tanë kanë edhe lidhje ekonomike dhe kanë investuar në këtë lidhje, e cila padrejtësisht, tinëzisht dhe për interesa të caktuara, është ndarë dhe ka kaluar në një regjion, ku nuk na lidh asgjë. Nuk kemi asgjë kundër Komunës apo qytetit të Gjakovës, por duam të kthehemi aty ku na takon dhe të mos maltretohen qytetarët tanë”. Kurse disa anëtar të KK të Malishevës, kërkuan, që të pezullohet çdo bashkëpunim me institucionet në regjionin e Gjakovës.



Pas debatit rreth këtij shqetësimi të qytetarëve, u vlerësua se ky kalim i institucioneve, nga regjioni i Prizrenit në atë të Gjakovës, është bërë pa u njoftuar qytetarët, është i dëmshëm për qytetarët e Malishevës dhe ky veprim i institucioneve, është jashtë vullnetit të qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Me këtë rast, unanimisht, anëtarët e KK të Malishevës, nga të gjitha subjektet politike, IQM, PDK, LDK, VV, AAK dhe AKR, kërkuan nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, që të filloj procedurat, për rikthimin e institucioneve me regjionin e Prizrenit. Anëtarët e KK-së, thanë se do të përkrahin çdo formë të veprimit, për kthimin aty ku kemi qen gjithmonë, përfshi edhe referendumin, pasi askush nuk ka të drejt të dal mbi vullnetin e qytetarëve.

Rikthimi nën regjionin e Prizrenit, ka muaj të tërë, që po kërkohet nga ana e qytetarëve të Komunës së Malishevës.

U mbajt mbledhja e njëmbëdhjetë e KK-së

Malishevë, 26 nëntor

Kuvendi i Komunës së Malishevës, dje deri në orët e mbrëmjes ka mbajtur mbledhjen e njëmbëdhjetë të radhës, e cila u drejtua nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, ndërsa në rend dite ishin disa pika me rëndësi për shqyrtim, raporti nëntë mujor financiar, raporti për arsimin, pastaj çështja e kalimit të institucioneve në regjionin e Gjakovës dhe të tjera.

Raportin njëmujor i buxheti të këtij viti, u prezantua nga drejtori i drejtorisë për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, e ku sipas tij, në nëntë mujorin e parë, buxheti komunal është realizuar 77 përqind në të gjitha kategoritë buxhetore, ndërsa t hyrat vetanake të planifikuara janë tejkaluar për tre përqind. Më pas drejtori Krasniqi, ka dhënë edhe sqarimet e detajizuara për mënyrën e shpenzimit të buxhetit, si dhe është përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të KK-së.

Temë tjetër, me rëndësi ishte edhe debati për kalimin e institucioneve nën regjionin e Gjakovës, gjë e cila u kundërshtua ashpër nga KK e Malishevës dhe u kërkua fillimin i procedurave për rikthim me regjionin e Prizrenit.

Po ashtu në këtë mbledhje u debatua edhe për raportin e drejtorisë së arsimit, për mbarimit e vitit të kaluar shkollor dhe fillimin e këtij viti shkollor. Raportin e paraqiti drejtori drejtorisë së arsimit, z.BlerimThaçi, i cili u përgjigj edhe në pyetjet e shumta të anëtarëve të KK-së.

KK i Malishevës, mori vendim për caktimin e një zyrtari, i cili do të merret me diasporën, si dhe mori vendim për caktimin e komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015.

Malisheva një prej vendeve më të qeta në aspektin e sigurisë

Malishevë, 27 nëntor

Komuna e Malishevës, me 46 vendbanimet e saja, vazhdon të mbetet një prej rajoneve më të sigurta dhe më të qeta në vend. Kështu u vlerësua në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), ku u trajtua situa e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës.

Nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Raxhep Mazreku, duke folur për situatën e sigurisë së përgjithshme, tha se “është e qetë, stabile dhe pa indikacione për prishje të kësaj gjendje”, përderisa vlerësoi lartë edhe punën dhe bashkëpunimin e institucioneve përgjegjëse për sigurinë në vend, në raport me institucionin e Komunës.

Nga ana tjetër, komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, bazuar në të dhënat policore, e vlerësoi të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme, dhe gjithashtu vlerësoi lartë bashkëpunimin ndërinstytucional, për krijimin e një ambienti të gjithë qytetarët. Kapiteni Morina, po ashtu njoftoi edhe për ligjëratat e mbajtura me rreth 2300 nxënës të shkollave të mesme, kundër narkotikëve dhe për aksionin e përbashkët me ATK-në, inspektorët komunal dhe policin, për mbylljen e lokaleve të lojërave të fatit, të cilat nuk kanë respektuar distancën e lejuar me ligj, në raport me institucionet publike.

Ahmet Morina, nga drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, njoftoi për një aksion, për largimin e rrezikut në Stapanica (Burim), ku njësia e zjarrfikësve dhe shpëtimit, ka larguar një lis të gjatë mbi 30 metra, e që rrezikonte të rrëzohej mbi një shtëpi banimi, në trotuarin ku ecin nxënësit apo mbi rrjetin e shpërndarjes së rrymës.

U përrua rregullimi i urës kryesore në Malishevë

Malishevë, 27 nëntor



Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e datës më të madhe shqiptare, 28 Nëntorit, sot në qytetin e Malishevës, u bë përrimi i rregullimit dhe zgjerimit të urës në rrugën “Rilindja Kombëtare”. Rregullimi i kësaj, është mundësuar nga buxheti komunal i Malishevës dhe UN HABITAT-it.

“Kjo është punë e mirë dhe jetëgjatë, e cila do të mundësoj kalimin e lirë të këmbësorëve, pa rrezikuar jetën e

tyre, sepse ura sot ka trotuare në të dy anët e saj. Unë e falënderoj edhe UNHABITAT-in, për këtë bashkëfinancim, me shumë rëndësi për qytetin e Malishevës”, tha kryetari i Malishevës Ragip Begaj, me rastin e prerjes së shiritit të urës.

Ndërsa Gwendoline Mennetrier, nga zyra e UNHABITAT-it në Kosovë, e përgëzoi Komunën e Malishevës për realizimin e këtij projekti, si dhe për bashkëpunimin e mirë. Ajo po ashtu uroi edhe qytetarët e Malishevës, për rregullimin e urës.

Rregullimi i urës, është bërë në kuadër të projektit “Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe hapësirave publike në qendër të qytetit”, dhe ka kushtuar 74 mijë e 344 euro, ndërsa është financuar përgjysmë nga ana e Komunës së Malishevës dhe UNHABITAT-it.

Prerjen e shiritit e bënë, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, përfaqësuesja e UNHABITAT-it, znj. Gwendoline Mennetrier dhe një qytetar i rastit.

U zbulua lapidari i dëshmorëve në Gurishtë

Malishevë, 27 nëntor

Sot në fshatin Gurishtë, u bë zbulimi i lapidarit të dëshmorëve të kombit Nuhi e Hidajet Mazreku, dhe pllakës me emrat e të rënëve tjerë nga Gurishta gjatë periudhave të ndryshme të historisë. Në tubimin me rastin e zbulimit të këtij lapidari morën pjesë, Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj, me bashkëpunëtorët, deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Salih Morina, zëvendësministri i MPMS, z.Fatmir Shurdhaj, përfaqësues të institucioneve të ndryshme edukative, politike, shoqërore, familje të dëshmorëve, veteranë të luftës si dhe qytetar të shumtë nga fshati Gurishtë.



“Dëshmorët që kanë rënë në të gjitha periudhat, të gjithë ata njerëz që kanë dhënë jetën për këto troje, kanë dhënë jetë që shqiptarët të jetojnë të lirë të frymojnë e të punojnë lirshëm, dhe të ndërtojnë vendin e vet lirshëm. Mesazh i tyre ishte që të mos i braktisim trojet shqiptare, por duke i falënderuar për sakrificën e tyre, sot të gjitha trojet janë të mbushura me shqiptar”, tha kryetari Begaj, duke marr fjalën në këtë tubim.

“Sot këtë që po e bëjnë ky fshat, më bën të ndihem mirë unë dhe e gjithë Komuna e Malishevës. Me këtë tubim të sotëm këtu, që na bënë të kujtojmë sakrificën e disa brezave, disa gjeneratave që kanë rënë për lirinë e këtij vendi dhe për çlirimin e tokave shqiptare e ka

një domethënie shumë të madhe. Prandaj edhe shfrytëzoj rastin, t'ju uroj për ngritjen e këtij lapidari dhe t'ju uroj festat e 28 Nëntorit, të cilat janë festa të pa harruar për të gjithë ata që kanë gjak shqiptari” tha Begaj në fjalën e tij.

Kurse zv/ministri në MPMS, z.Fatmir Shurdhaj, foli për veprën e dëshmorëve, si dhe vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe vlerat e dëshmorëve të fshatit Gurishtë .

Për biografin e dëshmorëve të fshatit Gurishtë, foli drejtori i shkollës z.Xhevdet Mazreku, për përpjekjet e tyre për pavarësi dhe lirinë e vendit dhe kontributin e tyre që dhanë pa pushuar asnjëherë, për krenarinë, flijimin dhe veprat e dëshmorëve.

Në ndërtimin e lapidarit, ka kontribuar edhe Komuna e Malishevës.

28 Nëntori fat i mbarë i kombit shqiptar

Malishevë, 28 nëntor



Nën perkujdesjen e kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me aktivitet të shumta, u shënuar sot 28 Nëntori, Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Ditëlindja e Komandantit Legjendar Adem Jasharit dhe daljes së parë publike të UÇK-së .

Fillimisht, Kuvendi i Komunës së Malishevës, mbajti një mbledhje solemne, e ku folën i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili foli për këtë datë, siç e quajti “më të rëndësishmen, tek shqiptarët, pasi me këtë datë lidhen ngjarje të shumta, që lanë gjurmë në historinë e popullit shqiptar”.

Për këtë datë të rëndësishme, foli edhe kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, i cili 28 nëntorin e quajti “ditë e bekuar nga zoti”, pasi lidhen ngjarjet më të rëndësishme në përpjekjet e kombit shqiptar.

Më pas, u bënë nderime tek lapidari i Komandantit Legjendar Adem Jashari, në qendër të Malishevës, për të vazhduar me homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë, e për të përfunduar homazhet në Prekazin legjendar, aty prehet trupi i komandantit Adem Jashari dhe familjes së tij, të cilët u sakrifkuan për lirinë e popullit shqiptar në Kosovë.



Në Prekaz, një delegacion nga Malisheva, vizitoi edhe odën e Jasharjve, ku u pritën nga Lulzim Jashari dhe u shkëmbyen urimet e dy anshme me rastin e 28 Nëntorit. “Këto festa po na bashkojnë edhe më shumë, të gjithë neve si komb shqiptar dhe unë i falënderoj të gjithë”, tha Lulzim Jashari.

Pas këtyre aktiviteteve, në shtëpinë e kulturës në Malishevë, u mbajt edhe koncerti kryesor, ku morën pjesë

këngëtar të njohur, grupe e ansamble nga treva jonë.

Në vazhdim fjalimi i plotë i kryetarit Begaj, mbajtur në mbledhjen solemne dhe para qytetarëve të Malishevës:

Të nderuara Familje të Dëshmorëve, shoqata të dala nga Lufta e UÇK-së, I nderuar Kryesues i Kuvendit, Këshilltar, ish Kryetar të Komunës sonë, përfaqësues të institucioneve vendore, veteran të luftës dhe Ju të pranishëm, më lejoni që të ju uroj festën më të madhe të shqiptarëve, Festën e Flamurit dhe datën në të cilën lidhen ngjarje me shumë rëndësi në historinë e popullit shqiptar.

Me 28 Nëntor të vitit 1443, Gjergj Kastrioti Skënderbeu mori kalanë e Krujës, e cila ishte kryeqytet i Principatës së Kastriotëve dhe ngriti flamurin, duke e shpallur pavarësinë nga pushtimi otoman.

Me 28 Nëntor të vitit 1912, Ismail Qemajli, apo siç njihej në atë kohë si Ismail Bej Vlora, në çastet e fundit para se të ndaheshin trojet shqiptare nga pushtuesit sllav, ngriti flamurin në Vlorë dhe shpëtoi një pjesë të trungut shqiptar, me qëllim, që më pas të bëhej bashkimi i trojeve shqiptare.

Me 28 Nëntor të vitit 1955 në Prekazin legjendar, në familjen Jashari, lindi një njeri, i cili u pagëzua me emrin Adem, e ky njeri më vonë, do ta ndryshonte historinë, jo vetëm të shqiptarëve, duke u shndërruar në Komandant Legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Po me 28 Nëntor 1997, në Llaushë të Skënderajt, për herë të parë, doli publikisht dhe hoqi jo maskat, por hoqi përfundimisht të gjitha dilemat rreth ekzistimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ushtria e cila, luftoi deri në çlirimin e trojeve shqiptare në Kosovë, e si rezultat i saj, sot Kosova është shtet i pavarur dhe sovran, e i njohur ndërkombëtarisht nga më shumë se 100 shtete demokratike.

Të dashur pjesëmarrës, kjo datë historike, ishte fati i mbarë për kombin tonë. Në këtë datë, më 28 NËNTOR, lidhen shumica e ngjarjeve me rëndësi historike për popullin shqiptar. Në këtë datë u sendërtuan kërkesat, përpjekjet, sakrificat dhe lufta jonë për liri. Ata që e bënë, që këto data të shënohen, përjetësuan veten e tyre dhe kombin tonë. Historianët shkruan mijëra libra histori e ngjarje, shkruan romane e thurën këngë lavdie e heroizmi. Ne të gjallët u



frymëzuam nga këto vepra. Lufta është krenaria e një kombi, e Krenaria është pjesë e kulturës sonë. Gjatë viteve që do të vijjnë, do të përcjellim të gjallët që mbetën pas luftës. Për ta historia do të shkruhet – kontributi do të çmohet. Gjeneratat që do të vijjnë, do të kenë me çfarë të krenohen. Ne kemi një histori të çmuar, të pasur dhe të lavdishme.

Këtë fjalim, po e mbylli me fjalët e të madhit Gjergj Kastrioti Skënderbue, që tha në Krujë, me rastin e ngritjes së flamurit dhe marrjes së kalasë së Krujës: ***S'është as e re, as e papritun pamja që kam sot përpara syve. Ashtu si ju kujtonja, ashtu ju gjeta, stërnipër të thjeshtë të një race të vjetër dhe bujare, trima dhe besnikë të patronditur të vendit tuaj***".

Lavdi të gjithë Dëshmorëve të Kombit. Rroftë Populli Shqiptarë.



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 133- Dhjetor 2014 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Oborri i tregut në Malishevë



Panairi i veshjeve dhe ushqimeve tradicionale



Asfaltimi i rrugës në Vërmicë



Shkolla në Gollubovc



KPF me disa rekomandime për KK

Malishevë, 1 dhjetor

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), drejtuar nga kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, mbajti mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt. Në këtë mbledhje, janë trajtuar një varg çështjesh dhe u dhanë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale KPF, rekomandoi shqyrtimin dhe miratimin e Udhëzimit Administrativ (MAPL), për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme në Komunë, pastaj Formimi i panelit përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ sipas Udhëzimit Administrativ, për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna, dhe sipas vendimit të Kuvendit për themelimin e Komitetit Konsultativ në Komunën e Malishevës.

Komiteti për Politik dhe Financa (KPF), për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal dha edhe këto rekomandime: Ridizajnimi i sallës së Kuvendit Komunal, rekomandim tjetër ishte edhe miratimi i rekomandimeve të Komitetit për Arsim : a) mbledhjet e trupave të kuvendit të mbahen prej orës 14:00, b) të funksionalizohet puna e komisionit të Komitetit për Arsim.

Administrata komunale, e përgatitur për ofrimin e shërbimeve për mërgimtarët

Malishevë, 1 dhjetor

Komuna e Malishevës, ka marrë të gjitha masat dhe ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura, për pjesën e dytë të dhjetorit, kur pritet të ketë fluks të qytetarëve që kanë nevojë për nxjerrjen dhe rregullimin e dokumenteve, e ky fluks pritet të jetë nga mesi i dhjetorit, kur edhe vijnë mërgimtarët për festat e fundvitit.

Kështu tha drejtori i administratës z.Ekrem Kastrati, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, mbledhje të cilën e udhëhoqi i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj. Sipas drejtorit Kastrati, janë të furnizuar mirë për formular dhe material tjetër përcjellës, në mënyrë që shërbimet ndaj qytetarëve, edhe kur ka fluks të tyre, të jenë të shpejta dhe efikase.

“Ndryshimet klimatike, kanë rritur numrin e pacientëve edhe në qendrat mjekësore të Malishevës, ndërsa numri pritet të rritet edhe më shumë gjatë këtij muaji, që është normale në këtë periudhë të vitit”, tha drejtori i shëndetësisë, z.Hajdin Berisha.

Edhe drejtorët tjerë raportuan për punën e tyre, dhe përfundimin e projekteve, pasi jemi në prag të përfundimit të vitit kalendarik, si dhe raportuan për përgatitjet që janë duke i bërë për vitin e ardhshëm.

Në fillim të mbledhjes së sotme, kryetari Begaj, ka kërkuar nga drejtorët të bëjnë përmbledhjen e punëve gjatë këtij viti, përderisa tha se “Jemi munduar ti rrumbullakojmë të gjitha projektet, e të cilat nuk janë pak, por kjo nuk do të thotë që ne të jemi të kënaqur me punën e bërë, por duhet edhe me shumë të angazhohemi”.

Handikos falënderon kryetarin Begaj për përkrahje

Malishevë, 3 dhjetor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot një delegacion nga Qendra e Rehabilitimit “Handikos” në Malishevë. Kjo vizitë e Handikos, është bërë në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe me këtë rast, ky delegacion i Handikos-it, e ka falënderuar kryetarin Begaj për mbështetje.

“Ne si komunë, jemi përpjekur gjithmonë që brenda mundësive buxhetore, t’ju ofrojmë mbështetje dhe të krijojmë kushte më të mira për qendrën e rehabilitimit, por kufizimet buxhetore, po na kufizojnë edhe neve si komunë, që ndoshta edhe të mos ju përkrahim sa duhet”, tha Begaj.

Ndërsa menaxherja e Qendrës së Rehabilitimit “Handikos” në Malishevë, znj.Feride Hoxha, e falënderoi kryetarin Begaj, për mbështetjen e vazhdueshme. “Ne ju falënderojmë për përkrahjen që na jepni dhe falë kësaj ne po përpiqemi t’ju ofrojmë shërbimet e nevojshme personave me aftësi të kufizuara”, tha znj.Hoxha.

Në këtë datë, menaxherja e Handikos-it në Malishevë, shfrytëzoi rastin të shpreh pakënaqësinë e saj, për moskrijimin e kushteve në disa institucione, për qasje në objekte, për rreth 70 persona nga Malisheva, të cilët lëvizin me karrocë.

Si pasojë e eksplozimit të gazit, humbi jetën punëtori i shkollës

Malishevë, 5 dhjetor



Sot në orët e para të mëngjesit, në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, ka ndodhur një rast i rëndë, ku ka humbur jetën një punëtor teknik, si pasojë e eksplozimit të nxemjes me gaz në këtë shkollë.

Zymer B. Hoti (1971) nga Malisheva, punëtor teknik në këtë shkollë, ka humbur jetën, përderisa kishte hyrë në objektin ku gjendet

ngrohja e shkollës, e cila në atë moment kishte eksploduar.

Menjëherë në vendngjarje kanë dalë Policia e Kosovës dhe ekipet e shpëtimit, si dhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, nënkryetari Rexhep Mazreku, drejtori i arsimit Blerim Thaçi, drejtori për mbrojtje dhe shpëtim Ahmet Morina, dhe drejtor e zyrtar tjerë komunal.

Me këtë rast, Kryetari i Komunës së Malishevës, “i shpreh ngushëllimet më të thella familjes Hoti dhe farefisit të gjerë nga Malisheva” dhe këtë rast e quajti “një ngjarje e rëndë dhe tronditëse për të gjithë Malishevën”.

Organet e rendit, janë duke u marrë me rastin, ndërsa mësimi është ndërprerë përkohësisht në këtë shkollë.

KK i Malishevës mbajti mbledhjen e dymbëdhjetë

Malishevë, 5 dhjetor

Kuvendi i Komunës së Malishevës, kryesuar nga kryesuesi z.Enver Hoti, mbajti mbledhjen e dymbëdhjetë të radhës, mbledhja e cila filloi me një minutë heshtje, për rastin e humbjes së jetës së një punëtori në vendin e punës, në shkollën fillore në Malishevë, ndërsa ngushëllime familjes Hoti, i dërguan të gjitha grupet politike, anëtare të KK të Malishevës.


Përndryshe, KK i Malishevës, në mbledhjen e sotme, mori disa vendime, e të cilat lidhen kryesisht me punën e komiteteve dhe trupave të kuvendit. Fillimisht KK i Malishevës, formoi komisionin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për punën e kuvendit.

Më pas, KK i Malishevës, debatoi rreth punës së komiteteve dhe trupave tjerë të kuvendit, për numrin e mbledhjeve, si dhe pagesat që mund ti kenë këto trupa, ndërsa bazuar në udhëzimin administrativ të MAPL-së, për përbërjen e komiteteve, KK, mori vendim për zbritjen e numrit të anëtarëve të KPF-së, si dhe për ndryshimin e përbërjes së komitetit për komunitete.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, KK, mori vendim për formimin e panelit zgjedhor për zgjedhjen e anëtarëve të Komiteti Konsultativ.

U mbajt mbledhje komemorativë për Zymer Hotin

Malishevë, 5 dhjetor



Organizuar nga kolektivi dhe drejtorja e SHMU ‘Ibrahim Mazreku’, sot u mbajt një mbledhje komemorativë, për punëtorin e kësaj shkolle, Zymer Hoti, i cili sot tragjikisht humbi jetën, pas aksidentit në kaldanë e ngrohjes së shkollës. Në këtë mbledhje, përveç kolektivit të shkollës, mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me bashkëpunëtorë, kryesuesi i KK të Malishevës, Enver Hoti, me anëtarët e KK të Malishevës dhe qytetar të shumtë të Malishevës.

Me këtë rast, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, tha se kjo është humbje e madhe, pasi Zymeri, ka humbur jetën në vendin e punës dhe në shërbim të shkollës. “E nderuara familje Hoti, të



nderuar punëtor të kësaj shkolle, sot në mëngjes mora lajmin për rastin e humbjes së jetës, së një punëtori të vyeshëm, i cili humbi jetën aksidentalisht në vendin e tij të punës, e humbja e jetës në vend të punës, është e barabartë me një heroizëm. Të gjithë ndiejmë dhimbje, së bashku me ju. Në emër të Komunës së Malishevës, ju shprehi ngushëllimet më të singerta familjes dhe kolektivit të shkollës”, tha kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, në fjalën e rastit.

Për jetën dhe angazhimin e Zymerit, në këtë shkollë, nga viti 2003, foli mësuesi Hamdi Mazreku, sipas të cilit, “Zymeri ka qenë shembulli më i mirë i një punëtori në shkollë. I afërt, i dashur, bashkëpunues dhe i hareshëm me nxënës”.

Në emër të familjes, i vëllai, Vesel Hoti, i falënderoi të gjithë për pjesëmarrje dhe për ngushëllimet, ndërsa i ngushëlloi kolektivin e shkollës për humbjen e punëtorit të tyre.

Zymer Hoti, sot aksidentalisht ka humbur jetën, pas një shpërthimi në kaldanë e ngrohjes së shkollës. Zymeri ka lënë pas vetes gruan dhe dy vajza.

Këshilli i Drejtorëve mbajti mbledhjen e radhës

Malishevë, 8 dhjetor

Këshilli i Drejtorëve, drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e radhës, ku janë trajtuar disa çështje, që lidhen me punët e drejtorive komunale, në përfundim të vitit, ku kryesisht është diskutuar për përfundimin e projekteve, nëse premtojnë kushtet atmosferike, si dhe për çështje tjera me rëndësi.

Në këtë mbledhje, temë kryesore e diskutimit, ishte ndërhyrja emergjente që duhet të bëhet në ngrohjen e shkollës fillore në Malishevë, aty ku javën e kaluar, kishte në aksident me sistemin e ngrohjes, e ku kishte humbur jetën një person, ndërsa është ndërprerë edhe mësimi, pasi tashmë, ajo shkollë nuk ka ngrohje. Në këtë mbledhje, u tha se duhet aktivizim i shpejtë i ngrohjes, në mënyrë që të mund të rifilloj mësimi në këtë shkollë.

Po ashtu në mbledhjen e sotme, drejtori për shëndetësi, z.Hajdin Berisha, falënderoi Këshillin e Drejtorëve për iniciativën, dhe të gjithë punëtorët e administratës komunale dhe të institucioneve tjera në Malishevë, për solidaritetin e treguar, me rastin e grumbullimit të mjeteve për ta ndihmuar 14 vjeçarin Ilir Berisha, i cili falë edhe ndihmës nga ministria e shëndetësisë, ka arritur të siguroj mjetet e nevojshme për ndërhyrjen kirurgjike, për transplantimin e veshkave dhe shpresohet në shpëtimin e jetës së këtij të riu.

Përveç diskutimit për çështje që lidhen me përfundimin e projekteve për këtë vit, i diskutua edhe për përgatitjet për vitin e ardhshëm, sidomos për projekte me rëndësi, të cilat duhet të fillohen nga tani të përgatiten, siç është fushata e masave parandaluese kundër etheve hemorragjike dhe të tjera.

Shtrohen rrugët në Vërmicë dhe Mleqan

Malishevë, 8 dhjetor



Në kuadër të ndërtimit të infrastrukturës rrugore nëpër vendbanimet e Komunës së Malishevës, sot ka filluar asfaltimi i një rruge në fshatin Vërmicë, ndërsa dje janë shtruar dy rrugë në Mleqan dhe një tjetër është duke u përgatitur për asfaltim dhe me këto rregullime, disa nga projektet kapitale, po shkojnë drejt përfundimit për këtë vit.

Asfaltimin e këtyre rrugëve, e ka parë nga afër sot, edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili i ka uruar banorët e këtyre dy fshatrave, për rregullimin e rrugëve.

Nga ana tjetër, banorët e Vërmicës dhe Mleqanit, e kanë falënderuar kryetarin Begaj, për rregullimin e rrugëve dhe asfaltimin e tyre, pasi përveç lëvizjes më të lehtë, edhe nxënësit, fëmijët, tani e kanë më të lehtë ecjen nga shtëpitë deri në shkollat e tyre përkatëse.

Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e dhjetë të radhës

Malishevë, 8 dhjetor

Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendit të Komunës në Malishevë, i drejtuar nga kryetari i këtij komiteti, z.Fatmir Ademaj, ka mbajtur sot mbledhjen e dhjetë të rregullt, ku janë trajtuar një varg çështjesh të punës së këtij komitetit dhe për aktivitetet në vazhdim.

Kryesuesi i këtij komiteti z.Fatmir Ademi, para anëtarëve të komiteti, prezantoi planin e punës së këtij komitetit për vitin 2015, plan i cili i miratua nga ana e anëtarëve të këtij komiteti dhe u rekomandua për miratim në Asamblenë Komunale.

Ndër të tjera, u bë e ditur, se në kuadër të vizitave të grupeve të ndryshme të interesit, anëtarët e Komitetit për Komunitete e kanë vizituar edhe Qendrën për Rehabilitim Handikos, ku janë takuar me menaxheren e kësaj qendre znj.Feride Hoxha, e cila i ka njoftuar për punën e saj me personat me nevoja të veçanta, si dhe e ka falënderuar Komunën për përkrahjen e vazhdueshme të kësaj qendre rehabilituese.

Komuna ndihmon fermerët

Malishevë, 11 dhjetor



Drejtorja për Bujqësi e Pylltari dhe Zhvillim Rural (BPZHR) në Komunën e Malishevës, në mesin shumë investimeve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, sot ka realizuar edhe një projekt të këtij sektori, duke ndarë makina mjelëse për 9 fermer. Shuma e ndarë e mjeteve për këtë donacion nga komuna ishte 2700 euro.

Sipas drejtorit të BRZHR-së z. Hajrullah Mazreku, ky është vetëm fillimi i përkrahjes së punëve të fermerëve për të lehtësuar dhe stimuluar, në aktivitetet të cilat i bëjnë çdo ditë nëpër stallat e tyre. “ Ne nuk do të kursejmë asgjë si institucion që të ju dalim në ndihmë të gjithë fermerëve të komunës sonë, në përpjekje për kushte më të mira dhe rritje të zhvillimit të bujqësisë në përgjithësi” tha drejtori Mazreku.

Ligji për skemën sociale rrezikon të lë jashtë listës shumë familje

Malishevë, 15 dhjetor

Ndryshimet që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka bërë në ligjin e përfituesve të skemës sociale, rrezikon që shumë familje të mbesin pa këtë mbështetje të cilën deri më tani e kanë pasur një pjesë e familjeve, edhe nga Komuna e Malishevës, dhe largimet nga kjo skemë do ta rëndojnë edhe më shumë situatën sociale.

Kështu u bë e ditur sot në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, ku drejtori për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, z.Hajdin Berisha, ka paralajmëruar, se “ndryshimet që ministria ka bërë në këtë ligj, ku janë ashpërsuar kriteret për të qenë përfitues i skemës sociale, do të sjellë telashe



edhe për komunën, pasi shumë familje, mund të mos jenë më përfitues të saj dhe gjendja sociale e tyre, do të vështirësohet edhe më shumë”.

Përndryshe në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, drejtorët komunal raportuan për aktivitetet e drejtorive të tyre, në këtë përfundim të vitit dhe përmbylljes së projekteve, e të cilat janë jo pak të realizuara gjatë këtij viti, që do të prezantohen këtë të mërkurë në debatin me qytetar, që do të mbaj Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Kërkohet përkujdesje e zonave të mbrojtura

Malishevë, 16 dhjetor

Komiteti për planifikim urban, kadastër, mbrojtje të mjedisit, turizëm dhe monitorim të projekteve publike, i cili kryesohet nga anëtari i KK-së, z.Muhamet Bytyçi, në mbledhjen e sotme, ka diskutuar për disa çështje, ndërsa ka dhënë disa rekomandime, kryesisht për përkujdesje të zonave të mbrojtura, si dhe ka diskutuar edhe për kadastrën dhe punën e kësaj drejtorie.

Ky komitet, në rend dite, kishte edhe zonat e mbrojtura në territorin e Komunës së Malishevës, ku dha disa rekomandime, për krijimin e një harte për zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulture dhe trashëgimisë natyrore, shenjzimin dhe rrethimin e këtyre zonave dhe për mbledhjen e të dhënave të plota për këto zona, për dokumentimin e tyre, përfshi edhe fotografi, dhe ruajtjen e vazhdueshme të tyre.

Ndërsa në pikën për kadastër, drejtori i drejtorisë për gjeodezi dhe kadastër, z.Fadil Shala, i ka informuar anëtarët e komitetit, për procesin e rindërtimit të kadastrit në disa zona të Malishevës, pastaj i ka informuar edhe për aktivitetet në përgjithësi të drejtorisë, për të hyrat nga kjo drejtori, si dhe për çështje tjera me interes për komitetin, përderisa për të gjitha informacionet e kërkuara i ka pajisur me dokumentacion të plotë.

Anëtarët e komitetit, kanë kërkuar nga drejtorja, harmonizimin e dokumentacionit, me organet qendrore, përkatësisht me drejtorinë e rrugëve, pasi shpeshherë në këtë fushë janë shfaqur probleme të ndryshme.

Në dy pika tjera, që kishin të bëjnë me dy kontrata të punimeve, janë shtyrë, pasi sipas kryesuesit të komitetit, ende nuk i kanë marrë materialet e nevojshme, për trajtimin këtyre pikave.

Pas një sëmundje të rëndë vdes mësuesi Daut Bytyçi

Malishevë, 16 dhjetor



Me një mbledhje komemorative, të mbajtur sot në ambientet e shkollës në Kërvasari të Malishevës, sot është nderuar puna e mësuesit Daut Bytyçi nga ky fshat, i cili vdiq nga një sëmundje e rëndë. Kolektiviteti të shkollës, nxënësve dhe familjes, i shprehi ngushëllime edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtorja e arsimit në Malishevë.

“E bashkëndiej dhimbjen me ju mësues e nxënës të shkollës, pasi sot është ndarë nga ne një nga mësuesit më të mirë, por ju vazhdoni rrugën e tij. Mësuesi Daut, ka qenë një intelektual i kompletuar dhe vdekja e tij është një humbje e madhe, pasi kemi pasur ende nevojë për të”, tha kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në fjalën e rastit. Fjalën e tij, kryetari Begaj, e përmbylli me thënien “Mësuesi Daut, vdiq siç vdesin njerëzit e mëdhenj”, pasi ka lënë pas vetes një kontribut të madh në arsim.

Ndërsa mësuesit e kësaj shkolle, duke folur për mësuesin Daut Bytyçi, i cili vdiq, pas një sëmundje të rëndë, e vlerësuan lartë punën e tij 40 vjeçare në arsim dhe thanë se ka qenë “një mësues i dalluar në punë, mësues me shumë mirënjohje për punën e tij. Madje kontributin e tij në arsim nuk e ndali as në kohën sa ka qenë i sëmurë”. Sipas tyre, Daut Bytyçi, ka qenë mësues i urtë dhe i dalluar, ndërsa shkolla dhe fshati krenohen, pasi kanë pasur një mësues si Dautin.

Kryetari Begaj, mbajti takimin e dytë publik me qytetarë

Begaj: Mbi 31 kilometra rrugë të ndërtuara gjatë këtij viti

Malishevë, 18 dhjetor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, në kuadër të përmbushjes së obligimeve ligjore, që kanë të bëjnë me organizimin e takimeve publike me qytetarë, sot ka mbajtur takimin e dytë publik, ku ka prezantuar punën e qeverisë komunale, për vitin 2014, si dhe ka dëgjuar nga qytetarët edhe hallet, problemet dhe nevojat që qytetarët kanë, e të cilat lidhen me punën e kryetarit dhe qeverisë komunale.

Në fjalën e tij, të mbajtur para qytetarëve prezent, kryetari Begaj, vitin 2014, e vlerësoi si një vit të suksesshëm, pasi janë realizuar qindra projekte të ndryshme, të cilat ndikojnë edhe në mirëqenien e qytetarëve të Komunës së Malishevës. “Vetëm në infrastrukturë rrugore, kemi investuar në mbi 31 kilometra rrugë, pastaj afro 37 kilometra kanalizime në fshatra, në ujësjellës, në bujqësi, në shëndetësi dhe të tjera”, tha kryetari Begaj. “Nëse pyetëm, se a është e mjaftueshme, unë them se nuk është e mjaftueshme puna që kemi bërë, nëse pyetëm, se a kemi pasur mundësi, mund të them se nuk kemi pasur më shumë mundësi, pasi kaq kemi buxhet dhe jemi të kufizuar, por angazhimi im personal dhe i tërë qeverisë komunale, ka qenë maksimal”, tha kryetari, duke prezantuar projektet e realizuara.

Sipas kryetarit Begaj, buxheti i planifikuar për investime kapitale, ka qenë 4 166 755 euro, ndërsa investimet, përfshi edhe donacionet, kanë qenë 4.4 milion ose rreth 300 mijë euro më shumë se planifikimi, ndërsa këtu, nuk janë të paraqitura projektet dyvjeçare, të cilat do të duhej të përfundojnë në vitin e ardhshëm.

Pas prezantimit, kryetari Begaj, është përgjigjur në të gjitha pyetjet e parashtruara nga ana e qytetarëve prezent në këtë debat, si dhe i ka evidentuar të gjitha sugjerimet, vërejtjet apo kërkesat e qytetarëve drejtuar kryetarit dhe komunës, e që lidhen me përditshmërinë tonë.

Në fund të këtij takimi, edhe kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, paraqiti para të pranishmëve, punën e Asamblesë Komunale, dhe i njoftoi ata edhe adresimin e çështjeve të qytetarëve në raport me institucionet tjera, siç është çështje e kalimit në regjionin e Gjakovës dhe kundërshtimin e fuqishëm nga ana e Asamblesë, pastaj mos regjistrimin e studentëve malishevas në menzë dhe në konvikte të UP-së dhe për çështje tjera me rëndësi.

U hap panairi i veshjeve dhe ushqimeve tradicionale

Malishevë, 18 dhjetor



Organizuar nga shoqata “Fatjona”, sot në qendër të Malishevës, është hapur panairi i ushqimeve dhe punimeve të dorës, tradicionale, ndërsa në këtë panair po marrin pjesë shoqata apo individ nga të gjitha trevat kosovare, ku po prezantojnë veshjet dhe ushqimet tradicionale të vendit tonë.

Në hapjen e panairit mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës,

z.Ragip Begaj me bashkëpunëtor, i cili i uroi të gjithë pjesëmarrësit në këtë panair dhe ju dëshiroj suksese në punën e tyre. “Unë ju përgëzoj edhe për punën e juaj, që ju e ruani dhe e vazhdoni traditën tonë, si në veshjet, ashtu edhe në gatimet, që nënat tona na gatuanin neve”, tha kryetari Begaj, në fjalën e tij me këtë rast.

Panairi i veshjeve tradicional dhe ushqimeve tradicionale, do të qëndroj i hapur dy ditë në Malishevë, ndërsa shoqatën “Fatjona”, si organizatore e ka mbështetur Komuna e Malishevës, për mbajtjen e këtij panairi, i cili mbahet për herë të dytë brenda vitit në Malishevë.

Kopja e altarit që i kushtohet hyjneshës “Nemezë” kthehet në Malishevë

Malishevë, 18 dhjetor



Instituti Arkeologjik i Kosovës (IAK), sot ka kthyer në muzeun e Malishevës, artefaktin e Altarit të kultit, i cili ishte marrë nga IAK, për studime të mëtutjeshme, ndërsa ishte premtuar bërja e kopje të ngjashme për ekspozim në muzeun e Malishevës. Artefakti ishte gjetur në fshatin Banjë të Malishevës dhe është njëra nga gjetjet më të rralla të antikitetit dhe njëra nga dëshmitë më të rëndësishme, që tregon për qytetërimin e hershëm në këtë zonë.

Artefaktin, sot në muzeun e qytetit në Malishevë e kanë sjellë, drejtori i IAK-së z.Enver Rexha dhe hulumtuesi i IAK-së, z.Haxhi Mehmetaj, ndërsa pranimin e kopjes e kanë bërë kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtoresha për kulturë znj.Blerta Krasniqi.

Artefakti është i punuar në formë identike, me mermer cilësor të bardhë, i njëjtë me artefaktin e gjetur në Banjë.

Altari i kultit, i cili kushtohet hyjneshës Nemezë (latinisht: Nemesis), i takon vitit 250 të erës sonë dhe në të janë të skalitur tetë rreshta me shkronja latine, ku shihet edhe emri i hyjneshës Nemezë, ndërsa deshifrimi i plotë, do të silllet më vonë.

Begaj: 2014-ta vit i suksesshëm

Malishevë, 22 dhjetor

Qeveria komunale e Malishevës, e drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur takimin e rregullt të së hënës, ku kryetari Begaj, e ka vlerësuar si vit të suksesshëm 2014-të, por ka kërkuar që në vitin 2015, të eliminohen të gjitha mangësitë eventuale që kanë mundur të evidentohen gjatë këtij viti.



“Është mirë që të bëhet analizë në secilën drejtori, për punën gjatë këtij viti dhe të bëhen parashikimet për vitin e ardhshëm. Duhet të evidentohen të gjitha ngeçjet eventuale që kanë mundur të jenë shfaqur gjatë punës suaj, gjë që është normale, dhe të përmirësohen të gjitha këto ngeçje, në mënyrë që të mos shfaqen gjatë viti të ardhshëm”, tha kryetari Begaj, para drejtorëve të drejtorive komunale.

“E di që ndoshta shpesh herë kam qenë kritik në punën tuaj, por këtë e kam bërë me qëllim, që të dalim sa më të suksesshëm në punën tonë të përbashkët dhe besoj ja kemi arritur, që të përmbysim një vit shumë të suksesshëm, por viti i ardhshëm duhet të jetë edhe më i suksesshëm”, tha kryetari Begaj, duke kërkuar edhe më shumë angazhim në vitin 2015.

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, drejtorët e drejtorive, kanë raportuar për punët gjatë javës që lamë pas dhe për përgatitjet për javën tjetër, si dhe për përfundimin e raporteve për këtë vit.

Përndryshe, në këtë mbledhje, u bë e ditur, se buxheti komunal është shpenzuar mbi 98 për qind, ndërsa projektet e ndërtimit kanë përfunduar për këtë vit, e tani jemi në fazën e pranimeve teknike të projekteve.

Po ashtu, u bë e ditur, se ka filluar të rritet numri i qytetarëve që kërkojnë rregullimin e dokumenteve personale, kjo për shkak të ardhjes së mërgimtarëve në fundvit, por shërbimet komunale, me sukses janë duke i kryer shërbimet dhe nuk ka vonesa në këtë drejtim.

Edhe sipas inspektorëve nga ministria, në Komunën e Malishevës, nuk ka gabime gjatë kryerjes së këtyre shërbimeve nga gjendja civile, si dhe nuk ka as ankesa dhe as vërejtje për kryerjen e shërbimeve.

KKSB mbajti mbledhjen e fundit për vitin 2014

Malishevë, 23 dhjetor



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i drejtuar nga i pari i komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e gjashtë të radhës dhe të fundit për vitin 2014, ndërsa në këtë mbledhje edhe njëherë u vlerësua se Komuna e Malishevës, vazhdon të mbetet si komuna më e sigurt, në aspektin e sigurisë së përgjithshme dhe pa tendenca të prishjes së këtij imazhi të mirë për Malishevën.

“Malisheva vazhdon të mbaj primatin e komunës më të sigurt në vend, pavarësisht rasteve të izoluara që mund të ndodhin dhe këtë vlerësim për Malishevën e japin të gjitha raportet nga organet e rendit dhe të sigurisë në vend”, tha në fillim të këtij takimi, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

“Gjatë këtij muaji, edhe pse ka ndodhur një aksident me ngrohjen në një shkollë, ku humbi jetën një person, megjithatë situata e sigurisë mbetet e mirë, stabile dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situatë”, tha kryetari Begaj.

Edhe komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, bazuar në të dhënat policore vlerësoi situatën e qetë dhe stabile, ku sipas tij, numri i krimeve në raport me muajin paraprak ka rënie të dukshme, ndërsa bashkëpunimi me qytetar, sipas kapitenit Morina, është shumë i mirë.

Drejtori i drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, z.Ahmet Morina, i falënderoi të gjitha organet e sigurisë dhe të rendit, për bashkëpunimin e mirë me drejtorinë që udhëheq dhe uroi që ky bashkëpunim të vazhdoj edhe në vitet e ardhshme.

Përndryshe, edhe në këtë mbledhje, u fol edhe për shqetësimin e qytetarëve, për rrezikun nga qentë endacak.



KK i Malishevës mbajti mbledhjen e fundit për këtë vit

Malishevë, 29 dhjetor

Kuvendi Komunal i Malishevës, i kryesuar nga kryesuesi z.Enver Hoti, ka mbajtur sot mbledhjen e fundit për vitin 2014, ku janë trajtuar disa çështje, siç ishte miratimi i listës për kryetarët e fshatrave, ridizajnimi i sallës së kuvendit dhe disa çështje nga komiteti i arsimit.

Fillimisht, nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, paraqiti para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, një fjalim përmbyllës, lidhur me punën e ekzekutivit, të arriturat dhe sfidat gjatë vitit 2014, vit i cili, sipas nënkryetarit Mazreku, ka qenë një vit i suksesshëm, ku janë realizuar shumë projekte me rëndësi, investime nga të cilat, kanë përfituar secili fshat, së paku një projekt.

Më pas, komisioni për organizimin dhe monitorimin e zgjedhjeve në fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës, i kryesuar nga anëtari i KK-së, z.Rrahim Morina, paraqiti punën e komisionit dhe listën me emrat e kryetarëve të rinj të fshatrave, raport dhe listë e cila u miratua nga ana e KK-së.

Pas kësaj, me kërkesën e anëtarëve të KK-së, u mor vendim që të ridizajnohet salla e Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të krijohet kushte më të mira për punën e kuvendit.

Në fund, KK, mori disa vendime, që kanë të bëjnë me komitetin për arsim, kulturë, rini dhe sport, siç është përbërje e re e këtij komiteti, që do të ketë pesë anëtar, pastaj u mor vendim për funksionalizimin e një komisioni të këtij komiteti, si dhe u miratua edhe kërkesa e këtij komiteti, që trupat e kuvendit, ti mbajnë takimet nga ora 14:00, për shkak se disa nga anëtarët e këtyre trupave, janë mësimdhënës dhe mbajtja e mbledhjeve, në orët më të hershme, po ndikon në procesin mësimor.

Komiteti për Diasporë mbajti mbledhjen e fundit për këtë vit

Malishevë, 30 dhjetor

Komiteti për diasporë, i drejtuar nga kryetari i saj z.Besnik Hoti, ka mbajtur sot mbledhjen e katërt të rregullt dhe në të njëjtën kohë të fundit për këtë vit, duke bërë përmbylljen e vitit 2014. Komiteti për diasporë ka përshëndetur funksionalizimin e një zyre për bashkatdhetarët e cila është miratuar nga Kuvendi Komunal .

Kryesuesi i Komitetit për Diasporë, z.Besnik Hoti në takimin përmbyllës të vitit 2014 tha se “si komitet jemi angazhuar dhe jemi munduar të bëjmë një punë të mirë, brenda mundësive dhe kapaciteteve tonave jemi mundu që pak a shumë të merremi me çështjet dhe problematikat e bashkatdhetarëve tanë, sidomos tash sa janë këtu”. “Gjatë këtij viti ne kemi diskutuar dhe jemi mundu që të japim ide të nxjerrim konkluzione për çështje të ndryshme të bashkatdhetarëve, si për hapjen e një zyre, organizimi i një takimi me ta, diskutimi rreth njoftimit të veprimeve, aktiviteteve të punës së tyre në botën e jashtme dhe të tjera” tha Hoti.

Angazhimi i komitetit për Diasporë për vitin e ardhshëm do të jetë edhe më i madh dhe do të jenë shumë më aktiv, në mënyrë që edhe ti realizojnë synimet dhe obligimet e komitetit.

Gëzim Elshani, sportisti i vitit në Malishevë, me 13 medalje ari

Malishevë, 30 dhjetor



Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të aktiviteteve tradicionale, për shpalljen e më të mirëve të vitit, sot ka shpallur më të mirët e vitit 2014 në fushat e sportit, rinisë, leximit, nxënësve më të mirë, si dhe ka ndarë mirënjohje edhe për bashkatdhetarët, që kanë dhënë kontribut në këto fusha. Sportisti i vitit u shpall Gëzim Elshani.

Nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, duke marrë fjalën e rastit, përmbylljen e 2014-ës, e cilësoi si “një përmbyllje e një viti të suksesshëm në të gjitha fushat dhe për të gjitha klubet e kulturës dhe sportit”. “Po ashtu shfrytëzoj rastin ti falënderoj të gjithë ata aktivistë që kanë dhënë kontribut në kulturë dhe sport, ndër vite, duke e mbajtur gjallë sportin dhe kulturën edhe në kohët e vështira”, tha Mazreku. “Malisheva ka talent të shumtë, por duhet që të punohet sistematikisht në ngritjen e këtyre talenteve”, tha në fund nënkryetari Mazreku, duke ju bërë thirrje arsimtarëve, që të punojnë edhe më shumë me këta fëmijë talent.

Ndërsa drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i ka përshëndetur dhe i ka falënderuar të gjithë “ata që kanë dhënë kontribut në kulturën dhe sportin në Komunën e Malishevës dhe të gjithë ata që me dinjtet e përfaqësojnë Malishevën dhe Kosovën në arenën ndërkombëtare”. Po ashtu drejtoresha Krasniqi, i ka falënderuar edhe bashkatdhetarët tanë që kanë dhënë kontribut në të gjitha fushat.



Më pas janë ndër mirënjohje për bashkatdhetarët tanë që kanë kontribuar në ngritjen e një kabineti të informatikës në një nga shkollat e Malishevës, pastaj për mësuesit e dalluar, nxënësit e dalluar të viti, sikur edhe lexuesit më të mirë dhe aktivistët e rinisë.

Pas këtyre, janë shpallur edhe sportistët e vitit në të gjitha llojet e sporteve, të zhvillohen në Komunën e Malishevës, dhe në fund, janë shpallur më të mirët e vitit, ku sportist i viti është shpallur Gëzim Elshani, anëtar i kubit të notit “Besa”, i cili i ka fituar 13 medalje të arit, klubi më i mirë është shpallur klubi i notit “Besa” nga Banja dhe trajner i viti, trajneri i kubit “Besa”, Adrian Telaku.

Një mirënjohje e veçantë, është ndarë edhe për kikkoksierin Dardan Morina, kampion i botës në kikkoks, i cili është Drenovci i Malishevës, por garon për shtetin gjerman.



Në vazhdim disa të dhëna rreth investimeve kapitale të Komunës gjatë vitit 2014

Asfaltimi i rrugës në Vërmicë, Lagja Ukajve,	101,229.00 €
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Tërpezë	73,545.00 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Tërpezë të Ulët	127,300.50 €
Asfaltimi i rrugës në Kërvasari (Kodrali)	71,481.00 €
Asfaltimi i rrugës në Lladroviq (Kirellt)	92,787.50 €
Asfaltimi i rrugës në Ploqicë e ulët	60,601.00 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Marali (lagja Hoxhaj)	17,313.00 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Guncat	89,658.31 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Turjakë-Lagja e Kajtazëve	42,253.20 €
Asfaltimi i rrugës në Fshatin e Ri	71,787.35 €

Asfaltimi i rrugës në fshatin Bellanicë	37,687.50 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Llapqevë	47,901.10 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Turjakë-Lagja e Berishëve	5,906.63 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Gurbardh	22,979.50 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Gullubove	24,192.00 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Shkozë	42,352.00 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Janqist	25,299.10 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Balincë (lagja Kelmendëve)	37,705.00 €
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bubël	68,425.00 €
Asfaltimi i rrugës në fshatin Burim(lagja Baiq)	61,460.00 €

Asfaltimi i rrugës në fshatin Kijevë	14,405.00 €	
Asfaltimi i rrugës në fshatin Astrazup	33,534.00 €	
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shkarashnik	121,512.00 €	
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mleqan	110,565.00 €	
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Drenovë (lagjet Kapllan -Mzez)	53,390.00 €	
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Berishë	61,015.50 €	
Vërmicë(xhamia)	49,764.00 €	
Asfaltimi i oborrit të zjarrfikësve dhe shpëtimimit	13,438.90 €	
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bubavec	14,139.00 €	
Gjithsejtë:	31577 m	1,593,627.09 €

Gjatë këtij vitit, kanë vazhduar investimet në ndërtimin e institucioneve shkollore. Këtu bëhet fjalë për tetë institucione shkollore, shtatë shkolla dhe çerdhja e fëmijëve. Ndërtimi i dy shkollave është trashëguar nga vitet paraprake, ndërsa këtë vit, kemi filluar me ndërtimin e pesë shkollave të reja dhe çerdhes. Këto projekte janë një dhe dy vjeçare.

Investimi në total në ndërtimin e shkollave, kapë një shumë prej 3 milion, e 116 mijë, e 739.7 € (3 116 739.7 €), shumica nga buxheti i komunës dhe një pjesë nga donacionet, siç është shkolla në Damanek, e cila është investim i Unionit Evropian.

Ndërtimi i shkollës në fshatin Goriq	288888.88 €
Ndërtimi i shkollës në fshatin Gullubove	298779.67 €
Ndërtimi i shkollës në fshatin Carrallukë-“Imer Krasniqi”	331543.98 €
Ndërtimi i shkollës në Bubavec	288038.69 €
Ndërtimi i shkollës në Damanek	1100000 €
Ndërtimi i shkollës në Vërmicë	324538.76 €
Ndërtimi i shkollës në Shkozë	355555.55 €
Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Malishevë	129394.17 €
Gjithsejtë:	3116739.7 €

Po ashtu gjatë këtij viti janë renovuar 22 shkolla të mesme dhe fillore.

Renovimet në shkolla

Renovimet në 22 shkolla fillore dhe të mesme
37983.83 euro
Gjithsejtë: 37983.83 euro

Këtë vit, kemi investuar edhe në hapësirat sportive të shkollave, duke ndërtuar fushën e sportit në shkollën e Panorit dhe jemi në përfundim të ndërtimit të fushës sportive në Temeqinë, e të cilat kushtuan 61 698.8 €.



Po ashtu, gjatë këtij viti janë riparuar edhe 13 objekte shëndetësore

Renovimet ne punktet shëndetësore të fshatrave dhe QKMF- 13 objekte	34817.25
Gjithsejtë;	34817.25 €

Renovime tjera janë: zgjerimi i urës në qytetin e Malishevës 74344.18 €
Renovimi i objektit të ish gjykatës: 28150.01 €
Rregullimi i platosë së oborrit te tregu i vjetër: 43571.00 €
Rregullimi i ngrohjeve në shkolla: 9950.00 €

Investimet nuk kanë munguar as në rrjetet e ujësjellësve, e investimi kryesor, është në ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Drenovc, investim i cili kap një shumë prej **321 459.19 €**. Po ashtu, Komuna ka investuar edhe në kërkim të ujit për pije, duke bërë shpime, siç është në Pagarushë, shpim i cili i ka kushtuar buxhetit komunës, rreth 13 mijë euro (13 000 €).
Po ashtu, kemi filluar me ndërtimin e akumulacionit në fshatin Panore, e që buxhetit të komunës, do të kushton **348 918.90 €**.



Krahas këtyre, po vazhdojnë investimet edhe në ndërtimin ujëmbledhësit në fshatin Senik, prej ku parashihen të furnizohen me ujë rreth 12 fshatra të Komunës së Malishevës.

Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së kanalizimeve, gjatë këtij viti, janë ndërtuar rrjete të reja të kanalizimit, apo rirregullime të rrjetit ekzistues, në gjatësi totale prej afro 37 kilometrave, e të cilat kapin një shumë të përgjithshme prej **484,066.23 €**.

Kësaj shume dhe këtyre projekteve, i shtohen edhe projektet e tjera, duke filluar me fushatën e spërkatjes kundër etheve hemorragjike “krime kongo”, fushatë e cila i ka kushtuar buxhetit komunal, hiq më pak se 200 mijë euro (200 000 €).

Pastaj, një investim tjetër i Komunës, e që ka qenë edhe prioritet i kryetarit Begaj, është pastrimi i ambientit, ku komuna ka ndarë një buxhet prej 9 856 €, për largimin e deponive ilegale të mbeturinave.

Komuna ka ndihmuar mjaft edhe në meremetimin e apo në ndërtimin e shtëpive të personave të pastrehë, siç është një familje në Lladrovë, e cila është ndihmuar me 8 185 €.

Ndërsa, një ndihmë të madhe komuna, ju ka dhënë edhe familjeve të cilat jetojnë në kushte të rënda sociale, ku komuna i ka ndihmuar këto kategori në një shumë prej rreth 50 mijë euro.

Pamje nga fushata e spërkatjes masive nga ajri-kundër rriqrave (200 mijë euro), si dhe spërkatja selektive nga toka dhe dezinfektimi i shtallave




Pamje nga ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve nëpër vendbanime



Shrimi i rrjetit të ujësjellësit në Drenovc



Fillimi i ndërtimit të ujëmbledhësit në Panorc



Shpimet në kërkim të ujit për ndërtimin e ujësjellësit për Pagarushë- 12 996 euro



Asfaltimi i rrugës në Vërmicë, lagja Ukajve, rruga deri te shkolla e re
101,229.00 € dhe rruga deri te xhamia - 49,764.00 €



Asfaltimi i rrugës në fshatin Shkozë - 42,352.00 €



Asfaltimi i rrugës në fshatin Janqist - 25,299.10 €



Asfaltimi i rrugës në fshatin Balincë (lagja Kelmendëve) - 37,705.00 €




Asfaltimi i rrugës në fshatin Tërpezë e Ulët - 127,300.50 €



Rregullimi – hapja e rrugës në Kërvasari (Kodralli) - 71,481.00 €



Asfaltimi i rrugës në Lladroviq (Kirellt) - 92,787.50 €




Asfaltimi i rrugës në Plloqicë e ulët - 60,601.00 €



Asfaltimi i rrugës në fshatin Guncat - 89,658.31 €



Asfaltimi i rrugës në fshatin Turjakë-Lagja e Kajtazëve - 42,253.20 €
dhe lagja e Berishëve - 5,906.63 €



Asfaltimi i rrugës në Fshatin e Ri - 71,787.35 €



Asfaltimi i rrugës në fshatin Bellanicë - 37,687.50 €



Asfaltimi i rrugës në fshatin Llapqevë - 47,901.10 €



Asfaltimi i rrugës në fshatin Gurbardh - 22,979.50 €



Asfaltimi i rrugës në fshatin Gullubovc - 4,192.00 €



Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bubël - 68,425.00 €



Asfaltimi i rrugës në fshatin Kijevë - 14,405.00 €




Asfaltimi i rrugës në fshatin Astrazup - 33,534.00 €





Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shkarashnik-Carrallukë - 121,512.00 €



Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mleqan - 110,565.00 €



Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bubavec - 14,139.00 €



Asfaltimi i oborrit të zjarrfikësve dhe shpëtimit - 13,438.90 €





Rregullimi i hapësirës te tregu në Malishevë – 43 571 euro



Prioritet me rëndësi për këtë vit ka qenë edhe pastrimi i ambientit



Investimet në bujqësi- janë ndihmuar bujqit dhe fermerët, me subvencione të ndryshme, si në subvencionimin e qumështit, makina mjelëse, ndërtimin e serrave, në bletari, dhe në fusha tjera të bujqësisë dhe blegtonisë. Shuma e kësaj përkrahje, është rreth 22 mijë euro, ndërsa në këtë vit, do të ndihmojmë blegorët në rritjen e numrit të lopëve, me rreth 80 mijë euro.



Përkrahje për fermerët







Ndërtimi i shkollës në Vërmicë - 324538.76 E



Ndërtimi i shkollës në Shkozë - 355555.55 E



Ndërtimi i shkollës në Damanek – 1100000 E



Shkolla në Carrallukë – në ndërtim e sipër



Fillimi i ndërtimit të shkollës në Gurishtë



Ndërtimi i shkollës në fshatin Gullubovc - 298779.67 €



Çerdhja për fëmijë- në përfundim e sipër



Fusha e sportit në shkollën e Panorcit





Ndërtimi i shkollës në fshatin Gurishtë -288888.88
Ndërtimi i shkollës në fshatin Gullubovc -298779.67
Ndërtimi i shkollës në fshatin Carrallukë-“Imer Krasniqi” - 331543.98
Ndërtimi i shkollës në Bubavec - 288038.69
Ndërtimi i shkollës në Damanek -1100000
Ndërtimi i shkollës në Vermicë - 324538.76
Ndërtimi i shkollës në Shkozë - 355555.55
Ndërtimi i çerdhës së fëmijëve në Malishevë -129394.17
Gjithsejtë; 3116739.7 euro

Po ashtu gjatë këtij viti janë rinovuar 22 shkolla të mesme dhe fillore.
Renovimet në 22 shkolla fillore dhe të mesme - 37983.83 euro
Gjithsejtë; 37983.83 euro

Këtë vit, kemi investuar edhe në hapësirat sportive të shkollave, duke ndërtuar fushën e sportit në shkollën e Panorçit dhe jemi në përfundim të ndërtimit të fushës sportive në Temeqinë, e të cilat kushtuan 61 698.8 €.



Përkrahje në rindërtimin e shtëpive, me rreth 60 mijë euro



Renovime të punkteve shëndetësore - 34817.25



Renovimi i QMF në Bellaninë



Pamje nga ambientet e brendshme të renovimeve në punktet shëndetësore





Renovimi i objektit të ish gjykatës: 28150.01 €



Rregullimi i oborrit të muzeut – 1680 E



Gjatë këtij viti nuk kanë munguar aktivitetet kulturore, ndërsa aktiviteti më me rëndësi, është festivali “Oda e Llapushës”



Gjatë këtij viti, kryetari i Komunës, z. Ragip Begaj, ka zhvilluar takime në shumicën e vendbanimeve të Malishevës dhe me të gjitha kategoritë e shoqërisë



Vetëm në muajt e parë të vitit, Kryetari ka zhvilluar 33 takime me banorët e fshatrave, ndërsa çdo të premte, i ka pritur qytetarët në zyrën e tij



Gjatë muajit nëntor, kryetari Begaj i ka vizituar shumicën e shkollave



Po ashtu, kryetari Begaj, i ka përkrahur të rinjtë edhe në lokalitetet më të largëta, për zhvillimin e aktiviteteve të lira



Zgjerimi i urës në qytetin e Malishevës 74344.18 €






Buxheti i Planifikuar dhe aktual-Shpenzimi i buxhetit për vitin 2014

Kategoria Ekonomike	Buxheti i fillestar 2014	Buxheti final 2014	Realizimi	% e Realizimit	
Pagat	6,215,277.00	7,219,405.77	7,219,323.01	100.00%	
Mallrat dhe Sherbimet	867,591.00	867,702.42	749,285.90	87.00%	15% janë tërhequr nga MF për paga
Sherbimet Komunale	305,000.00	305,000.00	259,194.77	85.00%	nga M+SH dhe Komunal, andaj 100% janë shpenzuar këto
Subvencionet dhe Transferet	60,000.00	60,000.00	59,955.00	99.93%	Kategori ekonomike
Shpenzimet Kapitale	4,166,755.00	4,323,138.01	4,198,426.78	97.12%	
Totali:	11,614,623.00	12,775,246.20	12,486,185.46	97.74%	

Buxheti i Planifikuar dhe ai aktual dalton për shkak të të gjitha të hyrave të bartura dhe mjetet e Çerdhës së Fëmijëve.

Te hyrat vetanake 2014		
Të planifikuara	Të realizuara	% e realizimit
787,500.00	869,304.19	110%

Paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të buxhetit komunal në vitin 2014





Përgatitur nga Zyra për Informim Publik- Malishevë

Pranverë Kastrati-Shefe e Zyrës për Informim
Artan Paçarizi- Zyrtar për Informim

E-mail:

kmalisheve@gmail.com & komuna.malisheve@rks-gov.net

Tel:

029 269 043

<http://kk.rks-gov.net/malisheve/>